

BIBLËN MUND TA KUPTOSH DHE TI!

**VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM
I DHATËS SË RE**

MATEU - ZBULESA

BOB UTLEY
PROFESOR I HERMENEUTIKËS
(INTERPRETIMIT BIBLIK)

PËRKTHEU: FLORENC MENE

BIBLE LESSONS INTERNATIONAL, MARSHALL, TEKSAS

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I DHIATËS SË VJETËR ZANAFILLA-MALAKIA

DR. BOB UTLEY
Bible Lessons International

PËRMBAJTJE

Udhëzues për leximin e mirë biblik	1
Mësim hyrës	7
Hyrje për Mateun	9
Hyrje për Markun	14
Hyrje për Lukën	20
Hyrje për Gjonin	27
Hyrje për Veprat	35
Hyrje për Romakët	44
Hyrje për 1 Korintasit	49
Hyrje për 2 Korintasit	56
Hyrje për Galatasit	62
Hyrje për Efesianët	67
Hyrje për Filipianët	76
Hyrje për Kolosianët	82
Hyrje për letrat e Thesalonikasve	90
Hyrje për letrat pastorale: I dhe II Timoteut dhe Titit	99
Hyrje për Titin	107
Hyrje për Filemonin	109
Hyrje për Hebrenjtë	112
Hyrje për Jakobin	118
Hyrje për I Pjetrin	123
Pjetri si Person	127
Hyrje për II Pjetrin	131
Hyrje për I Gjonin	136
Hyrje për II dhe III Gjonin	142
Hyrje për Judën	144
Hyrje për profecinë e DHV	149
Artikull hyrës kyç – Zbulesa	153
Hyrje për Zbulesën	158
Shtojca 1	170
Shtojca 2	179
Shtojca 3	183

UDHËZUES PËR LEXIMIN E MIRË BIBLIK: KËRKIM PERSONAL PËR TË VËRTETËN E VERIFIKUESHME

A mund ta njohim të vërtetën? Ku gjendet? E verifikojmë dot logjikisht? A ekziston autoriteti absolut? A ka vlera absolute që mund të na udhëheqin jetën dhe botën tonë? A ka kuptim jeta? Pse jemi këtu? Ku po shkojmë? Këto pyetje (pyetje që përsiasin të gjithë njerëzit e logjikshëm) e kanë përndjekur mendjen njerëzore që nga agji i kohës (Pred. 1:13-18; 3:9-11). Më kujtohet kërkimi im vetjak për një qendër integruese në jetën time. Unë u bëra besimtar në Krishtin në moshë të re, kryesisht në bazë të dëshmisë së disa personave të rëndësishëm në familjen time. Me rritjen drejt pjekurisë, m'u rritën edhe pyetjet për veten dhe botën time. Klishetë e thjeshta kulturore dhe fetare nuk u jepnin kuptim përjetimeve për të cilat lexoja dhe me të cilat ndeshesha. Ishte një kohë pësjtjellimi, kërkimi, përmallimi dhe, shpesh, e një mungese shprese përballë botës së pandjeshme dhe të ashpër ku jetoja.

Shumë pretendonin se kishin përgjigje për këto pyetje absolute, por, pas hulumtimeve dhe përsiatjeve, vëreja se përgjigjet e tyre bazoheshin në (1) filozofi personale, (2) mite të lashta, (3) përjetime personale, ose (4) projeksione psikologjike. Kisha nevojë për njëfarë mase verifikimi, njëfarëlloj prove, një logjikë mbi të cilën të bazoja botëkuptimin tim, qendrën time integruese, arsyen për të jetuar.

Këto i gjeta në studimin e Biblës. Fillova të shqyrtoja për prova për vërtetësinë e saj, të cilat i gjeta në (1) besueshmërinë historike të Biblës, e vërtetuar nga arkeologjia, (2) saktësinë e profecive të Dhiatës së Vjetër, (3) unitetin e mesazhit të Biblës gjatë një mijë e gjashtëqind viteve të prodhimit të saj, dhe (4) dëshmitë personale të njerëzve të cilëve iu ndryshoi jeta një herë e përgjithmonë nga kontakti me Biblën. Krishterimi, si sistem i unifikuar besimi dhe bindjesh, ka aftësinë që të trajtojë pyetjet e koklavitura të jetës njerëzore. Kjo jo vetëm që më siguroi një kornizë logjike, por aspekti përjetues i besimit biblik më solli edhe gëzim e qëndrueshmëri emocionale.

Mendova se e gjeta qendrën integruese për jetën time: Krishtin, siç kuptohet përmes Shkrimeve. Ishte një përjetim ngazëllues, një çlirim emocional. Megjithatë, ende më kujtohet tronditja dhe dhimbja që pata kur fillova të kuptoja se sa shumë interpretime të ndryshme të këtij libri propagandoheshin, nganjëherë edhe brenda të njëjtave kisha dhe shkolla mendimi. Pohimi i frymëzimit dhe vërtetësisë së Biblës nuk ishte fundi, por vetëm fillimi. Si t'i vërtetoj ose mohoj interpretimet e larmishme dhe të kundërta të pasazheve të shumta e të vështira në Bibël, që ofroheshin nga ata që besonin në autoritetin dhe vërtetësinë e saj?

Kjo detyrë u bë synimi i jetës sime dhe shtegtimi i besimit tim. E dija se besimi në Krishtin (1) më kishte sjellë paqe dhe gëzim të madh. Mendja ime kërkonte me ngulm disa vlera absolute në mes të relativitetit të kulturës sime (postmodernizmit); (2) dogmatizmi i sistemeve të kundërta fetare (feve botërore); dhe (3) arroganca denominacionale. Në kërkimin tim për qasje të vlefshme për interpretimin e literaturës së lashtë, u habita kur zbulova dhe vetë anësitë e mia historike, kulturore, denominacionale dhe përjetuese. Shpesh, Biblën e kisha lexuar për të përforcuar pikëpamjet e mia. E përdorja si burim dogme për të sulmuar të tjerët dhe për të ripërkrahur vetë pasiguritë dhe mangësitë e mia. Sa të dhimbshëm e pata këtë ndërgjegjësim!

Ndonëse nuk mund të jem kurrë plotësisht objektiv, mund të bëhem lexues më i mirë i Biblës. Mund t'i kufizoj anësitë e mia duke i identifikuar dhe duke pranuar praninë e tyre. Ende nuk jam i çliruar prej tyre, por jam përballur me dobësitë e mia. Shpesh, interpretuesi është armiku më i keq i leximit të mirë biblik!

Më lejo të rendis disa nga presupozimet që sjell në studimin tim të Biblës në mënyrë që ti, si lexues, t'i shqyrtosh bashkë me mua:

- (1) Unë besoj se Bibla është e vetmja vetëzbulesë e frymëzuar e të vetmit Perëndi të vërtetë. Si rrjedhojë, duhet interpretuar në dritën e synimit të autorit fillestar hyjnor (Frymës) përmes shkrimtarit njerëzor në një sfond të veçantë historik.
- (2) Unë besoj se Bibla është shkruar për njeriun e zakonshëm – për të gjithë njerëzit! Perëndia na u përshtat për të na folur qartazi brenda një konteksti historik dhe kulturor. Perëndia nuk e fsheh të vërtetën – ai dëshiron të kuptojmë! Si rrjedhojë, Bibla duhet interpretuar në dritën e kohës së vet, jo sonës. Për ne, Bibla nuk duhet të ketë kurrë një kuptim të ndryshëm nga ajo që kuptuan ata që e lexuan dhe dëgjuan për herë të parë. Ajo është e kuptueshme nga mendja e zakonshme njerëzore dhe përdor forma e teknika normale të komunikimit njerëzor.
- (3) Unë besoj se Bibla ka një mesazh dhe synim të unifikuar. Ajo nuk bie në kundërshti me veten, ndonëse vërtet përmban pasazhe të vështira dhe paradoksale. Kështu, interpretuesi më i mirë i Biblës është vetë Bibla.

- (4) Unë besoj se çdo pasazh (përjashtoj profecitë) ka vetëm një kuptim, i bazuar në synimin e autorit të frymëzuar fillestar. Ndonëse s'mund të jemi kurrë absolutisht të sigurt se e njohim synimin e autorit fillestar, shumë tregues na dëftojnë në drejtimin e tij:
- Gjinia (lloji letrar) e zgjedhur për të shprehur mesazhin
 - Sfondi historik dhe/ose shkasi i veçantë që solli në ekzistencë shkrimin
 - Konteksti letrar i gjithë librit, si dhe i çdo njësie letrare
 - Modeli (përvijimi) tekstual i njësisë letrare në mënyrën si lidhen me gjithë mesazhin
 - Tiparet e veçanta gramatikore që janë përdorur për të komunikuar mesazhin
 - Fjalët e zgjedhura për të paraqitur mesazhin

Studimi i secilës prej këtyre zonave bëhet objekti i studimit tonë të pasazhit. Përpara se të shpjegoj metodologjinë time për leximin e mirë të Biblës, më lejon të përvijoj disa nga metodat e papërshtatshme që po përdoren sot, të cilat kanë shkaktuar kaq shumë larmi interpretimesh dhe që, si rrjedhojë, duhen shmangur:

- Anashkalimi i kontekstit letrar të librave të Biblës dhe përdorimi i çdo periudhe, fjalie, madje dhe fjalësh të veçanta si pohime të së vërtetës pa lidhje me synimin e autorit ose kontekstin më të gjerë. Shpesh, ky quhet “përdorim i teksteve si provë”.
- Anashkalimi i sfondit historik të librave duke e zëvendësuar me një sfond të hamendësuar historik që ka pak ose aspak mbështetje nga vetë teksti.
- Anashkalimi i sfondit historik të librave dhe leximi i tyre si gazetën lokale të mëngjesit, të shkruar kryesisht për të krishterët e sotëm si individë.
- Anashkalimi i sfondit historik të librave duke alegorizuar tekstin në një mesazh teologjiko-filozofik tërësisht pa lidhje me dëgjuesit e parë apo me synimin e autorit fillestar.
- Anashkalimi i mesazhit fillestar duke e zëvendësuar me sistemin tonë të teologjisë, ndonjë doktrinë që e kemi për zemër, apo me ndonjë çështje bashkëkohore pa lidhje me synimin dhe mesazhin e shprehur të autorit fillestar. Shpesh, ky fenomen vijon pas leximit fillestar të Biblës si mënyrë për të mbështetur autoritetin e folësit. Rëndom, ky quhet “reagim i lexuesit” (interpretim i llojit “çfarë më thotë teksti mua?”). Në çdo komunikim njerëzor me shkrim mund të gjenden tre përbërës të lidhur me njëri-tjetrin:



Në të shkuarën, teknikat e ndryshme të leximit janë fokusuar në njërin nga këta tre përbërës. Por, për të pohuar vërtet frymëzimin unik të Biblës, do të ishte më i përshtatshëm një diagram i ndryshuar:



Në të vërtetë, në procesin interpretues duhen përfshirë të tre këta përbërës. Për qëllime vërtetimi, interpretimi im fokusohet në dy përbërësit e parë: autori fillestar dhe teksti. Ndoshta, po reagoj ndaj keqpërdorimeve që kam përmendur: (1) alegorizimi ose shpirtërizimi i teksteve dhe (2) interpretimi i “reagimit të lexuesit” (ç’kuptim ka teksti për mua). Keqpërdorimi mund të ndodhë në secilën fazë. Duhet t’i kontrollojmë gjithmonë motivet, anësitë, teknikat dhe zbatimet tona. Por si t’i kontrollojmë nëse nuk ka asnjë kufi, cak, apo

kritere për interpretimet? Pikërisht këtu, synimi autorial dhe struktura e tekstit më sigurojnë disa kritere për t'ua kufizuar gamën interpretimeve të vlefshme të mundshme.

Në dritën e këtyre teknikave të përshtatshme leximore, cilat janë disa qasje të mundshme për leximin dhe interpretimin e mirë të Biblës, të cilat na ofrojnë një shkallë vërtetimi dhe konsistence?

Në këtë pikë, nuk po diskutoj për teknikat unike të interpretimit të gjinive të veçanta, por për parimet e përgjithshme hermeneutike që janë të vlefshme për të gjitha llojet e teksteve biblike. Një libër i mirë për qasjet sipas gjinive të ndryshme është *How To Read the Bible For All Its Worth (Si ta lexosh Biblën për gjithë vlerën që ka)*, nga Gordon Fee dhe Douglas Stuart, botuar nga Zondervan.

Metodologjia ime fokusohet fillimisht te fakti se lexuesi duhet t'i lejojë Frymës së Shenjtë që të hedhë dritë mbi Biblën përmes katër ciklesh personale leximi. Kjo i jep Frymës, tekstit dhe lexuesit vend parësor, jo dytësor. Po kështu, kjo e mbron lexuesin që të mos ndikohet në mënyrë të panevojshme nga komentuesit. Kam dëgjuar se dikush ka thënë: "Bibla hedh shumë dritë mbi komentaret". Ky nuk synohet si koment zhvlerësues për ndihmat studimore, por si thirrje për përdorimin e tyre në kohën e duhur.

Duhet të jemi në gjendje që interpretimet t'i mbështesim me vetë tekstin. Gjashtë zona sigurojnë të paktën një vërtetim të kufizuar:

- (1) Sfondi historik
- (2) Konteksti letrar
- (3) Strukturat gramatikore (sintaksa)
- (4) Përdorimi i fjalëve në kohën kur u shkruan
- (5) Pasazhet e përshtatshme paralele

Duhet të jemi në gjendje të japim arsyet dhe logjikën e interpretimeve tona. Bibla është burimi ynë i vetëm për besimin dhe praktikën. Mjerisht, shpesh, të krishterët nuk bien dakord për ato që mëson ose pohon ajo. Është vetëkundërshtuese që ne besimtarët të pohojmë frymëzimin e Biblës dhe, pastaj, të mos jemi në gjendje të biem dakord se çfarë na mëson dhe kërkon ajo!

Katër ciklet e leximit synojnë të na sigurojnë të dhënat interpretuese të mëposhtme:

- (1) Cikli i parë i leximit
 - (a) Lexo gjithë librin njëherësh. Lexoje sërish me një përkthim tjetër, ndoshta me një teori të ndryshme përkthimi
 - i. fjalë për fjalë (NKJV, NASB, NRSV)
 - ii. ekuivalencë dinamike (TEV, JB)
 - iii. parafrazim (Living Bible, Amplified Bible)
 - (b) Kërko qëllimin qendror të gjithë shkrimit. Identifiko idenë e tij kryesore.
 - (c) Izolo (nëse është e mundur) një njësi letrare, kapitull, paragraf, apo fjali që shpreh qartë qëllimin ose idenë e tij qendrore.
 - (d) Identifiko gjininë mbizotëruese letrare
 - i. Dhiata e Vjetër
 - 1) Narrativa hebraike
 - 2) Poezia hebraike (letërsi urtësie, psalm)
 - 3) Profecia hebraike (prozë, poezi)
 - 4) Kodet e ligjit
 - ii. Dhiata e Re
 - 1) Narrativa (ungjijtë, Veprat)
 - 2) Shëmbëlltyra (ungjijtë)
 - 3) Letra
- (2) Cikli i dytë i leximit
 - (a) Lexo sërish gjithë librin, duke u përpjekur të identifikosh temat ose subjektet kryesore.
 - (b) Përvijoj temat madhore dhe shpreh shkurtimisht përmbajtjen e tyre me një pohim të thjeshtë.
 - (c) Kontrolllo pohimin e synimit dhe përvijimin tënd të përgjithshëm me anë të ndihmave studimore.
- (3) Cikli i tretë i leximit
 - (a) Lexo sërish gjithë librin, duke u përpjekur të identifikosh sfondin historik dhe shkasit e veçantë për shkrimin e tij, duke u bazuar në të dhënat e vetë këtij libri biblik.
 - (b) Rendit elementet historike që përmenden në librin biblik
 - i. Autori

- ii. Data
- iii. Marrësit
- iv. Arsyeja e veçantë për shkrimin e tij
- v. Aspekte të sfondit kulturor që lidhen me qëllimin e shkrimit
- (c) Zgjerohet përvijimin tënd në nivel paragrafi për atë pjesë të librit biblik që po interpreton. Gjithmonë identifikoj dhe përvijoj njësinë letrare. Kjo mund të përbëhet nga një sërë kapitujsh ose paragrafesh. Kjo gjë të mundëson të ndjekësh logjikën dhe modelin tekstual të autorit fillestar.
- (d) Kontrollon sfondin historik duke përdorur ndihma studimore.
- (4) Cikli i katërt i leximit
 - (a) Lexo sërish njësinë e veçantë letrare në disa përkthime
 - (b) Gjej strukturat letrare ose gramatikore
 - i. Frazë të përsëritura
 - ii. Struktura të përsëritura gramatikore
 - iii. Koncepte të kundërta
 - (c) Rendit elementet e mëposhtme
 - i. Terma të rëndësishëm
 - ii. Terma të pazakontë
 - iii. Struktura të rëndësishme gramatikore
 - iv. Fjalë, fjali dhe periudha tejet të vështira
 - (d) Gjej pasazhet e duhura paralele
 - i. Gjej pasazhin më të qartë mësimor për temën tënde duke përdorur
 - a) Libra “të teologjisë sistematike”
 - b) Bibla me referenca
 - c) Përkues biblikë
 - ii. Gjej një çift të mundshëm paradoksal brenda temës tënde. Shumë të vërteta biblike paraqiten në çifte dialektike; shumë konflikte denominacionale vijnë nga mbështetja e njëanshme të gjysmave të një tensioni biblik. Gjithë Bibla është e frymëzuar, ndaj duhet të përipiqemi të gjejmë mesazhin e saj të plotë në mënyrë që t’i sigurojmë një drejtpeshim biblik interpretimit tonë.
 - iii. Kërko për paralele brenda të njëjtit libër, të njëjtit autor, ose të njëjtës gjini letrare; Bibla është interpretuesja më e mirë e vetes, pasi ajo ka një autor të vetëm, Frymën.
 - (e) Përdor ndihmat studimore për të kontrolluar vëzhgimet e tua për sfondin dhe shkasit historik
 - i. Bibla studimore
 - ii. Enciklopedi, manualë dhe fjalorë biblikë
 - iii. Hyrje biblike
 - iv. Komentare biblike (në këtë pikë në studimin tënd, lejo komunitetin besimtar, të kaluar dhe të tashëm, që të të ndihmojë në studimin tënd personal dhe të ta korrigjojë).

Në këtë pikë, i kthehemi zbatimit. Ke kaluar kohë për të kuptuar tekstin në sfondin e vet fillestar; tani, duhet ta zbatosh në jetën dhe kulturën tënde. Unë e përcaktoj autoritetin biblik si “të kuptuarit e asaj që po i thoshte autori fillestar biblik kohës së vet dhe zbatimin e asaj të vërtete në kohën tonë”.

Zbatimi duhet të ndjekë interpretimin e synimit të autorit fillestar si nga ana kohore, ashtu dhe ajo logjike. Nuk mund ta zbatojmë pasazhin biblik në kohën tonë pa kuptuar se çfarë po thoshte ai në kohën e vet! Pasazhi biblik nuk duhet të ketë një kuptim që nuk e pati kurrë vetë!

Si udhërrëfyes do të kesh përvijimin tënd të detajuar në nivelin e paragrafit (cikli i tretë i leximit). Zbatimi duhet bërë në nivelin e paragrafit, jo fjalës. Fjalët kanë kuptim vetëm në kontekst; fjalitë kanë kuptim vetëm në kontekst; periudhat kanë kuptim vetëm në kontekst. I vetmi person i frymëzuar, që është i përfshirë në procesin interpretues, është autori fillestar. Ne ndjekim vetëm udhëheqjen e tij me anë të përndritjes së Frymës së Shenjtë. Por përndritja nuk është frymëzim. Për të thënë, “kështu thotë Zoti”, duhet t’i qëndrojmë besnikë synimit të autorit fillestar. Zbatimi duhet të ketë lidhje të veçantë me synimin e përgjithshëm të gjithë shkrimit, me njësinë e veçantë letrare dhe me zhvillimin e mendimit në nivelin e paragrafit.

Mos lejo që problemikat e kohës sonë të interpretojnë Biblën; lër Biblën të flasë vetë! Kjo mund të na kërkojë që t'i nxjerrim parimet nga teksti. Kjo është e vlefshme nëse teksti mbështet një parim të caktuar. Fatkeqësisht, shumë herë, parimet tona janë thjesht të tilla, parime “tonat” – jo parime të tekstit.

Në zbatimin e Biblës, është e rëndësishme të kujtojmë se (përveçse në rastin e profecisë) vetëm një kuptim i vetëm është i vlefshëm për një tekst të caktuar biblik. Ai kuptim lidhet me synimin e autorit fillestar teksa trajtonte një krizë apo nevojës të kohës. Nga ky kuptim i vetëm mund të nxirren shumë zbatime të mundshme. Zbatimi do të bazohet në nevojat e marrësve, por duhet të ketë lidhje me kuptimin e autorit fillestar.

Deri tani, kam diskutuar për procesin logjik dhe tekstual që ka të bëjë me interpretimin dhe zbatimin. Tani, më lejoni të diskutoj shkurtimisht për aspektin shpirtëror të interpretimit. Lista e mëposhtme më ka rezultuar e dobishme:

- (1) Lutu për ndihmën e Frymës (shih 1 Kor. 1:26-2:16).
- (2) Lutu për falje dhe pastrim personal nga mëkatet e njohura (shih 1 Gjonit 1:9).
- (3) Lutu për një dëshirë më të madhe për të njohur Perëndinë (shih Psa. 19:7-14; 42:1 e më tej; 119:1 e më tej).
- (4) Çdo mësim të ri zbatoje menjëherë në jetë.
- (5) Vazhdo të jesh i përvuilur dhe i mësuësishëm.

Është shumë e vështirë të ruash ekuilibrin mes procesit logjik dhe udhëheqjes shpirtërore të Frymës së Shenjtë. Citimet e mëposhtme më kanë ndihmuar t'i ekuilibroj këto të dyja:

- (1) nga James W. Sire, *Scripture Twisting (Shtrembërimi i Shkrimit)*, f. 17-18:

“Përndritja i vjen në mendje popullit të Perëndisë – jo vetëm elitës shpirtërore. Nuk ka asnjë klasë *guru*-sh në krishterimin biblik, asnjë *iluminati*, as njerëz përmes të cilëve duhet të vijë çdo interpretim i saktë. Prandaj, ndonëse Fryma e Shenjtë jep dhunti të veçanta urtësie, njohurie dhe mprehtësie shpirtërore, ai nuk i cakton këta të krishterë të dhuntishëm që të jenë të vetmit interpretues të autoritetshëm të Fjalës së tij. Është në dorën e secilit individ të popullit të tij që të mësojë, të gjykojë dhe të dallojë në lidhje me Biblën, e cila qëndron si autoritet edhe mbi ata të cilëve Perëndia u ka dhënë aftësi të veçanta. Si përmbledhje, supozimi që shpreh në gjithë këtë libër është se Bibla është zbulosa e vërtetë e Perëndisë për gjithë njerëzimin, se ajo është autoriteti ynë absolut për të gjitha çështjet për të cilat flet, dhe se ajo nuk është mister i plotë, por mund të kuptohet mjaftueshëm nga njerëzit e zakonshëm në çdo kulturë”.

- (2) për Kirkegardin, gjetur në Bernard Ramm, *Protestant Biblical Interpretation (Interpretimi biblik protestant)*, f. 75:

Sipas Kirkegardit, studimi gramatik, leksikor dhe historik i Biblës është hap i nevojshëm, por paraprak, drejt leximit të vërtetë të Biblës. “Për ta lexuar Biblën *si fjalë të Perëndisë*, njeriu duhet ta lexojë me emocion të madh, në majtë gishtave, me pritshmëri të madhe, në kuvendim me Perëndinë. Nëse Biblën e lexon shkel e shko, pa kujdes, apo në mënyrë akademike, apo profesionale, nuk po e lexon si Fjalë të Perëndisë. Kur njeriu e lexon Biblën siç lexon një letër dashurie, atëherë po e lexon si Fjalë të Perëndisë”.

- (3) H. H. Rowley në *The Relevance of the Bible (Natyra aktuale e Biblës)*, f. 19:

“Asnjë kuptim thjesht mendor i Biblës, sado i plotë, s'mund t'ia zotërojë dot të gjitha thesaret asaj. Ajo nuk e përçmon këtë lloj kuptimi, sepse ai është thelbësor për të shkuar drejt të kuptuarit të plotë. Por kjo duhet të të çojë në një të kuptuar shpirtëror të thesareve shpirtërore të këtij libri, në mënyrë që të plotësohet. Dhe, për këtë të kuptuar shpirtëror, është e nevojshme diçka më tepër sesa vigjilenca mendore. Gjërat shpirtërore dallohen shpirtërisht, ndaj studiuesit të Biblës i nevojitet një qëndrim shpirtëror pranues, një zell për të gjetur Perëndinë që t'i dorëzohet atij, në mënyrë që të kalojë, përtej studimit të tij shkencor, në trashëgiminë më të pasur të librit më madhështor në botë”.

Komentari studimor udhëzues synon të të ndihmojë në procedurat interpretuese në mënyrat vijuese

1. Një përvijim i shkurtër historik shërben si hyrje e çdo libri. Pasi të kesh kryer “ciklin tre të leximit”, kontrollo këtë informacion.
2. Mësimet kontekstuale gjenden në fillim të secilit kapitull. Kjo do të të ndihmojë të kuptosh sesi është strukturuar njësia letrare.
3. Në fillim të çdo kapitulli ose njësie letrare kryesore, kam dhënë ndarjet e paragrafëve dhe titujt e tyre përshkruar nga një sërë përkthimesh moderne:

- a. Teksti greqisht i United Bible Society, botimi i katërt i rishikuar (UBS⁴)
- b. The New American Standard Bible, përditësimi i vitit 1995 (NASB)
- c. The New King James Version (NKJV)
- d. The New Revised Standard Version (NRSV)
- e. Today's English Version (TEV)
- f. The Jerusalem Bible (JB)

Ndarjet sipas paragrafëve nuk janë të frymëzuara. Ato duhen vërtetuar nga konteksti. Duke krahasuar disa përkthime moderne që nisen nga teori të ndryshme përkthimi dhe pikëvështrime të ndryshme teologjike, jemi në gjendje të analizojmë strukturën e hamendësuar të mendimit të autorit fillestar. Secili paragraf përmban nga një të vërtetë kryesore. Kjo është quajtur “fjalë të mëdha”, ose “ideja qendrore e tekstit”. Ky mendim unifikues është çelësi për interpretimin e duhur historik dhe gramatikor. S’duhet kurrë të interpretojmë, të predikojmë, ose të japim mësim nga më pak se një paragraf! Gjithmonë kujto se çdo paragraf ka lidhje me paragrafët rrethues. Ja pse është kaq e rëndësishme të bësh një përvijim të të gjithë librit në nivelin e paragrafëve. Duhet të jemi në gjendje të ndjekim rrjedhën logjike të temës që po trajtohet nga autori i frymëzuar fillestar.

4. Shënimet e Bobit ndjekin një qasje interpretimi “varg për varg”. Kjo na shtrëngon të ndjekim mendimin e autorit fillestar. Shënimet sigurojnë informacion për pikat e mëposhtme:
 - a. kontekstin letrar
 - b. të dhënat historike dhe kulturore
 - c. informacione gramatikore
 - d. studime fjalësh
 - e. pasazhe paralele të rëndësishme
5. Në pika të ndryshme gjatë këtij komentari, tekstit të shtypur të New American Standard Version (përditësimi i vitit 1995) do t’i shtojmë edhe përkthimet e një sërë versionesh të tjera moderne:
 - a. The New King James Version (NKJV), i cili ndjek dorëshkrimet tekstuale të “Textus Receptus”.
 - b. The New Revised Standard Version (NRSV), i cili është një rishikim “fjalë për fjalë” i Revised Standard Version, i kryer nga Këshilli Kombëtar i Kishave (National Council of Churches).
 - c. The Today's English Version (TEV), i cili është një përkthim ekuivalent dinamik i Shoqërisë Biblike Amerikane.
 - d. The Jerusalem Bible (JB), i cili është një përkthim anglisht i bazuar në një përkthim ekuivalent dinamik nga ana e katolikëve francezë.
6. Për ata që s’lexojnë greqisht, krahasimi i përkthimeve anglisht mund t’i ndihmojë në identifikimin e problemeve në tekst:
 - a. variantet në dorëshkrime
 - b. kuptimet e ndryshme të fjalëve
 - c. tekstet dhe strukturat që janë të vështira nga ana gramatikore
 - d. tekstet e paqarta

Ndonëse përkthimet anglisht nuk i zgjidhin dot këto probleme, gjithsesi i shigjetojnë si pjesë që kanë nevojë për një studim më të thellë dhe më tërësor.

7. Në përfundim të çdo kapitulli, jepen pyetje të vlefshme diskutimi, të cilat përpiqen të shigjetojnë çështjet kryesore interpretuese të atij kapitulli.

MËSIM HYRËS

I. PËRCAKTIM I TERMAVE MË TË PËRDORUR

A. EMRAT E PERËNDISË

1. Zot (JHVH / Kyrios)
2. Perëndi (Elohim / Theos)
3. Biri i Njeriut
4. Biri i Perëndisë
5. Shpëtimtar
6. Jezus
7. Krisht

B. EMRAT E TEKSTEVE DHE PËRKTHIMEVE

1. Teksti Masoret (MT)
2. Septuaginta (LXX)
3. Targumet
4. Vullgata
5. Peshita
6. Rrotullat e Detit të Vdekur

C. FJALORTH TERMASH (SHIH SHTOJCËN 1)

D. KRITIKA E TEKSTIT (SHIH SHTOJCËN 2)

E. TERMA GRAMATIKORE GREQISHT QË NDIKOJNË NË INTERPRETIM (SHIH SHTOJCËN 3)

II. VIJA KOHORE BAZË E DHIATËS SË RE

III. HARTA BAZË E BOTËS MESDHETARE TË SHEKULLIT TË PARË

A. Ujëra

1. Deti Mesdhe
2. Deti i Zi
3. Deti Adriatik
4. Deti Egje
5. Lumi Nil
6. Lumi Jordan

B. Vende të përmendura në DHR

1. Egjipt

2. Jude
3. Samari
4. Dekapol
5. Galile
6. Siri
7. Feniki
8. Kiliki
9. Kapadoki
10. Galati
11. Pamfili
12. Liki
13. Azi
14. Bitini
15. Pont
16. Akai
17. Maqedoni
18. Iliri
19. Itali

C. Ishuj të përmendur në DHR

1. Qipro
2. Kretë
3. Patmos
4. Sicili
5. Maltë

D. Qytete kryesore

1. Aleksandri
2. Memfis
3. Jerusalem
4. Antiok
5. Tars
6. Efes
7. Pergam
8. Korint
9. Athinë
10. Romë
11. Selanik

HYRJE PËR MATEUN

I. SHËNIME HYRËSE

- A. Deri në kohën e rilindjes/reformacionit, ungjilli i Mateut mendohej se ishte ungjilli i parë që u shkrua (dhe ende konsiderohet si i tillë nga kisha katolike).
- B. Ishte ungjilli më i kopjuar, më i cituar dhe më i përdorur në katekizëm dhe në liturgjinë e hershme të kishës në dy shekujt e parë.
- C. Ëlliam Barclay, në *The First Three Gospels*, f. 19, thotë: “Kur kthehemi te Mateu, shohim një libër që mund të konsiderohet me të drejtë dokumenti më i rëndësishëm i besimit të krishterë, sepse, në të, kemi rrëfimin e plotë dhe më sistematik të jetës dhe mësimëve të Jezusit”.
- Kjo ndodh për shkak se ky ungjill i zhvillon mësimet e Jezusit në mënyrë tematike. Përdorej për t’u mësuar sapokthyerve në besim (judenj dhe johebrej) jetën dhe mësimet e Jezusit të Nazaretit, Krishtit.
- D. Përbën një urë logjike mes Besëlidhjes së Vjetër dhe asaj të Re, mes besimtarëve judenj dhe atyre johebrenj. Mateu e përdor Dhiatën e Re në një kornizë premtimi/përmbushjeje, njësoj si në rastin e predikimeve të hershme të Veprave, që quhen *kerigma*. Dhiata e Vjetër citohet mbi pesëdhjetë herë dhe aludohet shumë herë të tjera. Po kështu, shumë prej titujve dhe analogjive që përdoren për JHVH i zbatohen Jezusit.
- E. Si rrjedhojë, synimet e ungjillit sipas Mateut janë ungjillizimi dhe dishepullizimi, dy aspekte të pandashme të Porosisë së Madhe (28:19-20).
1. Ata duhet t’i kthenin në besim judenjtë duke u treguar për jetën dhe mësimet e Jezusit.
 2. Duhet të dishepullizonin judenjtë dhe johebrenjtë besimtarë që të dinin si të jetonin si të krishterë.

II. AUTORËSIA

- A. Ndonëse kopjet e hershme të Dhiatës së Re greqisht (200-400 pas K.) përmbajnë titullin “sipas Mateut”, vetë ky ungjill është anonim.
- B. Tradita e njëzëshme e kishës së hershme është se ungjillin e shkroi Mateu (i njohur dhe si Levi, Marku 2:14; Luka 5:27, 29), që ishte tagrambledhës (shih Mat. 9:9; 10:3) dhe dishepull i Jezusit.
- C. Mateu, Marku dhe Luka janë tejet të ngjashëm:
1. Shpesh, kanë të njëjtën formë të citimeve të DHV, që nuk gjendet as në tekstin masoret, as në Septuagintë,
 2. Shpesh, e citojnë Jezusin me fjali të pazakonta gramatikisht, madje përdorin dhe fjalë të rralla greqisht,
 3. Shpesh, përdorin fraza, madje dhe fjali, që janë plotësisht të njëjta në greqisht,
 4. Qartazi, këtu kemi të bëjmë me një huazim letrar.
- D. Janë paraqitur një sërë teorish në lidhje me marrëdhënien mes Mateut, Markut dhe Lukës (ungjijtë sinoptikë).
1. Tradita uniforme e kishës së hershme është se ungjillin e shkroi Mateu (Levi), tagrambledhësi dhe dishepulli i Jezusit. Apostulli Mate është pranuar në mënyrë të njëzëshme si autor i këtij ungjilli deri në kohën e rilindjes/reformacionit.
 2. Rreth vitit 1776, A. E. Lessing (dhe, më vonë, Gieseler më 1818), nxori teorinë e një faze gojore në zhvillimin e ungjijve sinoptikë (“shoh së bashku” në greqisht). Ai hodhi mendimin se të tre ungjijtë mbështeteshin në tradita të mëparshme gojore, të cilat shkruesit e ungjijve i modifikuan për lexuesit e tyre të synuar:
 - a. Mateu: judenjve

- b. Marku: romakëve
 - c. Luka: johebrenjve
- Secili prej tyre kishte lidhje me një qendër të veçantë gjeografike të krishterimit
- a. Mateu: Antioki, Siri
 - b. Marku: Romë, Itali
 - c. Luka: Cezareja në anë të detit, Palestinë
 - d. Gjoni: Efes, Azi e Vogël
3. Në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë, J. J. Griesbach nxori teorinë se Mateu dhe Luka shkruan në mënyrë plotësisht të pavarur nga njëri-tjetri rrëfime për jetën e Jezusit. Marku shkroi një ungjill të shkurtër, ku u përpoq të ishte diku mes këtyre dy rrëfimeve të tjera.
 4. Në fillim të shekullit të njëzetë, H. J. Holtzmann nxori teorinë se Marku ishte i pari ungjill që u shkrua, dhe se Mateu me Lukën e përdorën strukturën e ungjillit të Markut së bashku me një dokument të veçantë, që përmbante thënie të Jezusit, dhe quhej Q (gjermanisht, *quelle*, ose “burim”). Kjo u etiketua si teoria e “dy burimeve” (e përkrahur dhe nga Frederick Schleiermacher më 1832).
 5. Më vonë, B. H. Streeter parashtroi një teori të modifikuar të “dy burimeve”, që u quajt teoria “e katër burimeve”, ku hipotezonte një “proto-Lukë”, së bashku me Markun dhe Q.
 6. Teoritë e mësipërme për formimin e ungjijve sinoptikë janë vetëm hamendësime. Nuk ka të dhëna historike apo dorëshkrimore për ekzistencën e “Q”-së, ose të “proto-Lukës”.
 Studiuesit e sotëm nuk e dinë realisht sesi u zhvilluan ungjijtë, ose se kush i shkroi (e njëjta gjë vlen dhe për ligjin e DHV apo për Profetët e Hershëm). Gjithsesi, kjo mungesë informacioni nuk ndikon negativisht për pikëpamjen që ka kisha për frymëzimin dhe vërtetësinë e ungjijve si dokumente besimi, por edhe historike.
 7. Qartazi, ungjijtë sinoptikë përmbajnë ngjashmëri strukturore dhe fjalësh, por edhe shumë dallime të forta. Dallimet janë normale për rrëfime okulare. Kisha e hershme nuk e pati problem mospërputhjen e plotë të këtyre tre rrëfimeve okulare për jetën e Jezusit.
 Ndoshta, këto dallime mund të lidhen me lexuesit e synuar të ungjijve, me stilin e autorit, ose me gjuhët e ndryshme (aramaisht dhe greqisht). Duhet thënë se këta shkruer, redaktorë, apo përpilues të frymëzuar kishin lirinë që të përzgjidhnin, rendisnin, përshtasin dhe përmbledhnin ngjarjet dhe mësimet e jetës së Jezusit (shih, *How to Read the Bible for All Its Worth*, nga Fee dhe Stuart, f. 113-148).
- E. Sipas një tradite të kishës së hershme, e shkruar në librin e Euzebit, *Historia e Kishës* 3:39:16, Papia, peshkopi i Hierapolit (130 para K.), thoshte se Mateu e shkroi ungjillin e vet në aramaisht. Mirëpo, studiuesit e sotëm e kanë hedhur poshtë këtë traditë pasi
1. Greqishtja e Mateut nuk përmban tiparet e një përkthimi nga aramaishtja
 2. Mateu përdor lojë fjalësh greqisht (shih 6:16; 21:41; 24:30)
 3. Shumica e citimeve nga DHV janë në versioni i Septuagintës (LXX), jo nga tekstet hebraike masorete
- Ka mundësi që 10:3 aludon për autorësinë e Mateut. Pas emrit të tij, ky varg shton fjalën “tagrambledhës”. Ky koment nënçmues për veten nuk gjendet te Marku. Mateu nuk ishte njeri i mirënjohur në DHR apo në kishën e hershme. Pse duhet të ishte zhvilluar një traditë kaq e njohur në emrin e tij dhe ky ungjill i parë apostolik nëse s’do ta kishte shkruar Mateu?

III. DATA

- A. Në shumë mënyra, datimi i këtij ungjilli varet nga problemi sinoptik. Cili ungjill u shkrua i pari, dhe kush huazoi nga të tjerët?
 1. Euzebi, në *Historinë e Kishës* 3:39:15, thotë se Mateu e përdori Markun si udhërrëfyes strukturor.
 2. Ndërsa Augustini e quajti Markun “person dytësor” dhe shkurtues të Mateut.
- B. Qasja më e mirë është të përpiqemi të përcaktojmë caqet e datimeve të mundshme
 1. Duhet të jetë shkruar përpara vitit 96 ose 115 pas K.
 - a. Klementi i Romës (96 pas K.) aludon për ungjillin e Mateut në letrën drejtuar korintasve.

- b. Ignati (110-115 pas K.), peshkopi i Antiokisë, e citoi Mateun 3:15 në letrën e tij *drejtuar smirnianëve*, 1:1
- 2. Pyetja më e vështirë është: sa herët mund të jetë shkruar Mateu?
 - a. pa dyshim, duhet të jetë shkruar pas ngjarjeve të përmendura aty, pra pas mesit të viteve ‘30
 - b. duhet të kishte kaluar njëfarë kohe për nevojën e shkrimit, përpilimin dhe qarkullimin e ungjillit
 - c. cila është marrëdhënia e kapitullit 24 me shkatërrimin e Jerusalemit në 70 pas K.? Disa pjesë të Mateut lënë të kuptohet se sistemi i flijimeve ekzistonte ende (5:23-24; 12:5-7; 17:24-27; 26:60-61). Kjo nënkupton një datë përpara vitit 70 pas K.
 - d. nëse Mateu dhe Marku u shkruan gjatë kohës së shërbesës së Palit (48-68 pas K.), pse nuk i përmend asnjëherë Pali? Ireneu citohet nga Euzebi në *Historinë e Kishës* 5:8:2, sikur thoshte se Mateu e shkroi ungjillin e tij gjatë kohës kur Pali dhe Pjetri ishin në Romë. Pjetri dhe Pali u vranë gjatë mbretërimit të Neronit, që përfundoi më 68 pas K.
 - e. në botën e sotme studimore, hamendësimi më i hershëm për shkrimin e librit është viti 50 pas K.
- C. Shumë studiues mendojnë se katër ungjijtë lidhen më tepër me qendrat gjeografike të krishterimit sesa me autorët e tyre tradicionalë. Mateu mund të jetë shkruar nga Antiokia e Sirisë për shkak të problematikave të atyshme në kishë mes judenjve dhe johebrenjve, ndoshta rreth viti 60 ose të paktën përpara vitit 70 pas K.

IV. MARRËSIT

- A. Njësoj si autorësia dhe datimi i ungjillit, edhe marrësit e tij janë të panjohur. Ndoshta, më e mira është të themi se u shkrua për judenjtë dhe johebrenjtë besimtarë. Kisha në Antioki të Sirisë në shekullin e parë përputhet më së miri me këtë profil.
- B. Origeni citohet nga Euzebi në *Historinë e Kishës* 6:25:4 të ketë thënë se ky ungjill u shkrua për besimtarët judenj.

V. PËRVIJIMI STRUKTUROR

- A. Si është strukturuar ky ungjill? Mënyra më e mirë për të zbuluar synimin e autorit të frymëzuar të këtij ungjilli është duke analizuar strukturën e gjithë librit.
- B. Studiuesit kanë sugjeruar një sërë strukturimesh për përvijimin
 - 1. lëvizjet gjeografike të Jezusit
 - a. Galile
 - b. Veriu i Galilesë
 - c. Perea dhe Judea (teksta udhëtonte për në Jerusalem)
 - d. në Jerusalem
 - 2. Pesë njësitë tematike të Mateut. Ato vihen në dukje nga fraza e përsëritur “dhe, pasi Jezusi i përfundoi këto gjëra” (shih 7:28; 11:1; 13:53; 19:1; 26:1). Shumë studiues i shohin këto pesë ndarje si përpjekje të Mateut për ta portretizuar Jezusin si “Moisiun e ri”, ku secila pjesë përkon me një nga pesë librat e Moisiut (Zan., Eks., Lev., Num., LiP.).
 - a. Një strukturë kiastike, që kalon nga narrativa në pjesët ligjëruese
 - b. Një format teologjik/biografik që merr shkas nga fraza e përsëritur “që nga ajo kohë, Jezusi filloi...” (shih 4:17; 16:21); në këtë mënyrë, libri ndahet në tre pjesë (1:1-4:16; 4:17-16:20; dhe 16:21-28:29)
 - c. Theksimi që Mateu u bën pasazheve profetizuese të DHV duke përdorur termin kyç “përmbushje” (shih 1:22; 2:15, 17, 23; 4:14; 8:17; 12:17; 13:35; 21:4; 27:9 dhe 27:35).
- C. “Ungjijtë” janë gjini letrare unike. Nuk janë biografi. Nuk janë narrativë historike. Janë një gjini letrare tejet e strukturuar, me motive të përzgjedhura teologjike. Secili nga shkruarit e ungjijve

zgjodhi disa ngjarje dhe mësimet e Jezusit në mënyrë që t'ua paraqisnin dëgjuesve të tyre si personazh unik. Ungjijtë janë “fletushka ungjillizimi”.

VI. FJALË DHE FRAZA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

1. Mesia, 1:1
2. Virgjëresha, 1:23, 25
3. Imanuel, 1:23
4. Të urtët, 2:1
5. Nazareas, 2:23
6. Pendohu, 3:2
7. Rrëfëhu, 3:6
8. Farisenjtë, 3:7
9. Saducenjtë, 3:7
10. “t’ia heq sandalet”, 3:11
11. “ky është Biri im i dashur”, 3:17
12. “maja e tempullit”, 4:5
13. “Ligji ose Profetët”, 5:17
14. “vërtetimi i divorcit”, 5:31
15. “stoli i këmbëve të tij”, 5:35
16. Sinagogë, 6:2
17. “porta e ngushtë”, 7:13
18. Skrib, 8:19
19. “i demoniaua”, 8:28
20. “ishte mbështetur në tryezë”, 9:10
21. Calikë vere, 9:17
22. Fyelltarët, 9:23
23. Apostuj, 10:2
24. Zgjedha, 11:29, 30
25. “kjo epokë ose epoka e ardhshme”, 12:32
26. Shëmbëlltyrë, 13:3
27. Egjra, 13:25
28. “tradita e pleqve”, 15:2
29. Hades, 16:18
30. U shpërfytyrua, 17:2
31. I përhënur, 17:15
32. “taksa e dy drakmave”, 17:24
33. Dinar, 20:2, 9
34. Hozana, fjalë për fjalë “na shpëto tani”, aramaisht, “pushteti mbretëror i takon [filanit]”, 21:9
35. “dhimbjet e lindjes”, 24:8
36. “neveria e shkatërrimit”, 26:64
37. Talent, 25:20
38. “gjithë këshilli”, 26:59
39. “duke ardhur me retë e qiellit”, 26:64
40. “Fusha e Gjakut”, 27:8
41. Pretoriumi, 27:27
42. “Golgota”, 27:33
43. “por disa dyshuan”, 28:17

VII. PERSONA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

1. Zerubabel, 1:12
2. Herod, 2:13
3. Biri i Davidit, 9:27

4. Biri i Njeriut, 10:23
5. Shërbëtori im, 12:18
6. Beelzebul, 12:24
7. Herodiada, 14:6
8. Simon Barjona, 16:17
9. “krerët e priftërinjve dhe pleqtë”, 21:23
10. Herodianët, 22:16
11. Rabin, 23:7
12. Kajafa, 26:3
13. Pilat, 27:2
14. Baraba, 27:16
15. Marie Magdalena, 27:56
16. Jozefi i Arimateas, 27:57

VIII. VENDNODHJET QË DUHEN GJETUR NË HARTË

1. Betlehem, 2:1
2. Shkretëtira e Judesë, 3:1
3. Galile, 3:13
4. Nazaret, 4:13
5. Kapernaum, 4:13
6. Sodomi dhe Gomorra, 10:15
7. Betsaida, 11:21
8. Sidon, 15:21
9. Cezare e Filipisë, 16:13
10. Mali i Ullinjve, 21:2
11. Gjetseman, 26:36

IX. PYETJE PËR DISKUTIM

1. Pse dallojnë nga njëra-tjetra gjenealogjitë e Mateut dhe Lukës?
2. Çfarë kanë të përbashkët Tamara, Rahabi dhe Ruthi?
3. Çfarë kanë të përbashkët Elija dhe Gjon Pagëzori?
4. Çfarë është “mbretëria e qiellit”?
5. Për çfarë po e tundonte Satani Jezusin në shkretëtirë?
6. Shpjego 5:17 me fjalët e tua.
7. Shpjego 5:48 me fjalët e tua.
8. Shpjego 7:6 me fjalët e tua.
9. Pse është kaq i pazakontë dhe domethënës pasazhi 8:5-13?
10. Shpjego 10:38 me fjalët e tua.
11. Shpjego 10:19 me fjalët e tua.
12. Pse shëronte Jezusi ditën e shabatit?
13. Çfarë është blasfemia kundër Frymës? (12:31-32)
14. Si lidhet mbirja me prodhimin e fryteve në shëmbëlltyrën e mbjellësit? (13)
15. Shpjego 13:44 me fjalët e tua.
16. Shpjego 15:11 me fjalët e tua.
17. Shpjego 16:20 me fjalët e tua.
18. Shpjego 18:8 me fjalët e tua.
19. A ka çdo besimtar nga një engjell mbrojtës?
20. Shpjego 19:17 në lidhje me faktin se Jezusi është Biri i Perëndisë.
21. Shpjego 21:18-19 me fjalët e tua.
22. Pse u foli kaq ashpër Jezusi skribëve dhe farisenjve në kapitullin 23?
23. Cila është domethënia e 24:36?

HYRJE PËR MARKUN

I. SHËNIME HYRËSE

- A. Zakonisht, kisha e hershme nuk e kopjonte, studionte, apo mësonte ungjillin e Markut, pasi preferohej më shumë Mateu dhe Luka për shkak se kisha e mendonte Markun si version “të përmbledhur” (pra, ungjill të shkurtuar) të Mateut; kjo pikëpamje u shpreh qartë më vonë nga Augustini.
- B. Marku nuk citohet shpesh nga etërit e hershëm të kishës apo nga apologët e shekullit të dytë (mbrojtësit e besimit).
- C. Që nga ngritja e qasjes moderne historiko-gramatikoe për interpretimin biblik, ungjilli i Markut ka rimarrë rëndësi për shkak se konsiderohet ungjilli i parë që u shkrua. Si Mateu, ashtu dhe Luka, përdorin Markun në paraqitjen që i bëjnë jetës dhe rëndësisë së Jezusit. Kështu, Marku është kthyer në dokumentin themelor të kishës si rrëfimi i parë zyrtar i jetës së Jezusit.

II. GJINIA LETRARE

- A. Ungjijtë nuk janë biografi apo histori moderne. Ato janë shkrime të përzgjedhura teologjike që synonin t’u prezantonin Jezusin dëgjuesve të ndryshëm dhe t’i sillnin në besim tek ai. Ato janë rrëfime “të lajmit të mirë” për jetën e Jezusit dhe kanë qëllim ungjillizues (shih Gjoni 20:30-31).
- B. Marku trajton katër kontekste të ndryshme historike për katër qëllime teologjike
 1. për jetën dhe mësimet e Jezusit
 2. jetën dhe shërbesën e Pjetrit
 3. nevojat e kishës së hershme
 4. qëllimin ungjillizues të Gjon Markut
- C. Katër ungjijtë janë unikë në literaturën e Lindjes së Afërt apo atë greko-romake. Autorët e frymëzuar të ungjijve patën detyrën që, të udhëhequr nga Fryma, të përzgjidhnin mësimet dhe veprimet e Jezusit që zbulonin qartë karakterin dhe qëllimin e tij.

Ata i renditën këto fjalë dhe vepra në mënyra të ndryshme. Një shembull është kur krahasojmë Predikimin në Mal të Mateut (Mat 5-7) me Predikimin në Pllaje të Lukës. Është e qartë se Mateu prirej t’i përmbledhte të gjitha mësimet e Jezusit në një predikim të gjatë, ndërsa Luka i shpërndante këto mësimet gjatë gjithë ungjillit. Kjo gjë mund të thuhet dhe për faktin se Mateu i mbledh së bashku mrekullitë e Jezusit, ndërsa Luka i përhap në gjithë ungjillin.

Kjo tregon aftësinë e shkrimtarëve të ungjijve, jo vetëm që të përzgjidhnin dhe rendisnin mësimet e Jezusit, por edhe t’i përshtasin për qëllimet e tyre teologjike shih (Fee dhe Stuart, *How to Read the Bible For All Its Worth*, f. 113-134). Kur lexojmë ungjijtë, duhet të pyesim se ç’synim teologjik po përpiqen të përçojnë këta shkrimtarë. Pse e kanë përfshirë një ngjarje, mrekulli, apo mësim të caktuar në një vend të caktuar?
- D. Ungjilli i Markut është shembull i qartë i përdorimit të greqishtes *koine* si gjuhë e dytë e popujve të botës mesdhetare. Gjuha amtare e Markut duhet të ketë qenë aramaishtja (e njëjta gjë vlen dhe për Jezusin dhe gjithë judenjtë në Palestinën e shekullit të parë). Ky ngjyrim semit është një nga tiparet e ungjillit të Markut.

III. AUTORËSIA

- A. Tradita kishtare e ka lidhur Gjon Markun me apostullin Pjetër për shkrimin e ungjillit. Vetë ky libër (si gjithë ungjijtë e tjerë) është anonim.
- B. Një tjetër dëshmi se ky libër është dëshmi okulare e Pjetrit është fakti se Marku nuk përmend tre ngjarje të veçanta ku Pjetri u përfshi personalisht.

1. ecja e Pjetrit në ujë (shih Mat. 14:28-33)
 2. fakti se Pjetri u bë zëdhënës i apostujve në Cezare të Filipisë kur dëshmoi për besimin të Dymbëdhjetëve (shih Mat. 16:13-20); te Marku, vetëm 8:27-30 dhe pasazhet e “mbi këtë shkëmb” dhe “çelësat e mbretërisë” nuk përmenden.
 3. Gjetja e taksës së tempullit për Jezusin dhe për vete (shih Mat. 17:24-27)
- Ndoshta, modestia e bëri Pjetrin që të mos i theksonte këto ngjarje në predikimet e tij.

C. Tradita e kishës së hershme

1. Në *I Klementit*, shkruar në Romë rreth 95 pas K., aludon për Markun (të njëjtën gjë bën dhe *Bariu i Hermës*).
2. Papia, peshkopi i Hierapolit (rreth 130 pas K.), shkroi *Interpretimin e Thënive të Zotit*, të cilin Euzebi (275-339 pas K.) e citon në *Historinë kishtare* 3.39.15. Ai thotë se Marku ishte interpretues i Pjetrit; ai mbajti shënim në mënyrë të saktë, por jo kronologjike, kujtimet e Pjetrit për Jezusin. Me sa duket, Marku i mori predikimet e Pjetrit dhe i përshtati e organizoi në formën e një paraqitjeje ungjilli. Papia pretendonte se këtë informacion e kishte marrë nga “plaku”, që ndoshta bën fjalë për apostullin Gjon.
3. Justin Martiri (150 pas K.), kur citon Markun 3:17, shton se ky ishte kujtim i Pjetrit.
4. Prologu Anti-Markionit i Markut, i shkruar rreth 180 pas K., e identifikon Pjetrin si dëshmitarin okular të ungjillit të Markut. Ky prolog pohon se Marku e shkroi ungjillin në Itali pas vdekjes së Pjetrit (tradita thotë se vdiq në Romë rreth 65 pas K.).
5. Ireneu, që shkroi rreth vitit 180 pas K., e përmend Gjon Markun si interpretuesin e Pjetrit dhe përpiluesin e kujtimeve të tij pas vdekjes (shih *Contra Haereses*, 3:1:2).
6. Klementi i Aleksandrisë (195 pas K.) thotë se ata që dëgjuan predikimet e Pjetrit në Romë i kërkuan Markut t’i mbante shënim predikimet.
7. Fragmenti Muratorian (i kanonit të Biblës) shkruar rreth 200 pas K. në Romë, ndonëse përmban një tekst të paplotë, duket se pohon se Gjon Marku mbajti shënim predikimet e Pjetrit.
8. Tertuliani (200 pas K.), në *Kundër Markionit* (4:5), thotë se Marku botoi kujtimet e Pjetrit.
9. Në *The Expositor’s Bible Commentary*, vëll. 8, f. 606, Ëalter Ëessel jep mendimin interesant se traditat e mësipërme të kishës së hershme vijnë nga qendra kishtare që ishin të ndryshme nga ana gjeografike:
 - a. Papia nga Azia e Vogël
 - b. Prologu Anti-Markionit dhe Fragmenti Muratorian nga Roma
 - c. Ireneu (shih *Adv. Haer.* 3.1.1.) nga Lioni në Francë. Tradita e Ireneut gjendet dhe te Tertuliani (shih *Adv. Marc.* 4.5) në Afrikën veriore dhe te Klementi i Aleksandrisë, në Egjipt (shih *Hypotyposesis* 6, që Euzebi e citon në *Hist. Kish.* 2.15.1-2; 3.24.5-8; 6:14:6-7). Kjo larmi gjeografike ia shton besueshmërinë kësaj historie për shkak se kjo traditë u pranua gjerësisht në krishterimin e hershëm.
10. Sipas Euzebit, *Historia kishtare* 4:25. Origjeni (230 pas K.) në librin *Komentat për Mateun* (nuk njihet asnjë komentat për Markun para shekullit të pestë), thotë se Marku e shkroi ungjillin ashtu siç ia kishte shpjeguar Pjetri.
11. Vetë Euzebi diskuton për ungjillin e Markut në *Hist. Kish.* 2.15 dhe thotë se Marku i mbajti shënim predikimet e Pjetrit pas kërkesës së atyre që i kishin dëgjuar, që t’ua lexonin gjithë kishave. Euzebi e bazon këtë traditë në shkrimet e Klementit të Aleksandrisë.

D. Çfarë dimë për Gjon Markun

1. Nëna e tij ishte besimtare e mirënjohur në Jerusalemin; në shtëpinë e saj mblidhej kisha (ndoshta dhe natën e Darkës së Zotit, shih Marku 14:14-15; Veprat 1:13-14; Veprat 12:12). Ndoshta, ai ishte dhe i riu që s’i përmendet emri, i cili iku me vrap nga Gjetsemani (Marku 14:51-52).
2. Shoqëroi xhaxhain e vet Barnabën (shih Kol. 4:10) dhe Palin kur u kthyen nga Jerusalemi në Antioki (Veprat 12:25).
3. Ishte shoqëruar i Barnabës dhe Palit në udhëtimin e parë misionar (Veprat 13:5), por u kthye papritur në shtëpi (Veprat 13:13).
4. Më vonë, Barnaba donte ta merrte me vete Markun në udhëtimin e dytë misionar, por kjo shkaktoi një mosmarrëveshje të fortë mes Barnabës dhe Palit (Veprat 15:37-40).

5. Më vonë, u ribashkua me Palin dhe u bë mik dhe bashkëpunëtor i tij (Kol. 4:10; 2 Tim. 4:11; ilemoni 24).
 6. Ishte shoqëruar dhe bashkëpunëtor i Pjetrit (1 Pje. 5:13), me gjasë në Romë.
- E. Njohuria personale që kishte Marku për jetën e Jezusit duket se vërtetohet nga 14:51-52, ku një djalosh ia mbath i zhveshur nga kopshti i Gjetsemanit sapo arrestohet Jezusi. Kjo hollësi e pazakontë dhe tërësisht e papritur duket se pasqyron përvojën personale të Markut.

IV. DATA

- A. Ky ungjill është dëshmi okulare dhe interpretim i jetës, veprave dhe mësimëve të Jezusit; me sa duket, janë marrë nga predikimet e Pjetrit. Ato u përpiluan dhe u shpërndanë si një libër pas vdekjes së Pjetrit; kështu thotë Prologu Anti-Markionit dhe Ireneu (që shton se kjo ndodhi pas vdekjes së Palit). Pjetri dhe Pali u martirizuan nën Neronin (54-68 pas K.) në Romë (sipas traditës së kiëhs). Datat e sakta janë të paqarta, por, nëse kjo është e vërtetë, atëherë ungjilli i Markut datohet diku rreth mesit të viteve '60.
- B. Ka mundësi që Prologu Anti-Markionit dhe Ireneu nuk bëjnë fjalë për vdekjen e Pjetrit, por për largimin (pra, daljen) e tij nga Roma. Ka disa të dhëna tradite (p.sh., Justini dhe Hipoliti) sipas së cilave Pjetri e vizitoi Romën gjatë mbretërimit të Klaudit (41 deri 54 pas K.) (Euzebi, *Hist. Kisht.* 2.14.6).
- C. Me sa duket, Luka e përmbyll librin e Veprave me momentin kur Pali është ende në burg në fillim të viteve '60. Nëse është e vërtetë se Luka përdori Markun për të shkruar ungjillin e vet, atëherë Marku i bie të jetë shkruar para Veprave dhe, si rrjedhojë, përpara fillimit të viteve '60.
- D. Autorësia dhe datimi i Markut nuk prekin aspak të vërtetat historike/teologjike/ungjillizuese të këtij ungjilli (apo dhe të ungjijve të tjerë). Personazhi kyç është Jezusi, jo autori njerëzor!
- E. Është e habitshme që asnjë nga ungjijtë (madje, as Gjoni, i shkruar 95-96 pas K.) nuk e përmend (madje, as tërthorazi) shkatërrimin e Jerusalemit (shih Mat. 24; Marku 13; Luka 21) më 70 pas K. nga gjenerali Romak dhe, më vonë, perandori, Titi. Marku mund të jetë shkruar para kësaj ngjarjeje. Madje, ka mundësi që dhe Mateu me Lukën të jenë shkruar para këtij gjykimi të rëndë të judaizmit nga Zoti. Thjesht duhet pranuar se datat e sakta për përpilimin e ungjijve sinoptikë janë të paqarta deri tani (kjo vlen dhe për marrëdhënien e tyre letrare).

V. MARRËSIT

- A. Marku shoqërohet me Romën nga një sërë shkrimtarësh të kishës së hershme
 1. 1 Pjetrit 5:13
 2. Prologu Anti-Markionit (Itali)
 3. Ireneu (Romë, shih *Adv. Haer.* 3.1.2)
 4. Klementi i Aleksandrisë (Romë; shih Euzebi, *Hist. Kisht.* 4.14.6-7; 6.14.5-7)
- B. Marku nuk i shpreh qartë synimet pse e shkroi ungjillin. Janë dhënë një sërë teorish.
 1. është trakt ungjillizues (shih 1:1), i shkruar posaçërisht për romakët (shih 1:15; 10:45)
 - a. elementet judaie shpjegohen (shih 7:3-4; 14:12; 15:42)
 - b. fjalët aramaisht përkthehen (shih 3:17; 5:41; 7:1, 34; 10:46; 14:36; 15:22, 34)
 - c. përdor shumë fjalë latinisht (p.sh., ekzekutuesi, 6:27; sekstani, 7:4; census, 12:14; kuadrant, 12:42; pretorium, 15:16; centurion, 15:39; flagellare, 15:42)
 - d. përdoret terminologji përfshirëse në lidhje me Jezusin
 - (1) gjuhë përfshirëse për ata që jetonin në Palestinë (shih 1:5, 28, 33, 39; 2:13; 4:1; 6:33, 39, 41, 55)
 - (2) gjuhë përfshirëse në lidhje me gjithë njerëzit (shih 13:10)

2. përndjekja që vijoi pas zjarrit në Romë më 64 pas K., për të cilën Neroni fajësoi të krishterët, shkaktoi një dallgë të tmerrshme përndjekjeje ndaj besimtarëve. Marku i përmend shpesh përndjekjet (p.sh., vuajtjet e Jezusit në 8:31; 9:39; 10:33-34, 45, dhe vuajtjet e ndjekësve të tij, 8:34-38; 10:21, 30, 35-44).
3. Vonimi i ardhjes së dytë
4. Vdekja e dëshmitarëve okularë të Jezusit, veçanërisht e apostujve
5. Dalja e herezive brenda kishave të krishtera, që ishin përhapur ngado
 - a. Judaizuesit (Galatasve)
 - b. Gnostikët (1 Gjonit)
 - c. Kombinimi i a. dhe b. (p.sh., Kolosianëve dhe Efesianëve; 2 Pje. 2)

VI. PËRVIJIMI STRUKTUROR

- A. Marku është strukturuar në mënyrë të tillë që java e fundit e jetës së Jezusit të përbëjë fokusin e mbi një të tretës së librit. Rëndësia teologjike e Javës së Mundimeve është e dukshme.
- B. Meqë, sipas traditës së kishës së hershme, ungjilli i Markut u bazua në predikimet e Pjetrit (ndoshta në Romë), është e kuptueshme pse nuk përmend rrëfimet e lindjes së Jezusit. Marku nis aty ku fillon përvoja e Pjetrit, kur Jezusi ishte i rritur, dhe lidhet teologjikisht me mesazhin e Gjon Pagëzorit, që flet për pendimin dhe besimin si përgatitje për punën e Mesisë.
 Predikimet e Pjetrit duhet të kenë përdorur konceptet e “Birit të Njeriut” dhe “Birit të Perëndisë”. Ky ungjill pasqyron teologjinë e Pjetrit për personalitetin e Jezusit. Në fillim, Jezusi shihej si mësues dhe shërues i madh, por u bë Mesi! Ky Mesi nuk ishte gjenerali pushtues që pritej, por Shërbëtori i Përvuajtur (shih Isaia 53).
- C. Përvijimi thelbësor gjeografik i Markut gjendet dhe në ungjijtë e tjerë sinoptikë (pra, Mateu dhe Luka):
 1. Shërbesa në Galile (1:14-6:13)
 2. Shërbesa jashtë Galilesë (6:14-8:30)
 3. Udhëtimi për në Jerusalem (8:31-10:52)
 4. Java e fundit në zonën e Jerusalemit (11:1-16:8)
- D. Madje, ka mundësi që struktura e Markut të imitojë modelin bazë të predikimit të hershëm apostolik (shih Veprat 10:37-43; si dhe librin e C. H. Dodd, *New Testament Studies*, f. 1-11). Nëse kjo është e vërtetë, atëherë ungjijtë e shkruar janë kulminimi i periudhës së traditave gojore (pra, *kerigma*). Judaizmi e konsideronte mësimin gojor si më të rëndësishëm se tekstet e shkruara.
- E. Marku karakterizohet nga një stil i shpejtë rrëfimi (p.sh., “menjëherë”, 1:10) i jetës së Jezusit. Marku nuk përmend sesione të gjata mësimdhënieje, por kalon shpejt nga një ngjarje te tjetra (p.sh., përdorimi i shpeshtë i fjalës “menjëherë”). Ungjilli i Markut e zbulon Jezusin me anë të veprimeve të tij. Gjithsesi, ky rrëfim me ritëm të shpejtë është i mbushur me hollësi të gjalla prej dëshmitari okular (pra, të Pjetrit).

VII. FJALË DHE FRAZA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

1. pagëzim pendimi, 1:4
2. rrobat me qime deveje, 1:5
3. si pëllumb, 1:10
4. dyzet ditë, 1:13
5. mbretëria e Perëndisë është afër, 1:15
6. sinagogë, 1:23

7. blasfemi, 2:7
8. skribët, 2:6
9. calikë vere, 2:22
10. shëmbëlltyra, 4:2
11. manteli, 5:27
12. majaja e farisenjve, 8:15
13. “Shporru, Satan”, 8:33
14. U shpërfytyrua, 9:2
15. Ferr (Gehena), 9:47
16. Shtëpi lutjeje për të gjitha kombat, 11:17
17. Dinar, 12:15
18. Pashka, 14:1
19. Vaj nardi, 14:3
20. Kjo kupë, 14:36
21. Ka ardhur ora, 14:41
22. Dita e Përgatitjes, 15:42
23. Dita e parë e javës, 16:2

VIII. PERSONA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

1. Simon, 1:16
2. Zebede, 1:20
3. Frymë e ndyrë, 1:23
4. Levi, 2:14
5. Abiatar, 2:26
6. Kananeas, 3:18
7. Beelzebul, 3:22
8. Legjion, 5:9
9. Mbreti Herod, 6:14
10. Herodiada, 6:17
11. Sirofenikase, 7:26
12. Bartime, 10:46
13. Cezar, 12:14
14. Neveria e shkatërrimit, 13:14
15. I zgjedhur, 13:20
16. Krisht i rremë, 13:22
17. Krerët e priftërinjve, 14:1
18. Abba, 14:36
19. Këshilli, 14:55
20. Baraba, 15:7, 11
21. Simoni i Kirenës, 15:21
22. Salome, 15:40
23. Centurion, 15:45

IX. VENDNDODHJET QË DUHEN GJETUR NË HARTË

1. Judea, 1:4
2. Jerusalem, 1:4
3. Lumi Jordan, 1:5
4. Nazaret, 1:9
5. Galile, 1:9
6. Kapernaum, 1:21
7. Idume, 3:8
8. Tir, 3:8

9. Sidon, 3:8
10. Gerasenët, 5:1
11. Dekapoja, 5:20
12. Betsaidë, 6:45
13. Dalmanutha, 8:10
14. Jeriko, 10:46
15. Mali i Ullinjve, 11:1
16. Gjetseman, 14:32

X. PYETJE PËR DISKUTIM

1. Çfarë është pagëzimi me Frymën? (1:8)
2. Cilat janë kërkesat e besëlidhjes së re? (1:15)
3. Pse u mahnitën dëgjuesit nga mësimet e Jezusit? (1:22)
4. Pse nuk i lejoi Jezusi demonët të flisnin? (1:34)
5. Pse u tha Jezusi atyre që shëroi që të mos ia tregonin askujt? (1:43)
6. Pse akuzohet për blasfemi Jezusi në kapitullin 2?
7. Shpjego 2:17 me fjalët e tua.
8. Pse shëroi kaq shpesh ditën e shabatit Jezusi?
9. Pse mësonte me shëmbëlltyra? (3:10-13)
10. Shpjego shëmbëlltyrën e llojeve të dheut me fjalët e tua (4:3-9)
11. Pse nuk bëri shumë mrekulli Jezusi në vendlindjen e vet? (6:4-6)
12. Pse eci në ujë Jezusi në kapitullin 6?
13. Shpjego profecinë e Isaisë në 7:6-7.
14. Shpjego 7:15 me fjalët e tua.
15. Pse citon Marku fjalët aramaisht të Jezusit?
16. Shpjego 8:38 me fjalët e tua.
17. Pse e pyesin farisenjtë Jezusin për divorcin në kapitullin 10?
18. Pse u habitën dishepujt (10:26) nga fjalët e Jezusit në 10:25?
19. Pse ecën Jezusi mbi një këriç në kapitullin 11?
20. Pse e pastroi tempulli Jezusin në kapitullin 11?
21. Pse është pyetje kaq e rëndësishme ajo që thuhet në 11:28?
22. Pse është kaq e fuqishme shëmbëlltyra në fillim të kapitullit 12, dhe për kë bën fjalë?
23. Cili është urdhërimi më i madh në Dhiatën e Vjetër?
24. Pse është kaq e vështirë të interpretohet 13:30?
25. Shpjego 15:34 me fjalët e tua.

HYRJE PËR LUKËN

I. SHËNIME HYRËSE

- A. Luka është ungjilli më i gjatë. Luka-Veprat (nëse mendojmë se Hebrenjve nuk është shkruar nga Pali) përmbajnë numrin më të madh të faqeve ndër autorët e Dhiatës së Re; ai ishte johebre dhe i krishterë i brezit të dytë!
- B. Luka shkroi në greqishten më elegante *koine* ndër gjithë shkruesit e Dhiatës së Re me përjashtim të autorit të Hebrenjve. Me sa duket, greqishten e kishte gjuhën e nënës. Ishte tejet i arsimuar dhe mjek (shih Kol. 4:14).
- C. Luka thekson dashurinë dhe përkujdesjen e Jezusit për njerëzit që krerët judenj nuk ua varnin fare:
1. gratë (p.sh., Maria, Elizabeta, Ana, Maria dhe Marta, etj.),
 2. të varfrit (shih Lumturitë e Lukës, Luka 6:20-23 dhe mësimet për pasurinë, 12:13-21; 16:9-13, 19-31)
 3. të përjashtuarit për shkaqe shoqërore, racore dhe fetare
 - a. gratë e shturura (shih 7:36-50)
 - b. samaritanët (shih 9:51-56; 10:29-37; 17:11-16)
 - c. lebrozët (shih 17:11-19)
 - d. tagrambledhësit (shih 3:12-13; 18:9-14; 19:1-10)
 - e. kriminelët (shih 23:35-43)
- D. Luka përmend kujtimet okulare të Marisë (për shembull, dy kapitujt e parë të Veprave) dhe, ndoshta, gjenealogjinë e saj (shih 3:23-38). Ungjilli i Lukës përmend përkujdesjen e Jezusit për judenjët dhe johebrenjtë.

II. AUTORI

- A. Tradita e kishës së hershme është e njëzëshme
1. Ireneu (175-195 pas K., *Kundër herezive*, 3.1.1; 3.14.10) thotë qartazi se Luka shkroi në një libër ungjillin e predikuar nga Pali.
 2. Prologu Anti-Markionit i Lukës (175 pas K.) thotë se autori i këtij ungjilli ishte Luka.
 3. Tertuliani (150-160-220/240 pas K., në *Kundër Markionit*, 4:2, 3; 4:5, 3) thotë se Luka shkroi një përmbledhje të ungjillit të Palit
 4. Fragmenti Muratorian (180-200 pas K.) e përmend Lukën si autor dhe quan shoqëruesin mjek të Palit. Po kështu, thotë se Luka e shkroi rrëfimin e vet në bazë të atyre që kishte dëgjuar (pra, intervistoi dëshmitarët okularë).
 5. Origeni, i cituar nga Euzebi në komentarin për Mateun (*Hist. Kish.* 6.25.6) thotë se autorësia e këtij ungjilli i përket Lukës.
 6. Euzebi (*Hist. Kish.* 3.4.2,6-7) pohon autorësinë e Lukës për ungjillin e Lukës dhe librin e Veprave.
- B. Të dhënat e brendshme për autorësinë e Lukës
1. Ky ungjill, ashtu si shumë libra biblikë, është anonim.
 2. Nëse Luka-Veprat është libër dyvëllimësh, gjë që duket se mbështetet nga fakti se përmbajnë hyrje të ngjashme, atëherë pjesët “ne” në Veprat (shih 16:10-17; 20:5-16; 21:1-18; 27:1-28:16) janë dëshmi okulare për veprimtarinë misionare të Palit.
 3. Hyrja e Lukës (shih 1:1-4) tregon se Luka hulumtoi rrëfime okulare për të shkruar një rrëfim historik të jetës së Jezusit, gjë që tregon se Luka vetë ishte besimtar i brezit të dytë. Hyrja e Lukës mbulon dhe Veprat. Luka dhe Veprat mbivendosen disi nga ana kohore (dmth., për ngjarjet pas ringjalljes së Jezusit).

III. LUKA SI PERSON

- A. Prologu Anti-Markionit i Lukës (175 pas K.)
 - 1. Vendas i Antiokisë në Siri
 - 2. Mjek
 - 3. Beqar
 - 4. Ndjekës i Palit
 - 5. Shkroi nga Akaia
 - 6. Vdiq në moshën 84 vjeçare në Beti
- B. Euzebi i Cezaresë (275-339 pas K.), në *Hist. Kish.* III.4.2
 - 1. Nga Antiokia
 - 2. Shoqërues misionar i Palit
 - 3. Shkroi ungjillin dhe Veprat
- C. Jeronimi (346-420 pas K., në *Migna* XXVI. 18)
 - 1. Shkroi nga Akaia
 - 2. Vdiq në Beti
- D. Ishte i mirarsimuar
 - 1. Greqishten *koinè* e shkroi në mënyrë të saktë gramatikore
 - 2. Fjalor i gjerë (sidomos mjekësor dhe detar)
 - 3. Metoda hulumtuese (shih 1:1-4)
 - 4. Ndoshta, ishte mjek (shih Kol. 4:14). Po kështu, komentet negative të Markut për mjekët në Marku 5:26 nuk përfshihen në rrëfimin paralel të Luka 8:43. Luka përdori fjalë që lidheshin me mjekësinë, kurat, sëmundjet, etj., të paktën 300 herë (shih Ë. K. Hobart, *The Medical Language of Luke*, ose më mirë, shih A. Harnack, *Luke the Physician*).
- E. Ishte johebre
 - 1. Pali duket se bën një dallim në listën e ndihmësve në Kol. 4:10-11 (pra, “ata që janë nga rrethprejra”) dhe ndihmësve të tjerë (pra, Epafrai, Luka dhe Dema).
 - 2. Në Veprat 1:9, Luka përmend “në gjuhën e tyre”, kur e ka fjalën për aramaishten. Kjo nënkupton se aramaishtja nuk ishte gjuha e tij.
 - 3. Në ungjillin e vet, Luka lë pa përmendur debatet me farisenjtë në lidhje me ligjin gojor të judenjve.
- F. Ndonëse ishte shkruesi i ungjillit më të gjatë, dhe bashkë me Veprat ishte shkruesi i pjesës më të madhe të Dhiatës së Re, është e habitshme që u zgjodh një johebre pothuajse i panjohur dhe jo dëshmitar okular (pra, jo apostull). Mirëpo kjo është tradita e njëzëshme e kishës së hershme, pa asnjë zë kundërshtues!

IV. DATA E SHKRIMIT

- A. Nuk është mësuar kurrë marrëdhënia e saktë mes (1) shënimeve fillestare hulumtuese të Lukës (ndoshta, i shkroi teksta Pali ishte në burg në Cezare [shih Veprat 23-26, dhe veçanërisht 24:27]); (2) versionit të tij përfundimtar (pra, ungjilli i Lukës siç e njohim, që përdori Markun dhe “Q”); dhe (3) qarkullimit të Luka-Veprave (për Teofilin, ose drejtuar Teofilit).
- B. Duhet të jetë shkruar para vitit 95 pas K. nëse *I Klementit* citon ose bën aludime nga Veprat; Veprat u shkrua pas ungjillit
 - 1. Veprat 13:22 – *I Klementit* 18:1
 - 2. Veprat 20:36 – *I Klementit* 2:1
- C. Veprat duhet të jetë shkruar para shkatërrimit të Jeruselemit (70 pas K.) nga gjenerali romak, Titi.

1. Nuk përmendet fare vdekja e
 - a. Apostullit Jakob (62 pas K.)
 - b. Apostullit Pal (64-67 pas K.)
2. Predikimi i Stefanit në Veprat 7 nuk e përfshin shkatërrimin e Tempullit, ndonëse kjo do ta kishte ilustruar fuqishëm gjykimin e judaizmit nga Perëndia
3. Pali viziton Jerusalemin në Veprat 21, kështu që, nëse Luka do ta kishte shkruar librin pas vitit 70, ndoshta do ta kishte përmendur shkatërrimin e Jerusalemit në ungjill

D. Nëse Luka përdori si strukturë përvijuese ungjillin e Markut, dhe/ose nëse Luka e shkroi ungjillin afër kohës së hulumtimeve në Palestinë, atëherë ungjilli u shkrua në fund të viteve '50 dhe në fillim të viteve '60 (ndërsa Veprat u shkrua pak më vonë ndërsa Pali ishte i burgosur në Romë, 62-63 pas K.).

V. MARRËSIT

A. I kushtohet Teofilut (shih Luka 1:1-4; Veprat 1:1). Ka disa teori për identitetin e tij:

1. zyrtar qeveritar romak; Luka e quan “shumë i shkëlqyeshmi” në Luka 1:3 dhe përdor të njëjtin titull për Feliksin (shih Veprat 23:26; 24:3) dhe Festin (shih Veprat 26:25)
2. bamirës i pasur (Teofil ishte emër i zakonshëm për judenj të dhe grekët) që ndihmoi në mbulimin e shpenzimeve për shkrimin, kopjimin dhe shpërndarjen e Luka-Veprave.
3. Emri i tij do të thotë “Perëndia deshi”, “i dashur nga Perëndia”, prandaj mund të jetë dhe përmendje e koduar e një të krishteri të caktuar.

B. Ungjilli i Lukës ka si synim lexuesit johebrenj

1. shpjegon zakonet judaike
2. ungjilli është për gjithë popujt (shih 2:10)
3. citon profeci që përmendin “gjithë mishin” (shih 3:5-6, që është citim nga Isaia 40)
4. gjenealogjia kthehet pas deri tek Adami (pra, gjithë njerëzit, shih 3:38)
5. ka shumë shembuj të dashursisë së Perëndisë për johebrenjtë (pra, Luka i zgjeron kufijtë e atyre që ishin të mirëpritur në gostinë mesianike, 13:29)
6. shembuj të Dhiatës së Vjetër shpallin dashurinë e Perëndisë për johebrenjtë (shih 2:32; 4:25-77)
7. Porosia e Madhe e Lukës – falja t’u predikohet gjithë kombeve (shih 24:47)

VI. QËLLIMET PSE SHKROI LUKA

A. Të gjithë ungjijtë u shkruan për grupe të veçanta njerëzish me qëllim ungjillizimin (shih Gjoni 20:30-31).

1. Mateu, për judenj të
2. Marku, për romakët
3. Luka, për johebrenjtë
4. Gjoni, për johebrenjtë

Luka është i vetmi që përmend misionin e të Shtatëdhjetëve (shih 10:1-24). Për rabinët, 70 ishte numri që tregonte gjuhët e gjithë botës (shih Zan. 10). Duke dërguar 70 predikues të lajmit të mirë, Jezusi tregoi se ungjilli u duhej përçarur të gjitha kombeve.

B. Qëllime të tjera të mundshme

1. për të shpjeguar vonimin e Ardhjes së Dytë
 - a. Luka 21 është e ngjashme me Mat. 24 dhe Mk. 13 (ndonëse me ca ndryshime të vogla) dhe flet për kthimin e Krishtit nga çasti në çast dhe për fundin e botës.
 - b. Mirëpo Luka flet dhe për ungjillizimin e botës, gjë që kishës i kërkon kohë për ta përmbushur (shih 24:47).
 - c. Po kështu, Luka (si dhe Pali) thekson faktin se mbretëria e Perëndisë është këtu tani (shih 10:9, 11; 11:20; 17:21) si dhe në të ardhmen.
 - d. Një përmbledhje e qartë e mendimeve dhe diskutimeve të studiuesve biblikë mund të gjendet në *The Anchor Bible*, vëll. 28, f. 231-235.

2. për t'u shpjeguar krishterimin qeveritarëve romakë (si në rastin e Veprave)
 - a. titulli "i shkëlqyeri" në hyrje
 - b. Luka 23 tregon se Pilati tha tri herë, "nuk gjej faj te ky njeri" (shih 23:4, 14-15, 22)
 - c. Qeveritarët në Veprat paraqiten në dritë pozitive; po kështu, fjalimet e Palit para zyrtarëve romakë tregojnë respekt ndaj tyre, ndërsa ata i përgjigjen në mënyrë pozitive (shih Veprat 26:31-32)
 - d. Po kështu, centurioni romak te vendi i kryqëzimit jep dëshmi pozitive për Jezusin (shih Luka 23:47)
- C. Disa motive unike teologjike luajnë rolin e tyre në qëllimet pse shkroi Luka ungjillin
1. Luka tregon kujdes të veçantë ndaj disa grupimeve të ndryshme.
 - a. të varfrit kundrejt të pasurve (shih Lumturitë te Luka 6:20-23)
 - b. të përjashtuarit
 - (1) gratë e shturura (shih Luka 7:36-50)
 - (2) samaritanët (shih Luka 9:51-56; 10:29-37)
 - (3) ikanakët rebelë (shih Luka 15:11-32)
 - (4) tagrambledhësit (shih Luka 19:1-10)
 - (5) lebrozët (shih Luka 17:11-19)
 - (6) kriminelët (shih Luka 23:39-43)
 2. Luka përmend tempullin në Jerusalem. Ungjilli nis me judenjtë dhe Shkrimet e tyre (pra, Jezusi përmbush profecitë e DHV), por ata e refuzojnë (shih 11:14-36). Ai bëhet shpëtimtari i gjithë botës (shih 10:1-24) dhe e zëvendëson tempullin e tyre me veten.

VII. BURIMET PËR UNGJILLIN E LUKËS

- A. Janë parashtruar një sërë teorish për marrëdhënien mes Mateut, Markut dhe Lukës (ungjijtë sinoptikë)
1. Tradita e njëzëshme e kishës së hershme thotë se ungjillin e shkroi Luka, një mjek johebre dhe shoqëruar misionar i apostullit Pal.
 2. Rreth 1776, A. E. Lessing (dhe, më vonë, Gieseler më 1818) parashtroi teorinë e një faze gojore në zhvillimin e ungjijve sinoptike (greqisht, "shoh së bashku"). Ai dha mendimin se të tre ungjijtë u bazuan në tradita më të hershme gojore, të cilat shkruesit i modifikuan për t'ua përshtatur dëgjuesve të tyre të veçantë.
 - a. Mateu: judenjve
 - b. Marku: romakëve
 - c. Luka: johebrenjve

Secili prej tyre lidhej me një qendër të caktuar gjeografike të krishterimit

 - a. Mateu: Antioki, Siri ose Jude
 - b. Marku: Romë, Itali
 - c. Luka: Cezarea në anë të detit, Palestinë, ose Akai
 - d. Gjoni: Efes, Azi e Vogël
 3. Në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë, J. J. Griesbach nxori teorinë se Mateu dhe Luka shkruan rrëfimet e tyre për jetën e Jezusit, plotësisht në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri. Marku shkroi një ungjill të shkurtër në përpjekje për të qenë diçka midis këtyre dy rrëfimeve të mëparshme.
 4. Në fillim të shekullit të njëzetë, H. J. Holtzmann parashtroi teorinë se Marku ishte ungjilli i parë që u shkrua dhe se Mateu dhe Luka e përdorën strukturën e Markut së bashku me një dokument tjetër që përmbante thëniet e Jezusit (dhe quhej Q, në gjermanisht *quelle*, ose "burim"). Kjo u quajt teoria e "dy burimeve" (e përkrahur dhe nga Frederick Schleiermacher më 1832).
 5. Më vonë, B. H. Streeter parashtroi një teori të modifikuar "të dy burimeve", e quajtur teoria e "katër burimeve", ku ai shtoi dhe një "proto-Lukë" bashkë me Markun dhe bashkë me Q-në.
 6. Teoritë e mësipërme për formimin e ungjijve sinoptikë janë thjesht hamendësime. Nuk ka të dhëna historike apo dorëshkrimore për ekzistencën e burimit "Q", ose të "proto-Lukës".

Bota e sotme studimore nuk e di sesi u zhvilluan ungjijtë, apo se kush i shkroi (e njëjta gjë vlen dhe për ligjin e DHV dhe profetët e hershëm). Megjithatë, kjo mungesë të dhënash nuk

ndikon aspak negativisht në pikëpamjen që ka kisha për frymëzimin ose besueshmërinë e tyre si dokumente historike dhe besimi.

7. Ungjijtë sinoptikë përmbajnë ngjashmëri të qarta në strukturë dhe fjali, por edhe shumë dallime interesante. Dallimet janë diçka e zakonshme në rrëfimet e dëshmitarëve okularë. Kisha e hershme nuk shqetësohej nga dallimet mes këtyre rrëfimeve okulare të jetës së Jezusit.

Arsye të mundshme për këto dallime në dukje mund të kenë qenë dëgjuesit e synuar të secilit ungjill, stili i secilit autor dhe gjuhët e ndryshme të përdorura (aramaisht dhe greqisht). Duhet tëhënë se këta shkrues, redaktorë, apo përpilues të frymëzuar kishin lirinë që të përzgjidhnin, rendisnin, përshtasnin dhe përmblihdnin ngjarjet dhe mësimet e jetës së Jezusit sipas nevojës (shih *How to Read the Bible for All Its Worth*, nga Fee dhe Stuart, f. 113-148).

- B. Luka shprehet qartë se bëri hulumtime (shih Luka 1:1-4) për jetën e Jezusit në bazë të dëshmitarëve okularë. Burgosja e Palit në Cezarenë përbri detit në Palestinë i dha Lukës kohë dhe mundësi takimi me këta njerëz. Kapitujt 1-2 ndoshta pasqyrojnë kujtimet e Marisë (shih Sir Eilliam Ramsay, *Was Christ Born at Bethlehem?*); e njëjta gjë mund të thuhet dhe për gjenealogjinë e kapitullit 3.
- C. Një sërë burimesh të kishës së hershme përmendin faktin se Luka ishte shoqëruar dhe bashkërrugëtar misionar i apostullit Pal. Disa prej këtyre burimeve të hershme thonë se ungjilli i Lukës u bazua dhe te predikimet e Palit. Nuk mund të mohohet se misioni mbarëbotëror i ungjillit identifikohet qartë si profeci e përmbushu te Luka, Veprat dhe shkrimet e Palit.

VIII. NATYRA UNIKE E LUKËS

- A. Dy kapitujt e parë shfaqen vetëm te Luka dhe mund të kenë ardhur nga Maria; e njëjta dhe vlen dhe për gjenealogjinë e 3:23-28.
- B. Mrekulli që përmenden vetëm te Luka
 1. ringjallja e birit të vejushës së Nainit, 7:12-17
 2. gruaja e sëmurë në sinagogë shërohet ditën e shabatit, 13:10-17
 3. i sëmuri në sinagogë shërohet në shabat, 14:1-6
 4. shërimi i dhjetë lebrozëve; vetëm njëri, një samaritan, kthehet të falënderojë Jezusin, 17:11-18
- C. Shëmbëlltira që shfaqen vetëm te Luka
 1. Samaritani i mirë, 10:25-37
 2. Miku këmbëngulës, 11:5-13
 3. Pasaniku mendjelehtë, 12:13-21
 4. Monedha e humbur, 15:8-10
 5. Dy bijtë, 15:11-32
 6. Administratori i padrejtë, 18:1-8
 7. Fariseu dhe tagrambledhësi, 18:9-14
- D. Shëmbëlltira të Lukës, që shfaqen dhe tek Mateu, por përdoren ndryshe
 1. 12:39-46 (Mat. 24:43-44)
 2. 14:16-24 (Mat. 22:2-14)
 3. 19:11-27 (Mat. 25:14-30)
- E. Rrëfime të tjera unike
 1. Ngjarjet e dy kapitujve të parë
 2. Tagrambledhësi Zake, 19:1-10
 3. Pilati dërgon Jezusin te Herodi për ta marrë në pyetje, 23:8-12
 4. Dy dishepujt në rrugën për në Emaus, 24:13-32
- F. Elementet më unike tek Luka gjenden në 9:51-18:14. Këtu, Luka nuk bazohet te Marku apo te “Q” (pra, te thëniet e Jezusit që, ndoshta, u shkruan nga Mateu). Edhe ngjarjet ose mësimet e ngjashme

jepen në formë tjetër. Motivi përbashkues i kësaj pjese është “në udhën për në Jerusalem” (shih 9:51; 13:22, 33; 17:11; 18:31; 19:11, 28), që, në të vërtetë, ishte rruga e Jezusit drejt kryqit.

IX. FJALË DHE FRAZA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

1. Shterpë, 1:7
2. Shpengim, 1:6, 8
3. Biri i shpëtimit, 1:69
4. Regjistrimi, 2:1
5. Zelot, 6:15
6. Mbretëria e Perëndisë, 6:20
7. I ramë flautit, 7:32
8. Drejtuesi i sinagogës, 8:49
9. Biri i Njeriut duhet të vuajë, 9:22
10. Samaritan, 10:33
11. Mjerë ju! 11:42, 43, 44, 47, 52
12. Pendohuni, 13:3, 5
13. Dera e ngushtë, 13:24
14. Të mbajë kryqin e vet, 14:27
15. Mamoni, 16:11
16. Ligji dhe Profetët, 16:16
17. Në gji të Abrahamit, 16:22
18. Gur mulliri, 17:2
19. Derisa të përmbushet koha e johebrenjve, 21:24
20. Këshilli i pleqve, 22:66
21. Parajsë, 23:43

X. PERSONA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

1. Teofil, 1:3
2. Zakaria, 1:5
3. Një engjëll i Zotit, 1:11; 2:9
4. Gabriel, 1:26
5. Kuirin, 2:2
6. Ana, 2:36
7. Tiberi, 3:1
8. Herod tetrarku, 3:1, 19
9. Kajafa, 3:2
10. Naamani, 4:2
11. Mbretëresha e jugut, 11:31
12. Zakaria, 10:51
13. Lazar, 16:23
14. Zake, 19:2
15. Jozef, 23:50
16. Kleopa, 24:18

XI. VENDNDOHJE QË DUHEN GJETUR NË HARTË

1. Galile, 1:26
2. Nazaret, 1:4
3. Betlehem, 1:4
4. Iturea, 3:1
5. Betsaida, 9:10
6. Korazin, 10:13

7. Tir, 10:13
8. Kapernaum, 10:15
9. Samari, 17:11
10. Sodom, 17:29
11. Jeriko, 19:1
12. Emaus, 24:13
13. Betani, 24:50

XII. PYETJE PËR DISKUTIM

1. Cila është domethënia e faktit se Perëndia ua zbuloi lindjen e Jezusit së pari disa barinjve?
2. Cila është domethënia e shprehjes së Jezusit në 2:49?
3. Pse kthehet pas deri tek Adami gjenealogjia e Lukës?
4. Si po e thyenin ligjin dishepujt në 6:1-5? Cilat ligje po thyenin?
5. Shpjego fjalët e Jezusit në 6:46.
6. Pse dyshoi Gjoni te Jezusi si Mesia i premtuar në kapitullin 17:18-23?
7. Pse donin banorët e Gerasenës që të largohej Jezusi?
8. Shpjego me fjalët e tua domethënien e 9:62.
9. Kur ra nga qielli Satani? (10:18)
10. Pse i urrenin judenjtë samaritanët?
11. A nënkupton 12:41-48 se ferri ka shkallë ose nivele të ndryshme dënimi?
12. Shpjego 13:28-30 me fjalët e tua.
13. Cili është qëllimi (ose qëllimet) i shëmbëlltyrës së djalit plangprishës në 15:11-32?
14. Shpjego 16:18 me fjalë e tua, por sigurohu ta interpretosh në bazë të kontekstit historik.
15. A mbështet 17:34-35 konceptin e rrëmbimit të fshehtë? Pse, ose pse jo?
16. Pse është pyetje e rëndësishme ajo që gjendet në 20:2?
17. Cilët janë vreshtarët, sipas 20:10?
18. A ishte i përgjegjshëm për veprimet e tij Juda në bazë të 22:3?
19. Pse është e rëndësishme që Luka shkroi vargun 23:20?

HYRJE PËR GJONIN

I. SHËNIME HYRËSE

- A. Mateu dhe Luka fillojnë me lindjen e Jezusit, Marku ia nis nga pagëzimi i tij, ndërsa Gjoni fillon para krijimit.
- B. Gjoni paraqet natyrën e plotë hyjnore të Jezusit të Nazaretit që në vargun e parë të kapitullit të parë dhe këtë theks e përsërit gjatë gjithë ungjillit. Ungjijtë sinoptikë e fshehin këtë të vërtetë deri nga fundi i prezantimeve të tyre (“sekreti mesianik”).
- C. Me sa duket, Gjoni e zhvillon ungjillin e vet në dritën e pohimeve themelore të ungjijve sinoptikë. Ai përpiket të shtojë dhe të interpretojë jetën dhe mësimet e Jezusit në dritën e nevojave të kishës së hershme (fondi i shekullit të parë).
- D. Gjoni duket se e strukturon prezantimin që i bën Jezus Mesisë rreth
1. shtatë mrekullish/shenjash dhe interpretimit të tyre
 2. njëzeteshtatë intervistash dhe/ose dialogësh me individë
 3. ditësh të caktuara adhurimi dhe festash
 - a. Shabati
 - b. Pashka (shih Gjoni 5-6)
 - c. Festa e Tabernakujve (shih Gjoni 7-10)
 - d. Hanuka (shih Gjoni 10:22-39)
 4. Pohimeve “Unë jam”
 - a. të lidhura me emrin hyjnor (JHVH)
 - 1) unë jam ai (Gjoni 4:26; 8:24, 28; 13:19; 18:5-6)
 - 2) përpara se të ishte Abrahami, unë jam (Gjoni 8:54-59)
 - b. me kallëzues emëror
 - 1) unë jam buka e jetës (Gjoni 6:35, 41, 48, 51)
 - 2) unë jam drita e botës (Gjoni 8:12)
 - 3) unë jam dera e deleve (Gjoni 10:7, 9)
 - 4) unë jam bari i mirë (Gjoni 10:11, 14)
 - 5) unë jam ringjallja dhe jeta (Gjoni 11:25)
 - 6) unë jam udha, e vërteta dhe jeta (Gjoni 14:6)
 - 7) unë jam hardhia e vërtetë (Gjoni 15:1, 5)
- E. Ndryshimet mes Gjonit dhe ungjijve të tjerë
1. Ndonëse është e vërtetë se qëllimi parësor i Gjonit është teologjik, përdorimi që i bën historisë dhe gjeografisë është jashtëzakonisht i saktë dhe i hollësishëm. Arsyeja e sigurt për mospërputhjet mes ungjijve sinoptikë dhe Gjonit është e paqartë
 - a. një shërbesë e hershme në Jude (pastrimi i hershëm i tempullit)
 - b. kronologjia dhe data e javës së fundit të jetës së Jezusit
 - c. një ristrukturim i qëllimshëm teologjik
 2. Do të ishte e dobishme të kalonim një çast për të diskutuar dallimin e dukshëm mes Gjonit dhe ungjijve sinoptikë. Më lejoni të citoj George Eldon Ladd nga *A Theology of the New Testament (Teologji e Dhiatës së Re)* për dallimet:
 - a. “Ungjilli i katërt është kaq i ndryshëm nga sinoptikët saqë duhet të përballemi ndershmërisht me pyetjen nëse ai i raporton saktësisht mësimet e Jezusit, apo nëse besimi i krishterë e ka modifikuar kaq shumë traditën saqë historia është përpirë nga interpretimi teologjik” (f. 215).
 - b. “Zgjidhja që duket si më e kapshme është se mësimet e Jezusit shprehen me zhargonin johanin. Nëse kjo është zgjidhja e saktë, dhe nëse duhet të arrijmë në përfundimin se ungjilli i katërt është i veshur me zhargonin johanin, ngrihet kjo pyetje e rëndësishme: në çfarë shkalle teologjia e ungjillit të katërt është e Gjonit, dhe jo e Jezusit? Në çfarë shkalle është asimiluar

- mësimi i Jezusit kaq shumë në mendjen e Gjonit saqë ajo që kemi përpara është më tepër një interpretim johanin sesa një paraqitje e saktë e vetë mësimit të Jezusit?” (f. 215).
- c. Ladd citon dhe W. F. Albright, nga “Recent Discoveries in Palestine and the Gospel of John” (Zbulimet e kohëve të fundit në Palestinë dhe ungjilli i Gjonit) në *The Background of the New Testament and Its Eschatology (Sfondi i Dhiatës së Re dhe eskatologjia e saj)*, redaktuar prej W. D. Davies dhe D. Daube
- “Nuk ka asnjë dallim themelor në mësim midis Gjonit dhe sinoptikëve; kontrasti mes tyre gjendet në përqendrimin e traditës rreth disa aspekte të veçanta të mësimave të Krishtit, veçanërisht ato që duket se i ngjanin më ngushtësisht mësimit të esenëve.
- Nuk ka absolutisht asgjë që të demonstrojë se ndonjë nga mësimet e Jezusit është shtrembëruar apo falsifikuar, apo se atyre u është shtuar ndonjë element i ri jetik. Faktin se nevojat e kishës së hershme ndikuan në përzgjedhjen e elementeve që do të përfshiheshin në ungjill mund ta pranojmë pa ngurrim, por nuk ka arsye të hamendësojmë se nevojat e asaj kishe ishin përgjegjëse për ndonjë shpikje apo risi me vlerë teologjike.
- Një nga supozimet më të çuditshme të studiuesve dhe teologëve kritikë të Dhiatës së Re është se mendja e Jezusit ishte kaq e kufizuar saqë çdo kontrast në dukje mes Gjonit dhe sinoptikëve duhet të jetë për shkak të dallimeve mes teologëve të krishterë të hershëm. Çdo mendimtar dhe personalitet i madh ka për t’u interpretuar ndryshe nga miqtë dhe dëgjuesit e ndryshëm, të cilët do të përzgjedhin atë që duket si më e pëlqyeshme ose më e dobishme nga ato që kanë parë dhe dëgjuar” (f. 170-171).
- d. Dhe sërish nga George E. Ladd:
- “Dallimi mes tyre nuk është se Gjoni është teologjik ndërsa të tjerët jo, por se të gjithë janë teologjikë në mënyra të ndryshme. Historia e interpretuar mund t’i paraqesë më vërtetësisht faktet e një situatë sesa kronika e thatë e ngjarjeve. Nëse Gjoni është interpretim teologjik, ai është një interpretim ngjarjesh që Gjoni është i bindur se ndodhën në histori. Qartazi, synimi i ungjijve sinoptikë nuk është të japin raportimin e *ipsissima verba* (fjalëve të sakta) të Jezusit, apo një biografi të ngjarjeve të jetës së tij. Ato janë portrete të Jezusit dhe përmbledhje të mësimit të tij. Mateu dhe Luka ndihen të lirë të rirendisin materialin e Markut dhe të raportojnë mësimin e Jezusit me liri të madhe. Nëse Gjoni tregoi më tepër liri se Mateu dhe Luka, këtë e bëri pasi dëshironte të jepte një portret më të thellë dhe, në fund fare, më real të Jezusit” (f. 221-222).

II. AUTORI

- A. Ungjilli është anonim, por aludon për autorësinë e Gjonit.
1. autori është dëshmitar okular (shih Gjoni 19:35)
 2. fraza “dishepulli i dashur” (si Polikrati, ashtu dhe Ireneu, e identifikojnë me Gjon apostullin)
 3. Gjoni, biri i Zebedeut, s’përmendet kurrë me emër
- B. Sfondi historik është i qartë nga vetë ungjilli; si rrjedhojë, çështja e autorësisë nuk është faktor kyç për interpretimin. Thelbësor është pohimi i një autori të frymëzuar!
- Autorësia dhe data e ungjillit të Gjonit nuk prekin frymëzimin, por interpretimin. Komentuesit kërkojnë një sfond historik, një shkas që i dha shtysë shkrimit të librit. A duhet të krahasojmë dualizmin e Gjonit me (1) dy epokat judaike; (2) mësuësin e drejtësisë të Kumranit; (3) fenë zoroastriane; (4) mendimin gnostik; (5) perspektivën unike të Jezusit?
- C. Pikëpamja e hershme tradicionale është se apostulli Gjon, biri i Zebedeut, është burimi njerëzor si dëshmitar okular. Kjo duhet qartësuar pasi burimet e jashtme nga shekulli i dytë duket se lidhin disa të tjerë me prodhimin e ungjillit:
1. Bashkëbesimtarët dhe pleqtë efesianë inkurajuan apostullin e moshuar që të shkruante (Euzebi citon Klementin e Aleksandrisë)
 2. Një bashkë-apostull, Andrea (Fragmenti Muratorian, 180-220 pas K., nga Roma)

- D. Disa studiues të sotëm kanë supozuar një autor tjetër në bazë të një sërë supozimesh për stilin dhe lëndën e ungjillit. Shumë syresh supozojnë një datim në fillim të shekullit të dytë (përpara 115 pas K.):
1. shkruar nga dishepujt e Gjonit (një rreth ndikimi johanin), të cilët kujtonin mësimet e tij (J. Weiss, B. Lightfoot, C. H. Dodd, O. Cullmann, R. A. Culpepper, C. K. Barrett)
 2. shkruar nga “plaku Gjon” (njëri prej një sërë drejtuesve të hershëm nga Azia që u ndikuan nga teologjia dhe terminologjia e apostullit Gjon), një ide e deduktuar nga një pasazh i paqartë të Papi (70-146 pas K.), cituar nga Euzebi (280-339 pas K.).
- E. Prova për vetë Gjonin si burimi parësor për materialin e ungjillit
1. provat e brendshme
 - a. autori njihnte mësimet dhe ritualet judaike dhe ndante botëkuptimin e tyre të Dhiatës së Vjetër
 - b. autori njihnte Palestinën dhe Jerusalem në gjendjen e tyre para vitit 70
 - c. autori pretendon se është dëshmitar okular
 - 1) Gjoni 1:14
 - 2) Gjoni 19:35
 - 3) Gjoni 21:24
 - d. autori ishte anëtar i grupit apostolik, sepse njeh:
 - 1) hollësitë e kohës dhe vendit (grykimet natën)
 - 2) hollësitë e numrave (enëve të ujit të Gjoni 2:6 dhe peshqit të Gjoni 21:11)
 - 3) hollësitë e personave
 - 4) autori njihnte hollësitë e ngjarjeve dhe reagimin ndaj tyre
 - 5) autori duket se përcaktohet si “dishepulli i dashur”
 - a) Gjoni 13:23, 25
 - b) Gjoni 19:26-27
 - c) Gjoni 20:2-5,8
 - d) Gjoni 21:7, 20-24
 - 6) autori duket se është anëtar i rrethit të brendshëm, bashkë me Pjetrin
 - a) Gjoni 13:24
 - b) Gjoni 20:2
 - c) Gjoni 21:7
 - 7) Emri “Gjoni, biri i Zebedeut” nuk shfaqet kurrë në këtë ungjill, gjë që duket tejet e pazakontë, pasi ai ishte anëtar i rrethit të brendshëm apostolik
 - e. Provat e jashtme
 - 1) Ungjilli njihet nga
 - a) Ireneu (120-202 pas K.), i cili shoqërohej me Polikarpin, njihnte apostullin Gjon (shih *Historia Ecclesiastica* e Euzebit, 5:20:6-7) – “Gjoni, dishepulli i Zotit, i cili mbështetej në gjoksin e tij dhe vetë botoi ungjillin në Efes të Azisë” (*Haer.* 3:1:1, cituar nga Euzebi në *Hist. Eccl.* 5:8:4).
 - b) Klementi i Aleksandrisë (153:217 pas K.) – “Gjoni, i cili u nxit nga miqtë e vet dhe u shty në mënyrë hyjnore nga Fryma, përpiloi një ungjill shpirtëror” (Euzebi, *Historia Ecclesiastica* 6:14:7).
 - c) Justin Martiri (110-165 pas K.), në librin e tij *Dialog me Trifonin* 81:4
 - d) Tertuliani (145-220 pas K.)
 - 2) Autorësia e Gjonit pohohet nga dëshmitarë shumë të hershëm
 - a) Polikarpi (70-156 pas K., dokumentuar nga Ireneu), i cili ishte peshkop i Smirnës (155 pas K.)
 - b) Papi (70-146 pas K., dokumentuar nga Prologu anti-Markonit në Romë dhe nga Euzebi), i cili ishte peshkopi i Hierapolit në Frigji dhe thuhej se ishte dishepull i apostullit Gjon
- F. Arsyet që përdoren për të dyshuar autorësinë tradicionale
1. Lidhja e ungjillit me motive gnostike
 2. Shtojca e dukshme e kapitullit 21

3. Mospërputhjet kronologjike me ungjijtë sinoptikë
4. Gjoni nuk do ta kishte quajtur veten “dishepulli i dashur”
5. Jezusi i Gjoni përdor fjalor dhe gjini të ndryshme letrare nga sinoptikët

- G. Nëse supozojmë se autori ishte apostulli Gjon, atëherë çfarë mund të supozojmë për këtë njeri?
1. Ai shkroi nga Efesi (Ireneu thotë se “botoi ungjillin nga Efesi”)
 2. Ai shkroi kur ishte më i moshuar (Ireneu thotë se jetoi deri në mbretërimin e Trajanit, 98-117 pas K.)

III. DATA

A. Nëse pranojmë apostullin Gjon

1. përpara 70 pas K., kur Jerusalem u shkatërrua nga gjenerali (më vonë, perandori) romak Titi
 - a. në Gjoni 5:2: “Në Jerusalem, pranë portës së dheneve është një pellg që në hebraisht quhet Betesda, dhe ka pesë portikë...”
 - b. përdorimi i përsëritur i titullit të hershëm “dishepujt” për të përcaktuar grupin e apostujve
 - c. elemente, që supozoheshin se i përkisnin gnosticizmit të mëvonshëm, tani janë zbuluar në Pergamenat e Detit të Vdekur, të cilat tregojnë se ishin pjesë e zhargonit teologjik të shekullit të parë
 - d. asnjë përmendje e shkatërrimit të Tempullit dhe qytetit të Jerusalemit në 70 pas K.
 - e. arkeologu i famshëm amerikan, W. F. Albright, pohon për ungjillin një datim në fundin e viteve 70’ ose fillimin e viteve ‘80
2. më vonë në shekullin e parë
 - a. teologjia e zhvilluar e Gjoni
 - b. rënia e Jerusalemit nuk përmendet, pasi ndodhi para rreth njëzet vitesh
 - c. përdorimi i frazave dhe thekseve të llojit gnostik nga ana e Gjoni
 - d. traditat e hershme të kishës
 - 1) Ireneu
 - 2) Euzebi

- B. Nëse supozojmë “plakun Gjon”, atëherë data do të ishte fillimi ose mesi i shekullit të dytë. Kjo teori nisi me refuzimin e autorësisë së apostullit Gjon nga Dionisi (për arsye letrare). Euzebi, i cili e refuzoi autorësinë e apostullit Gjon për Zbulesën për arsye teologjike, mendonte se kishte gjetur një tjetër “Gjon” në kohën dhe në vendin e duhur në citimin e Papiasit (*Historia Ecclesiastica* 3:39:5, 6), i cili rendit dy “Gjona”: (1) apostullin dhe (2) një plak (presbiter).

IV. MARRËSIT

- A. Fillimisht u shkrua për kishat e provincës romake të Azisë së vogël, veçanërisht për Efesin.
- B. Për shkak të thjeshtësisë kuptimplotë dhe thellësisë së këtij rrëfimi të jetës dhe personit të Jezusit së Nazaretit, ky u bë ungjill i preferuar, si për besimtarët helenistë dhe johebrenj, ashtu dhe për grupet gnostike.

V. QËLLIMET

- A. Vetë ungjilli pohon synimin e vet ungjillëzues, Gjoni 20:30-31
1. për lexuesit hebrenj
 2. për lexuesit johebrenj
 3. për lexuesit e hershëm gnostikë
- B. Duket se ka një shtysë apologjetike
1. kundër ndjekësve fanatikë të Gjon Pagëzorit

2. kundër mësuesve të rremë të gnosticizmit që po mbinte (sidomos Prologu); këto mësimet të rreme gnostike formojnë dhe sfondin e librave të tjerë të Dh.R.:
 - a. Efesianët
 - b. Kolosianët
 - c. Letrat pastorale (1 Timoteu, Titi, 2 Timoteu)
 - d. 1 Gjoni (1 Gjoni mund të ketë funksionuar si letër shpjeguese për ungjillin)

- C. Ekziston mundësia që pohimi i synimit të Gjoni 20:31 të kuptohet sikur nxit jo vetëm ungjillizimin, por edhe doktrinën e qëndrueshmërisë, për shkak të përdorimit të vazhdueshëm të KOHËS SË TASHME për të përshkruar shpëtimin. Në këtë kuptim, Gjoni, ashtu si Jakobi, ndoshta po drejtpeshon një mbitheksim të teologjisë së Palit nga ana e disa grupeve në Azinë e vogël (shih 2 Pjetri 3:15-16). Është e habitshme që tradita e kishës së hershme identifikon Gjonin, dhe jo Palin, me Efesin (shih F. F. Bruce, *Peter, Stephen, James and John: Studies in Non-Pauline Christianity* [Pjetri, Stefani, Jakobi dhe Gjoni: studime për krishterimin jopalian], f. 120-121).

- D. Epilogu (Gjoni 21) duket se u përgjigjet pyetjeve të veçanta të kishës së hershme
 1. Gjoni plotëson rrëfimet e ungjijve sinoptikë. Sidoqoftë, ai fokusohet në shërbesën në Jude, veçanërisht në Jerusalem.
 2. Tre pyetjet që mbulon Shtojca, Gjoni 21
 - a. rimëkëmbja e Pjetrit
 - b. jetëgjatësia e Gjoni
 - c. kthimi i vonuar i Jezusit

- E. Disa mendojnë se Gjoni i heq theksin sakramentalizmit duke anashkaluar qëllimisht dhe duke mos shënuar ose diskutuar vetë sakramentet, pavarësisht mundësive të përsosura kontekstuale në Gjoni 3 (për pagëzimin) dhe Gjoni 6 (për eukaristinë, ose Darkën e Zotit).

VI. PËRVIJIMI BAZOHET TEK

- A. Një prolog filozofik/teologjik (Gjoni 1:1-18) dhe një epilog praktik (Gjoni 21)

- B. Shtatë shenja mrekulie gjatë shërbesës publike të Jezusit (kapitujt 2-12) dhe interpretimi i tyre:
 1. ndryshimi i ujit në verë në festën e dasmës në Kanë (Gjoni 2:1-11)
 2. shërimi i birit të nëpunësit të mbretit në Kapernaum (Gjoni 4:46-54)
 3. shërimi i ulokut në pellgun e Betesdës në Jerusalem (Gjoni 5:1-18)
 4. ushqyerja e rreth 5,000 vetëve në Galile (Gjoni 6:1-15)
 5. ecja mbi Detin e Galilesë (Gjoni 6:16-21)
 6. shërimi i burrit që kishte lindur i verbër në Jerusalem (Gjoni 9:1-41)
 7. ringjallja e Llazarit në Betani (Gjoni 11:1-57)

- C. Intervistat dhe dialogët me individë të ndryshëm
 1. Gjon Pagëzori (Gjoni 1:19-34; 3:22-36)
 2. dishepuj
 - a. Andrea dhe Pjetri (Gjoni 1:35-42)
 - b. Filipi dhe Natanaeli (Gjoni 1:43-51)
 3. Nikodemi (Gjoni 3:1-21)
 4. gruaja nga Samaria (Gjoni 4:1-45)
 5. judenjtë në Jerusalem (Gjoni 5:10-47)
 6. turma në Galile (Gjoni 6:22-66)
 7. Pjetri dhe dishepujt (Gjoni 6:67-71)
 8. vëllezërit e Jezusit (Gjoni 7:1-13)
 9. judenjtë në Jerusalem (Gjoni 7:14-8:59; 10:1-42)
 10. dishepujt në dhomën e sipërme (Gjoni 13:1-17:26)
 11. arrestimi dhe gjykimi judaik (Gjoni 18:1-27)

12. gjykimi romak (Gjoni 18:28-19:16)
13. bisedat pas ringjalljes, 20:11-29
 - a. me Marinë
 - b. me dhjetë apostujt
 - c. me Thomain
14. dialogu në epilog me Pjetrin, Gjoni 21:1-25.
15. (Gjoni 7:53-8:11, ndodhia e gruas kurorëshkelëse, nuk ishte pjesë e ungjillit të Gjonit që në fillim!)

D. Disa ditë adhurimi/festash

1. shabatet (Gjoni 5:9; 7:22; 9:14; 19:31)
2. pashkët (Gjoni 2:13; 6:4; 11:55; 18:28)
3. festa e Tabernakujve (Gjoni 8-9)
4. Hanuka (festivali i dritave, shih Gjoni 10:22)

E. Përdorimi i pohimeve “unë jam”

1. “Unë jam ‘Ai’” (Gjoni 4:26; 6:20; 8:24, 28, 54-59; 13:19; 18:5-6, 8)
2. “Unë jam buka e jetës” (Gjoni 6:35, 41, 48, 51)
3. “Unë jam drita e botës” (Gjoni 8:12; 9:5)
4. “Unë jam dera e deleve” (Gjoni 10:7, 9)
5. “Unë jam bari i mirë” (Gjoni 10:11, 14)
6. “Unë jam ringjallja dhe jeta” (Gjoni 11:25)
7. “Unë jam udha, e vërteta dhe jeta” (Gjoni 14:6)
8. “Unë jam hardhia e vërtetë” (Gjoni 15:1, 5)

VII. FJALË DHE FRAZA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

1. Fjala, 1:1
2. Besoj, 1:7
3. “bota u bë prej tij”, 1:10
4. “Fjala u bë mish”, 1:14
5. E vërteta, 1:17
6. Profeti, 1:21
7. Qengji i Perëndisë, 1:29
8. “si pëllumb”, 1:32
9. Rabin, 1:38
10. “Me të vërtetë, me të vërtetë”, 1:51
11. “engjëjt e Perëndisë që ngjitendhe zbresin”, 1:51
12. “gjashtë qypa guri”, 2:6
13. “drejtues i judenjve”, 3:1
14. “i rilindur”, 3:3
15. “Biri i Perëndisë duhet të ngrihet lart”, 3:14; 12:34
16. “jeta e përjetshme”, 3:16
17. “unë jam buka e jetës”, 6:35, 48
18. “Festa e Kasolleve”, 7:2
19. “Ti ke demon”, 7:20; 8:48; 10:20
20. Shpërndarja (diaspora), 7:35
21. “Jezusi nuk ishte përlëvduar ende”, 7:39
22. “përpara se të lindte Abrahami, unë jam”, 8:58
23. “e përjashtuan nga sinagoga”, 9:22
24. “dera e deleve”, 10:7
25. “Festa e Kushtimit”, 10:22
26. Blasfemim, 10:36
27. “gjeti një këriç, u ul mbi të”, 12:14

28. “ora”, 12:23
29. “atëherë, Satani hyri në të”, 13:27
30. “një urdhërim të ri”, 13:34
31. “vendbanime”, 14:2
32. “qëndroni në mua”, 15:4
33. “duke ngritur sytë nga qielli”, 17:1
34. “i vetmi Perëndi i vërtetë”, 17:3
35. “përpara themelimit të botës”, 17:24
36. E rrahën me kamxhik, 19:1
37. Gabbata, 19:13
38. Golgota, 19:17
39. “i kërkuan Pilatit që t’u thyeshin këmbët”, 19:31
40. “dita judaike e përgatitjes”, 19:42

VIII. PERSONA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

1. Gjon, 1:6
2. Biri i Perëndisë, 1:34
3. Mesia, 1:41
4. Kefa, 1:42
5. Nikodem, 3:1
6. Profeti, 7:40
7. Lazar, 11:2
8. Didimus, 11:16
9. Judë Iskarioti, 13:2
10. Ndhmësi, 14:26
11. Malkus, 18:10
12. Ana, 18:24
13. Maria, gruaja e Kleopës, 19:25

IX. VENDNDODHJET QË DUHEN GJENDUR NË HARTË

1. Galile, 1:43
2. Nazaret, 1:45
3. Kana, 2:1
4. Kapernaum, 2:12
5. Aeonni pranë Salimit, 3:23
6. Samaria, 4:4
7. Tiberiada, 6:1
8. Betlehem, 7:42
9. Betani, 11:1
10. Kidron, 18:1
11. Deti i Tiberiadës, 21:1

X. PYETJE PËR DISKUTIM

1. Pse është kaq i rëndësishëm Gjoni 1:1?
2. Pse ishte i pazakontë pagëzimi i Gjoni?
3. Ç’do të thotë të lindësh sërish/ të rilindësh?
4. Cila është lidhja mes “besoj” dhe “bindem” në 3:35?
5. Ç’do të thotë 4:24?
6. Pse është në kllapa katrore Gjoni 5:4?
7. A nënkupton 9:2 rimishërimin? Nëse jo, shpjego pse.
8. Shpjego ironinë e 9:41.

9. Shpjego me fjalët e tua pasazhin 10:34-35.
10. Pse ua lau Jezusi këmbët dishepujve në kapitullin 13? Cili është konteksti i kapitujve 13-17?
11. Pse është kaq i rëndësishëm Gjoni 14:6?
12. Pse është kaq i rëndësishëm Gjoni 14:23?
13. Shpjego Gjoni 15:16.
14. Gjoni 17 quhet “Lutja kryepriiftërore e Jezusit”. Ai lutet për tre grupe të ndryshëm njerëzish: përmendi.
15. Shpjego bisedën mes Jezusit dhe Pilatit në Gjoni 18:33-38.
16. A e morën dishepujt Frymën në 20:22, apo në ditën e Rrëshajëve (Veprat 1)?
17. Pse është i rëndësishëm Gjoni 20:31?

HYRJJE PËR VEPRAT E APOSTUJVE

I. SHËNIME HYRËSE

- A. Veprat shërbejnë si hallkë e domosdoshme për të lidhur rrëfimet e jetës së Jezusit (ungjijtë) me predikimin e apostujve në Veprat, me interpretimin e tyre dhe me zbatimin e letrave apostolike në Dhiatën e Re.
- B. Kisha e hershme zhvilloi dhe qarkulloi dy grupime shkrimesh të Dhiatës së Re: (1) ungjijtë (katër ungjijtë) dhe (2) *Apostullin* (pra, letrat e Palit). Ndërkaq, me shfaqjen e herezive të hershme kristologjike në shekullin e dytë, vlera e librit të Veprave del në pah. Veprat na zbulon këtë përmbledhje dhe qëllim të predikimit apostolik (*kerigma*) dhe rezultatet e mahnitshme të ungjillit.
- C. Saktësia historike e Veprave është theksuar dhe pohuar nga zbulimet e sotme arketologjike, sidomos për sa i përket titullit të zyrtarëve romakë (p.sh., *stregigoi*, 16:20, 22, 35, 36 [që përdorej dhe për kapitenët e tempullit, Luka 22:4, 52; Veprat 4:1; 5:24-26]; *politarkas*, 17:6,8; dhe *proto*, Veprat 28:7; shih A. N. Sherwin-White, *Roman Society and Roman Law in the New Testament*). Luka përmend tensione brenda kishës së hershme, madje dhe zënkën mes Palit dhe Barnabës (shih Veprat 15:39). Kjo tregon se ai shkroi në mënyrë të ndershme, të drejtpeshuar dhe me hulumtime të sakta historiko-teologjike.

D. Titulli i librit gjendet në forma disi të ndryshme në tekstet e hershme greke:

1. Dorëshkrimi *Alef* (Sinaitikus), Tertuliani, Didimus, Euzebi e quajnë “Veprat” (ASV, NIV)
2. Dorëshkrimet B (Vatikanus), D (Beza) në një mbishkrim, Ireneu, Teruliani, Kipriani dhe Athanasi e quajnë “Veprat e Apostujve” (KJV, RSV, NEB)
3. Dorëshkrimet A² (pra, korrigjuesi i parë i kodikut Aleksandinus), E, G dhe Gojarti e quajnë “Veprat e Apostujve të Shenjtë”

Ka mundësi që fjala greke *prakseis*, *praksis* (pra, veprat, mënyrat, sjellja, praktika) të pasqyrojë një gjini letrare të lashte të Msedheut, që shkruan për jetën dhe veprat e njerëzve të famshëm ose me ndikim (p.sh., Gjoni, Pjetri, Stefani, Filipi, Pali). Ndoshta, në fillim, ky libër nuk kishte titull (si ungjilli i Lukës).

E. Ekzistojnë dy tradita të veçanta tekstuale për Veprat. Më e shkurtra është ajo aleksandriane (dorëshkrimet P45, P74, *Alef*, A, B, C). Familja “perëndimore” e dorëshkrimeve (P29, P38, P48 dhe D) duket se përfshin shumë më tepër hollësi. Është e paqartë nëse ato vijnë nga autori, apo janë ndërfaqe të mëvonshme nga kopjuesit, në bazë të traditave të kishës së hershme. Shumica e studiuesve tekstualë mendojnë se dorëshkrimet “perëndimore” janë shtesa të mëvonshme pasi (1) thjeshtësojnë, ose përpriqen të rregullojnë, pasazhe të vështira ose të pazakonta; (2) shtojnë hollësi të mëtejshme; (3) shtojnë fraza të veçanta që theksojnë se Jezusi është Krishti; dhe (4) nuk citohen nga asnjë shkrimtar i hershëm i krishterë në tre shekujt e parë (shih F. F. Bruce, *Acts: Greek Text*, f. 69-80). Për një diskutim më të hollësishëm, lexo *A Textual Commentary on the Greek New Testament*, nga Bruce M. Metzger, botuar nga United Bible Societies, f. 259-272.

Për shkak të numrit të madh të shtesave të mëvonshme, ky komentari nuk do të trajtojë të gjitha mundësitë tekstuale. Vetëm kur një variant tekstual është kyç për interpretimin, do të trajtohet në këtë komentari.

II. AUTORI

A. Libri është anonim, por nënkuptohet qartë se e shkroi Luka.

1. Pjesët unike dhe të habitshme në vetën e parë shumë (pra, “ne”), 16:10-17 (udhëtimi i dytë misionar në Filipi); 20:5-15; 21:1-18 (fundit i udhëtimit të tretë misionar) dhe 27:1-28:16 (Pali dërgohet si i burgosur në Romë) nënkuptojnë se Luka është autori.
2. Lidhja mes ungjillit të Lukës dhe Veprave është e qartë nëse krahason Lukan 1:1-4 me Veprat 1:1-2.

3. Luka, një mjek johebre, përmendet në Kol. 4:10-14, Filemoni 24 dhe 2 Timoteut 4:11 si shoqërues i Palit. Luka është i vetmi shkruar johebre në DHR.
 4. Dëshmia e njëzëshme e kishës së hershme ishte se autori i Veprave është Luka.
 - a. Fragmenti Muratorian (1820-200 pas K., në Romë, thotë: “përpiluar nga mjeku Luka”)
 - b. Shkrimet e Ireneut (130-200 pas K.)
 - c. Shkrimet e Klementit të Aleksandrisë (156-215 pas K.)
 - d. Shkrimet e Tertulianit (160-200 pas K.)
 - e. Shkrimet e Origenit (185-254 pas K.)
 5. Të dhënat e brendshme të stilit dhe fjalorit (sidomos termat mjekësore) mbështesin idenë se autor ishte Luka (p.sh., shih William Ramsay dhe A. Harnack).
- B. Kemi tre burime informacioni për Lukën.
1. Tre pasazhe të DHR (Kol. 4:10-14; Filemoni 24; 2 Tim. 4:11) dhe vetë libri i Veprave.
 2. Prologu Anti-Markionit i Lukës, shekulli i dytë (160-180 pas K.)
 3. Historiani i kishës së hershme në shekullin e katërt, Euzebi, në *Historia Kishtare* 3:4, thotë: “Luka, vendas i Antiokisë nga ana e prejardhjes, me profesion mjek, pasi u shoqërua kryesisht me Palin dhe me apostuj e tjerë më pak, na ka lënë shembuj të shërimit të shpirtrave, të cilat i përftoi prej tyre, në dy librat e tij të frymëzuar, *Ungjilli* dhe *Veprat e Apostujve*”.
 4. Ky është një profil i përmbledhur i Lukës.
 - a. Johebre (renditur te Kol. 4:12-14, bashkë me Epafrain dhe Demën si ndihmës, por jo në listën e ndihmësve judenj)
 - b. Nga Antiokia e Sirisë (nëse ndjekim prologun Anti-Markionit të Lukës), ose nga Filipia e Maqedonisë (pra, William Ramsay për Veprat 16:19)
 - c. Mjek (shih Kol. 4:14; ose, të paktën, njeri shumë i arsimuar)
 - d. Shoqërues udhëtimi i Palit (pjesët “ne” te Veprat)
 - e. I pamartuar
 - f. Shkroi Ungjillin e tretë dhe Veprat (hyrje të ngjashme, si dhe stil e fjalor i ngjashëm)
 - g. Vdiq në moshën 84 vjeçare në Beti
- C. Sfidat ndaj autorësisë së Lukës
1. Predikimi i Palit në Kodrën e Marsit në Athinë përdor kategori filozofike dhe fjalë greke në mënyrë që të krijojë terren të përbashkët (shih Veprat 17), por, në Rom. 1-2, Pali duket se e konsideron të kotë “terrenin e përbashkët” (pra, natyrën, dëshminë e brendshme morale).
 2. Predikimi dhe komentet e Palit në Veprat e tregojnë si të krishterë jude që e merr seriozisht Moisiun, por letrat e Palit e nënçmojnë Ligjin si problematik dhe kalimtar.
 3. Predikimet e Palit në Veprat nuk kanë atë fokus eskatologjik që gjendet në letrat e tij të hershme (pra, 1 dhe 2 Thesalonikasve).
 4. Ky kontrast termash, stilesh dhe theksesh është interesant, por jo vendimtar. Kur këto kritere i zbatohen ungjijve, Jezusi i ungjijve sinoptikë flet shumë ndryshe nga Jezusi i Gjonit. Megjithatë, shumë pak studiues s’do ta pranonin faktin se të katërt ungjijtë pasqyrojnë jetën e Jezusit.
- D. Kur diskutohet për autorësinë e Veprave, është thelbësore që të diskutojmë për burimet e Lukës, sepse shumë studiues (p.sh., C. C. Torrey) besojnë se Luka përdori dokumente burimore aramaisht (ose tradita gojore aramaike) për shumë prej pesëmbëdhjetë kapitujve të parë. Nëse kjo është e vërtetë, Luka është redaktor, jo autor, i këtyre materialeve. Edhe në predikimet e mëvonshme të Palit, Luka na jep vetëm një përmbledhje të fjalëve të Palit, jo regjistrim të çdo fjale të shprehur. Përdorimi që u bën Luka burimeve ka vlerë kyçe për diskutimet për autorësinë e librit të Veprave.

III. DATA

- A. Ka shumë debate dhe mospajtime për kohën e shkrimit të Veprave, por ngjarjet vetë mbulojnë periudhën 30-63 pas K. (Pali doli nga burgu në Romë në mes të viteve '60, pastaj u arrestua dhe u ekzekutua nën Neronin, ndoshta gjatë përndjekjeve të 65 pas K.).
- B. Nëse pranojmë natyrën apologjetike të librit në lidhje me qeverisjen romake, atëherë bëhet fjalë për një datë (1) përpara 64 pas K. (fillimi i përndjekjes së të krishterëve në Romë nga Neroni) dhe/ose (2) lidhet me revoltën judaike të 66-73 pas K.
- C. Nëse përpiqemi ta vendosim Veprat në vijë kronologjike pas ungjillit të Lukës, atëherë datat e shkrimit të ungjillit do të ndikojë në datimin e shkrimit të Veprave. Meqë rënia e Jerusalemit nga Titi (70 pas K.) profetizohet (Luka 21) por nuk përshkruhet në ungjill, kjo duket se nënkupton një datë para vitit 70 pas K. Nëse është kështu, atëherë Veprat u shkrua si pasthënie dhe duhet datuar në vitet 80.
- D. Nëse përmbyllja e papritur (pra, Pali ende në burg në Romë; shih F. F. Bruce) ngjan problematike, atëherë duhet preferuar një datë që lidhet me fundin e burgosjes së parë romake të Palit, 58-63 pas K.
- E. Disa data që lidhen me ngjarje historike të përmendura në Veprat.
 - 1. Zia e përhapur e bukës në kohën e Klaudit, Veprat 11:28, 44-48 pas K.
 - 2. Vdekja e Herod Agripës I, Veprat 12:20-23, 44 pas K. (pranverë)
 - 3. Prokonsullimi i Sergj Paulit, Veprat 13:7, i caktuar më 53 pas K.
 - 4. Dëbimi i judenjve nga Roma nga Klaudi, Veprat 18:2, 49 pas K. (?)
 - 5. Prokonsullimi i Galios, Veprat 18:12, 51 ose 52 pas K. (?)
 - 6. Prokonsullimi i Feliksit, Veprat 23:26; 24:27; 52-56 pas K. (?)
 - 7. Zëvendësimi i Feliksit nga Festi, Veprat 24:27, 57-60 pas K. (?)
 - 8. Zyrtarët romakë të Judesë
 - a. Prokuratorë
 - (1) Ponc Pilati, 26-36 pas K.
 - (2) Markeli, 36-37 pas K.
 - (3) Maruli, 37-41 pas K.
 - b. Më 41 pas K., metoda prokuratoriale e administratës romake u zëvendësua nga një model empirik. Perandori romak, Klaudi, caktoi Herod Agripën I më 41 pas K.
 - c. Pas vdekjes së Herod Agripës I, 44 pas K., metoda e prokuratorëve u rivendos deri më 66 pas K.
 - (1) Antonius Feliks
 - (2) Porkius Festus

IV. QËLLIMI DHE STRUKTURA

- A. Një qëllim i librit të Veprave ishte dokumentimi i shtimit të shpejtë të ndjekësve të Jezusit: nga rrënjët judaike në shërbesën mbarëbotërore; nga dhomëza e vogël e Darkës së Fundit në pallatin e Cezarit:
 - 1. Ky model gjeografik ndjek Veprat 1:8, që përbën Porosinë e Madhe të Veprave (Mat. 28:19-20).
 - 2. Ky zgjerim gjeografik shprehet në mënyra të ndryshme.
 - a. Përdorimi i qyteteve kryesore dhe kufijve kombëtarë. Në Veprat përmenden 32 vende, 54 qytete dhe 9 ishuj të Mesdheut. Tre qytetet kryesore janë Jerusalemi, Antiokia dhe Roma (shih Veprat 9:15).
 - b. Përdorimi i personave kyçë. Veprat mund të ndahet pothuajse në dy gjysma: shërbesa e Pjetrit dhe ajo e Palit. Në Veprat përmenden mbi 95 persona, por kryesorët janë: Pjetri, Stefani, Filipi, Barnaba, Jakobi dhe Pali.
 - c. Në Veprat shfaqen në mënyrë të përsëritur dy ose tre forma letrare, që duket se pasqyrojnë përpjekjen e vetëdijshme të autorit për t'i dhënë strukturë librit:
 - (1) Thënie përmbledhëse:

- 1:1 – 6:7 (në Jerusalem)
- 6:8 – 9:31 (në Palestinë)
- 9:32 – 12:24 (në Antioki)
- 12:25 – 15:5 (në Azinë e Vogël)
- 16:6 – 19:20 (në Greqi)
- 19:21 – 28:31 (në Romë)
- (2) Thënie për rritjen e kishës
 - 2:47
 - 5:14
 - 6:7
 - 9:31
 - 12:24
 - 16:5
 - 19:20
- (3) Përdorimi i numrave
 - 3:41
 - 4:4
 - 5:14
 - 6:7
 - 9:31
 - 11:21, 24
 - 12:24
 - 14:1
 - 19:20

B. Qartazi, Veprat lidhet me keqkuptimin që lidhej me vdekjen e Jezusit për tradhëti të lartë. Me sa duket, Luka po u shkruan johebrenjve (Teofili mund të ishte një zyrtar romak). Ai përdor (1) fjalimet e Pjetrit, Stefanit dhe Palit për të treguar kurthin e judenjve dhe (2) qëndrimin pozitiv të zyrtarëve romakë kundrejt krishterimit. Romakët s'kishin arsye pse t'u druheshin ndjekësve të Jezusit.

1. Fjalimet e krerëve të krishterë
 - a. Pjetri, 2:14-40; 3:12-26; 4:8-12; 10:34-43
 - b. Stefani, 7:1-53
 - c. Pali, 13:10-42; 17:22-31; 20:17-25; 21:40-22:21; 23:1-6; 24:10-21; 26:1-29
2. Kontaktet me qeveritarët
 - a. Ponc Pilati, Luka 23:13-25
 - b. Sergj Pali, Veprat 13:7, 12
 - c. Kryemagjistratët e Filipisë, Veprat 16:35-40
 - d. Galio, Veprat 18:12-17
 - e. Aziarkët e Efesit, Veprat 19:23-41 (sidomos v. 31)
 - f. Klaud Lisia, Veprat 23:29
 - g. Feliksi, Veprat 24
 - h. Porc Festi, Veprat 24
 - i. Agripa II, Veprat 26 (sidomos v. 32)
 - j. Publi, Veprat 28:7-10
3. Kur i krahason predikimet e Pjetrit me ato të Palit është e qartë se Pali nuk po sjell asnjë risi, por është shpallës besnik i të vërtetave apostolike të ungjillit. *Kerigma* është një!

C. Luka mbroi jo vetëm krishterimin para qeverisjes romake, por edhe Palin para kishës johebraike. Pali sulmohej vazhdimisht nga grupimet judaike (pra, nga judaizuesit e Galatasve, “super-apostujt” e 2 Kor. 10-13) dhe nga grupet heleniste (dmth., gnosticizmi i Kolosianëve dhe Efesianëve). Luka tregon natyrën normale të Palit duke zbuluar qartazi zemrën dhe teologjinë e tij nëpërmjet udhëtimeve dhe predikimeve të veta.

- D. Ndonëse Veprat nuk u shkrua si libër doktrinor, përmban elementet e predikimit të hershëm të apostujve, të cilin C. H. Dodd e ka quajtur “*Kerigma*” (pra, të vërtetat, thelbësore për Jezusin). Kjo na ndihmon të kuptojmë se cilat ishin, sipas tyre, elementet thelbësore të ungjillit, sidomos në lidhje me vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit.

TEMË E VEÇANTË: *KERIGMA* (THE *KERYGMA*)

Për krishterimin ka shumë mendime të ndryshme. Koha jonë karakterizohet nga pluralizmi fetar, njësoj si shekulli i parë. Unë vetë i përfshij dhe i pranoj të gjitha grupet që thonë se njohin dhe besojnë në Jezu Krishtin. Të gjithë nuk biem dakord me njëri-tjetrin për aspekte të ndryshme, por, në thelb, gjithë krishterimi përmbledhet në Jezu Krishtin. Mirëpo ka dhe grupime që pretendojnë se janë të krishterë por, në të vërtetë, janë vetëm “sozi”, ose që janë krijuar rishtazi. Si ta bëjmë dallimin?

Ekzistojnë të paktën dy mënyra:

- A. Një libër i dobishëm për të mësuar se çfarë besojnë grupimet e sotme të kulteve (me pjesë të marra nga vetë librat e tyre) është *The Kingdom of the Cults*, nga Walter Martin.
- B. Predikimet e kishës së hershme, sidomos ato të apostujve Pjetër dhe Pal në librin e Veprave, na japin një përvijm bazë të mënyrës sesi e paraqesnin autorët e frymëzuar të shekullit të parë krishterimin kur flisnin me grupime të ndryshme. Kjo “shpallje”, ose “predikim” i hershëm (Veprat janë përmbledhje e tij) njihet me emrin greqisht *kerygma*. Më poshtë vijojnë të vërtetat bazë të ungjillit për Jezusin në librin e Veprave:
 1. përmbush shumë profeci të DHV – Veprat 2:17-21,30-31,34; 3:18-19,24; 10:43; 13:17-23,27; 33:33-37,40-41; 26: 6-7,22-23
 2. u dërgua nga JHVH siç ishte premtuar – Veprat 2:23; 3:26
 3. kreu mrekulli që vërtetuan mesazhin e tij dhe zbuluan dhembshurinë e Perëndisë – Veprat 2:22; 3:16; 10:38
 4. u dorëzua dhe u mohua – Veprat 3:13-14; 4:11
 5. u kryqëzua – Veprat 2:23; 3:14-15; 4:10; 10:39; 13:28; 26:23
 6. u kthye në jetë – Veprat 2:24,31-32; 3:15,26; 4:10; 10:40; 13:30; 17:31; 26:23
 7. u lartësua në të djathtë të Perëndisë – Veprat 2:33-36; 3:13, 21
 8. do të kthehet sërish – Veprat 3:20-21
 9. u caktua Gjykatës – Veprat 10:42; 17:31
 10. dërgoi Frymën e Shenjtë – Veprat 2:17-18, 33, 38-39; 10:44-47
 11. Shpëtimtar i gjithë atyre që besojnë – Veprat 13:38-39
 12. Askush tjetër nuk është Shpëtimtar – Veprat 4:12; 10:34-36

Ja disa mënyra si duhet t’u përgjigjemi këtyre shtyllave apostolike të së vërtetës:

1. Pendohuni – Veprat 2:38; 3:19; 17:30; 26:20
2. Besoni – Veprat 2:21; 10:43; 13:38-39
3. Pagëzohuni – Veprat 2:38; 10:47-48
4. Merrni Frymën – Veprat 2:38; 10:47
5. Të gjithë mund të vijnë tek ai – Veprat 2:39; 3:25; 26:23

Kjo skemë shërbeu si shpallja thelbësore e kishës së hershme, ndonëse autorë të ndryshëm të Dhiatës së Re mund ta lënë pa përmendur një pjesë, ose të thekojnë disa pjesë të tjera në shkrimet e tyre. Gjithë ungjilli i Markut ndjek me kujdes aspektin pjetrin të *kerigmës*. Nga tradita, Marku shihet si strukturues i predikimeve të Pjetrit, të bëra në Romë, duke u dhënë formën e një ungjilli me shkrim. Si Mateu ashtu dhe Luka ndjekin strukturën bazë të Markut.

- E. Në komentarin e tij, *The Book of Acts, the Early Struggle for an Unhindered Gospel*, Frank Stagg shprehet se qëllimi i Veprave është kryesisht kalimi i mesazhit të Jezusit (pra, ungjilli) nga judaizmi, që ishte rreptësisht kombëtarist, në një mesazh të përbotshëm për gjithë njerëzit. Komentari i Stagg-ut përqendrohet në qëllimin (ose qëllimet) pse Luka shkroi Veprat. Një përmbledhje dhe analizë të shkëlqyer të teorive të ndryshme mund ta gjeni në faqet 1-18. Stagg përqendrohet te fjala “pa pengesë” në 28:31, që përbën një mënyrë të pazakontë për përmbylljen e një libri; ai mendon se kjo

fjalë është çelësi për të kuptuar theksin që Luka vendos te fakti se përhapja e krishterimit tejkalon çdo pengesë.

F. Ndonëse Fryma e Shenjtë përmendet më tepër se pesëdhjetë herë në Veprat, ky libër nuk është “Veprat e Frymës së Shenjtë”. Fryma nuk përmendet fare në njëmbëdhjetë kapituj. Ai përmendet më tepër në gjysmën e parë të Veprave, kur Luka citon burime të tjera (ndoshta të shkruara, në fillim, në aramaisht). Veprat nuk është e përqendruar te Fryma siç janë ungjijtë të përqendruar te Jezusi! Nuk po përpiqem ta nënçmoj rolin e Frymës, por duhet të ruhem që të mos e ndërtojme teologjinë e Frymës kryesisht, ose kryekëput, nga Veprat.

G. Veprat nuk ka synim të na mësojë doktrina (shih Fee dhe Stuart, *How to Read the Bible for All Its Worth*, f. 94-112). Një shembull i kësaj është përpjekja për ta bazuar teologjinë e kthimit në besim tek Veprat; kjo përpjekje është e destinuar të dështojë. Rendi dhe elementet e kthimit në besim ndryshojnë te Veprat; pyetja, pra, është: cili prej këtyre modeleve është normativ? Për ndihmë doktrinale duhet të shkojmë te Letrat.

Gjithsesi, është interesant fakti se disa studiues (p.sh., Hans Conzelmann) mendojnë se Luka po i riorienton qëllimisht eskatologjitë e tipit “nga çasti në çast Krishti do të kthehet” në shekullin e parë drejt një qasjeje të shërbesës së duruar për shkak të vonesës së kthimit të Krishtit. Mbretëria është këtu tani me fuqi; ajo po ndryshon jetën e njerëzve. Fokusi tani bëhet funksionimi i kishës në të tashmen, jo shpresa eskatologjike.

H. Një tjetër qëllim i mundshëm i Veprave është i ngjashëm me Rom. 9-11: pse e mohuan judenjtë Mesinë e tyre jude, dhe pse kisha ishte bërë kryesisht johebraike? Në disa pasazhe të Veprave shpallet qartë natyra e mbarëbotshme e ungjillit. Jezusi i dërgon dishepujt në të gjithë botën (1:8). Judenjtë e mohojnë, kurse johebrentjët e pranojnë. Mesazhi i tij arrin deri në Romë.

Ka mundësi që qëllimi i Lukës është të tregojë se krishterimi judaik (pra, Pjetri) dhe krishterimi johebraik (pra, Pali) mund të jetojnë dhe të rriten së bashku! Nuk janë në konkurrencë me njëri-tjetrin, por të bashkuar për ungjillizimin e botës.

I. Sa i përket qëllimit, unë bie dakord me F. F. Bruce (*New International Commentary*, f. 18) se, meqë Luka dhe Veprat ishin një vëllim i vetëm në fillim, prologu i Lukës (1:1-4) shërben dhe si prolog për Veprat. Ndonëse nuk ishte dëshmitar okular i të gjitha ngjarjeve, Luka i hulumtoi me kujdes dhe i dokumentoi me saktësi, duke përdorur kornizën e vet historike, letrare dhe teologjike.

Kështu, në ungjillin dhe narrativën e Veprave, Luka dëshiron të tregojë realitetin historik dhe vërtetësinë teologjike (shih Luka 1:4) të Jezusit dhe kishës. Ndoshta, fokusi i Veprave është tematika e përmbushjes (pra, “i papenguar”, shih 28:31, që është dhe fjala e fundit e librit). Kjo tematikë përshkon gjithë librin nëpërmjet disa fjalëve dhe frazave të ndryshme (shih Walter L. Liefeld, *Interpreting the Book of Acts*, f. 23-24). Ungjilli nuk është mendim rastësor, plan B, apo diçka e re. Ai është plani i paracaktuar i Perëndisë (shih Veprat 2:23; 3:18; 4:28; 13:29).

V. GJINIA LETRARE

A. Veprat shërben në DHR si Jozueu-2 Mbretërve shërben në DHV: janë narrativa historike. Narrativa historike biblike bazohet në fakte historike, por fokusohet jo te kronologjia, as te regjistrimi shterues i ngjarjeve. Ajo përzgjedh disa ngjarje që shpjegojnë se kush është Perëndia, kush jemi ne, si të kemi marrëdhënien e duhur me të, dhe si dëshiron Perëndia që të jetojmë.

B. Problemi për interpretimin e narrativës biblike është se autorët nuk e shprehin kurrë qartë në tekst (1) ç’synim kanë, (2) cila është e vërteta kryesore, ose (3) si duhet të ndjekim shembullin e gjërave të përmendura në libër. Lexuesi duhet t’i bëjë vazhdimisht vetes këto pyetje:

1. Pse përmendet filan ngjarje?
2. Ç’lidhje ka ajo me materialin e mëparshëm biblik?
3. Cila është e vërteta teologjike qendrore?

4. A ka rëndësi konteksti letrar? (Cila ngjarje i paraprin, ose vjen pas tij? A është trajtuar dhe gjetkë kjo temë?)
 5. Sa i madh është konteksti letrar? (Nganjëherë, një narrativë e gjatë përbën një tematikë ose qëllim të vetëm teologjik.)
- C. Narrativa historike nuk duhet të jetë burimi i vetëm i doktrinës. Shpesh, regjistrohen gjëra që janë dytësore për qëllimin e autorit. Narrativa historike mund të ilustronjë të vërteta që përmenden dhe gjetkë në Bibël. Fakti se ndodh diçka nuk do të thotë se kjo gjë është vullneti i Perëndisë për gjithë besimtarët në çdo periudhë kohore (p.sh., vetëvrasja, poligamia, lufta e shenjtë, kapja e gjarpërinjve me dorë, etj.).
- D. Diskutimi më i saktë për mënyrën si duhet interpretuar narrativa historike gjendet në librin e Gordon Fee dhe Douglas Stuart, *How to Read the Bible for All Its Worth*, f. 78-93 dhe 94-112.

VI. BIBLIOGRAFI PËR KONTEKSTIN HISTORIK

Është botuar një seri e re librash që e vendosin Veprat në kontekstin e shekullit të parë; janë shkruar nga klasikienë. Kjo qasje ndërdisiplinare ka ndihmuar së tepërmi në të kuptuarit e DHR. Kjo seri redaktohet nga Bruce M. Winter.

- A. *The Book of Acts in Its Ancient Literary Setting*
- B. *The Book of Acts in Its Graeco-Roman Setting*
- C. *The Book of Acts and Paul in Roman Custody*
- D. *The Book of Acts in Its Palestinian Setting*
- E. *The Book of Acts in Its Diaspora Setting*
- F. *The Book of Acts in Its Theological Setting*

Gjithashtu, libra tejet të dobishëm janë:

1. A. N. Sherwin-White, *Roman Society and Roman Law in the New Testament*
2. Paul Barnett, *Jesus and the Rise of Early Christianity*
3. James S. Jeffers, *The Greco-Roman World*

VII. FJALË DHE FRAZA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

1. “shumë prova bindëse”, 1:3
2. “dyzet ditë”, 1:3
3. “mbretëria e Perëndisë”, 1:3
4. “një re e mori”, 1:9
5. “udhëtimi i një dite shabati”, 1:12
6. “Fusha e Gjakut”, 1:19
7. “short”, 1:26
8. “Rrëshaja/Pentakosti”, 2:1
9. “u mbushën me Frymën e Shenjtë”, 2:4
10. “të flisnin në gjuhë të tjera”, 2:4
11. “prozelitë”, 2:10; 13:43
12. “plani i paracaktuar dhe paranjohja e Perëndisë”, 2:23

13. “Hades”, 2:31
14. “dora e djathtë e Perëndisë”, 2:33
15. “pendohuni”, 2:38; 3:19
16. “thyerja e bukës”, 2:42, 46
17. “ora e lutjes”, 3:1
18. “kërkonte lëmoshë”, 3:2
19. “portiku i Solomonit”, 3:11; 5:12
20. “I Shenjti dhe i Drejti”, 3:14
21. “kohët e ripërtëritjes”, 3:19
22. “të paarsimuar dhe të pamësuar”, 4:13
23. “ra në gjumë”, 7:60
24. “Udha”, 9:2
25. “vendosën duart mbi”, 9:12 (shih dhe 8:17)
26. “kohorta”, 10:1
27. “të krishterë”, 11:26
28. “fall”, 16:16
29. “me gjithë familjen e tij”, 16:33
30. “epikurian”, 17:18
31. “stoik”, 17:18
32. “Aeropag”, 17:22
33. “yshtës judenj demonësh”, 19:13
34. “librat e magjisë”, 19:19
35. “faltore të argjendta të Artemisë”, 19:24

VIII. PERSONA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

1. Teofil, 1:1
2. Gratë, 1:14
3. Matia, 1:23
4. Saducenjtë, 4:1; 5:17
5. Ana, 4:6
6. Kajafa, 4:6
7. “krerët dhe pleqtë e popullit”, 4:8
8. Anania, 5:1; 9:10
9. Safira, 5:1
10. Gamaliel, 5:34
11. Stefani, 6:4
12. Saul, 7:58; 8:1; 9:1
13. Filip, 8:5
14. Dorka, 9:36
15. Kornel, 10:1
16. Agab, 11:28; 21:10
17. Eutik, 20:9

IX. VENDNDODHJE QË DUHEN GJETUR NË HARTË

1. Jerusalem, 1:8
2. Jude, 1:8
3. Samari, 1:8
4. Partët, 2:9
5. Kapadoki, 2:9
6. Pont, 2:9
7. Azi, 2:9
8. Frigji, 2:10

9. Pamfili, 2:10
10. Egjipt, 2:10
11. Libi, 2:10
12. Kirenë, 2:10
13. Kretasit, 2:11
14. Nazaret, 2:22
15. Aleksandri, 6:9
16. Kiliki, 6:9
17. Damask, 9:2
18. Cezare
19. Jopa, 9:36
20. Feniki, 11:19
21. Qipro, 11:20
22. Tars, 11:25
23. Sidon, 12:20
24. Filipi, 16:12
25. Bere, 17:10
26. Athinë, 17:16
27. Korint, 18:1

X. PYETJE PËR DISKUTIM

1. Si e nxjerr në pah 1:6 mungesën e njohurisë së apostujve?
2. Si lidhet 1:8 me Mat. 28:19-20?
3. Rendit cilësitë e apostullit (1:22).
4. Pse shoqërohen me Frymën “era” dhe “zjarri”? (2:2-3)
5. Shpjego mrekullinë e 2:8.
6. Pjetri thotë se është përmbushur profecia e Joelit. Atëherë, si e shpjegon 1:17, 19-20?
7. Cila është domethënia teologjike e faktit se Jezusi quhet “Zot” dhe “Krisht”? (2:36)
8. A përbën 2:44 urdhër biblik për komunizmin? (shih 4:34-35)
9. Shpjego domethënien e 3:18.
10. Shpjego sesi i zbatohet Jezusit DHV në 4:11.
11. A shoqërohet gjithmonë me dëshmim në Veprat mbushja me Frymë?
12. Rendit kualifikimet e “të Shtatëve” në Veprat 6. Dhjakë ishin?
13. Pse ishte kaq i zemëruar me të krishterët Sauli? (8:1-3)
14. A u jep 8:15-16 besimtarëve të sotëm rendin e shpëtimit?
15. Cili është qëllimi i gjuhëve në 10:44-48?
16. Pse predikonte në fillim në sinagoga Pali? (13:5)
17. Çfarë ndodhi në Listra që e detyroi Palin dhe Barnabën të shqyenin rrobat? (14:8-18)
18. Cili ishte qëllimi i këshillit të Jerusalemit në Veprat 15?
19. Pse u grind Pali me Barnabën? (15:36-41)
20. Pse e ndaloi Fryma Palin që të mos shkonte në Azi? (16:6)
21. Pse ishin aq të acaruar krerët e qytetit në 16:35-40?
22. Pse e ndihmuan Apollon Priska me Akuilën? (18:24-28)
23. Pse është varg i rëndësishëm 20:21?
24. Cila është rëndësia e 21:9?
25. Pse u burgos në Jerusalem Pali në Veprat 21?
26. Shpjego 23:6-7 me fjalët e tua.

HYRJE PËR ROMAKËT

I. SHËNIME HYRËSE

- A. Romakëve është libri doktrinar më sistematik dhe logjik i Apostullit Pal. Ai u ndikua nga rrethanat në Romë, prandaj është një dokument “sipas rastit.” Diçka ndodhi që e shtyu Palin ta shkruante letrën. Megjithatë, është më neutrali i shkrimeve të Palit, në atë që mënyra e Palit për t’u marrë me problemin (ka të ngjarë xhelozit midis udhëheqësve besimtarë hebrenj dhe johebrenj, krh. 14:1-15:13) ishte një prezantim i qartë i ungjillit dhe rrjedhëve të tij për jetën e përditshme.
- B. Prezantimi nga Pali i ungjillit të Romakëve e ka ndikuar jetën e Kishës në çdo epokë.
1. Agustini u bë besimtar në vitin 386 pas Krishtit duke lexuar Romakëve 13:13-14.
 2. Të kuptuarit e Martin Luterit për shpëtimin ndryshoi rrënjësisht në vitin 1513 pas Krishtit kur krahasoi Ps 31:1 me Rom 1:17 (krah. Hab. 2:4).
 3. Xhon Uesli, duke kaluar pranë një takimi Menonit në Londër, në vitin 1738, u kthye në besim pasi dëgjoi predikimin e Luterit mbi hyrjen e Romakëve.
- C. Të njohësh letrën e Romakëve është të njohësh krishtërimin! Ajo e paraqet jetën dhe mësimet e Jezusit në formën e të vërtetave themeltare për Kishën për të gjitha kohërat.

II. AUTORI

Pali është pa dyshim autori. Përshëndetja e tij tipike gjendet në 1:1. Në përgjithësi mendohet se “gjembi në mish” i Palit ishte shikimi i kufizuar, prandaj ai nuk e shkroi letrën vetë fizikisht, por përdori një shkruar, Tercin (krah. 16:22).

III. DATA

- A. Një datë e mundshme për autorësinë e Romakëve është viti 56-58 pas Krishtit. Ky është një nga librat e paktë të Dhiatës së Re që mund të datohet me mjaft saktësi. Kjo bëhet duke krahasuar Veprat 20:2 e më tej me Romakëve 15:17 e më tej. Romakëve ka mundësi të jetë shkruar në Korint nga fundi I udhëtimit të tretë misionar të Palit, pak para se të nisej për në Jerusalem.
- B. Kronologji e mundshme e shkrimeve të Palit, sipas F. F. Bruce dhe Murray Harris, me disa përshtatje të vogla.

<u>Libri</u>	<u>Data</u>	<u>Vendi i shkrimit</u>	<u>Lidhja me Veprat</u>
1. Galatasve	48	Antiokia e Sirisë	14:28; 15:2
2. 1 Thesalonikasve	50	Korint	18:5
3. 2 Thesalonikasve	50	Korint	
4. 1 Korintasve	55	Efes	19:20
5. 2 Korintasve	56	Maqedoni	20:2
6. Romakëve	57	Korint	20:3
7-10. Letrat e Burgut			
Kolosianëve	fillim '60		
Efesianëve	fillim '60	Romë	
Filemonit	fillim 60'		
Filipianëve	fund 62-63		28:30-31
11-13. Udhëtimi i Katërt Misionar			
1 Timoteut	63 (ose më vonë,	Maqedoni	
Titit	63 (por përpara	Efes (?)	
2 Timoteut	64 (68 pas K.)	Romë	

IV. MARRËSIT

Letra përmend si destinacion Romën. Nuk e dimë kush e themeloi kishën në Romë.

- A. Mund të kenë qenë disa nga njerëzit që ishin në Jerusalem Ditën e Rrëshajëve, të cilët besuan dhe kur u kthyen në vendin e tyre filluan një kishë (krh. Veprat 2:20);
- B. Mund të kenë qenë dishepuj që u larguan për shkak të përndjekjes në Jerusalem pas vdekjes së Stefanit (krh. Veprat 8:4); ose
- C. Mund të kenë qenë të kthyer në besim nga udhëtimet misionare të Palit që shkuan në Romë. Pali nuk e kishte vizituar asnjëherë këtë kishë, por kishte shumë dëshirë ta vizitonte (krh. Veprat 19:21). Ai kishte shumë miq atje (krh. Romakëve 16).

Me sa duket, plani i tij ishte të vizitonte Romën rrugës për në Spanjë (krh. Rom. 15:28) pas udhëtimit në Jerusalem me “dhuratën e dashurisë.” Pali e konsideronte të përfunduar shërbesën e tij në Mesdheun lindor. Ai kërkonte fusha të reja (krh. Rom. 15:20-23, 28). Ajo që e çoi letrën nga Pali në Korint për në Romë ishte Feba, një dhjake e cila po udhëtonte për atje (krh. Rom 16:1). Pse është kaq e çmuar kjo letër, e shkruar në rrugët e parëndësishme të Korintit në shekullin e parë nga një çadrapërës hebre? Martin Luteri e quajti “libri kryesor në Dhiatën e Re dhe ungjilli më i pastër.” Vlera e këtij libri gjendet në faktin që ai është një shpjegim i thellë i ungjillit nga rabini i bërë i krishterë, Sauli i Tarsit, i thirrur për të qenë apostull i johebrenjve. Pjesa më e madhe e letrave të Palit kanë një ngjyrim të fortë nga një situatë lokale, por jo Romakëve. Ajo është një paraqitje sistematike e besimit të një Apostulli.

A e dije, mik i krishterë, që pjesa më e madhe e termave teknike që ne përdorim sot për të përshkruar “besimin” (“shfajësimi,” “veshja e drejtësisë,” “birësimi” dhe “shenjtërimi”) vijnë nga Romakëve? Ajo është zhvillimi teologjik i të vërtetave të Galatasve. Lutju Perëndisë të të ndihmojë ta kuptosh këtë letër të mrekullueshme ndërsa kërkujmë së bashku vullnetin e Tij për jetët tona sot!

V. QËLLIMI

- A. Një kërkesë për ndihmë ndaj kishës në Romë për udhëtimin e tij misionar në Spanjë. Pali e konsideronte të përfunduar punën e tij apostolike në Mesdheun lindor (krh. 15:20-23, 28).
- B. Për t’iu adresuar problemit në kishën e Romës midis besimtarëve hebrej dhe atyre johebrenj. Ky ishte ndoshta rezultat i dëbimit të hebrenjve nga Roma dhe rikthimit të tyre të mëvonshëm. Deri atëherë udhëheqësit e krishterë hebrej ishin zëvendësuar me udhëheqës të krishterë johebrenj
- C. Për ta prezantuar veten me kishën e Romës. Kishte shumë kundërshtim ndaj Palit nga hebrej të sinqertë të bërë të krishterë që ishin në Jerusalem (krh. Këshillin e Jerusalemit tek Veprat 15), nga hebrej jo të sinqertë (judenjtë tek Galatasve dhe 2 Korintasve 3, 10-13), dhe nga johebrenj (Kolosianëve, Efesianëve) që përpiqeshin ta përzienin ungjillin me teoritë dhe filozofitë e tyre të dashura.
- D. Pali u akuzua si dikush që po sillte risi të rrezikshme, që po u shtonte mësimet e Jezusit pa përfillur pasojat. Libri i Romakëve ishte mënyra e tij për të mbrojtur veten në mënyrë sistematike duke treguar se si ungjilli i tij ishte i vërtetë, duke përdorur Dhiatën e Vjetër dhe mësimet e Jezusit (ungjijtë).

VI. PËRVIJIM I SHKURTËR

- A. Hyrje (1:1-17)
 - 1. Përshëndetje (1:1-7)
 - a. Autori (1-5)
 - b. Marrësit (6-7a)
 - c. Përshëndetje (7b)
 - 2. Shkasi i shkrimit (1:8-15)

3. Tematika (1:16-17)
- B. Nevoja për drejtësinë hyjnore (1:18-3:20)
 1. Rënia e botës pagane (1:18-32)
 2. Hipokrizia e judenjve ose paganëve moralistë (2:1-16)
 3. Gjikimi i judenjve (2:17-3:8)
 4. Dënimi i gjithë botës (3:9-20)
 - C. Çfarë është drejtësia hyjnore (3:21-8:39)
 1. Drejtësia vetëm me anë të besimit (3:21-31)
 2. Baza e drejtësisë: premtimi i Perëndisë (4:1-25)
 - a. Pozita e drejtë e Abrahamit (4:1-5)
 - b. Davidi (4:6-8)
 - c. Marrëdhënia e Abrahamit me rrethprerjen (4:9-12)
 - d. Premtimi i Perëndisë për Abrahamin (4:13-25)
 3. Arritja e drejtësisë (5:1-21)
 - a. Aspekti subjektiv: dashuri e pamerituar, gëzim i pakrahasueshëm (5:1-5)
 - b. Baza objektive: dashuria e mahnitshme e Perëndisë (5:6-11)
 - c. Tipologjia Adam/Krisht: shkelja e Adamit, zgjidhja që siguroi Perëndia (5:12-21)
 4. Drejtësia hyjnore duhet të çojë në drejtësi personale (6:1-7:25)
 - a. Liria nga mëkati (6:1-14)
 - (1) Një kundërshtim i mundshëm (6:1-2)
 - (2) Kuptimi i pagëzimit (6:3-14)
 - b. Skllavi i Satanit apo skllavi i Perëndisë: zgjedhja është jotja (6:15-23)
 - c. Martesa e njeriut me Ligjin (7:1-6)
 - d. Ligji është i mirë, por mëkati e pengon të mirën (7:7-14)
 - e. Beteja e përjetshme e mirësisë me ligësinë brenda besimtarit (7:15-25)
 5. Rezultatet konkrete të drejtësisë hyjnore (8:1-39)
 - a. Jeta në Frymën (8:1-17)
 - b. Shpengimi i krijimit (8:18-25)
 - c. Ndihma e vazhdueshme e Frymës (8:26-30)
 - d. Triumfi gjyqësor i shfajësimit me anë të besimit (8:31-39)
 - D. Synimi hyjnor për gjithë njerëzimin (9:1-11:32)
 1. Zgjedhja e Izraelit (9:1-33)
 - a. Trashëgimtarët e vërtetë të besimit (9:1-13)
 - b. Sovraniteti i Perëndisë (9:14-26)
 - c. Plani i përbotshëm i Perëndisë përfshin dhe paganët (9:27-33)
 2. Shpëtimi i Izraelit (10:1-21)
 - a. Drejtësia e Perëndisë kundrejt drejtësisë së njerëzimit (10:1-13)
 - b. Mëshira e Perëndisë bën të domosdoshëm lajmëtarët; thirrje për misionin botëror (10:14-18)
 - c. Mosbesimi i vazhdueshëm i Izraelit ndaj Krishtit (10:19-21)
 3. Dështimi i Izraelit (11:1-36)
 - a. Mbetja e judenjve (11:1-10)
 - b. Smira e judenjve (11:11-24)
 - c. Verbëria e përkohshme e Izraelit (11:25-32)
 - d. Shpërthimi i Palit në lavdërim (11:33-36)
 - E. Rezultati i dhuratës së drejtësisë hyjnore (12:1-15:13)
 1. Thirrje për shenjtërim (12:1-2)
 2. Përdorimi i dhuntive (12:3-8)
 3. Marrëdhëniet e besimtarëve me besimtarë të tjerë (12:9-21)
 4. Marrëdhëniet me shtetin (13:1-7)
 5. Marrëdhëniet me fqinjët (13:8-10)

6. Marrëdhëniet me Zotin (13:11-14)
7. Marrëdhëniet me bashkanëtarët e kishës (14:1-12)
8. Efekti ynë tek të tjerët (12:13-23)
9. Marrëdhëniet në ngjashmërinë me Krishtin (15:1-13)

F. Përmbyllje (15:14-33)

1. Planet personale të Palit (15:14-29)
2. Kërkesa për lutje (15:30-33)

G. Pasthënie (16:1-27)

1. Përshëndetje (16:1-24)
2. Bekim (16:25-27)

VII. FJALË DHE FRAZA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

1. Apostull, 1:1
2. “pasardhës i Davidit sipas mishit”, 1:3
3. Shenjtorët, 1:7
4. Drejtësia, 1:17
5. Zemërimi i Perëndisë, 1:18
6. Pendimi, 2:4
7. “nuk ka anësi te Perëndia”, 2:11
8. Rrethprerja, 2:25
9. “orakujt e Perëndisë”, 3:2
10. I shfajësuar, 3:4
11. Pajtimi, 3:25
12. “ne gëzohemi dhe në sprova”, 5:3
13. “tani, pasi u shfajësua me anë të gjakut të tij”, 5:9
14. “dhuratën e drejtësisë”, 5:17
15. “ai që ka vdekur është çliruar nga mëkati”, 6:7
16. Shenjtërim, 6:19
17. “Fryma e Perëndisë banon në ju”, 8:9
18. Abba, 8:15
19. Qëndresa, 8:25
20. Paranjohu, 8:29
21. Paracakti, 8:29
22. Përlëvdoi, 8:29
23. “dora e djathtë e Perëndisë”, 8:34
24. “principata... pushtete”, 8:38
25. Birësim, 9:4
26. Besëlidhjet, 9:4
27. “gurë pengese”, 9:33
28. “rrëfeje”, 10:9
29. Besoj, 10:4, 11
30. Degët e natyrshme, 11:21
31. Mister, 11:25
32. Amen, 11:36
33. Ushtroni mikpritje, 12:13
34. Mallkim, 12:14
35. “nënshtrojuni autoriteteve qeverisëse”, 13:1
36. “lini mënjane... vishni”, 13:12
37. “të dobët në besim”, 14:1
38. “ne që jemi të fortë”, 15:1

VIII. PERSONA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

1. Abraham, 4:1
2. Etërit, 9:5
3. Esau, 9:13
4. Baal, 11:4
5. Feba, 16:1
6. Priska dhe Akuila, 16:3
7. Junia, 16:7 (KJV, Junia)
8. Terci, 16:22

IX. VENDNDODHJE QË DUHEN GJETUR NË HARTË

1. Romë, 1:7
2. Kenkrea, 16:1

X. PYETJE PËR DISKUTIM

1. Pse është kaq karakteristik për Palin vargu 1:16?
2. Në cilat dy mënyra e njohin Perëndinë gjithë njerëzit? (pra, kapitujt 1-2)
3. Si e trajton 1:26-27 çështjen e tanishme të homoseksualitetit?
4. Ç’lidhje ka 2:6 me Gal. 6:7?
5. Në kapitullin 3, vargjet 9-18, Pali jep një varg citimesh nga DHV. Me cilën të vërtetë teologjike lidhen ato?
6. Pse është kaq i rëndësishëm 4:6?
7. Shpjego 4:15 me fjalët e tua.
8. Çfarë na tregon 5:8 për Perëndinë?
9. Në ç’mënyra janë paralele me njëra-tjetrën 5:18 dhe 5:19?
10. Shpjego rrjedhojën praktike të 6:11.
11. Romakëve 6:23 është quajtur “thelbi i ungjillit”. Pse?
12. Shpjego dallimin mes “ririsë së Frymës” dhe vjetërsisë së shkronjës” (7:6).
13. Kë përshkruan kapitulli 7?
14. Çfarë na thotë 7:7-12 për qëllimin e ligjit të DHV?
15. Si gjen zbatim 7:19 në jetën tënde?
16. Shpjego 8:22 me fjalët e tua.
17. A e ka fjalën 8:26-27 për të folurit në gjuhë të panjohura?
18. Ç’lidhje ka 8:28 me 8:29?
19. Cila është tema e njësisë letrare që gjendet në kapitujt 9-11?
20. Shpjego 10:4 me fjalët e tua.
21. Shpjego 11:7 me fjalët e tua.
22. Shpjego 11:26 me fjalët e tua.
23. A janë ende në fuqi dhe në veprim dhuntitë frymërore që përmenden në kapitullin 12?
24. Shpjego 12:20 me fjalët e tua.
25. Shpjego 14:14 me fjalët e tua.
26. Shpjego 14:23 me fjalët e tua.

HYRJE PËR 1 KORINTASVE

(KËSHILLA PRAKTIKE PËR NJË KISHË TË TRAZUAR)

I. SHËNIME HYRËSE

- A. Citohet më shpesh dhe më herët nga etërit e kishës së hershme se sa çdo shkrim tjetër i Palit, e cila dëshmon për rëndësinë dhe dobinë e kësaj letre.
- B. Në Fragmentin Muratorian, i cili ishte një listë e librave kanonikë nga Roma (viti 200 pas Krishtit), renditet si letra e parë e shkrimeve të Palit, që sërish dëshmon për rëndësinë e saj.
- C. Pali bën një dallim në këtë letër praktike midis mendimit të vet personal dhe urdhërimeve të Zotit. Megjithatë, kjo bazohet në njohuritë e tij për mësimet e Jezusit mbi subjektet që trajtohen. Nëse ai do të mundte, do të transmetonte fjalët e Jezusit. Ai besonte se edhe mendimet e tij ishin të frymëzuara dhe me autoritet (shih 1 Kor. 7:25, 40).
- D. Parimi udhëzues i Palit për marrëdhënie në kishë është që liria e besimtarëve individualë, por gjithashtu edhe përgjegjësia e tyre e përbashkët sipas proporcionit përkatës, nuk bazohet mbi ligjin por mbi dashurinë. Shëndeti dhe rritja e të gjithë kishës shfuqizon çdo preferencë apo privilegj personal (shih 1 Kor. 12:7).
- E. Kjo letër (së bashku me letrën II drejtuar Korintasve) na jep një pamje të hershme tek kisha e Dhjatës së Re, struktura, metodat dhe mesazhi i saj. Megjithatë, gjithashtu duhet mbajtur mend se kjo kishë ishte një bashkësi problematike, jo-tipike.

II. QYTETI I KORINTIT

- A. Itineraret transportuese të dimrit përreth pikës më jugore të Greqisë (dmth., Kepi Malea) ishin shumë të rrezikshme. Prandaj, ishte thelbësore një rrugë tokësore e gjatësisë më të shkurtër të mundshme. Vendndodhja gjeografike e Korintit në isthmusin prej 4 milje midis Gjirit të Korintit (dmth., Deti Jon) dhe Gjirit Saronik (dmth., Deti Egje) e bënin qytetin një qendër të rëndësishme biznesi transportues, tregtues (i specializuar në llojet e poçeve dhe një lloj të veçantë tunxhi) dhe ushtarake. Në kohën e Palit ky ishte realisht vendi ku takoheshin kultura perëndimore me atë lindore.
- B. Korinti ishte gjithashtu një qendër e rëndësishme kulturore e botës greko-romake sepse në mbaheshin dy herë në vit lojërat Isthmiane të cilat nisën në vitin 581 para lindjes së Krishtit (në tempullin e Poseidon-it). Vetëm Lojërat Olimpikë që mbaheshin në Athinë, çdo katër vjet, mund t'i konkurronin ato nga përmasa dhe rëndësia (Tuqididi, *Hist.* 1.13.5).
- C. Në vitin 146 para lindjes së Krishtit, Korinti u përfshi në një revoltë (dmth., Liga Akeane) kundër Romës dhe u shkatërrua nga Gjenerali Romak Lucius Mummius dhe popullata greke u shpërbë në skllavëri. Për shkak të rëndësisë së saj ekonomike dhe ushtarake, ai u rindërtua ose në vitin 46 ose në vitin 48 përpara Krishtit nga Julius Caesar. Ai u bë një koloni romake ku ushtarët romakë qëndronin në periudhën e pensionit. Ishte një imitim i Romës në arkitekturë dhe kulturë dhe ishte qendra administrative e provincës romake (dmth., Senatoriali) të Akaias në vitin 27 para lindjes së Krishtit. Ajo u bë provinca perandorake në vitin 15 pas lindjes së Krishtit.
- D. Akropoli i Korintit të Vjetër, i ngritur në mbi 570 metra mbi sipërfaqje, ishte vendndodhja e tempullit të Afroditës. Tek ky tempull rrinin 1,000 prosituta (Strabo, *Gjeografia*, 8.6.20-22). Që të quheshe “një korintas”, (dmth., *Korinthiazesthai*, i cituar nga Aristophanes [450-385 para Krishtit]) ishte sinonim me një stil jetese të lirshëm, të tërbuar. Ky tempull, sikurse pjesa më e madhe e qytetit, u shkatërrua nga një tërmet rreth 150 vjet përpara se të vinte Pali aty, sikurse ndodhi sërish në vitin 77 pas Krishtit. Është e pasigurtë nëse kulti i pjellorisë vazhdonte në kohën e Palit. Duke qënë se romakët, në vitin

146 pas Krishtit, shkatërruan qytetin dhe vranë ose skllavëruan të gjithë qytetarët e tij, shija greke e qytetit u zëvendësua me statusin e saj të kolonisë romake (Pausanias, II.3.7). Ky kontekst kulturor romak në vend të kulturës greke, bën dallimin në interpretimin e letrës së parë drejtuar Korintasve.

III. AUTORI

- A. Në këtë qytet erdhi apostulli Pal në udhëtimin e tij të dytë misionar; për të shkruhet tek Veprat e Apostujve 18:1-21. Përmes një vegimi që Zoti i zbuloi Palit, shumë besuan dhe asnjë kundërshti e suksesshme nuk i qëndroi shërbesës së tij (shih Veprat e Apo. 18:9-10).
- B. Strategjia misionare e Palit ishte të mbillte një kishë në qytetet e mëdha të kohës së tij, duke e ditur se vizitorët, biznesmenët që udhëtonin dhe marinarët e konvertuar do ta shpërndanin ungjillin ndërsa vazhdonin rrugëtimin e tyre. Pastaj varej nga kisha e tyre lokale që të merrnin përgjegjësinë për ungjillizimin dhe dishepullizimin e zonës së tyre.
- C. Pali gjeti Akuilën dhe Prishilën, të cilët gjithashtu ishin tenda-bërës ose punues lëkure besimtarë hebrenj, në Korint. Ata i përzonë nga Roma në vitin 49 pas Krishtit mbi bazë të dekretit të Klaudius-it (Orosius, *Hist.* 7:6:15-16) kundër çdo riti apo rituali hebre (shih Veprat e Apo. 18:2). Pali kishte ardhur në Korint vetëm. Të dy, Silasi dhe Timoteu, ishin me detyrë në Maqedoni (shih Veprat e Apo. 18:5). Ai ishte shumë i dekurajuar (shih Veprat e Apo. 18:9-19; 1 Kor. 2:3). Megjithatë, ai ngulmoi dhe qëndroi në Korint për tetëmbëdhjetë muaj (shih Veprat e Apo. 18:11).
- D. Autorësia e Palit për këtë libër u vërtetua nga Klementi i Romës, i cili i shkroi një letër Korintit në vitin 95/96 pas Krishtit (*I Klementi* 37:5; 47:1-3; 49:5). Autorësia e Palit për këtë letër nuk është dyshuar kurrë, madje as nga studiuesit kritikë modernë.

IV. DATA

- A. Data e vizitës së Palit në Korint është konstatuar nga një mbishkrim i Perandorit Klaudius të gjetur në Delfi, i cili daton në kohën e guvernatorit Gallo, i cili ishte në detyrë që në korrik të vitit 51 pas Krishtit deri në korrik të vitit 52 (shih Veprat e Apo. 18:12-17), fakte që e bëjnë mbërritjen e Palit të datojë rreth viteve 49-50 pas Krishtit.
- B. Data e letrës së Palit është diku tek mesi i viteve 50-të. Ai e shkroi atë nga Efesi ku ai shërbeu nga dy vjet (shih Veprat e Apo. 19:10) dhe tre vjet (shih Veprat e Apo. 20:31).
- C. Kronologji e mundshme e shkrimeve të Palit, sipas F. F. Bruce dhe Murray Harris, me disa përshtatje të vogla.

<u>Libri</u>	<u>Data</u>	<u>Vendi i shkrimit</u>	<u>Lidhja me Veprat</u>
1. Galatasve	48	Antiokia e Sirisë	14:28; 15:2
2. 1 Thesalonikasve	50	Korint	18:5
3. 2 Thesalonikasve	50	Korint	
4. 1 Korintasve	55	Efes	19:20
5. 2 Korintasve	56	Maqedoni	20:2
6. Romakëve	57	Korint	20:3
7-10. Letrat e Burgut			
Kolosianëve	fillim '60		
Efesianëve	fillim '60	Romë	
Filemonit	fillim 60'		
Filipianëve	fund 62-63		28:30-31
11-13. Udhëtimi i Katërt Misionar			
1 Timoteut	63 (ose më vonë, Maqedoni)		
Titit	63 (por përpara	Efes (?)	
2 Timoteut	64 (68 pas K.)	Romë	

(Pali mund të jetë ekzekutuar rreth 65 pas K.)

V. MARRËSIT E LETRËS

- A. Marrëse e letrës ishte kisha e re e përbërë më së shumti nga johebrenj. Popullsia e Korintit ishte e përzierë nga ana raciale dhe kulturore. Ne e dimë nga arkeologjia dhe Shkrimet (shih Veprat e Apo. 18:4-8) që gjendej një sinagogë në Korint.
- B. Ushtarët romakë kalonin atje kohën e pensionit pasi kishin përfunduar njëzet vite shërbimi ushtarak. Korinti ishte një qytet i lirë, një koloni romake dhe kryeqyteti i provincës romake të Akaias
- C. Letra duket se reflekton disa grupe në kishë: (1) Grekët intelektualë të cilët ishin ende shumë krenarë për traditat e tyre filozofike dhe po përipiqeshin të lidhnin zbuluesën e krishterë me këto zakone të vjetra dhe tradita intelektuale; (2) Padronët romakë dhe elita sociale; (3) Një kontigjent hebrenjsh besimtarë së bashku me një grup johebrenjsh “që kishin frikë Perëndinë”, të cilët merrnin pjesë në sinagogë; (4) Një numër i lartë skllëvërish të kthyer në besim.

VI. QËLLIMI I LETRËS

- A. Pali dëgjoji problemet që ishin zhvilluar në Korint nga këto burime
 - 1. Njerëzit e Kloes, 1 Kor. 1:11
 - 2. Një letër nga kisha që i bënte pyetje, 1 Kor. 7:1,25; 8:1; 12:1; 16:1,12
 - 3. Një vizitë personale nga Stefanasi, Fortunati dhe Akaiku, 1 Kor. 16:17. Është e mundur që letra (pika numër 2) të jetë dërguar nga këta burra (pika numër 3).
Është interesante që Murry Harris ka skicuar librin e letrës së parë drejtuar Korintasve të bazuar mbi informacionin që Pali kishte marrë rreth kishës.
 - 1. Raportim gojor nga anëtarë të shtëpisë së Kloes, që rezultoi në shkrimin e kapitujve 1 Kor. 1-4 nga Pali
 - 2. Raportim gojor nga përfaqësues të kishës (dmth., Stefanasi, Fortunati dhe Akaiku), që rezultoi në kapitujt 1 Kor. 5-6
 - 3. Pyetje të shkruara nga kisha, që rezultuan në kapitujt 1 Kor. 7-16
- B. Kisha ishte përçarë, duke mbrojtur drejtues të ndryshëm: Palin, Apollin, Pjetrin dhe ndoshta një parti të Krishterë (shih 1 Kor. 1:12). Jo vetëm ishte kisha e ndarë mbi llojet e drejtimit, por gjithashtu edhe mbi disa çështje morale dhe përdorimi i dhuntive frymore. Një pikë kryesore e grindjeve ishte autoriteti apostolik i Palit (sidomos në letrën e dytë drejtuar Korintasve)!

VII. KONTAKTET E PALIT ME KISHËN KORINTASE – PROPOZIM I MUNDSHËM

- A. Sa letra i shkroi Pali kishës në Korint?
 - 1. Vetëm dy, letrën e I dhe II drejtuar Korintasve
 - 2. Tre, dhe një letër është humbur
 - 3. Katër, dhe dy letra kanë humbur
 - 4. Disa studiues modernë gjejnë pjesë të dy letrave të humbura në 2 Korintasve
 - a. Një letër e mëparshme (1 Kor. 5:9, tek 2 Kor. 6:14-17:1)
 - b. Një letër e ashpër (2 Kor. 2:3-4,9; 7:8-12, tek 2 Kor. 10-13)
 - 5. Pesë, ku 2 Kor. 10-13 janë letra e pestë, e dërguar pas raportimit të Titit të lidhur me lajme të tjera të këqija
- B. Teoria numër 3 duket se i përshtatet më mirë
 - 1. Letra e mëparshme, e humbur (1 Kor. 5:9)
 - 2. 1 Korintasve

3. Letër e ashpër, e humbur (ku mundësisht pjesë prej së cilës janë regjistruar tek 2 Kor. 2:1-11; 7:8-12)
4. 2 Korintasve

C. Një rindërtim i propozuar i ngjarjeve

DATA	VIZITA	LETRA
50-52 p.K. Udhëtimi i dytë misionar i Palit	a. Në udhëtimin e dytë misionar, Pali qëndroi në Korint për 18 muaj (shih Veprat 18:1-11)	
50 p.K. Galio ishte prokonsull nga viti 52 p.K. (shih Veprat 18:12-17)		a. 1 Kor. 5:9-11 duket se bën fjalë për një letër për një situatë imorale në kishë. Kjo letër është e panjohur përveçse nëse: (1) siç mendojnë disa, 2 Kor. 6:14-7:1 ishte pjesë e kësaj letre, ose (2) se 2 Kor. 2:3, 4, 9 janë aoriste letrare dhe bëjnë fjalë për 2 Korintasve.
56 p.K. (pranverë)	b. Pali dëgjon për problemet në kishë gjatë qëndrimit në Efes prej dy burimesh: (1) njerëzit e Kloes, 1 Kor. 1:11; dhe (2) Stefanai, Fortunati dhe Akaiku, 1 Kor. 16:17. Me sa duket, ata i sollën një letër nga kishat-shtëpi të Korintit, që përmbante pyetje	
56 p.K. (dimër) ose 57 p.K. (dimër)	c. Pali bëri një vizitë urgjente dhe të dhimbshme në Korint (të paregjistruar në Veprat, shih 2 Kor. 2:1). Nuk pati sukses, por u betua se do të rikthehej.	b. Pali u përgjigjet këtyre pyetjeve (shih 1 Kor. 7:1, 25; 8:1; 12:1; 16:1, 2) duke shkruar 1 Korintasve. Timoteu (shih 1 Kor. 4:17) e çon përgjigjen nga Efesi (shih 1 Kor. 16:8) në Korint. Timoteu s'ia doli t'i zgjidhte problemet në kishë.
	d. Pali planifikoi të takohej me Titin në Troadë, por Titi nuk shkoi, kështu që Pali shkoi në Maqedoni (shih 2 Kor. 2:13; 7:5, 13), ndoshta në Filipi (shih dorëshkrimet Bc, K, L, P)	c. Pali u shkroi një letër të ashpër (shih 2 Kor. 2:3-4:9; 7:8-12) kishave-shtëpi në Korint, që ua përçoi Titi (shih 2 Kor. 2:13; 7:13-15). Kjo letër është e panjohur, përveçse nëse, siç hamendësojnë disa, një pjesë e saj na jepet te 2 Kor. 10-13.
	e. Vizita e fundit e regjistruar e Palit në Korint duket se përmendet në Veprat 20:2-3. Ndonëse Korinti nuk përmendet me emër, nënkuptohet. Pali qëndroi aty gjatë muajve të dimrit.	d. Pali e gjeti Titin dhe dëgjoi se kisha i ishte përgjigjur pozitivisht udhëheqjes së tij; pastaj, shkroi 2 Korintasve duke i falendëruar thellësisht (shih 7:11-16). Letrën ua çoi Titi
57-58 p.K. (dimër)		e. Ndryshimi i theksuar i gjendjes emocionale mes kapitujve 1-9 dhe 10-13 shpjegohet nga disa studiues si lajme të tjera të këqija (ndoshta, rigjallërimi i kundërshtarëve të vjetër dhe shtimi i kundërshtarëve të rinj) nga brenda shtëpive-kisha të Korintit pas shkrimit të kapitujve 1-9 (F. F. Bruce).

VIII. PËRMBYLLJE

- A. Tek 1 Korintasve ne shohim Palin, një pastor, që merret me një problem të kishës. Në këtë letër dhe tek letra drejtuar Galatasve e shohim teka e zbaton të vërtetën universale të ungjillit në mënyra të ndryshme, në bazë të nevojave të kishës: liri për kishat galatase / kufizim për kishën korintase.
- B. Ky libër është ose një seri “dinosaurësh kulturorë” ose një pasuri të vërtetash parimore të zbatuara tek një rrethanë e caktuar historike / kulturore. Ne duhet të jemi të kujdesshëm që të mos ngatërrojmë të vërtetën me zbatimet kulturore të asaj të vërtete. Për një diskutim të mirë të kësaj çështjeje mjaft të rëndësishme hermeneutike shihni librin e Gordon D. Fee dhe Douglas Stuart *How To Read the Bible for All Its Worth* [Si ta Lexosh Biblën për Gjithë Vlerën e Saj] fq. 65-76.
- C. Ky libër do t’ju shtyjë në limitin e aftësisë frymore për të interpretuar Biblën. Ai do t’ju detyrojë të rimendoni aspektet e teologjisë tuaj. Do të hapë një derë për vullnetin e Perëndisë në ditët tona, duke na folur në mënyrë praktike, si pak shkrime të tjera biblike.

IX. PËRVIJIM I SHKURTËR I 1 KORINTASVE

- A. Hyrje 1:1-9
 - 1. Përshëndetje, 1:1-3
 - 2. Falënderim, 1:4-9
- B. Problemet e raportuara të Korintit, 1:10-6:20
 - 1. Ndasitë brenda kishës për shkak të keqkuptimit të synimeve dhe meszhit të udhëheqjes së krishterë (pra, Pali, Apollo dhe Pjetri), 1:10-4:12
 - 2. Shthurja tronditëse, 5:1-13
 - 3. Proceset gjyqësore mes të krishterëve, 6:1-11
 - 4. Liria e krishterë kufizohet nga përgjegjësia, 6:12-20
- C. Një letër nga Korinti që bën pyetje të vështira, 7:1-16:4
 - 1. Seksualiteti njerëzor, 7:1-40
 - 2. Marrëdhënia me kulturën idhujtare dhe liria e krishterë, 8:1-11:1
 - 3. Adhurimi dhe përsëritja e krishterë, 11:2-14:40
 - 4. Mësime për eskatologjinë, sidomos për ringjalljen, 15:1-58
 - 5. Kontributi vullnetar për kishën nënë në Jerusalem, 16:1-4
- D. Thënie përmblylëse
 - 1. Planet për udhëtim të Palit (me bashkëpunëtorët e tij), 16:5-12
 - 2. Nxitjet e fundit dhe përshëndetja, 16:13-24

X. SUGJERIM PËR LEXIME TË MËTEJSHME PËR MENDIMIN E PALIT

- A. *The Mind of St. Paul* [Mendja e Shën Palit], William Barclay, publikuar nga Harper & Row
- B. *Paul, Apostle of the Heart Set Free* [Pali, Apostulli me Zemrën e Liruar], F. F. Bruce, publikuar nga Eerdmans
- C. *The Origins of Paul's Religion* [Origjinat e Fesë së Palit], J. Gresham Machen, publikuar nga Eerdmans
- D. *Paul, An Outline of His Theology* [Pali, Një Skicim i Teologjisë së Tij], Herman Ridderbos (përkthyer nga John De Witt), publikuar nga Eerdmans
- E. *Epochs in the Life of Paul* [Epoka në Jetën e Palit], A. T. Robertson, publikuar nga Baker
- F. *A Man In Christ* [Një Njeri në Krishtin], James S. Steeart, publikuar nga Harper & Row

- G. *Dictionary of Paul and His Letters* [Fjalor i Palit dhe Letrave të Tij], publikuar nga IVP
- H. *Paul in the Roman World, The Conflict at Corinth* [Pali në Botën Romake, Konflikti në Korint], Robert M. Grant, publikuar nga Ëestminister, John Knox Press
- I. *Philo and Paul Among the Sophists* [Filo dhe Pali mes Sofistëve], Bruce W. Winter, publikuar nga Eerdmans
- J. *After Paul Left Corinth* [Pasi Pali u largua nga Korinti], Bruce W. Winter

XI. FJALË DHE FRAZA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

- 1. Shenjtëruar, 1:2
- 2. Epokat, 2:7, 8
- 3. “thellësitë e Perëndisë”, 2:10
- 4. “godina e Perëndisë”, 3:9
- 5. “jeni tempull i Perëndisë”, 3:16, 17
- 6. “misteret e Perëndisë”, 4:1
- 7. “ia dorëzoni atë njeri Satanit”, 5:5
- 8. “ne do të gjykojmë engjëjt”, 6:3
- 9. “dhe të tillë ishit disa prej jush”, 6:11
- 10. “në lidhje me virgjëreshat”, 7:25
- 11. “që unë vetë të mos skualifikohem”, 9:27
- 12. “u flijojnë demonëve”, 10:20
- 13. “pini nga kupa e Zotit”, 10:21
- 14. “për shkak të engjëjve”, 11:10
- 15. “dëgjoj se ka ndasi mes jush”, 11:18
- 16. “Jezusi është i mallkuar”, 12:3
- 17. “dallojnë frymërat”, 12:10
- 18. Cimbale tingëlloje, 13:1
- 19. “kur të vijë e përsosura”, 13:10
- 20. “shohim vagullt si në pasqyrë”, 13:12
- 21. Profetizimi, 14:39
- 22. u anulua, 15:24
- 23. “mbledhja e ndihmave për shenjtorët”, 16:1

XII. PERSONA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

- 1. Sosteni, 1:1
- 2. Njerëzit e Kloes, 1:11
- 3. Apollo, 1:12
- 4. Kefa, 1:12
- 5. Krispi dhe Gai, 1:14
- 6. “sunduesit e kësaj epoke”, 2:6, 8
- 7. Njeriu i natyrshëm, 2:14
- 8. Njeriu shpirtëror, 3:1
- 9. Foshnja në Krishtin, 3:1
- 10. Kefa, 15:5
- 11. Të dymbëdhjetët, 15:5
- 12. Jakobi, 15:7

XIII. VENDNDODHJE QË DUHEN GJETUR NË HARTË

- 1. Korint, 1:2
- 2. Kishat e Galatisë, 16:1
- 3. Jerusalem, 16:3
- 4. Maqedoni, 16:5

5. Efes, 16:8
6. Akai, 16:15
7. Azi, 16:19

XIV. PYETJE PËR DISKUTIM

1. Pse e mohonin judenjtë Jezusin si Mesi?
2. Pse e mohonin grekët Jezusin?
3. Pse thotë Pali gjëra kaq negative për filozofinë në 1:18-25 dhe 2:1-5?
4. Shpjego rrjedhojat e 1:26-31.
5. Për kë bën fjalë 3:10-15?
6. Pse e dënoi kishën Pali në 5:1-8?
7. A i përjashton pasazhi 6:1-11 gjyqet mes të krishterëve sot?
8. A po nënkupton Pali se beqaria është vullneti i Perëndisë në kapitullin 7?
9. A nënkupton 7:12-13 se besimtarët mund të martohen me jobesimtarë?
10. Si ngjason kapitulli 8 me Romakëve 14?
11. Pse s'pranonte Pali që të merrte mbështetje monetare nga kisha në Korint? (9:3-18)
12. Shpjego rrjedhojat e 9:19-23.
13. Shpjego me fjalët e tua 10:1-13.
14. Pse është varg i mrekullueshëm për besimtarët 10:13?
15. Shpreh parimin shpirtëror të 10:23 me fjalët e tua.
16. Si e kundërshton 11:5 vargun 14:34?
17. A nënkupton 11:30 se disa besimtarë kishin vdekur duke ngrënë Darkën e Zotit?
18. Shpjego rrethanat e mendimit të Palit në 11:34.
19. Cila është domethënia e parimit shpirtëror në 11:7?
20. A lidhen dhuntitë shpirtërore me talentet e natyrshme të njeriut? Kur i marrin besimtarët këto dhunti shpirtërore?
21. A i përgjigjet 12:29-30 pyetjes: “A duhet të flasin gjithë besimtarët në gjuhë të panjohura”? (14:5)
22. Sipas 13:8, çfarë do të kalojë dhe çfarë do të mbetet?
23. Si e përshkruan kapitulli 14 përdorimin e gjuhëve në adhurimin publik?
24. Cilat janë ato tri grupe që Pali i kufizon në adhurimin publik në kapitullin 14?
25. Rendit pikat e ungjillit sipas 15:1-4.
26. Kur ndodh 15:6 në jetën e Jezusit?
27. Si ngjason 15:22 me Romakëve 5:12-21?

HYRJE PËR 2 KORINTASVE

I. SHËNIME HYRËSE

- A. Ky libër, më shumë se çdo letër tjetër e Palit, na tregon zemrën dhe mendjen e Apostullit për johebrenjtë. Është më e afërta që kemi ndaj autobiografisë së tij frymërore / pastorale.
- B. Ky libër mund të jetë vepra retorike më e arrirë e Palit. Raymond E. Brown tek *An Introduction to the New Testament* [Një Hyrje në Dhjatën e Re], thotë: “mund të jetë një nga shkrimet më bindëse oratorike të të gjitha shkrimeve të Palit”, fq. 541. Megjithatë, kjo u bë për të refuzuar sofistët të cilët kishin ardhur në Korint dhe kishin sulmuar metodat e të folurit në publik të Palit sikurse dhe ungjillin e tij (dmth., sulmi i tij ndaj urtësisë tek 1 Korintasve 1-4).

TEMË E VEÇANTË: SOFISTËT (SPECIAL TOPIC: SOPHISTS)

Fjala greke *sofia* do të thotë urtësi. Termi i lidhur me të, *sophistēs*, mori kuptimin e dikujt “me aftësi” ose “i edukuar në retorikë”. Ajo zakonisht përcaktonte një folës publik, shpesh shëtitës, i cili shkonte në një qytet dhe përpiquej të niste një shkollë për të trajnuar fëmijët e klasës elitë. Kjo e folur në publik (dmth., trajnim retorik) i bënte prindërit t’i kërkonin ata për mësim apo shkollim privat për fëmijët e tyre.

Kishte një konkurrencë të madhe midis këtyre “burrave të mençur” lidhur me reputacionet dhe aftësitë e tyre për të tërhequr studentët. Kishte madje një sërë rregullash për mundësitë e tyre fillestare të të folurit. Një nga këto grupe procedurash ishte pjesa ku filozofi duhet të rendiste kualifikimet dhe pikat e tij të forta.

Problemet e Palit në Korint duken se lidhen me

1. Grupimet në kishë, ku secili pretendonte se ndiqte një mësues të caktuar (1 Korintasve 1-4)
2. Mësuesit e rremë hebraikë të trajnuar helenistikë nga Jeruzalemi (2 Korintasve 10-13)

Refuzimi që i bëri Pali “urtësisë” tek 1 Korintasve 1-4 shpjegon rrethanat për sulmin e tij nga ata që mburreshin me trajnimin e tyre filozofik dhe retorik dhe gjykonin gjithë të tjerët nën dritën e këtyre kritereve. Është e habitshme që mësuesit hebraikë mburreshin me kategoritë filozofike, por një precedent në Judaizëm gjendet te Filoja i Aleksandrisë dhe ndoshta te trajnimi dhe eksperiencia e Apollit të Aleksandrisë.

Pali nuk ishte folës publik i rafinuar. Madje, sulmohej për këtë. Ai kundërpërgjigjet duke shkruar në formë të rafinuar, ekuilibruar, retorike dhe të strukturuar mjaft mirë tek 2 Korintasve 10-13. Pali përdor termat e tyre, format e tyre dhe ekspozon qëndrimet e tyre të papërshtatshme dhe arrogancën e tyre. Shih Bruce W. Winter, *Philo and Paul Among the Sophists*.

- C. Ky libër është një kombinim i çuditshëm, sikurse vetë Pali, i pikave të larta dhe të ulëta frymërore, të emocioneve që rrjedhin të lira duke kaluar nga zemërimi deri tek gëzimi i madh.
- D. Ky libër është vërtet një letër dhe si një letër është vetëm gjysma e një bisede. Shumë nga ngjarjet e mëparshme dhe rrethanat llogjike pas përgjigjeve të Palit janë humbur. Ky është një shembull i mirë i së vërtetës që letrat e Dhjatës së Re ishin shkruar fillimisht si një korrespondencë ndaj nevojave specifike, jo si dizertacione teologjike të pavarura.
- E. Ky libër është lënë pas dore nga shkollat dhe në predikime. Gjenden më pak komantarë mbi letrën e dytë të korintasve se çdo libër tjetër i Dhjatës së Re. Kjo është për të ardhur keq sepse është burimi i diskutimit më përcaktues të Palit mbi vuajtjen në jetën e krishterë.
- F. Për pastorët, ky libër ofron udhëzime të vlefshme mbi mënyrën se si të trajtojnë problemet me kishat lokale. Pali na jep të gjithëve një shembull për t’u ndjekur në mes të sulmeve dhe keqkuptimeve personale.

II. AUTORI

- A. Edhe në mes të të gjithë mohimeve shkollore moderne të autorësisë tradicionale të librave biblik, për këtë libër nuk është mohuar kurrë që autori të jetë Pali.
- B. Është kaq autobiografik dhe aq e vështirë të kuptosh disa nga frazat e tij sa mundësia e dikujt që përpiqet të imitojë Palin duke shkruar një libër si ky është tejet e pamundur. Vështirësia dhe specifika e letrës flasin për origjinalitetin e saj. Është e vërtetë që shumë nga studiuesit e Dhjatës së Re mendojnë se letra e dytë e Korintasve është një letër e përbërë që kombinon disa letra të ndara të Palit në një të vetme. Unë i qëndroj njëjesisë së saj për shkak se:
1. Nuk ka asnjë të dhënë për copëzim të letrës në dorëshkrimet antike greke
 - a. Asnjë variacion të njësive letrare
 - b. Asnjë dorëshkrim i cili nuk përmban të trembëdhjetë kapitujt
 2. Edhe pse 2 Korintasve 13 ishte dukshëm i panjohur për Klementin e Romës në vitin 96 pas lindjes së Krishtit, ai citohet nga Polycarp në vitin 105 pas lindjes së Krishtit.
 3. Libri kuptohet si një njësi. Duket se ka tema të caktuara të cilat tregojnë unitetin e tij, siç është “vuajtja”.
 4. Prova e brendshme është tepër e kufizuar për të mbrojtur një copëzim rrënjësor të 2 Korintasve
- C. Pali pohohet se është autori tek 2 Kor. 1:1 dhe 10:1.

III. DATA

- A. Data e 2 Korintasve është e lidhur në mënyrë të pandashme me 1 Korintasve dhe librin e Veprave të Apostujve.
- B. Veprat e Apostujve 18:1-18 dhe 20:2-3 lidhet me qëndrimin e Palit në Korint, por gjithashtu duket se ka pasur të paktën edhe një udhëtim tjetër të paregjistruar (2 Korintasve 2:1; ku një vizitë përmendet tek 2 Kor. 12:14; 13:1-2).
- C. Pyetja kryesore është marrëdhënia kohore midis vizitave të Palit dhe letrave të tij ndaj Korintit.
- D. Problemi i vërtetë me datimin e ndodhive të lidhura me Korintin është se ne nuk kemi asnjë provë të jashtme apo informacion midis Veprave të Apo. 18:1-18 dhe Veprave të Apo. 20:2-3, përveç provave të brendshme të paqarta të vetë letrave korintase.

E. Kontaktet e Palit me kishën korintase – një rindërtim i propozuar i ngjarjeve.

DATA	VIZITA	LETRA
50-52 p.K. Udhëtimi i dytë misionar i Palit	a. Në udhëtimin e dytë misionar, Pali qëndroi në Korint për 18 muaj (shih Veprat 18:1-11)	
50 p.K. Galio ishte prokonsull nga viti 52 p.K. (shih Veprat 18:12-17)		a. 1 Kor. 5:9-11 duket se bën fjalë për një letër për një situatë imorale në kishë. Kjo letër është e panjohur përveçse nëse: (1) siç mendojnë disa, 2 Kor. 6:14-7:1 ishte pjesë e kësaj letre, ose (2) se 2 Kor. 2:3, 4, 9 janë aoriste letrare dhe bëjnë fjalë për 2 Korintasve.
56 p.K. (pranverë)	b. Pali dëgjon për problemet në kishë gjatë qëndrimit në Efes prej dy burimesh: (1) njerëzit e Kloes, 1 Kor. 1:11; dhe (2) Stefanai, Fortunati dhe Akaiku, 1 Kor. 16:17. Me sa duket, ata i sollën një letër nga kishat-shtëpi të Korintit, që përmbante pyetje	
56 p.K. (dimër) ose 57 p.K. (dimër)	c. Pali bëri një vizitë urgjente dhe të dhimbshme në Korint (të paregjistruar në Veprat, shih 2 Kor. 2:1). Nuk pati sukses, por u betua se do të rikthehej.	b. Pali u përgjigjet këtyre pyetjeve (shih 1 Kor. 7:1, 25; 8:1; 12:1; 16:1, 2) duke shkruar 1 Korintasve. Timoteu (shih 1 Kor. 4:17) e çon përgjigjen nga Efesi (shih 1 Kor. 16:8) në Korint. Timoteu s'ia doli t'i zgjidhte problemet në kishë.
	d. Pali planifikoi të takohej me Titin në Troadë, por Titi nuk shkoi, kështu që Pali shkoi në Maqedoni (shih 2 Kor. 2:13; 7:5, 13), ndoshta në Filipi (shih dorëshkrimet Bc, K, L, P)	c. Pali u shkroi një letër të ashpër (shih 2 Kor. 2:3-4:9; 7:8-12) kishave-shtëpi në Korint, që ua përçoi Titi (shih 2 Kor. 2:13; 7:13-15). Kjo letër është e panjohur, përveçse nëse, siç hamendësojnë disa, një pjesë e saj na jepet te 2 Kor. 10-13.
	e. Vizita e fundit e regjistruar e Palit në Korint duket se përmendet në Veprat 20:2-3. Ndonëse Korinti nuk përmendet me emër, nënkuptohet. Pali qëndroi aty gjatë muajve të dimrit.	d. Pali e gjeti Titin dhe dëgjoji se kisha i ishte përgjigjur pozitivisht udhëheqjes së tij; pastaj, shkroi 2 Korintasve duke i falendëruar thellësisht (shih 7:11-16). Letrën ua çoi Titi
57-58 p.K. (dimër)		e. Ndryshimi i theksuar i gjendjes emocionale mes kapitujve 1-9 dhe 10-13 shpjegohet nga disa studiues si lajme të tjera të këqija (ndoshta, rigjallërimi i kundërshtarëve të vjetër dhe shtimi i kundërshtarëve të rinj) nga brenda shtëpive-kisha të Korintit pas shkrimit të kapitujve 1-9 (F. F. Bruce).

IV. SA LETRA I SHKROI PALI KORINTIT

- A. Vetëm dy, I dhe II drejtuar Korintasve
- B. Tre, dhe një letër ka humbur
- C. Katër, dhe dy letra kanë humbur
- D. Disa studiues modernë gjejnë pjesë të dy letrave të humbura në 2 Korintasve
 - 1. Një letër e mëparshme (1 Kor. 5:9) tek 2 Kor. 6:14-17:1
 - 2. Një letër e ashpër (2 Kor. 2:3-4,9; 7:8-12) tek 2 Kor. 10-13
- E. Pesë, ku 2 Kor. 10-13 janë letra e pestë, e dërguar pas raportimit të Titit të lidhur me lajme të tjera të këqija
- F. Unë i qëndroj teorisë C (shih gjithashtu H. C. Thiessen, *Introduction to the New Testament* [Hyrje në Dhjatën e Re], fq. 209)
 - 1. Letra e mëparshme, e humbur (1 Kor. 5:9)
 - 2. 1 Korintasve
 - 3. Letër e ashpër, e humbur (2 Kor. 2:1-11; 7:8-12)
 - 4. 2 Korintasve

V. ARMIQTË E PALIT NË KORINT

- A. Tek 2 Korintasve problemi duket se është me disa grupime që sundojnë në shtëpi kisha të ndryshme (jo domosdoshmërisht të njëjtat grupime si tek 1 Korintasve, por ndoshta po).
 - a. Një grup besimtarësh që mbështetin kulturën dhe zakonet tradicionale romake
 - b. Një grup besimtarësh që mbështetin trajnimin retorik tradicional grek
 - c. Një grup besimtarësh që mbështetin kulturën dhe zakonet tradicionale hebraike
 - d. Një grup besimtarësh nga shtresat shoqërore të pafuqishme dhe pa të drejtë vote
- B. Mbërritja e ngatërrestarëve hebraikë nga Palestina shkaktoi kundërshti të shtuar (shih 2 Korintasve 10-13). Ata janë të ndryshëm nga judazierët e Galatianëve dhe hebrenjtë / grekët legalistë të Kolosianëve. Ata ishin ndoshta mësues karizmatikë, të trajnuar nga ana retorike, të ngjashëm me Apollin.
- C. Më poshtë janë disa nga akuzat e ngritura kundër Palit ndaj të cilave ai u përgjigj
 - 1. Pali ishte i paqëndrueshëm (dmth., planet e tij të udhëtimit ndryshonin, shih 2 Kor. 1:15 e në vazhdim).
 - 2. Pali ishte shkrimtar i fuqishëm, por i dobët kur fliste ballë për ballë (shih 2 Kor. 10:10).
 - 3. Pali nuk ishte orator i rafinuar (shih 2 Kor. 10:10; 11:6).
 - 4. Pali nuk pranonte para (shih 2 Kor. 11:7 e në vazhdim; 12:13 e në vazhdim).
 - 5. Pali nuk ishte apostull i vërtetë (shih 2 Kor. 11:5,13; 12:4).
 - 6. Pali nuk ishte jude fetar (shih 2 Kor. 11:21 e në vazhdim).
 - 7. Pali nuk pati zbulesë të drejtëpërdrejtë dhe vegime frymërore të drejtëpërdrejtja sikurse patën ata (shih 2 Kor. 12:1 e në vazhdim).

VI. SHKASI DHE SYNIMI I 2 KORINTASVE

- A. Mirënjohje për përgjigjen pozitive të kishës ndaj drejtimit të Palit (shih 2 Kor. 2:12,13; 7:11-16)
- B. Përgatitja për vizitën e tretë të Palit (shih 10:1-11). Vizita e tij e dytë ishte dukshëm e dhimbshme dhe pa sukses. Toni i ndryshuar emocional i kapitujve 10-13 është i dukshëm. Disa kanë pranuar se është

si rezultat i disa letrave të Palit ndaj kishës në Korint që janë kombinuar në letrën e dytë të Korintasve. Gjithashtu është e mundur që Pali i shkroi ato pasi dëgjoi për një shpërthim të ri kundërshtimi brenda bashkësisë korintase. Është një shtojcë emocionale.

- C. Kundërshtimi i mësuesve të rremë dhe shëtitës judenj (shih 2 Kor. 10-12), të cilëte kishin refuzuar Palin:
1. Si person
 2. Motivet e tij
 3. Autoritetin e tij
 4. Stilin e të folurit
 5. Mesazhin e ungjillit të tij

VII. NJËSITË E MUNDSHME LETRARE

- A. Përvijimi i këtij libri është tejet i vështirë për shkak të:
1. Ndryshimeve të tonalitetit
 2. Larmisë së temave
 3. Parantezave të zgjatura (2 Kor. 2:14-7:1 ose 7:4)
 4. Njohurive tona të kufizuara për situatën locale
- B. Megjithatë, është e qartë se ekzistojnë tri ndarje kryesore sipas temave:
1. Pali i përgjigjet mesazhit të Titit dhe e lidh me planet e tij të udhëtimit, kapitujt 1-7 (gjendet një shprehje kryesore në kllapa që trajton shërbesën apostolike të Palit, 2 Kor. 2:14-7:1 ose 7:4)
 2. Inkurajimi i Palit për përmbushjen e kontributit për kishën në Jeruzalem, kapitujt 8-9
 3. Mbrojtja e Palit për drejtimin e tij, kapitujt 10-13
- C. Unë mbështes unitetin e 2 Korintasve si letër për këto arsye:
1. Nuk gjendet asnjë shenjë mungese uniteti në dorëshkrimet e lashta greke
 - a. S'ka asnjë larmi njësisish letrare
 - b. Asnjë dorëshkrim që nuk përmban të trembëdhjetë kapitujt
 2. Klementi i Romës (rreth 96 pas K.) duket se e njëjtte 2 Kor. 13, dhe Polikarpi e citon në 105 pas K.
 3. Libri është i kuptueshëm si njësi e qenësishme letrare. Duket se ekzistojnë disa tematika që tregojnë unitetin e letrës, si tema e vuajtjes.
 4. Të dhënat e brendshme janë tepër të kufizuara për të mbrojtur idenë e ndarjes së 2 Korintasve në disa letra.

VIII. FJALË DHE FRAZA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

1. Hir dhe paqe, 1:2
2. “në ditën e Zotit tonë Jezus”, 1:14
3. Vulosur, 1:22
4. “na prin në triumf”, 2:14
5. Aromë e ëmbël, 2:14
6. “matrapazllëk me fjalën e Perëndisë”, 2:17
7. “letra rekomandimi”, 3:1
8. “nga Zoti, Fryma”, 3:18
9. Njeriu i jashtëm, 4:16
10. Njeriu i brendshëm, 4:16
11. Çadra tokësore, 5:1
12. “Fryma si garanci”, 5:5
13. Krijesë e re, 5:17
14. Pajtuar, 5:18
15. “armqtë e luftës sonë nuk janë prej mishi”, 10:4

16. Engjëll drite, 11:14
17. Qielli i tretë, 12:2
18. Parajsë, 12:4
19. Puthje e shenjtë, 13:12

IX. PERSONA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

1. “perëndia i kësaj bote”, 4:4
2. Belial, 6:15
3. Titi, 7:6

X. VENDNDODHJE QË DUHEN GJETUR NË HARTË

1. Akaia, 1:1
2. Azi, 1:8
3. Maqedoni, 1:16
4. Jude, 1:16
5. Korint, 1:23
6. Troadë, 2:12
7. Damask, 11:32

XI. PYETJE PËR DISKUTIM

1. Cila është domethënia teologjike e 1:20?
2. Shpjego me fjalët e tua 3:6.
3. Si përdoret fjala “perde” në dy kuptime në kapitullin 3? (4:3)
4. Rendit vuajtjen e Palit në 4:7-11; 6:4-10; 11:23-28
5. A do të dalin besimtarët para fronit gjykues të Krishtit? Nëse po, për çfarë?
6. Shpjego me fjalët e tua parimin shpirtëror të 5:14-15.
7. Çfarë doktrine shpreh 5:21
8. Rendit parimet e dhënies që gjenden në kapitujt 8-9.
9. Si e përshkruajnë kundërshtarët Palin në 10:10?
10. Për kë e ka fjalën Pali te 11:4?
11. Rendit mënyrat sesi Pali e krahason veten me të tjerët në 11:21-30.
12. Cili ishte gjembi në mish i Palit? (12:7)

HYRJE PËR GALATASIT

I. HYRJE

- A. Letra e Galatasve është një nga shprehjet më të qarta të së vërtetës falas dhe rrënjësisht të re të shpëtimit vetëm me anë të hirit, vetëm nëpërmjet besimit. Shpesh, ajo është quajtur “Magna Karta e lirisë së krishterë”.
- B. Kjo letër ndezi zjarrin e reformacionit protestant.
1. Martin Luteri tha: “libërthi i vogël i Galatasve është letra ime; jam fejuar me të; e kam nuse”.
 2. Xhon Uezli gjeti paqe për gjithë jetën nga një predikim i Galatasve.
 3. Në librin e tij *Study Bible Commentary*, f. 11, Curtis Vaughan shkroi: “të paktë janë ata libra që kanë ndikuar kaq thellë në mendjen e njerëzve, që kanë formëzuar kaq rrënjësisht rrjedhën e historisë njerëzore, ose që kanë vazhduar të flasin me kaq aktualitet për nevojat më të thella të jetës moderne”.
- C. Kjo letër me orientim doktrinor, ndoshta letra më e hershme e Palit, i parapriu Romakëve dhe zhvillimit të atyshëm të doktrinës së shfajësimit me anë të besimit veçmas theksimit të judaizmit për zbatimin e ligjit:
1. Shpëtimi nuk mund të gjendet edhe te ligji, edhe te hiri.
 2. Shpëtimi duhet gjetur ose te ligji, ose të hiri.
 3. Kthimi i vërtetë në besim vijohet nga ngjashmëria me Krishtin.
 4. Ruhuni nga legalizmi i krishterë.
- D. Ky shpëtim, që është rrënjësisht falas, dhe që vjen vetëm nga hiri dhe vetëm me anë të besimit, është dëshpërimisht i nevojshëm në kohën tonë për shkak të tërheqjes së përsëritur dhe tinzare të vetëdijes sonë fetare, që orientohet nga egoja dhe veprat. Në çdo epokë sfidohet e vërteta e thjeshtë e dashurisë së pakushtëzuar, nismëtare dhe altruiste të Perëndisë nëpërmjet pendimit njerëzore dhe besimit të përrulur. Mësuesit e rremë të Galatasve nuk po mohonin rolin qendror të Krishtit në shpengim, por po i shtonin diçka. Problemi nuk është çfarë i shtojmë ungjillit, por që s’duhet t’i shtojmë asgjë!

II. AUTORI

Autorësia e Palit nuk është vënë kurrë seriozisht në dyshim, pasi përbën një shtyllë të rëndësishme të koleksionit të letrave të Palit. Galatasve është tejet autobiografike dhe personale. Ka tonalitet të fortë emocional, por është dhe precize nga ana logjike.

III. DATA DHE MARRËSIT

- A. Këto dy aspekte të njohurive për sfondin e letrës duhen trajtuar së bashku për shkak se në datimin e Galatasve ndikojnë dy teori të kundërta për identitetin e marrësve të saj. Të dyja teoritë kanë peshë logjike dhe të dhëna të kufizuara biblike.
- B. Dy teoritë janë:
1. Teoria tradicionale, që ishte e pranuar njëzëshmi deri në shekullin e tetëmbëdhjetë.
 - a. Quhet “Teoria e Galatisë Veriore”.
 - b. Sipas saj, “Galatia” bën fjalë për galatasit etnikë të pllajës qendrore-veriore të Turqisë (shih 1 Pje. 1:1). Këta galatas etnikë ishin keltë (greqisht, *keltoi*, ose latinisht, *gali*), që e pushtuan këtë zonë në shekullin e tretë para Krishtit. Ata quheshin “galo-grekë”, që t’i dallonin nga vëllezërit e tyre evropiano-perëndimorë. U mposhtën më 230 para K. nga Atali I, mbreti i Pergamit. Ndikimi i tyre gjeografik shtrihej vetëm në Azinë e Vogël qendrore-veriore, ose Turqia e sotme.

- c. Nëse pranohet si marrës i letrës ky grup etnik, atëherë data e shkrimit të saj duhet të jetë mesi i viteve '50 gjatë udhëtimit të dytë ose të tretë misionar të Palit. Bashkudhëtarët e Palit ishin Sila dhe Timoteu.
 - d. Disa e kanë lidhur sëmundjen e Palit në Gal. 4:13 me malarien. Ata thonë se Pali udhëtoi në veri në malësinë e Galatisë për t'u larguar nga ultësirat bregdetare, që ishin të mbushura me kënetë dhe malarie.
2. Teoria e dytë u parashtrua nga Sër Wm. M. Ramsay, *St. Paul the Traveller and Roman Citizen*, New York: G. P. Putnam's Sons, 1896.
 - a. Teoria tradicionale e përcaktonte "Galatinë" nga ana etnike, kurse kjo teori e përcakton nga ana administrative. Duket se Pali i përdorte shpesh emrat e provincave romake (shih 1 Kor. 16:19; 2 Kor. 1:1; 8:1, etj.). Provinca romake e "Galatisë" përfshinte një zonë më të gjerë sesa "Galatia" etnike. Këta keltë etnikë e mbështetën Romën qysh herët, ndaj u shpërblyen me një autonomi më të madhe lokale dhe me autoritet të zgjeruar territorial. Nëse kjo zonë e gjerë njihej me emrin "Galati", atëherë ka gjasa që udhëtimi i parë misionar i Palit në këto qytete jugore të Antiokisë në Pisidi, Listra, Derbe dhe Ikon, që përmenden në Veprat 13-14, të ketë qenë vendndodhja e këtyre kishave.
 - b. Nëse pranohet "Teoria e Jugut", data e shkrimit të letrës duhet të ketë qenë shumë herët – pranë kohës (ndonëse jo përpara) së "këshillit të Jerusalemit" në Veprat 15, që trajton të njëjtën tematikë si dhe letra e Galatasve. Ky këshill u mbledh më 48-49 pas K, kështu që kjo letër mund të jetë shkruar gjatë së njëjtës periudhe. Nëse kjo është e vërtetë, Galatasve është letra e parë e Palit në Dhiatën e Re.
 - c. Disa të dhëna për teorinë e Galatisë së jugut:
 - (1) Nuk përmenden me emër bashkudhëtarët e Palit, por Barnaba përmendet tri herë (shih 2:1, 9, 13). Kjo përputhet me udhëtimin e parë misionar të Palit.
 - (2) Përmendet fakti se Titi nuk ishte i rrethprerë (shih 2:1-5). Kjo përputhet më së miri me kohën para Këshillit të Jerusalemit në Veprat 15.
 - (3) Përmendja e Pjetrit (shih 2:11-24) dhe problemi i bashkësisë me johebrenjtë përputhet më së miri me kohën para Këshillit të Jerusalemit.
 - (4) Kur u çuan paratë në Jerusalem, u përmenden disa shokë të Palit nga zona të ndryshme (shih Veprat 20:4). Mirëpo nuk përmendet asnjë nga qytetet e Galatisë veriore, ndonëse e dimë se dhe kishat e këtyre galatasve etnikë u përfshinë në kontributin vullnetar (shih 1 Kor. 16:1).
 3. Për paraqitjen e hollësishme të argumenteve të ndryshme për këto dy teori, konsultoni ndonjë komentuar teknik. Të dyja kanë argumente të vlefshme, por, deri tani, nuk është arritur në mendim unanim; gjithsesi, "Teoria Jugore" duket se përputhet më mirë me faktet.

C. Marrëdhënia e Galatasve me Veprat:

1. Pali e vizitoi pesë herë Jerusalemin, gjë që përmendet nga Luka në librin e Veprave:
 - a. 9:26-30, pas kthimit në besim
 - b. 11:30; 12:25, për të sjellë ndihma nga kishat johebraike
 - c. 15:1-30, Këshilli i Jerusalemit
 - d. 18:22, një vizitë e shkurtër
 - e. 21:15 e më tej, një tjetër shpjegim i punës ndër johebrenjtë
2. Në Galatasve përmenden dy vizita në Jerusalem:
 - a. 1:18, pas tri vitesh
3. Duket më e mundshme që Veprat 9:26 të lidhet me Gal. 1:18. Veprat 11:30 dhe 15:1 e më tej përbëjnë kontekstin e takimeve të paregjistruara që përmenden në Gal. 2:1.
4. Ka disa dallime mes Veprave 15 dhe ngjarjeve në Gal. 2, por kjo ndoshta ndodh për shkak të:
 - a. Këndvështrimeve të ndryshme
 - b. Qëllimeve të ndryshme të Lukës dhe Palit
 - c. Fakti se Gal. 2 mund të ketë ndodhur njëfarë kohe para takimit të përshkruar në Veprat 15, por në lidhje me të.

D. Kronologjia e mundshme e letrave të Palit, që ndjek atë të F. F. Bruce dhe Murray Harris me disa përshtatje të vogla.

<u>Libri</u>	<u>Data</u>	<u>Vendi i shkrimit</u>	<u>Lidhja me Veprat</u>
1. Galatasve	48	Antiokia e Sirisë	14:28; 15:2
2. 1 Thesalonikasve	50	Korint	18:5
3. 2 Thesalonikasve	50	Korint	
4. 1 Korintasve	55	Efes	19:20
5. 2 Korintasve	56	Maqedoni	20:2
6. Romakëve	57	Korint	20:3
7-10. Letrat e Burgut			
Kolosianëve	fillim '60		
Efesianëve	fillim '60	Romë	
Filemonit	fillim 60'		
Filipianëve	fund 62-63		28:30-31
11-13. Udhëtimi i Katërt Misionar			
1 Timoteut	63 (ose më vonë,	Maqedoni	
Titit	63 (por përpara	Efes (?)	
2 Timoteut	64 (68 pas K.)	Romë	

IV. QËLLIMI I LETRËS

A. Pali trajtoi tre fusha të veçanta që e preokuponin për mesazhin e mësuesve të rremë. Këta heretikë janë etiketuar si “judaistë” pasi besonin se njeriu duhet të bëhet jude përpara se të bëhet i krishterë (shih 6:12). Preokupimet e tij lidheshin me akuzat e judaistëve:

1. Pali nuk ishte apostull i vërtetë si të dymbëdhjetët (shih Veprat 1:21-22); për këtë arsye, ai varej nga autoriteti i tyre, ose të paktën nga autoriteti i kishës mëmë në Jerusalem.
2. Mesazhi i Palit ndryshonte nga mësimi i tyre dhe, si rrjedhojë, ishte i rremë. Kjo dukej se lidhej drejtpërdrejt me konceptin e “shfajësimit me anë të besimit, veçmas Ligjit”. Apostujt në Jerusalem ishin ende tejet judaikë në jetën personale.
3. Me këto kisha shoqërohej një element libertiznimi në njëfarë mënyre (shih 5:18-6:8). Sesi duhet shpjeguar kjo është diçka e debatueshme. Disa shohin dy grupe të ndryshme në letrat e Palit: judaistët dhe gnostikët (shih 4:8-11). Megjithatë, duket më e përshtatshme që këto vargje t'i lidhim me praktikën pagane. Judenjtë preokupoheshin për stilin e jetesës së johebrenjve. Ç'lidhje kishte hiri radikal falas i Palit me idhujtarinë dhe teprimet pagane?

B. Nga ana doktrimore, kjo letër është shumë e ngjashme me letrën e Palit drejtuar Romakëve. Këta dy libra përmbajnë doktrinën madhore të Palit, të përsëritura dhe të zhvilluara në kontekste të ndryshme.

V. PËRVIJIM I SHKURTËR

A. Prolog, 1:1-10

1. Hyrje e përgjithshme e letrës
2. Shkasi për shkrimin e letrës

B. Pali mbron apostullimin e vet, 1:11-2:14

C. Pali mbron të vërtetat doktrimore të ungjillit, 2:15-4:20

D. Pali mbron rrjedhojat praktike të ungjillit, 5:1-6:10

E. Përmbledhje personale dhe përmbyllje, 6:11-18

VI. FJALË DHE FRAZA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

1. “kjo epokë e tanishme e ligë”, 1:4
2. “një ungjill i ndryshëm”, 1:6
3. Judaizëm, 1:13
4. Traditat e paraardhësve, 1:14
5. “kurrë mos qoftë”, 2:17
6. “o galatas të marrë”, 3:1, 3
7. Të magjepsur, 3:1
8. “nëse ishte vërtet kot”, 3:4; 4:11
9. “nën mallkim”, 3:10
10. “fara e tij”, 3:16
11. “i shpallur nëpërmjet engjëjve me anë të një ndërmjetësi”, 3:19
12. “ne mbaheshim nën mbikëqyrje nën ligjin”, 3:23
13. “gjërat elementare”, 4:3, 9
14. Abba, 4:6
15. “sëmundje e trupit”, 4:13
16. “me anë të skllaves... nga e lira”, 4:23
17. Alegorikisht, 4:24
18. “ecni me anë të Frymës”, 5:16
19. “fryti i Frymës”, 5:22
20. “çfarë shkronjash të mëdha”, 6:11
21. “shenjat e Jezusit”, 6:17

VII. PERSONA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

1. “një engjëll nga qielli”, 1:8
2. Kefa, 1:18
3. Barnaba, 2:1
4. Titi, 2:2
5. “ata që kishin emër”, 2:2, 6
6. “vëllezërit e rremë”, 2:4
7. “që konsideroheshin shtylla”, 2:9
8. “pala e rrethprerjes”, 2:12
9. “kujdestarë dhe administratorë”, 4:2
10. Hagar, 4:25

VIII. VENDNDODHJE QË DUHEN GJETUR NË HARTË

1. Kishat e Galatisë, 1:2
2. Arabi, 1:17
3. Damask, 1:17
4. Siri, 1:21
5. Kiliki, 1:21
6. Antioki, 2:11

IX. PYETJE PËR DISKUTIM

1. Shpjego me fjalët e tua 1:11-12.
2. Kur e përdoqi Pali kishën e Perëndisë? (1:13)
3. Pse disa donin që Titi të rrethpritej? (7:3)
4. Shpjego me fjalët e tua 2:6.
5. Galatasve 2:16 mund të jetë tema e gjithë librit. Pse?
6. Shpjego me fjalët e tua 2:20.

7. Si do t'i përgjigjeshe pyetjes së Palit në 3:3?
8. Shpjego domethënien e citimit nga Pali të Zan. 15:6, 8 në Gal. 3:6-8.
9. Si u mallkua Jezusi? (3:13)
10. Cili ishte qëllimi i DHV sipas 3:19?
11. Pse është përmbledhje e shkëlqyer 3:22?
12. Pse është e vërtetë e rëndësishme 3:28?
13. Çfarë ishte sëmundja trupore e Palit, e përmendur në 4:13?
14. Cili është qëllimi i krishterimit? (4:19)
15. Cili është argumenti teologjik i Palit në 5:3?
16. Shpjego fjalën e urtë në 5:9.
17. Ç' do të thotë 5:4: "keni rënë nga hiri"?
18. Si lidhet 5:13 me Romakëve 14:1-15:13?
19. Shpjego 5:23 me fjalët e tua.
20. Si duhet të sillen besimtarët me ata bashkëbesimtarë që jetojnë në mëkat? (6:1-5)
21. Cili është parimi shpirtëror në 6:7?
22. Si na tregon 6:10 që të sillemi me ata që janë jashtë komunitetit të besimtarëve?

HYRJE PËR EFESIANËT

I. SHËNIME HYRËSE

- A. Të vërtetat e këtij libri kanë ndikuar në jetën e shumë shenjtorëve
 - 1. Samuel Coleridge e quajti “kompozimin hyjnor të njeriut”
 - 2. Gjon Kalvini e quante librin e tij të preferuar të Biblës.
 - 3. Xhon Noksi kërkoi që predikimet e Kalvinit për letrën e Efesianëve t’ia lexonin ndërsa dergjej në shtratin e vdekjes
- B. Ky libër është quajtur “xhevahiri i kurorës”, ose pika kulmore e teologjisë së Palit. Të gjitha temat kryesore të Palit shprehen në mënyrë të mrekullueshme dhe përmbledhëse.
- C. Ashtu si përdori letrën e Romakëve për të nisur reformacionin, Perëndia do ta përdorë dhe Efesianëve për të ribashkuar krishterimin e përçarë. Uniteti dhe përbashkësia e besimtarëve në Krishtin duhet të tejkalojë çdo dallim mes tyre.

II. AUTORI

- A. Pali
 - 1. Shprehet shkoqur në 1:1, 3:1
 - 2. Përmendja e burgosjes (ndoshta në Romë) në 3:1; 4:1; 6:20
 - 3. Tradita pothuajse e njëzëshme e kishës
 - a. Klementi i Romës, më 95 pas K., i shkroi Korintit një letër, ku citon Efesianëve 4:4-6
 - b. Ignati (30-107 pas K.) citon nga 1:9; 2:19; 3-9
 - c. Polikarpi (65-155 pas K.), dishepull i apostullit Gjon, dhe peshkop i Smirnës, pohon autorësinë e Palit
 - d. Ireneu (130-200 pas K.) pohon autorësinë e Palit
 - e. Klementi i Aleksandrisë (150-210 pas K.) pohon autorësinë e Palit
 - 4. Renditet në
 - a. Listën e librave të pranuar nga Markioni (që erdhi në Romë në vitet 140 pas K.)
 - b. Fragmentin Muratorian (180-200 pas K.), një listë librash kanonikë nga Roma, ku Efesianëve vendoset në shkrimet e Palit
 - 5. Përmbylljet e Kolosianëve dhe Efesianëve përmbajnë 29 fjalë që janë plotësisht të njëjta në greqisht (Kolosianëve përmben dhe dy fjalë shtesë).
- B. Një autor tjetër
 - 1. Erazmi ishte i pari që vuri në dyshim autorësinë e Palit në bazë të
 - a. Stilit – fjali të gjata, që nuk janë karakteristike për letrat e tjera të Palit
 - b. Asnjë përshëndetje personale
 - c. Fjalor unik
 - 2. Bota studimore kritike e shekullit të 18-të filloi të mohonte autorësinë e Palit
 - a. Disa vargje duket sikur janë shkruar nga një besimtar i brezit të dytë, 2:20; 3:5
 - b. Përdoren disa fjalë teologjike me përcaktime të ndryshme (për shembull: “mister”)
 - c. Natyra unike e gjinisë letrare të letrave ciklike ose qarkore
- C. Përgjigje ndaj argumenteve të Erazmit
 - 1. Stili është i ndryshëm për shkak se Pali pati kohë që të mendohej përpara se të shkruante Efesianëve ndërsa ishte në burg.
 - 2. Mungesa e përshëndetjeve personale shpjegohet nga fakti se Efesianëve ishte një letër qarkore që u duhej dërguar shumë kishave në atë rajon. Rruga e postës romake, që përfshinte Efesin dhe luginën e lumit Likus, mund të shihet në Zbu. 2-3. Pali shkroi një letër “binjake”, Kolosianëve, drejtuar një grupi të veçantë prej tre kishash, ku përfshiu një sërë përshëndetjesh personale.

3. Numri i fjalëve unike në Efesianët është njësoj me numrin e fjalëve unike (*hapaks legomena*) në Romakëve. Qëllimi, tematika, marrësit dhe shkasi i shkrimit shpjegojnë përdorimin e fjalëve të reja.
4. Pali flet për “apostujt dhe profetët” në 1 Kor. 12:28, që ngjason me Efe. 2:20 dhe 3:5. Askush nuk e mohon autorësinë e 1 Korintasve si letër e Palit.

III. MARRËDHËNIA LETRARE MES KOLOSIANËVE DHE EFESIANËVE

A. Marrëdhënia historike mes letrës së Kolosianëve dhe asaj të Efesianëve

1. Epafrai (Kol. 1:7; 4:12; Filemoni 23) u kthye në besim gjatë fushatës efesianase të Palit (Veprat 19)
 - a. Ai e çoi besimin e tij të ri në vendlindje, në luginën e lumit Likus.
 - b. Epafrai mbolli tri kisha: në Hierapol, Laodice dhe Kolos.
 - c. Epafrai i kërkoi këshilla Palit si ta kundërshtonte shkrirjen e pikëpamjes së krishterë me atë të heretikëve. Pali ishte i burgosur në Romë (në fillim të viteve '60)
2. Mësuesit e rremë kishin ardhur dhe po mësonin shkrirjen e ungjillit me ontologjinë greke
 - a. Shpirti dhe materia janë të përjetshme
 - b. Shpirti (Perëndia) është i mirë
 - c. Materia (krijimi) është e ligë
 - d. Ekzistojnë një sërë *eonash* (nivelesh engjëllore) midis Perëndisë së epërm dhe të mirë dhe një perëndi më të ulët, i cili krijoi materien
 - e. Shpëtimi bazohet në njohjen e disa fjalëkalimeve të fshehta, që i ndihmojnë njerëzit të kalojnë nga një *eonë* (nivel engjëllor) në tjetrën

B. Marrëdhënia letrare mes këtyre dy letrave të Palit

1. Pali dëgjoi nëpërmjet Epafrait për herezinë në këto kisha, të cilat nuk i kishte vizituar kurrë personalisht.
2. Pali shkroi një letër të fortë me fjali të shkurtra dhe emocionale, që synonte të godiste mësuesit e rremë. Tematika qendrore ishte se Jezusi zotëron gjithë krijimin. Kjo njihet si letra e Palit drejtuar Kolosianëve.
3. Me sa duket, pak kohë pasi shkroi Kolosianëve, kësaj here duke patur më shumë kohë në dispozicion gjatë burgosjes, Pali i zhvilloi më tej këto tematika. Efesianëve karakterizohet nga fjali të gjata dhe koncepte të zhvilluara teologjike (1:3-14, 15-23; 2:1-10, 14-18, 19-22; 3:1-12, 14-19; 4:11-16; 6:13-20). Kjo letër merr si pikë fillese Kolosianët dhe i çon më tej rrjedhojat e saj teologjike. Tema e saj kryesore është uniteti i të gjitha gjërave në Krishtin, që përbën një kontrast me konceptin proto-agnostik.

C. Strukturë e ngjashme letrare dhe teologjike

1. Ngjashmëria e strukturës bazë
 - a. Të dyja letrat kanë hyrje shumë të ngjashme
 - b. Kanë pjesë doktrinale, që trajtojnë kryesisht Krishtin
 - c. Kanë pjesë praktike, që bëjnë thirrje për një stil jetese të krishterë duke përdorur kategori, fjalë dhe fraza të njëjta
 - d. Kanë vargje përmblylëse që përmbajnë 29 fjalë të njëjta në greqisht; Kolosianëve ka shtuar vetëm dy fjalë.
2. Ngjashmëria e fjalëve ose frazave të shkurtra (në greqisht)

Ef. 1:1c dhe Kol. 1:2a	“besnik”
Ef. 1:4 dhe Kol. 1:22	“i shenjtë dhe i patëmetë”
Efe. 1:7 dhe Kol. 1:14	“shpengimi... falja”
Efe. 1:10 dhe Kol. 1:20	“të gjitha gjërat... qiell... tokë”
Efe. 1:15 dhe Kol. 1:3-4	“dëgjoj... dashuri për gjithë shenjtorët”
Efe. 1:18 dhe Kol. 1:27	“pasuritë e lavdisë”
Efe. 2:1 dhe Kol. 1:13	“ishit të vdekur”
Efe. 2:16 dhe Kol. 1:20	“pajtoi... kryqin”

- | | |
|---------------------------------|--|
| Efe. 3:2 dhe Kol. 1:25 | “kujdestari” |
| Efe. 3:3 dhe Kol. 1:26, 27 | “misteri” |
| Efe. 4:3 dhe Kol. 3:14 | “unitet” |
| Efe. 4:15 dhe Kol. 2:19 | “kreu” dhe “rritet” |
| Efe. 4:24 dhe Kol. 3:10, 12, 14 | “vishni...” |
| Efe. 4:31 dhe Kol. 3:8 | “zemërim”, “tërbim”, “keqdashje”, “fyerje” |
| Efe. 5:3 dhe Kol. 3:5 | “shthurje”, “papastërti”, “lakmi” |
| Efe. 5:5 dhe Kol. 3:5 | “idhujtari” (lakmi) |
| Efe. 5:6 dhe Kol. 3:6 | “zemërimi i Perëndisë” |
| Efe. 5:16 dhe Kol. 4:5 | “shfrytëzohen plotësisht kohën” |
3. Fraza dhe fjali të njëjta
- Efe. 1:1a dhe Kol. 1:1a
Efe. 1:1b dhe Kol. 1:2a
Efe. 1:2a dhe Kol. 1:2b
Efe. 1:13 dhe Kol. 1:5
Efe. 2:1 dhe Kol. 2:13
Efe. 2:5b dhe Kol. 2:13c
Efe. 4:1b dhe Kol. 1:10a
Efe. 6:21-22 dhe Kol. 4:7-8 (29 fjalë të njëjta njëra pas tjetrës, me përjashtim të “*kai syndoulos*” në Kolosianëve)
4. Ngjashmëri frazash ose fjalish
- Efe. 1:21 dhe Kol. 1:16
Efe. 2:1 dhe Kol. 1:13
Efe. 2:16 dhe Kol. 1:20
Efe. 3:7a dhe Kol. 1:23d, 25a
Efe. 3:8 dhe Kol. 1:27
Efe. 4:2 dhe Kol. 3:12
Efe. 4:29 dhe Kol. 3:8; 4:6
Efe. 4:32b dhe Kol. 3:13b
Efe. 5:15 dhe Kol. 4:5
Efe. 5:19-20 dhe Kol. 3:16
5. Koncepte sinonimike nga ana teologjike:
- | | |
|----------------------------|---|
| Efe. 1:3 dhe Kol. 1:3 | lutje falenderimi |
| Efe. 2:1, 12 dhe Kol. 1:21 | tëhuajtje nga Perëndia |
| Efe. 2:15 dhe Kol. 2:14 | armiqësia e Ligjit |
| Efe. 4:1 dhe Kol. 1:10 | ecje e denjë |
| Efe. 4:15 dhe Kol. 2:19 | trupit i Krishtit rritet drejt pjekurisë nga Koka |
| Efe. 4:19 dhe Kol. 3:5 | papastërtia seksuale |
| Efe. 4:22, 31 dhe Kol. 3:8 | “lini mënjanë” mëkatet |
| Efe. 4:32 dhe Kol. 3:12-13 | të krishterët të jenë mirëdashës ndaj njëri-tjetrit |
| Efe. 5:4 dhe Kol. 3:8 | të folurit e krishterë |
| Efe. 5:18 dhe Kol. 3:16 | mbushja me Frymë = fjala e Krishtit |
| Efe. 5:20 dhe Kol. 3:17 | falënderim Perëndisë për të gjitha gjërat |
| Efe. 5:22 dhe Kol. 3:18 | gratë t’u nënshtrohen burrave |
| Efe. 5:25 dhe Kol. 3:19 | burrat t’i duan gratë e tyre |
| Efe. 6:1 dhe Kol. 3:20 | fëmijët t’u binden prindërve |
| Efe. 6:4 dhe Kol. 3:21 | etërit të mos i nxisin fëmijët për zemërim |
| Efe. 6:5 dhe Kol. 3:22 | skllëvërit t’u binden padronëve |
| Efe. 6:9 dhe Kol. 4:1 | zotërinjtë dhe skllëvërit |
| Efe. 6:18 dhe Kol. 4:2-4 | kërkesa e Palit për lutje |

6. Fjalët e përdorura në Kolosianëve dhe Efesianëve, që nuk gjenden në letrat e tjera të Palit
 - a. “mbushulli/plotësi”

Efe. 1:23	“mbushullia e atij që mbush gjithçka në gjithçka”
Efe. 3:19	“mbushuni me gjithë plotësinë e Perëndisë”
Efe. 4:13	“në mbushullinë e Krishtit”
Kol. 1:19	“që gjithë plotësia të banojë në të”
Kol. 2:9	“sepse në të banon gjithë plotësia e Hyjnisë”
 - b. Krishti si “kreu” i kishës
Efe. 4:15, 5:23 dhe Kol. 1:18; 2:19
 - c. “tëhuajtur”
Efe. 2:12; 4:18 dhe Kol. 1:21
 - d. “shfrytëzoni kohën”
Efe. 5:16 dhe Kol. 4:5
 - e. “rrenjosur”
Efe. 3:17 dhe Kol. 2:7
 - f. “fjala e së vërtetës, ungjilli”
Efe. 1:13 dhe Kol. 1:5
 - g. “duron”
Efe. 4:2 dhe Kol. 3:13
 - h. Fraza dhe fjalë të pazakonta (“mbahet së bashku”, “furnizon”)
Efe. 4:16 dhe Kol. 2:19

D. Përmbledhje

1. Mbi një e treta e fjalëve të Kolosianëve gjendet në Efesianëve. Është llogaritur se 75 nga 155 vargjet e Efesianëve paralelizohen në Kolosianëve. Të dyja thonë se u shkruan nga Pali gjatë kohës në burg.
2. Të dyja letrat i çoi miku i Palit, Tikiku.
3. Të dyja u dërguan në të njëjtën zonë (Azia e Vogël).
4. Të dyja trajtojnë të njëjtën temë kristologjike.
5. Të dyja theksojnë Krishtin si kreu i kishës.
6. Të dyja inkurajojnë jetesën e përshtatshme të të krishterëve.

E. Pika kryesore ndryshimesh

1. Kisha është gjithmonë lokale te Kolosianëve, por universale tek efesianëve. Kjo mund të jetë për shkak të natyrës qarkore të letrës së Efesianëve.
2. Herezia, që ishte tipar i spikatur te Kolosianët, nuk përmendet drejtpërdrejt në Efesianët. Sidoqoftë, të dyja letrat përdorin fjalë tipike gnostike (“urtësi”, “njohuri”, “plotësi”, “mister”, “principatat dhe pushtetet” dhe “kujdestari”).
3. Ardhja e dytë është e atypëratyshme te Kolosianët, por e vonura tek Efesianët. Kisha kishte (dhe ka) thirrjen që të shërbejë në një botë të rënë (2:7; 3:21; 4:13).
4. Një sërë fjalësh tipike për Palin përdoren ndryshe. Një shembull është fjala “mister”. Në Kolosianëve, misteri është vetë Krishti (Kol. 1:26-27; 2:2; 4:3), kurse tek Efesianëve (1:9; 5:32) misteri është plani hyjnor, më parë i fshehur, por tani i zbuluar, për unitetin e johebrenjve me judenjët.
5. Efesianëve përmban një sërë aludimesh për Dhiatën e Vjetër (1:22—Ps. 8; 2:17—Isa. 57:19) (2:20—Ps. 118:22) (4:8—Ps. 68:18) (4:26—Ps. 4:4) (5:15—Isa. 26:19, 51:17, 52:1, 60:1) (5:3—Zan. 3:24) (6:2—3-Eks. 20:12) (6:14—Isa. 11:5, 59:17) (6:15—Isa. 52:7), kurse letra e Kolosianëve përmban vetëm një ose dy aludime të tilla (2:3—Isa. 11:2) or (2:22—Isa. 29:13).

F. Ndonëse shumë të ngjashme në fjalë, fraza dhe, madje, përvijim, këto dy letra përmbajnë dhe të vërteta unike.

1. Bekimi triumf i hirit – Efe. 1:3-14
2. Pasazhi i hirit – Efe. 2:1-10
3. Shkrimi i judenjve me johebrenjtë në një trup të ri – Efe. 2:11-3:13

4. Uniteti dhe dhuntishmëria e trupit të Krishtit – Efe. 4:1-16
5. “Krishti dhe kisha” janë model për “burrin dhe gruan”, Efe. 5:22-33
6. Pasazhi për luftën shpirtërore – Efe. 6:10-18
7. Pasazhi kristologjik – Kol. 1:13-18
8. Rituali dhe ritet fetare njerëzore – Kol. 2:16-23
9. Tema e rëndësishme kozmike të Krishtit te Kolosianët kundrejt temës së unitetit të gjithçkaje në Krishtin tek Efesianët

G. Si përfundim, gjëja më e mirë është që të biem dakord me A. T. Robertson dhe F. F. Bruce kur thonë se Pali i shkroi të dyja këto letra në kohë shumë të afërt me njëra-tjetrën duke i zhvilluar mendimet e Kolosianëve në një paraqitje kulmore të së vërtetës te letra e Efesianëve.

IV. DATA

- A. Data e kësaj letrë lidhet me një nga burgosjet e Palit në Efes, Filipi, Cezare, ose Romë. Burgosja në Romë duket se përputhet më së miri me faktet e Veprave.
- B. Nëse pranojmë Romën si vendin e burgosjes, ngrihet pyetja: në ç’kohë? Pali ishte në burg në fillim të viteve ’60, siç na thuhet tek Veprat, por u lirua nga burgu dhe shkroi letrat pastorale (1 dhe 2 Timoteut dhe Titit), pastaj, u arrestua sërish dhe u vra përpara datës 9 qershor, 68 pas K., që ishte data e vetëvrasjes së Neronit.
- C. Hamendësimi më i saktë për shkrimin e Efesianëve është burgosja e parë e Palit në Romë në fillim të viteve ’60.
- D. Tikiku, së bashku me Onesimin, mund t’i ketë çuar letrat e Kolosianëve, Efesianëve dhe Filemonit në Azinë e Vogël.
- E. Kronologji e mundshme e shkrimeve të Palit, sipas F. F. Bruce dhe Murray Harris, me disa përshtatje të vogla.

<u>Libri</u>	<u>Data</u>	<u>Vendi i shkrimit</u>	<u>Lidhja me Veprat</u>
1. Galatasve	48	Antiokia e Sirisë	14:28; 15:2
2. 1 Thesalonikasve	50	Korint	18:5
3. 2 Thesalonikasve	50	Korint	
4. 1 Korintasve	55	Efes	19:20
5. 2 Korintasve	56	Maqedoni	20:2
6. Romakëve	57	Korint	20:3
7-10. Letrat e Burgut			
Kolosianëve	fillim ’60		
Efesianëve	fillim ’60	Romë	
Filemonit	fillim 60’		
Filipianëve	fund 62-63		28:30-31
11-13. Udhëtimi i Katërt Misionar			
1 Timoteut	63 (ose më vonë, Maqedoni)		
Titit	63 (por përpara Efes (?))		
2 Timoteut	64 (68 pas K.)	Romë	

V. MARRËSIT

- A. Shumë dorëshkrime (papuruset e Chester Beatty, P46; Sinaitiku; Vatikani, B; teksti greqisht i Origenit, dhe teksti greqisht i Tertullianit) nuk e përmbajnë fjalën “Efes” në 1:1. RSV dhe përkthimi i Ëilliams veprojnë njësoj, dhe nuk e përmbajnë këtë fjalë.

- B. Gramatika greke e vargut 1 lë vend për një emër vendi. Ndoshta, si letër qarkore, emri i vendit të kishës në fjalë u la bosh në mënyrë që të vendosej nga lexuesi kur t'ua lexonte me zë të lartë kishave. Ndoshta, kjo shpjegon dhe frazën në Kolosianëve 4:15-16, “letra drejtuar laodiceasve”, që mund të ketë qenë letra e Efesianëve (Markioni e quante Efesianëve “letra drejtuar laodiceasve”).
- C. Efesianëve iu shkrua së pari johebrenjve, 2:1; 4:17, të cilët Pali nuk i kishte takuar personalisht, 1:15; 3:2. Kishat në luginën e lumit Likus (Laodicea, Hierapoli dhe Kolosi) u mbollën nga Epafrasi, jo nga Pali (Kol. 1:7; 4:12; Filemoni 23).

VI. QËLLIMI

- A. Tema e librit gjendet në 1:10 dhe 4:1-10, që thekson unitetin e të gjitha gjërave në Krishtin. Krishti rimëkëmb shëmbëllimin e Perëndisë të njerëzimi dhe bota (*kosmos*).
- B. Efesianëve është një nga letrat e burgut të Palit. Përvijimet e Efesianëve dhe Kolosianëve janë shumë të ngjashme. Kolosianëve u shkrua për të sulmuar herezinë e proto-gnosticizmit në luginën e lumit Likus në Azinë e Vogël. Efesianëve u shkrua si letër qarkore për këtë rajon me qëllim që t'i përgatiste kishat e tjera për herezinë që po vinte. Kolosianëve është letër e prerë dhe goditëse, ndërsa Efesianëve është një paraqitje e zgjeruar dhe logjike e të njëjtave të vërteta, por duket përdorur fjali shumë të gjata (1:3-14, 15-23; 2:1-9; 3:1-7, etj.).

VII. PËRVIJIM I SHKURTËR

- A. Letra ndahet natyrshëm në dy pjesë (si shumica e letrave të Palit):
1. Uniteti në Krishtin, kapitujt 1-3 (teologji)
 2. Uniteti në kishë, kapitujt 4-6 (zbatim)
- B. Përvijim i mundshëm tematik
1. Hyrja tradicionale e Palit, 1:1-2
 2. Plani i Atit për unitetin e të gjitha gjërave në Krishtin, 1:3-3:21
 - a. Lavdërimi i Atit nga Pali, 1:3-14
 - (1) Për dashurinë e Atit përpara kohës
 - (2) Për dashurinë e Atit në Birin në kohën e duhur
 - (3) Për dashurinë e vazhdueshme të Atit me anë të Frymës nëpërmjet kohës
 - b. Lutja e Palit drejtuar Atit për kishat, 1:15-23
 - (1) Që zbulesa e Atit në Krishtin të kuptohet
 - (2) Që fuqia e Atit të veprojë fort në besimtarët
 - (3) që Krishti të lartësohet nga Ati mbi gjithçka
 - c. Botëkuptimi i Palit për planin e Atit për gjithë njerëzimin, 2:1-3:13
 - (1) Nevoja e njerëzimit mëkatar
 - (2) Furnizimi i hirshëm i Atit
 - (3) Përgjigjja e nevojshme e njerëzimit ndaj besëlidhjes
 - (4) Zbulimi i plotë i planit të Atit
 - d. Lutja e Palit drejtuar Atit për besimtarët, 3:14-21
 - (1) Që të marrin fuqi të brendshme (me anë të Frymës)
 - (2) Që ta kuptojnë plotësisht ungjillin (jo vetëm të vërtetat domgatike) në përvojën e tyre dhe me dashuri
 - (3) Që të mbushen me plotësinë e Perëndisë (që është Krishti)
 - (4) E gjitha kjo do të kryhet nga Perëndia, që është i aftë
 3. Dëshira e Atit për unitetin e popullit të tij të ri, 4:1-6:20
 - a. Uniteti i Perëndisë trium pasqyrohet në unitetin e fëmijëve të tij, 4:1-16
 - (1) Uniteti nuk është uniformitet, por dashuri në mënyrën e jetesës
 - (2) Hyjnia është unitet trium
 - (3) Dhuntitë shpirtërore janë për të mirën e trupit, jo për nderimin individual

- (4) Uniteti kërkon shërbesë
 - (5) Uniteti është nën sulm engjëllor
 - (6) Uniteti është në Krishtin
 - b. Uniteti i krishterë i kundërvihet egoizmit pagan, 4:17-5:14
 - (1) Lini mënjane nevojat e jetës së vjetër
 - (2) Vishni ngjashmërinë me Krishtin
 - c. Mënyra për arritjen dhe ruajtjen e unitetit, 6:10-20
 - (1) Jini gjithmonë të mbushur me Frymën
 - (2) Përshkrimi i jetës së mbushur me Frymën
 - (a) Pesë pjesore, vgj. 19-21
 - (b) Tre shembuj familjarë
 - i. Burrat – gratë
 - j. Prindërit – fëmijët
 - k. Zotërinjtë – sklleverit
 - d. Përpjekja për unitetin e krishterë, 6:10-20
 - (1) Beteja shpirtërore
 - (2) Armatimi i Perëndisë
 - (3) Fuqia e lutjes
3. Fjalët përmbyllëse, 6:21-24

VIII. SFONDI FILOZOFIK DHE TEOLOGJIK I MËSUESVE TË RREMË (GNOSTICIZMI)

- A. Bindjet gnostike në shekullin e parë dhe të dytë:
1. Dualizëm ontologjik (i përjetshëm) mes shpirtit (Perëndisë) dhe materies (gjërave fizike).
 2. Shpirti është i mirë, kurse materia është e ligë.
 3. Një sërë nivelesh engjëjllore (*eona*) mes Perëndisë së lartë e të shenjtë dhe një perëndie tjetër, më i ulët, që i dha formë materies së ligë.
 4. Udhë drejt shpëtimit
 - a. Njohja e një fjalëkalimi të fshehtë, që mundësonte kalimin mes sferave engjëjllore nga toka drejt qiellit.
 - b. Një shkëndijë hyjnore në gjithë njerëzit, ndonëse jo të gjitha mund ta kuptonin ose të merrnin njohuri shpëtuese.
 - c. Njohuria i jepej vetëm një grupi elitare me anë të zbulesave të veçanta.
 5. Etika
 - a. S'kishte fare lidhje me jetën shpirtërore (libertinët, antinomët)
 - b. Kyçe për shpëtimin (legalistët).
- B. Dallimet e forta me krishterimin historik dhe biblik
1. Ndarja e natyrës njerëzore nga ajo hyjnore e Krishtit (gnostikët thoshin se ai nuk mund të ishte plotësisht Perëndi, ose nuk mund të ishte plotësisht njeri)
 2. Heqja e vdekjes së tij zëvendësuese si e vetmja mënyrë shpëtimi
 3. Zëvendësimi i hirit hyjnor falas me njohurinë njerëzore.

IX. FJALË DHE FRAZA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

1. Shenjtorët, 1:1
2. Zot, 1:2
3. Vendet qiellore, 1:3
4. “përpara themelimit të botës”, 1:4
5. Të pafajshëm, 1:4
6. Të paracaktuar, 1:5
7. “shpengim”, 1:7
8. Mister, 1:9
9. “plotësia e kohës”, 1:10

10. Vulosur, 1:13
11. Garancia, 1:14
12. Lavdi, 1:17
13. “ulur me të në të djathtë të tij”, 1:20
14. “plotësia e tij që mbush gjithçka në gjithçka”, 1:23
15. “udha e kësaj bote”, 2:2
16. “dhurata e Perëndisë”, 2:8
17. “bashkëqytetarë”, 2:19
18. “guri i themelit”, 2:20
19. “guxim dhe hyrje me siguri besimi”, 3:12
20. “mashtimet e njerëzve”, 4:14
21. “me dinakëri dhe plane mashtruese”, 4:14
22. “ecni në dashuri”, 5:2
23. “aromë erëmirë”, 5:2
24. “mbretërinë e Krishtit dhe Perëndisë”, 5:5
25. “nënshtrojuni njëri-tjetrit”, 5:21
26. “armatimi i plotë i Perëndisë”, 6:11
27. “përvishni ijët”, 6:14
28. “shpata e Frymës”, 6:17

X. PERSONA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

1. Gnostikët
2. “princi i pushtetit të ajrit”, 2:2
3. Johebrenjtë
4. Apostujt, 4:11
5. Profetët, 4:11
6. Ungjilltarët, 4:11
7. Kreu, 4:15
8. Djali, 4:27
9. “bijtë e mosbindjes”, 5:6
10. “fëmijët e Dritës”, 5:8
11. “forcat shpirtërore të ligësisë”, 6:12
12. Tikiku, 6:21

XI. VENDNDODHJET NË HARTË - ASNJË

XII. PYETJE PËR DISKUTIM

1. Cila është tema kryesore e 1:3-14?
2. Pse përdoret fraza “për përlëvdimin e lavdisë së tij” tri herë në 1:3-14?
3. Pse flet shpesh Pali për “urtësinë dhe mprehtësinë” ose “njohurinë” në këtë letër?
4. Për kë bën fjalë 1:19?
5. Shpjego konceptin judaik të dy epokave (1:21).
6. Përmblihdh temën e 2:1-3.
7. Përmblihdh temën e 2:4-6.
8. Shpjego aludimin historik në 2:14.
9. Për ç’zbulësë e ka fjalën Pali në 3:3?
10. Pse e quan Pali veten “më i ulti i gjithë shenjtorëve”? (3:8)
11. Pse përdoret kaq shpesh fjala “një” në 4:4-6?
12. Çfarë është dhurata e Krishtit në 4:7?
13. Ku gjendet në DHV citimi i Palit në 4:8? Pse ndryshon kaq shumë nga DHV citimi i Palit?
14. Pse është kaq i rëndësishëm 4:12?
15. A vlen 5:5 vetëm për ata që mund të shpëtohen?

16. Si lidhet dehja me mbushjen me Frymë? (5:18)
17. Pse dashuria dhe sakrifica e Krishtit për kishën ka lidhje me familjen e krishterë? (5:25-33)
18. Ç'lidhje ka “nderimi” me “bindjen”?
19. Pse është kaq i nevojshëm sot vargu 6:18?

HYRJE PËR FILIPIANËT

I. SHËNIME HYRËSE

- A. Kjo është një nga letrat më joformale të Palit. Me këtë kishë ai nuk e ndjeu të nevojshme që të mbronte autoritetin e vet apostolik. Dashuria e tij e jashtëzakonshme për ta është e qartë. Madje, i lejoi që t'i dërgonin dhe para (shih 1:5, 7; 4:15), gjë që ishte tejet e pazakontë për Palin.
- B. Pali ishte në burg, por e përdor mbi gjashtëmbëdhjetë herë fjalën “gëzim” (si emër ose si folje). Paqja dhe shpresa e tij nuk bazoheshin në rrethanat.
- C. Në kishë ishte një element mësimi i rremë (3:2, 18-19). Këta heretikë duket se ishin të ngjashëm me ata në kishat e Galatisë, që quheshin judaistë. Ata këmbëngulnin se duhet që njeriu të bëhej jude përpara se të bëhej i krishterë.
- D. Kjo letër përfshin një shembull të një himni, kredoje, ose poezie liturgjike të hershme të krishterë (shih 2:6-11). Është një nga pasazhet më të shkëlqyera kristologjike në gjithë Dhiatën e Re (shih Gjoni 1:1-14; Kol. 1:13-20; Heb. 1:2-3). Pali e përdor si shembull të përlësisë së Krishtit, që duhej imituar nga çdo besimtar (shih 2:1-5), jo thjesht si mësim doktrinor.
- E. Në një letër me vetëm 104 vargje, emri ose titulli i Jezusit përdoret 51 herë. Është e qartë se Jezusi ka rol qendror në zemrën, mendjen dhe teologjinë e Palit.

II. FILIPIA DHE MAQEDONIA

A. Qyteti i Filipisë

- 1. Në 356 para K., qyteti u pushtua dhe u zgjerua nga Filipi II i Maqedonië, babai i Aleksandrit të Madh. Në fillim, ky fshat trakas quhej *Krenides* (burimet). Ishte qytet i rëndësishëm për shkak të mineraleve të arit në rajon.
- 2. Në betejën e Pidnës më 168 para K., rajoni u bë provincë romake dhe, më vonë, një nga katër rajonet në Maqedoni.
- 3. Më 42 para K., Bruti dhe Kasi (republikanë romakë) luftuan kundër Antonit dhe Oktavianit (perandorakë romakë) pranë Filipisë, për reformat qeveritare në Romë. Pas betejës, Antoni vendosi aty disa nga veteranët e tij fitimtarë.
- 4. Më 31 para K., pas betejës së Aktit ku Oktaviani mposhti Antonin, mbështetësit e Antonit në Romë u dëbuan dhe u syrgjynosën në Filipi.
- 5. Më 31 para K., Filipia u bë koloni romake (shih Veprat 16:12). Banorët e qytetit u shpallën shtetas të Romës. Aty flitej latinisht dhe qyteti dukej si një Romë e vogël. Ndodhej në Rrugën Egnatia, autostrada kryesore romake lindje-perëndim. Privilegjet e veçanta që ata shijonin si shtetas romakë ishin:
 - a. S'paguanin asnjë taksë vendore, as taksa për tokën
 - b. Kishin të drejtë që të shisnin dhe blinin prona
 - c. Kishin të gjitha të drejtat dhe privilegjet e ligjit romak
 - d. Kishin drejtues qeveritarë lokalë (pretorë dhe liktorë)

B. Ungjilli vjen në Filipi

- 1. Në udhëtimin e dytë misionar, Pali donte të shkonte në veri dhe të hynte në Azinë qendrore veriore (Turqia e sotme, ose Bitinia biblike). Mirëpo, në një vegim, pa një burrë (ndoshta, Lukën) nga Maqedonia (Greqia veriore), që e thërriste të shkonte aty dhe t'i ndihmonte (Veprat 16:6-10). Me këtë vegim, Fryma e drejtoi Palin në Evropë.
- 2. Pali shoqërohej nga ndihmësit e vet
 - a. Sila (Silvani)

- (1) Sila ishte një drejtues i kishës së Jerusalemit dhe profet; ai zuri vendin e Barnabës si bashkëpunëtor misionar i Palit (shih Veprat 15:15, 22, 32; 36-41);
- (2) Sila dhe Pali u burgosën bashkë në Filipi (Veprat 16:16-26);
- (3) Pali e quan gjithmonë Silvan (shih 2 Kor. 1:19; 1 Thes. 1:1; 2 Thes. 1:1);
- (4) Ka mundësi që, më vonë, Sila të jetë bërë bashkëpunëtor i Pjetrit, si Gjon Marku (shih 1 Pje. 5:12).

b. Timoteu

- (1) u kthye në besim gjatë udhëtimit të parë misionar të Palit (shih Veprat 16:1-2; 2 Tim. 1:5; 3:15);
- (2) gjyshen dhe nënën i kishte hebraike, kurse babain e kishte grek (shih Veprat 16:1; 2 Tim. 1:5);
- (3) meqë kishte emër të mirë ndër vëllezërit (shih Veprat 16:2) dhe Pali pa tek ai dhunti shërbese (shih 1 Tim. 4:14; 2 Tim. 1:6), e zgjodhi si ndihmës, që të zëvendësonte Gjon Markun (shih Veprat 13:13);
- (4) Pali e rrethpreu Timoteun që ta pranonin judenjtë (shih Veprat 16:3);
- (5) Timoteu u bë përfaqësuesi i besuar apostolik i Palit (shih Fil. 2:19-22; 1 Kor. 4:17; 3:2, 6; 2 Kor. 1:1, 19).

c. Luka

- (1) autori anonim, por i mundshëm, i ungjillit të Lukës dhe Veprave;
- (2) me sa duket, ishte mjek johebre (shih Kol. 4:14). Disa mendojnë se fjala “mjek” kishte kuptimin “tejet i arsimuar”. Pa dyshim, wshtw e vwrwtw se njihte mirw njw swrw fushash tw specializuara pwrveç mjekwsw, si lundrimi. Gjithsesi, Jezusi e pwrldori kwtw fjalw nw kuptimin “mjek” (shih Mat. 9:12; Marku 2:17; 5:26; Luka 4:23; 5:31);
- (3) shoqwruesi i Palit nw udhwtime (shih Veprat 16:10-17; 20:5-15; 21:1-18; 27:1-28:16; Kol. 4:14; 2 Tim. 4:1; Filemoni 24);
- (4) wshtw interesante qw pjeswt “ne” nw Veprat nisin dhe pwrldojnw me Filipinw. Te *Paul, Apostle of the Heart Set Free* (f. 219), F. F. Bruce jep mendimin se Luka qwnedroi mw tej nw Filipi pwr tw ndihmuar besimtarwt e rinj dhe pwr tw mbledhur fondet e ndihmave tw johebrenjve pwr kishwn nw Jerusalem.
- (5) Nw njwfarw kuptimi, Luka mund tw ketw qenw mjeku personal i Palit. Pali kishte njw swrw problemesh fizike pwr shkak tw pasojave tw kthimit nw besim (shih Veprat 9:3, 9), shwrbesws (shih 2 Kor. 4:7-12; 6:4-10; 11:23-29) dhe dobwsive tw tij tw veçanta fizike (shih 2 Kor. 12:1-10).

3. Pali u kthye nw Filipi gjatw udhwtime tw tretw misionar (shih Veprat 20:1-3, 6). Mw herwt, kishte dwrgruar Silwn dhe Timoteun (shih Veprat 19:19-24; Fil. 2:19-24).

C. Filipi si koloni romake (shih Veprat 16:12)

1. Pali e pwrldori statusin e kwtij qyteti si koloni romake pwr terminologjinw e pwrldorur nw letwr
 - a. “roja pretoriane”, 1:13
 - b. “qytetaria”, 3:20 (Veprat 16:22-34, 35-40)
 - c. “familja e Cezarit”, 4:22
2. Qyteti popullohej nga ushtarët romakë në pension, ose të dëbuar nga Roma. Në shumë mënyra, ishte “një Romë e vogël”. Moda e Romës mund të shihej nëpër rrugët e Filipisë (shih Veprat 26:21).
3. Si Pali (Veprat 22:25; 26:32), ashtu dhe Sila (Veprat 16:37), ishin qytetarë romakë; kjo u lejonte të drejta ligjore dhe u jepte status shoqëror.

D. Provinca e Maqedonisë

1. Gratë në Maqedoni kishin më shumë liri shoqërore dhe mundësi ekonomike se kudo tjetër në perandorinë romake.
2. Kjo ilustron nga
 - a. Prania e shumë grave që adhuronin Zotin përbri lumit jashtë Filipisë (shih Veprat 16:13);
 - b. Tregtarja Lidia (shih Veprat 16:14);
 - c. Gratë bashkëpunëtoresh në ungjillin (shih 4:2-3);

d. Përmendja e një sërë grash të parisë në Selanik (dhe në Maqedoni, shih Veprat 17:4).

III. AUTORI

- A. Kjo letër tejet personale i është atribuar gjithmonë Palit. Përemrat në vetën e parë “unë” dhe “ime/imja” shfaqen 51 herë.
- B. Citohet ose aludohet nga autorë të hershëm (për një listë të plotë citimesh, shih H. C. G. Moule, *Studies in Philippians*, f. 20-21, botuar nga Kregel):
1. Klementi i Romës, te *1 Klementit*, shkruar për kishën korintase rreth 95 pas K.;
 2. Ignati, *letrat e Ignatit*, rreth 110 pas K.;
 3. Polikarpi, shoku i apostullit Gjon, në *Letrën drejtuar Filipianëve*, rreth 110 pas K.;
 4. Një parathënie markionite (nga një ndjekës i heretikut Markion) për letrën e Filipianëve rreth 170 pas K.
 5. Ireneu, rreth 180 pas K.;
 6. Klementi i Aleksandrisë, rreth 190 pas K.;
 7. Tertuliani i Kartagjenës, rreth 210 pas K.
- C. Ndonëse Timoteu përmendet bashkë me Palin në 1:1, ai ishte bashkëpunëtor, jo bashkautor i letrës (ndonëse ndonjëherë mund të ketë vepruar si shkruer për letrat e Palit).

IV. DATA

- A. Data e shkrimit varet nga vendi ku mund të ketë qenë i burgosur Pali (shih 2 Kor. 11:23)
1. Filipia, Veprat 16:23-40;
 2. Efesi, 1 Kor. 15:32; 2 Kor. 1:8;
 3. Jerusalemi/Cezarea, Veprat 21:32-33:30;
 4. Roma, Veprat 28:30 (e përmendur në Prologun Markionit për Filipianët)
- B. Shumica e studiuesve besojnë se burgosja në Romë përputhet më mirë me kontekstin e jetës së Palit dhe me Veprat. Nëse kjo është e vërteta, data më e mundshme është fillimi i viteve '60.
- C. Ky libër njihet si një nga “letrat e burgut” të Palit (Kolosianëve, Efesianëve, Filemonit dhe Filipianëve). Nga të dhënat e brendshme të letrës, duket se Kolosianëve, Efesianëve dhe Filemoni u shkruan herët gjatë burgosjes së Palit në Romë dhe u çuan së bashku në Azinë e Vogël nga Tikiku (Kol. 4:7; Efe. 6:21). Filipianëve shfaq një ton tjetër. Pali dukej i bindur se do të lirohej nga burgu (1:17-26) dhe do të shkonte t’i vizitonte (2:24).
- Kjo strukturë na jep dhe një periudhë kohore për: (1) ndikimin e Palit në ungjillizimin e ushtarëve perandorakë (shih 1:13; Veprat 28:16) dhe shërbëtorëve të perandorit (shih 4:22); dhe (2) për disa udhëtime mes Palit dhe lajmëtarëve nga kisha në Filipi.

V. QËLLIMET E LETRËS

- A. Për të përçuar falënderimin e Palit për këtë kishë të dashur, që e kishte ndihmuar financiarisht disa herë dhe, madje, i kishte dërguar dhe një ndihmës, Epafroditin (shih 1:3-11; 2:19-30; 4:10-20). Kjo letër mund të jetë shkruar edhe për të shpjeguar kthimin e hershëm të Epafroditit në shtëpi ndërsa Pali ishte ende në burg.
- B. Për të inkurajuar filipianët në lidhje me rrethanat e tij. Ungjilli po përparonte edhe në burg. Pali ishte i lidhur, kurse ungjilli ishte i zgjidhur!
- C. Për të inkurajuar filipianët pavarësisht mësimëve të rreme, që ngjasonin së tepërmi me ato të judaistëve të Galatasve. Këta heretikë kërkonin që besimtarët të bëheshin së pari judenj dhe, pastaj, të krishterë (shih Veprat 15).

Megjithatë, për shkak se lista e mëkateve në 3:19 përputhet më tepër me mësuësit e rremë grekë (gnostiëkt) sesa me ata judaikë, identiteti i këtyre heretikëve është i paqartë. Ka gjasa që disa besimtarë t'i jenë rikthyer stilit të mëparshëm pagan të jetesës.

- D. Për të inkurajuar besimtarët filipianë që të gëzohen edhe në mes të përndjekjeve të brendshme dhe të jashtme. Gëzimi i Palit nuk varej nga rrethanat, por nga gëzimi në Krishtin. Ky gëzim në mes të problemeve nuk ishte dorëzim stoik, por botëkuptim i krishterë dhe betejë e vazhueshme. Pali përdori metafora nga fusha të ndryshme të jetës për të përçar tensionin e jetës së krishterë:
1. Atletike (shih 3:12, 14; 4:3);
 2. Ushtarake (shih 1:7, 12, 15, 16, 17, 22, 28, 30);
 3. Tregtare (shih 3:7, 8; 4:15, 17, 18).

VI. PËRVIJIMI I KONTEKSTIT

- A. Është e vështirë të bësh një përvijim të Filipianëve për shkak se letra është tejet personale dhe joformale. Pali po fliste me miq dhe bashkëpunëtorë të besuar në Krishtin. Zemra i fliste përpara se mendja të organizonte mendimet. Në disa mënyra të mahnitshme dhe të qarta, kjo letër na zbulon zemrën e këtij apostulli të madh të johebrenjve. Pali ndiente “gëzim” në Krishtin, në çdo lloj situatë dhe në shërbim të ungjillit!
- B. Njësitë letrare
1. Një hyrje tipike paliane, 1:1-2
 - a. Përsëndetje
 - (1) Nga Pali (dhe Timoteu) 1:1
 - (2) Për shenjtorët në Filipi (përfshi mbikëqyrësit dhe dhjakët), 1:1
 - (3) Lutja e stilizuar e Palit, 1:2
 - b. Lutje, 1:3-11:
 - (1) Bashkëpunëtorët në ungjillin që nga fillimi, 1:5
 - (2) Mbështetësit e shërbesës së Palit, 1:7
 - (3) Kërkesa e Palit për:
 - (a) dashuri me bollëk, 1:9
 - (b) njohuri me bollëk, 1:9
 - (c) dallueshmëri me bollëk, 1:9
 - (d) shenjtëri me bollëk, 1:10
 2. Preokupimi i Palit për ta për shkak të preokupimit që kishin për të në burg, 1:12-26
 - a. Perëndia e ka përdorur kohën e tij në burg për t'ua shpallur ungjillin
 - (1) Rojes perandorake, 1:13
 - (2) Të tjerëve nga shtëpia e Cezarit, 1:13; 4:22
 - (3) Predikuesit kanë marrë guxim, 1:14-18
 - b. Besimi i Palit për lirin nga burgu për shkak të:
 - (1) lutjeve të tyre, 1:19
 - (2) Frymës së Shenjtë, 1:19
 - c. Besimi i Palit, qoftë nëse lirohej, qoftë nëse vdiste, 1:20-26
 3. Inkurajimi i Palit, 1:27-2:18:
 - a. Thirrje për unitet të krishterë në mes të përndjekjeve, 1:27-30
 - b. Jetoni në ngjashmëri me Krishtin, pa egoizëm, 2:1-4
 - c. Krishti, shembulli ynë, 2:5-11
 - d. Në dritën e shembullit të Krishtit, jetoni në paqe dhe me unitet, 2:12-18
 4. Planet e Palit në lidhje me Filipinë, 2:19-30
 - a. Dërgon Timoteun, 2:19-24
 - b. Kthimi i Epafroditit, 2:25-30
 5. Qëndroni të patundur kundër mësuësve të rremë, 1:27; 4:1
 - a. Qentë, rrethprerësit e rremë, judaistët (Veprat 15, Galatasve), 3:1-4

- b. Trashëgimia judaike e Palit:
 - (1) Në dritën e mësuesve të rremë, 3:5-6
 - (2) Në dritën e Krishtit, 3:7-16
- c. Hidhërimi i Palit për ta, 3:17-21
- 6. Pali përsërit thirrjet e tij:
 - a. Unitet, 4:1-3
 - b. Tipare të ngjashme me ato të Krishtit, 4:4-9
- 7. Pali përsërit mirënjohjen për ndihmën e filipianëve:
 - a. Dhurata e tyre kohët e fundit, 4:10-14
 - b. Dhuratat e tyre të mëparshme, 4:15-20 (1:5)
- 8. Përmbyllje tipike paliane, 4:21-23

VII. FJALË DHE FRAZA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

1. “në burgosjen time”, 1:7, 13
2. “dhembshuri”, 1:8
3. “dita e Krishtit”, 1:10
4. “fryti i drejtësisë”, 1:11
5. “roja pretoriane”, 1:13
6. “të vuaj për hir të tij”, 1:29
7. “e boshatisi veten”, 2:7
8. “në ngjashmëri me njerëzit”, 2:7
9. Rrëfej, 2:11
10. “nuk vrapova më kot, as nuk u mundova kotësisht”, 2:16
11. “po derdhem si ofertë pijeje”, 2:17
12. “ruhuni nga qentë”, 3:2
13. “hebre i hebrenjve”, 3:5
14. “ata janë armiq të kryqit të Krishtit”, 3:18
15. “qytetaria jonë është në qiejt”, 3:20
16. “emrat e të cilëve janë në librin e jetës”, 4:3

VIII. PERSONA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

1. mbikëqyrësit, 1:1
2. dhjakët, 1:1
3. Timoteu, 2:19
4. Epafroditi, 2:25
5. “rrethprerja e rreme”, 3:2
6. Sintika, 4:2

IX. VENDNDODHJE QË DUHEN GJETUR NË HARTË

1. Filipi, 1:1
2. Maqedoni, 4:15
3. Selanik, 4:16

X. PYETJE PËR DISKUTIM

1. Çfarë doktrin etekson 1:6?
2. Shpjego ç’po thoshte Pali në 1:16.
3. Çfarë nënkupton fraza “Fryma e Jezu Krishtit”?
4. Shpjego 1:21 me fjalët e tua.
5. Ç’lidhje kea 2:6 me paraekzistencën dhe natyrën hyjnore të Jezusit?
6. Pse vdiq në kryq Jezusi? (2:8)

7. Për kë bën fjalë shprehja “ata që janë në qiell, në tokë dhe nën tokë”?
8. Ç’kuptim ka fjalia “punoni për shpëtimin tuaj me frikë dhe me dridhje”? (2:12)
9. Rendit cilësitë judaike të Palit në 2:4-6.
10. Cila është domethënia e 3:9?
11. Filipianëve 4:4 thotë: “Zoti është afër”. Nëse është kështu, pse nuk është kthyer ende?

HYRJJE PËR KOLOSIANËT

I. SHËNIME HYRËSE

- A. Falënderoj Perëndinë për heretikët në Kolos; për shkak të tyre, Pali shkroi këtë letër të fuqishme. Mos harroni që, për ta kuptuar këtë letër, duhet ta lidhim me kontekstin historik. Letrat e Palit quhen “dokumente sipas rastit”, pasi ai trajtoi problemet lokale duke shprehur të vërteta unigjillore universale. Herezia në Kolos ishte një përzierje e çuditshme filozofish greke (gnosticismi) me judaizmin.
- B. Pozita kozmike e Jezusit si Zot është tema kryesore (shih 1:15-17). Kristologjia e këtij libri është e pashoqe! Kolosianëve përbën përvijimin bazë për Efesianët. Pali e dinte se kjo herezi do të përhapej në mbarë Azinë e Vogël. Kolosianëve sulmon mësimet e rreme, ndërsa Efesianëve zhvillon tematikat qendrore të Kolosianëve për t'i përgatitur kishat e tjera për herezinë që po vinte. Theksi i Kolosianëve është kristologjik, ndërsa theksi i Efesianëve është uniteti i të gjitha gjërave në Krishtin, i cili është Zot i gjithçkaje.
- C. Pali mposht me argumenta të fuqishëm legalizmin, si atë judaik ashtu dhe grek (2:6-23).

II. QYTETI

- A. Në fillim, qyteti i Kolosit ishte pjesë e mbretërisë së Pergamit brenda Frigjisë. Më 133 para K., qytetin e mori në dorë senati i Romës.
- B. Kolosi ishte qendër e madhe tregtare para kohës së Palit (shih Herodoti, *Historitë* VII:30 dhe Ksenofoni, *Anabasis* 1:2:6).
 - 1. Lugina ku ndodhej Kolosi ishte prodhuesja kryesore në botën e Mesdheut e leshit, sidomos e leshit të zi, si dhe e leshit të ngjyer, të purpurt dhe të kuq. Balta vullkanike prodhonte tokë të shkëlqyer kullote, ndërsa uji gëlqeror ndihmonte në procesin e lyerjes së leshit (Straboni, 13:4:14).
 - 2. Aktiviteti vullkanik (Straboni, 12:8:6) çoi në shkatërrimin e qytetit disa herë në histori; herën e fundit ndodhi në 60 pas K. (Taciti), ose 64 pas K. (Euzebi).
- C. Kolosi ndodhej në lumin Likus, degë e lumit Meandër, që kalonte përmes Efesit, 160 km më në jug. Në këtë luginë ndodheshin dhe Hierapoli (10 km më tej) me Laodicenë (16 km më tej) (shih 1:2; 2:1; 4:13, 15-16).
- D. Pasi romakët ndërtuan autostradën kryesore lindje-perëndim, *Via Egnatia*, që e anashkalonte Kolosin, qytetit i ra vlera dhe u pakësua deri në zhdukje (Straboni). Kjo i ndodhi dhe Petrës, në rajonin e transjordanit në Palestinë.
- E. Qyteti përbëhej kryesisht prej johebrenjsh (kolonë frigjianë dhe grekë), por kishte dhe shumë judenj. Jozefusi na thotë se Antioku III (223-187 para K.) çoi 2,000 judenj nga Babilonia në Kolos. Të dhënat tregojnë se, nga 76 pas K., në rajonin ku ishte kryeqytet Kolosi jetonin 11,000 meshkuj judenj.

III. AUTORI

- A. Letra ka dy dërgues, Pali dhe Timoteu (shih Kol. 1:1). Megjithatë, autori kryesor është Pali; Timoteu u dërgoi përshëndetjen e vet si bashkëpunëtor dhe, ndoshta, sekretar (*amanuensis*) i Palit.
- B. Letërsia e lashtë thotë njëzëri se autor i letrës është apostulli Pal:
 - 1. Markioni (që erdhi në Romë në vitet 140 pas K.), heretiku që sulmonte Dhiatën e Vjetër, e përfshiu këtë letër në grupin e letrave të Palit.

2. Renditet me letrat e Palit në Kanonin Muratorian (një listë librash kanonikë nga Roma, rreth 200 pas K.)
3. Një sërë etërish të hershëm të kishës e citojnë këtë letër dhe identifikojnë si autor të saj Palin:
 - a. Ireneu (shkoi 177-190 pas K.)
 - b. Klementi i Aleksandrisë (jetoj më 160-216 pas K.)

IV. MARRËDHËNIA LETRARE E KOLOAISNËVE ME EFESIANËT

A. Marrëdhënia historike mes këtyre dy letrave të burgut ndjek këtë përvijim:

1. Epafrai (Kol. 1:7; 4:12; Filemoni 23) u kthye në besim gjatë fushatës efesianase të Palit (Veprat 19)
 - a. Ai e çoi besimin e tij të ri në vendlindje, në luginën e lumit Likus.
 - b. Epafrai mbolli tri kisha: në Hierapol, Laodice dhe Kolos.
 - c. Epafrai i kërkoi këshilla Palit si ta kundërshtonte shkrirjen e pikëpamjes së krishterë me atë të heretikëve. Pali ishte i burgosur në Romë (në fillim të viteve '60)
2. Mësuesit e rremë përkrahnin metafizikën greke
 - a. Shpirti dhe materia janë të përjetshme
 - b. Shpirti (Perëndia) është i mirë
 - c. Materia (krijimi) është e ligë
 - d. Ekzistojnë një sërë *eonash* (nivelesh engjëllore) midis Perëndisë së epërm dhe të mirë dhe një perëndi më të ulët, i cili krijoi materien
 - e. Shpëtimi bazohet në njohjen e disa fjalëkalimeve të fshehta, që i ndihmojnë njerëzit të kalojnë nga një *eonë* (nivel engjëllor) në tjetrën

B. Marrëdhënia letrare mes këtyre dy letrave të Palit

1. Pali dëgjoi nëpërmjet Epafrait për herezinë në këto kisha, të cilat nuk i kishte vizituar kurrë personalisht.
2. Pali shkroi një letër të fortë me fjali të shkurtra dhe emocionale, që synonte të godiste mësuesit e rremë. Tematika qendrore ishte se Jezusi zotëron gjithë krijimin. Kjo njihet si letra e Palit drejtuar Kolosianëve.
3. Me sa duket, pak kohë pasi shkroi Kolosianëve, kësaj here duke patur më shumë kohë në dispozicion gjatë burgosjes, Pali i zhvilloi më tej këto tematika. Efesianëve karakterizohet nga fjali të gjata dhe koncepte të zhvilluara teologjike (1:3-14, 15-23; 2:1-10, 14-18, 19-22; 3:1-12, 14-19; 4:11-16; 6:13-20). Kjo letër merr si pikë fillese Kolosianët dhe i çon më tej rrjedhojat e saj teologjike. Tema e saj kryesore është uniteti i të gjitha gjërave në Krishtin, që përbën një kontrast me konceptin proto-agnostik.

C. Strukturë e ngjashme letrare dhe teologjike

1. Ngjashmëria e strukturës bazë
 - a. Të dyja letrat kanë hyrje shumë të ngjashme
 - b. Kanë pjesë doktrinale, që trajtojnë kryesisht Krishtin
 - c. Kanë pjesë praktike, që bëjnë thirrje për një stil jetese të krishterë duke përdorur kategori, fjalë dhe fraza të njëjta
 - d. Kanë vargje përmblylëse që përmbajnë 29 fjalë të njëjta në greqisht; Kolosianëve ka shtuar vetëm dy fjalë (“dhe bashkëskllavi”). Krahaso Efe. 6:21-22 me Kol. 4:7-9.
2. Ngjashmëria e fjalëve ose frazave të shkurtra (në greqisht)

Ef. 1:1c dhe Kol. 1:2a	“besnik”
Ef. 1:4 dhe Kol. 1:22	“i shenjtë dhe i patëmetë”
Efe. 1:7 dhe Kol. 1:14	“shpengimi... falja”
Efe. 1:10 dhe Kol. 1:20	“të gjitha gjërat... qiell... tokë”
Efe. 1:15 dhe Kol. 1:3-4	“dëgjoj... dashuri për gjithë shenjtorët”
Efe. 1:18 dhe Kol. 1:27	“pasuritë e lavdisë”
Efe. 2:1 dhe Kol. 1:13	“ishit të vdekur”
Efe. 2:16 dhe Kol. 1:20	“pajtoi... kryqin”

- | | |
|---------------------------------|--|
| Efe. 3:2 dhe Kol. 1:25 | “kujdestari” |
| Efe. 3:3 dhe Kol. 1:26, 27 | “misteri” |
| Efe. 4:3 dhe Kol. 3:14 | “unitet” |
| Efe. 4:15 dhe Kol. 2:19 | “kreu” dhe “rritet” |
| Efe. 4:24 dhe Kol. 3:10, 12, 14 | “vishni...” |
| Efe. 4:31 dhe Kol. 3:8 | “zemërim”, “tërbim”, “keqdashje”, “fyerje” |
| Efe. 5:3 dhe Kol. 3:5 | “shthurje”, “papastërti”, “lakmi” |
| Efe. 5:5 dhe Kol. 3:5 | “idhujtari” (lakmi) |
| Efe. 5:6 dhe Kol. 3:6 | “zemërimi i Perëndisë” |
| Efe. 5:16 dhe Kol. 4:5 | “shfrytëzohen plotësisht kohën” |
3. Fraza dhe fjali të njëjta
- Efe. 1:1a dhe Kol. 1:1a
Efe. 1:1b dhe Kol. 1:2a
Efe. 1:2a dhe Kol. 1:2b
Efe. 1:13 dhe Kol. 1:5
Efe. 2:1 dhe Kol. 2:13
Efe. 2:5b dhe Kol. 2:13c
Efe. 4:1b dhe Kol. 1:10a
Efe. 6:21-22 dhe Kol. 4:7-8 (29 fjalë të njëjta njëra pas tjetrës, me përjashtim të “*kai syndoulos*” në Kolosianëve)
4. Ngjashmëri frazash ose fjalish
- Efe. 1:21 dhe Kol. 1:16
Efe. 2:1 dhe Kol. 1:13
Efe. 2:16 dhe Kol. 1:20
Efe. 3:7a dhe Kol. 1:23d, 25a
Efe. 3:8 dhe Kol. 1:27
Efe. 4:2 dhe Kol. 3:12
Efe. 4:29 dhe Kol. 3:8; 4:6
Efe. 4:32b dhe Kol. 3:13b
Efe. 5:15 dhe Kol. 4:5
Efe. 5:19-20 dhe Kol. 3:16
5. Koncepte sinonimike nga ana teologjike:
- | | |
|----------------------------|---|
| Efe. 1:3 dhe Kol. 1:3 | lutje falenderimi |
| Efe. 2:1, 12 dhe Kol. 1:21 | tëhuajtje nga Perëndia |
| Efe. 2:15 dhe Kol. 2:14 | armiqësia e Ligjit |
| Efe. 4:1 dhe Kol. 1:10 | ecje e denjë |
| Efe. 4:15 dhe Kol. 2:19 | trupit i Krishtit rritet drejt pjekurisë nga Koka |
| Efe. 4:19 dhe Kol. 3:5 | papastërtia seksuale |
| Efe. 4:22, 31 dhe Kol. 3:8 | “lini mënjane” mëkatet |
| Efe. 4:32 dhe Kol. 3:12-13 | të krishterët të jenë mirëdashës ndaj njëri-tjetrit |
| Efe. 5:4 dhe Kol. 3:8 | të folurit e krishterë |
| Efe. 5:18 dhe Kol. 3:16 | mbushja me Frymë = fjala e Krishtit |
| Efe. 5:20 dhe Kol. 3:17 | falënderim Perëndisë për të gjitha gjërat |
| Efe. 5:22 dhe Kol. 3:18 | gratë t’u nënshtrohen burrave |
| Efe. 5:25 dhe Kol. 3:19 | burrat t’i duan gratë e tyre |
| Efe. 6:1 dhe Kol. 3:20 | fëmijët t’u binden prindërve |
| Efe. 6:4 dhe Kol. 3:21 | etërit të mos i nxisin fëmijët për zemërim |
| Efe. 6:5 dhe Kol. 3:22 | skllëvërit t’u binden padronëve |
| Efe. 6:9 dhe Kol. 4:1 | zotërinjtë dhe skllëvërit |
| Efe. 6:18 dhe Kol. 4:2-4 | kërkesa e Palit për lutje |

6. Fjalët e përdorura në Kolosianëve dhe Efesianëve, që nuk gjenden në letrat e tjera të Palit
 - a. “mbushulli/plotësi”

Efe. 1:23	“mbushullia e atij që mbush gjithçka në gjithçka”
Efe. 3:19	“mbushuni me gjithë plotësinë e Perëndisë”
Efe. 4:13	“në mbushullinë e Krishtit”
Kol. 1:19	“që gjithë plotësia të banojë në të”
Kol. 2:9	“sepse në të banon gjithë plotësia e Hyjnisë”
 - b. Krishti si “kreu” i kishës
Efe. 4:15, 5:23 dhe Kol. 1:18; 2:19
 - c. “tëhuajtur”
Efe. 2:12; 4:18 dhe Kol. 1:21
 - d. “shfrytëzoni kohën”
Efe. 5:16 dhe Kol. 4:5
 - e. “rrenjosur”
Efe. 3:17 dhe Kol. 2:7
 - f. “fjala e së vërtetës, ungjilli”
Efe. 1:13 dhe Kol. 1:5
 - g. “duron”
Efe. 4:2 dhe Kol. 3:13
 - h. Fraza dhe fjalë të pazakonta (“mbahet së bashku”, “furnizon”)
Efe. 4:16 dhe Kol. 2:19

D. Përmbledhje

1. Mbi një e treta e fjalëve të Kolosianëve gjendet në Efesianëve. Është llogaritu se 75 nga 155 vargjet e Efesianëve paralelizohen në Kolosianëve. Të dyja thonë se u shkruan nga Pali gjatë kohës në burg.
2. Të dyja letrat i çoi miku i Palit, Tikiku.
3. Të dyja u dërguan në të njëjtën zonë (Azia e Vogël).
4. Të dyja trajtojnë të njëjtën temë kristologjike.
5. Të dyja theksojnë Krishtin si kreu i kishës.
6. Të dyja inkurajojnë jetesën e përshtatshme të të krishterëve.

E. Pika kryesore ndryshimesh

1. Kisha është gjithmonë lokale te Kolosianëve, por universale tek efesianëve. Kjo mund të jetë për shkak të natyrës qarkore të letrës së Efesianëve.
2. Herezia, që ishte tipar i spikatur te Kolosianët, nuk përmendet drejtpërdrejt në Efesianët. Sidoqoftë, të dyja letrat përdorin fjalë tipike gnostike (“urtësi”, “njohuri”, “plotësi”, “mister”, “principatat dhe pushtetet” dhe “kujdestari”).
3. Ardhja e dytë është e atypëratyshme te Kolosianët, por e vonura tek Efesianët. Kisha kishte (dhe ka) thirrjen që të shërbejë në një botë të rënë (2:7; 3:21; 4:13).
4. Një sërë fjalësh tipike për Palin përdoren ndryshe. Një shembull është fjala “mister”. Në Kolosianëve, misteri është vetë Krishti (Kol. 1:26-27; 2:2; 4:3), kurse tek Efesianëve (1:9; 5:32) misteri është plani hyjnor, më parë i fshehur, por tani i zbuluar, për unitetin e johebrenjve me judenjët.
5. Efesianëve përmban një sërë aludimesh për Dhiatën e Vjetër (1:22—Ps. 8; 2:17—Isa. 57:19) (2:20—Ps. 118:22) (4:8—Ps. 68:18) (4:26—Ps. 4:4) (5:15—Isa. 26:19, 51:17, 52:1, 60:1) (5:3—Zan. 3:24) (6:2—3-Eks. 20:12) (6:14—Isa. 11:5, 59:17) (6:15—Isa. 52:7), kurse letra e Kolosianëve përmban vetëm një ose dy aludime të tilla (2:3—Isa. 11:2) or (2:22—Isa. 29:13).

F. Ndonëse shumë të ngjashme në fjalë, fraza dhe, madje, përvijim, këto dy letra përmbajnë dhe të vërteta unike.

1. Bekimi trium i hirit – Efe. 1:3-14
2. Pasazhi i hirit – Efe. 2:1-10
3. Shkrimi dhe johebrenjtë në një trup të ri – Efe. 2:11-3:13

4. Uniteti dhe dhuntishmëria e trupit të Krishtit – Efe. 4:1-16
5. “Krishti dhe kisha” janë model për “burrin dhe gruan”, Efe. 5:22-33
6. Pasazhi për luftën shpirtërore – Efe. 6:10-18
7. Pasazhi kristologjik – Kol. 1:13-18
8. Ritualit dhe ritet fetare njerëzore – Kol. 2:16-23
9. Tema e rëndësishme kozmike të Krishtit te Kolosianët kundrejt temës së unitetit të gjithçkaje në Krishtin tek Efesianët

G. Si përfundim, gjëja më e mirë është që të biem dakord me A. T. Robertson dhe F. F. Bruce kur thonë se Pali i shkroi të dyja këto letra në kohë shumë të afërt me njëra-tjetrën duke i zhvilluar mendimet e Kolosianëve në një paraqitje kulmore të së vërtetës te letra e Efesianëve.

V. DATA

- A. Data e Kolosianëve lidhet me një nga burgosjet e Palit (Efes, Filipi, Cezare, ose Romë). Burgosja në Romë duket se përputhet më së miri me faktet e Veprave.
- B. Nëse pranojmë Romën si vendin e burgosjes, ngrihet pyetja: në ç’kohë? Pali ishte në burg në fillim të viteve ’60, siç na thuhet tek Veprat, por u lirua nga burgu dhe shkroi letrat pastorale (1 dhe 2 Timoteut dhe Titit), pastaj, u arrestua sërish dhe u vra përpara datës 9 qershor, 68 pas K., që ishte data e vetëvrasjes së Neronit, ndoshta më 67 pas K.
- C. Hamendësimi më i saktë për shkrimin e Efesianëve është burgosja e parë e Palit në Romë në fillim të viteve ’60. (Filipianëve ishte letra e fundit e burgut, ndoshta e shkruar në mesin e viteve ’60.)
- D. Tikiku, së bashku me Onesimin, mund t’i ketë çuar letrat e Kolosianëve, Efesianëve dhe Filemonit në Azinë e Vogël. Më vonë, ndoshta disa vite më vonë, Epafroditi, i shëruar nga sëmundja që kishte, ia çoi letrën e Efesianëve kishës së tij.
- E. Kronologji e mundshme e shkrimeve të Palit, sipas F. F. Bruce dhe Murray Harris, me disa përshtatje të vogla.

<u>Libri</u>	<u>Data</u>	<u>Vendi i shkrimit</u>	<u>Lidhja me Veprat</u>
1. Galatasve	48	Antiokia e Sirisë	14:28; 15:2
2. 1 Thesalonikasve	50	Korint	18:5
3. 2 Thesalonikasve	50	Korint	
4. 1 Korintasve	55	Efes	19:20
5. 2 Korintasve	56	Maqedoni	20:2
6. Romakëve	57	Korint	20:3
7-10. Letrat e Burgut			
Kolosianëve	fillim ’60		
Efesianëve	fillim ’60	Romë	
Filemonit	fillim 60’		
Filipianëve	fund 62-63		28:30-31
11-13. Udhëtimi i Katërt Misionar			
1 Timoteut	63 (ose më vonë, Maqedoni)		
Titit	63 (por përpara Efes (?))		
2 Timoteut	64 (68 pas K.)	Romë	

VI. MARRËSIT DHE SHKASI I LETRËS

- A. Me sa duket, kjo kishë ishte mbjellë nga Epafrai (shih 1:7, 8; 2:1; 4:12-13), i cili mund të jetë kthyer në besim nga predikimi i Palit në Efes (shih Kol. 1:7-8 dhe krahasoje me 2:1). Shumica e kishës ishin johebreg (shih 1:21; 3:7). Epafrai shkoi te Pali në burg për t’i treguar për një problem me mësuesit e

rremë, të cilët predikonin një përzjerje të krishterimit me filozofinë greke të quajtur gnosticizëm (2:8) dhe me legalizmin judaik (shih elementet judaiste në 2:11, 16, 17; 3:11; adhurimi i engjëjve, 1:16; 2:15, 18 dhe asketizmi 2:20-23). Në Kolos ekzistonte një komunitet shumë i madh judenjsh, që ishin bërë shumë helenistë nga ana kulturore. Thelbi i problemit përqendrohej te natyra dhe vepra e Krishtit. Gnostikët nuk e pranonin se Jezusi ishte plotësisht njeri, por thoshin se ishte plotësisht hyjnor për shkak të dualizmit të tyre të përjetshëm dhe armiqësor mes materies dhe shpirtit. Ata pranonin natyrën hyjnore, por jo atë njerëzore, të Krishtit. Po kështu, nuk pranonin pozitën e tij unike si ndërmjetësues. Për ta ekzistonin disa nivele engjëjlore (*eona*) midis perëndisë së lartë e të mirë dhe njerëzimit: Jezusi, ndonëse eona më e lartë, ishte vetëm njëri prej këtyre perëndive më të ulëta. Po kështu, gnostikët ishin përjashtues nga ana intelektuale (shih 3:11, 14, 16, 17) dhe theksonin një njohuri të veçantë, të fshehtë dhe që pak e dinin (shih 2:15, 18, 19); kjo njohuri të çonte te Perëndia. S'kishte nevojë për flijimin pajtues dhe zëvendësues të Jezusit apo për besimin pendues të njerëzimit si përgjigje ndaj ofertës falas të faljes së Krishtit.

- B. Për shkak të kësaj atmosfere teologjike dhe filozofike, letra e Kolosianëve thekson
1. Natyrën unike të personit të Krishtit dhe veprës së tij të përfunduar të shpëtimit.
 2. Pronësinë, sundimin dhe rëndësinë kozmologjike të Jezusit të Nazaretit – lindja, mësimet, jeta, vdekja, ringjallja dhe ngjitja e tij në qiell! Ai është Zoti i të gjithëve!

VII. QËLLIMI

Qëllimi i Palit ishte të kundërshtonte herezinë kolosiane. Për t'ia arritur këtij qëllimi, ai lartësoi Krishtin si shëmbëllim të Perëndisë (1:15), Krijues (1:16), ruajtës paraekzistues të gjithçkaje (1:17), kreu i kishës (1:18), i pari që u ringjall (1:18), plotësi e hyjnisë në formë trupore (1:19; 2:9) dhe pajtues (1:20-22). Kështu, Krishti ishte plotësisht i mjaftueshëm. Besimtarët “kanë marrë plotësinë në Krishtin” (2:10). Herezia kolosiane ishte tërësisht e pamjaftueshme teologjikisht për të siguruar shpëtimin shpirtëror. Ishte një filozofi boshe dhe mashtruese (2:8); i mungonte aftësia për të përmbajtur natyrën e vjetër mëkatore (2:23).

Një temë e përsëritur në Kolosianëve është mjaftueshmëria e plotë e Krishtit në kundërshtim me filozofinë boshe dhe thjesht njerëzore të heretikëve. Kjo mjaftueshmëri shprehet në faktin se Jezusi është Zot i kozmosit. Ai është zotërues, krijuesi dhe sovrani mbi gjithçka, të dukshme apo të padukshme (shih 1:15-18).

VIII. PËRVIJIM

- A. Hyrje tradicionale paliane
1. Identifikimi i dërguesit, 1:1
 2. Identifikimi i marrësve, 1:2a
 3. Përshëndetje, 1:2b
- B. Epërsia e Krishtit (temat 1-10, të marra nga përvijimi që u bën paragrafëve NKJV)
1. Besimi në Krishtin, 1:3-8
 2. Epërsia e Krishtit, 1:9-18
 3. Pajtimi në Krishtin, 1:19-23
 4. Shërbesa flijuese për Krishtin, 1:24-29
 5. Jo filozofia, por Krishti, 2:1-10
 6. Jo legalizmi, por Krishti, 2:11-23
 7. Jo natyra mishore, por Krishti, 3:1-11
 8. Vishni Krishtin, 3:12-17
 9. Lëreni Krishtin që të ndikojë në familjet tuaja, 3:19-4:1
 10. Lëreni Krishtin që të ndikojë në jetën tuaj të përditshme, 4:2-6
- C. Lajmëtarët e Palit, 4:7-9

D. Miqtë e Palit dërgojnë përshëndetjet e tyre, 4:10-14

E. Pali dërgon përshëndetjet e tij, 4:15-17

F. Pali e përmyll duke shkruar me dorën e vet, 4:18

IX. GNOSTICIZMI

A. Pjesa më e madhe e njohurisë sonë për këtë herezi vjen nga shkrimet gnostike të shekullit të dytë. Sidoqoftë, idetë fillestare të gnosticizmit gjenden që në shekullin e parë (Pergamenat e Detit të Vdekur).

B. Problemi në Kolos ishte një hibridizim i krishterimit me gnosticizmin fillestar dhe me judaizmin legalist.

C. Disa parime të shprehura të gnosticizmit valentinian dhe kerintas në shekullin e dytë:

1. Materia dhe shpirti janë të dy të përjetshëm (dualizmi ontologjik). Materia është e ligë, ndërsa shpirti është i mirë. Perëndia, që është shpirt, nuk mund të ketë lidhje të drejtpërdrejtë me formësimin e materies së ligë.
2. Midis Perëndisë dhe materies ka një sërë rrezatimesh (*eona*, ose nivele engjëlllore). Niveli më i ulët është JHVH i Dhiatës së Vjetër, i cili formoi universin (*kozmos*).
3. Jezusi ishte një rrezatim si JHVH, por më i lartë, më i afërt me Perëndinë e vërtetë. Disa e vendosin në nivelin më të lartë poshtë Perëndisë, dhe nuk e pranonin se ishte hyjni e mishëruar (shih Gjoni 1:14). Meqë materia është e ligë, Jezusi nuk mund të ketë trup njerëzor dhe të jetë hyjnor. Ai vetëm sa u duk si njeri, por në të vërtetë ishte shpirt (shih 1 Gjonit 1:1-3; 4:1-6).
4. Shpëtimi arrihet nëpërmjet besimit në Jezusin plus një njohuri të veçantë, e cila u bëhet e ditur disa personave të veçantë. (Njohuria (fjalëkalimet) janë të domosdoshme për të kaluar përmes sferave qiellore. Edhe legalizmi judaik ishte i nevojshëm për të arritur Perëndinë.

D. Mësuesit e rremë gnostikë përkrahnin dy sisteme të kundërta etike:

1. Për disa, stili i jetesës s'kishte aspak lidhje me shpëtimin. Për ta, shpëtimi dhe spiritualiteti përfshiheshin te njohuria e fshehtë (fjalëkalimet) që ndihmonte në kalimin nga njëra sferë engjëlllore (*eona*) në tjetrën.
2. Për disa të tjerë, stili i jetesës ishte kyç për shpëtimin. Në këtë libër, mësuesit e rremë theksonin një stil jetese asket si provë e spiritualitetit të vërtetë (shih 2:16-23).

E. Një libër i mirë si referencë është *The Gnostic Religion*, nga Hans Jonas, botuar nga Beacon Press.

X. FJALË DHE FRAZA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

1. “shpresa e rezervuar për ju në qiell”, 1:5
2. Ungjilli, 1:5
3. “zotërimi i errësirës”, 1:13
4. Shpengim, 1:14
5. Perëndia i padukshëm, 1:15
6. “gjithë plotësia të banojë në të”, 1:19
7. “pasi bëri paqe me anë të gjakut të kryqit të tij”, 1:20
8. “për të plotësuar atë që mungon në mundimin e Krishtit”, 1:24
9. “traditën e njerëzve”, 2:8
10. “parimet fillestare të botës”, 2:8, 20
11. “u varrosëm me të në pagëzim”, 2:12
12. “ishit të vdekur në shkeljet tuaja”, 2:13
13. “e anuloi vërtetimin e borxhit”, 2:14
14. “jeta juaj është fshehur në Krishtin në Perëndinë”, 3:3

15. Barbar, 3:11
16. “letrën time, që vjen nga Laodicea”, 4:16

XI. PERSONA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

1. Epafrai, 1:7; 4:12
2. “i parëlinduri i gjithë krijimit”, 1:15
3. “frone, zotërime, sundimtarë, ose autoritete”, 1:16
4. I parëlinduri nga vdekja, 1:18
5. Skithas, 3:11
6. Tikiku, 4:7
7. Onesimi, 4:9
8. Marku, 4:10
9. Luka, 4:14
10. Dema, 4:14

XII. VENDNDODHJE QË DUHEN GJETUR NË HARTË

1. Kolos, 1:2
2. Laodice, 2:1
3. Hierapol, 4:13

XIII. PYETJE PËR DISKUTIM

1. Pse flet kaq shumë Pali për njohurinë dhe urtësinë? (1:9)
2. Çfarë nënkupton paralajmërimi i 1:23?
3. Cili është misteri i Perëndisë, që ishte i fshehur në epokat e kaluara? (1:27)
4. A i njihje Pali njerëzit e kësaj kishe? (2:1)
5. Si mund t’i robëronte dikush me anë të filozofisë? 2:8)
6. Çfarë doktrine thekson 2:9?
7. Shpjego sfondin historik romak të 2:15.
8. Për kë bën fjalë 2:16-17?
9. Si e trajton 2:14-23 legalizmin?
10. Pse mëkatet e 3:5 quhen idhujtari?
11. Si lidhet Kol. 3:11 me Gal. 3:28?
12. Cili është parimi shpirtëror i 3:23?
13. Shpjego me fjalët e tua fjalën e urtë të 4:6.
14. Pse Pali i shkruante me dorën e vet përmbylljet e të gjitha letrave? (4:18)

HYRJE PËR LETRAT DREJTUAR THESALONIKASVE

I. SHËNIME HYRËSE

A. Përmbledhje e shkurtër

1. Letrat drejtuar Thesalonikasve na japin njohuri të jashtëzakonshme për Palin si misionar dhe pastor. Shohim që ai themelon një kishë brenda një kohe të shkurtër dhe vazhdon të lutet e të preokupohet për rritjen, zhvillimin dhe shërbesën e saj.
2. E shohim Palin teksa shpall ungjillin, preokupohet për besimtarët që kishte kthyer në besim, i qorton, i lavdëron, i drejton, i nxit, i mëson, i do, dhe madje është gati të japë jetën për ta. Ai ngazëllehët nga ecuria e tyre deri në atë pikë, por edhe zhgënjehet me nivelin në të cilin janë pjekur.
3. Në këto letra shohim shërbëtorin e zellshëm dhe të dashur të Krishtit dhe një kishë të vogël, të zellshme dhe që po rritej, ndonëse ishte e re. Të dy janë besnikë, të dy po përdoren nga Perëndia, dhe të dy i shërbejnë njëri-tjetrit në një mënyrë aq të krishterë saqë rrallëherë shihej në popullin e Perëndisë.

B. Qyteti i Selanikut

1. Histori e shkurtër e Selanikut
 - a. Selaniku ndodhej në krye të Gjirit Termaik. Ishte qytet bregdetar dhe gjendej në rrugën kryesore romake, Via Egnatia (rruga e kombeve), e cila shtrihej nga lindja në perëndim, deri në Romë. Selaniku nuk ishte vetëm qytet-port, por gjendej dhe shumë afër një lugine të pasur bregdetare, të ujitur mirë. Këto tri avantazhe e bënin Selanikun qendrën më të madhe dhe më të rëndësishme tregtare e politike në Maqedoni.
 - b. Selaniku, në fillim, quhej Therma, që rridhte si fjalë nga burimet e nxehta që ndodheshin në atë zonë. Një historian i hershëm, Plini (Plaku), i përmend Thermën dhe Selanikun sikur ekzistonin së bashku. Nëse është kështu, Selaniku e rrethonte Thermën dhe, më vonë, e aneksoi (Leon Morris, *The First and Second Epistles to the Thessalonians*, Grand Rapids: Wm. B. Eerdmans Publishing Company, 1991, f. 11). Mirëpo shumica e historianëve mendojnë se Kasandri, një nga gjeneralët e Aleksandrit të Madh, ia ndryshoi emrin Thermës në Selanik (Thesalonika) në vitin 315 para K., duke i vënë emrin e bijt të Filipit të Maqedonisë dhe gjysmëmotrit të Aleksandrit, që ishte dhe gruaja e këtij gjenerali, Thesalonika (Straboni VII, Fragmenti 21). Dikur gjatë shekujve të parë të përhapjes së krishterimit, Selaniku u quajt “qyteti ortodoks” për shkak të karakterit të krishterë që kishte (Dean Farrar, *The Life and Work of St. Paul*, New York: Cassell and Company Limited, 1904, f. 364). Sot, ky qytet njihet me emrin Selanik dhe është ende qyteti më i rëndësishëm i Greqisë.
 - c. Selaniku ishte një metropol kozmopolit, i ngjashëm me Korintin; banohej nga popuj që vinin nga mbarë bota e njohur e kohës.
 - (1) Aty banonin disa popuj barbarë gjermanikë të veriut, që kishin sjellë me vete fenë dhe kulturën e tyre pagane.
 - (2) Banonin dhe grekë, që vinin nga jugu, domethënë nga Akaia dhe nga ishujt e detit Egje; edhe ata kishin sjellë filozofinë dhe kulturën e tyre të rafinuar.
 - (3) Aty ishin vendosur dhe romakë nga perëndimi. Kryesisht, ishin ushtarë të dalë në pension dhe kishin sjellë me vete forcën e vullnetit, pasurinë dhe fuqinë e tyre politike.
 - (4) Së fundi, aty kishte dhe një numër të madh judenjsh, që vinin nga lindja; në një periudhë të caktuar, një e treta e popullsisë së qytetit ishin judenj. Ata kishin sjellë me vete besimin e tyre monoteist dhe etik, por edhe paragjykimet e tyre kombëtare.
 - d. Duke patur një popullsi prej rreth 200,000 banorësh, Selaniku ishte vërtet qytet metropolitar. Ishte vend pushimesh dhe qendër shëndeti, pasi kishte burime të nxehta. Ishte edhe qendër tregtare për shkak të portit, pllajave pjellore dhe afërsisë me Rrugën *Egnatia*.
 - e. Si kryeqytet dhe si qyteti më i popullar, Selaniku ishte dhe selia politike qendrore e Maqedonisë. Meqë ishte kryeqytet i një province romake, si dhe vendbanimi i shumë shtetasve romakë (kryesisht ushtarë të dalë në pension), Selaniku fitoi statusin e “qytetit të

lirë”. Nuk paguante haraçe dhe qeverisej nga ligjet romake, pasi shumica e selanikasve ishin shtetas romakë. Kështu, sundimtarët selanikas quheshin “politarkë”. Ky titull nuk gjendet askund në literaturën e kohës, por ruhet në një mbishkrim të vensoru mbi harkun e triumfit në Selanik, që njihet si Porta e Vardarit (Farrar, f. 371n.).

2. Ngjarjet që çuan në ardhjen e Palit në Selanik
 - a. Shumë ngjarje e çuan Palin në Selanik, por pas të gjitha rrethanave fizike gjendet vullneti i drejtpërdrejtë dhe i qartë i Perëndisë. Pali nuk kishte planifikuar fillimisht që të hynte në kontinentin evropian. Por, në këtë udhëtim të dytë misionar, dëshira e tij ishte të vizitonte rishtaz kishat e Azisë së Vogël, të cilat i kishte themeluar gjatë udhëtimit të parë dhe, pastaj, të drejtohej për në lindje. Mirëpo, sapo erdhi çasti që të kthehej për në verilindje, Perëndia nisi t’ia mbyllte dyert. Pika kulmore erdhi kur Pali pa në ëndërr vegimin maqedonas (shih Veprat 16:6-10). Kjo bëri të ndodhnin dy gjëra: sëp ari, kontinenti i Evropës u ungjillizua dhe, së dyti, Pali, për shkak të rrethanave në Maqedoni, nisi të shkruante letrat (Thomas Carter, *Life and Letters of Paul*, Nashville: Cokesbury Press, 1921, f. 112).
 - b. Pas vërejmë drejtimin e mësipërm shpirtëror, rrethanat fizike që e çuan Palin në Selanik ishin këto:
 - (1) Pali shkoi në Filipi, një qytet i vogël pa sinagogë. Puna aty iu pengua nga pronarët e një vaje skllave profetike dhe demoniake, si dhe nga këshilli i qytetit. Pali u rrah dhe u poshtërua, por aty u formua një kishë pavarësisht gjithë kësaj. Për shkak të kundërshtive dhe ndëshkimit fizik, Pali u detyrua të largohej, ndoshta më herët nga ç’kishte dëshiruar.
 - (2) Ku të shkonte pas Filipisë? Ai kaloi përmes Amfipolit dhe Apollonisë, të cilat nuk kishin sinagoga, njësoj si Filipia.
 - (3) Mbërriti në qytetin më të madh të zonës, Selaniku, që kishte sinagogë. Pali e kishte zakon që të shkonte te judenjtë së pari. Këtë e bënte:
 - (a) për shkak të njohurisë që ata kishiën për Dhiatën e Vjetër;
 - (b) për shkak të mundësive për predikim dhe mësimdhënie që i ofronte sinagoga;
 - (c) për shkak të pozitës së tyre si populli i zgjedhur, ose populli i besëlidhjes së Perëndisë (shih Mat. 10:6; 15:24; Rom. 1:16-17; 9-11);
 - (d) për shkak se Jezusi e kishte ofruar veten e tij së pari për ta, pastaj për botën – kështu, dhe Pali ndiqte shembullin e Krishtit.
3. Shoqëruesit e Palit
 - a. Pali shoqërohej nga Sila dhe Timoteu kur shkoi në Selanik. Luka ishte me Palin në Filipi dhe aty qëndroi. Këtë e mësojmë nga pasazhet “ne” dhe “ata” të Veprave 16 dhe 17. Luka flet me “ne” në Filipi, por me “ata” kur Pali udhëtoi në Selanik.
 - b. Sila, ose Silvani, ishte personi që Pali zgjodhi ta shoqëronte në udhëtimin e dytë misionar pasi Barnaba me Gjon Markun u kthyen në Qipro;
 - (1) Ai përmendet së pari në Bibël në Veprat 15:22, ku quhet njeriu kryesor ndër vëllezërit e kishës së Jerusalemit.
 - (2) Edhe ai ishte profet (shih Veprat 15:32).
 - (3) Ishte shtetas romak, si Pali (shih Veprat 16:37).
 - (4) Ai dhe Juda Barsaba u dërguan në Antioki nga kisha e Jerusalemit për të inspektuar situatën (shih Veprat 15:22, 30-35).
 - (5) Pali e lavdëron në 2 Kor. 1:19 dhe e përmend në disa letra.
 - (6) Më vonë, përmendet si personi shkrues i letrës së 1 Pjetrit (1 Pje. 5:12).
 - (7) Pali dhe Pjetri e quajnë Silvan, ndërsa Luka e quan Sila.
 - c. Edhe Timoteu ishte shoqërues dhe bashkëpunëtor i Palit:
 - (1) Pali u takua për herë të parë me të në Listar, ku Timoteu u kthye në besim; ndodhi gjatë udhëtimit të parë misionar.
 - (2) Timoteu ishte gjysmëgrek (nga babai) dhe gjysmëjude (nga nëna). Pali donte që ta përdorte në shërbesën e ungjillizimit të johebrenjve.
 - (3) Pali e rrethpreu që të ishte në gjendje të punonte me judenjtë.
 - (4) Timoteu përmendet në përshëndetjet e këtyre letrave: 2 Korintasve, Kolosianëve, 1 dhe 2 Thesalonikasve dhe Filemonit.

- (5) Pali e quan “biri im në shërbesë” (shih 1 Tim. 1:2; 2 Tim. 1:2; Tit. 1:4). Toni i përgjithshëm i Pali gjatë gjithë letrave të tij të lë të kuptosh se Timoteu ishte djalë i ri dhe i ndrojtur.
- (6) Pali ka besim dhe siguri të madhe në të (shih Veprat 19:27; 1 Kor. 4:17; Fil. 2:19).
- d. Është me vend që, në pjesën për shoqëruesit e Palit, të përmendim dhe burrat që erdhën nga Selaniku dhe e shoqëruan Palin në misionet e mëvonshme. Ata janë Aristarku (Veprat 19:29; 20:4; 27:2) dhe Sekundi (Veprat 20:4). Po kështu, Dema mund të ketë qenë nga Selaniku (Filem. 24; 2 Tim. 4:10).
4. Shërbesa e Palit në atë qytet
- a. Shërbesa e Palit në Selanik ndoqi modelin e tij të zakonshëm: në fillim shkoi te judenjtë dhe, pastaj, te johebrenjtë. Pali predikoi tre të shtuna në atë sinagogë. Mesazhi i tij ishte: “Jezusi është Mesia”. Përdori Shkrimet e Dhiatës së Vjetër për të provuar se Mesia do të ishte person i përvuajtur (shih Zan. 3:15; Isa. 53), dhe jo një Mesi politik dhe i përkohshëm. Po kështu, Pali theksoi ringjalljen dhe se shpëtimi vlente për gjithë njerëzit. Jezusi u paraqit qartë si Mesia i premtuar që nga kohët e lashta, dhe që do të shpëtonte gjithë popujt.
- b. Përgjigjja ndaj mesazhit të Palit ishte se disa judenj, shumë johebrenj të perëndishëm dhe shumë gra të rëndësishme e pranuan Jezusin si Zot dhe Shpëtimtar. Një analizë e këtyre grupeve me besimtarë të rinj është domethënëse për të kuptuar letrat e mëvonshme të Palit drejtuar kësaj kishe.
- c. Johebrenjtë përbënin shumicën e anëtarëve të kishës, gjë që shihet nga mungesa e aludimeve nga DHV në këto dy letra. Johebrenjtë e pranuan menjëherë Jezusin si Shpëtimtar dhe Zot për disa arsye:
- (1) Fetë e tyre tradicionale ishin besëtytni të pafuqishme. Selaniku ndodhej në këmbë të malit Olimp dhe të gjithë e dinin se majat e tij ishin bosh.
 - (2) Ungjilli ishte falas për të gjithë.
 - (3) Krishterimi nuk përmbante asnjë ngjyrim nacionalizmi përjashtues hebre. Feja judaike kishte tërhequr shumë njerëz për shkak të monoteizmit dhe vlerave të larta morale, por, gjithashtu, kishte larguar dhe shumë të tjerë për shkak të ceremonive të saj të neveritshme (si rrethprerja), si dhe për shkak të paragjyqimeve racore dhe nacionaliste të qenësishme të judenjve.
- d. Shumë “gra të parisë” pranuan krishterimin; kjo ndodhi për shkak se këto gra kishin mundësi që ta merrnin vetë vendimin se ç’fe do të zgjidhnin. Në Maqedoni dhe në Azinë e Vogël gratë ishin më të lira sesa në pjesën tjetër të botës greko-romake (Sir Wm. M. Ramsay, *St. Paul the Traveller and Roman Citizen*, New York: G. P. Putnam’s Sons, 1896, f 227). Gjithsesi, klasa më e varfër e grave, ndonëse të lira, ishte ende nën pushtetin e besëtytnive dhe politeizmit (Ramsay, f. 229).
- e. Shumë studiues kanë gjetur një problem në lidhje me kohëzgjatjen e qëndrimit të Palit në Selanik:
- (1) Veprat 17:2 thotë se Pali arsyetoi me ta në sinagogë për tre të shtuna, gjatë kohës që ishte në Selanik.
 - (2) 1 Thes. 2:7-11 na tregon se Pali punoi në zanatin e vet. Ai bënte çadra, ose disa kanë shprehur mendimin se punonte me lëkurë.
 - (3) Fil. 4:16 mbështet një qëndrim më të gjatë kohor, kur Pali pranoi të paktën dy dhurata monetare nga kisha në Filipi, ndërsa ishte në Selanik. Largësia mes këtyre dy qyteteve ishte rreth 160 km. Disa mendojnë se Pali qëndroi dy ose tre muaj në Selanik, dhe se tre të shtunat bëjnë fjalë vetëm për shërbesën te judenjtë (Shepard, f. 165).
 - (4) Rrëfimet e ndryshme të njerëzve të kthyer në besim në Veprat 17:4 dhe 1 Thes. 1:9; 2:4 e mbështesin pikëpamjen e mësipërme; ndryshimi kyç mes këtyre rrëfimeve ishte se johebrenjtë refuzuan idhujt. Johebrenjtë në Veprat ishin prozelitë judenj, që ua kishin kthyer shpinën idhujve. Konteksti nënkupton se Pali mund të ketë patur një shërbesë më të gjerë mes johebrenjve paganë sesa mes judenjve.
 - (5) Koha kur mund të jetë kryer kjo shërbesë më e gjerë është e paqartë pasi Pali gjithmonë shkonte te judenjtë në fillim. Pasi ia refuzonin mesazhin, shkonte te johebrenjtë. Kur johebrenjtë i përgjigjeshin ungjillit pozitivisht në mënyrë masive, judenjtë bëheshin

xhelozë (kjo ishte një nga teknikat misionare të Palit, shih Rom. 9-11) dhe nisnin trazira mes turmave problematike në qytet.

- f. Për shkak të një trazire, Pali u largua nga shtëpia e Jasonit dhe u fsheh bashkë me Timoteun dhe Silën, ose të paktën nuk ishin të pranishëm kur turma mësyu shtëpinë e Jasonit që t'i gjente. Politarkët e detyruan Jasonin që të jepte një garanci pasurore për të siguruar qetësinë. Kjo bëri që Pali të largohej nga qyteti natën dhe të shkonte në Bere. Megjithatë, kisha aty vijoi dëshmimin për Krishtin pavarësisht kundërshtive të forta.

II. AUTORI

A. 1 Thesalonikasve. Vetëm kritikët moderne të formës tekstuale e kanë vënë seriozisht në dyshim autorësinë e Palit dhe vërtetësinë e 1 Thes., por përfundimet e tyre nuk kanë bindur shumë studiues. 1 Thes. U përfshi në kanonin e Markionit (140 pas K.) dhe në Fragmentin Muratorian (200 pas K.). Të dyja këto lista librash kanonikë të DHR qarkullonin në Romë. Ireneu e citoi 1 Thes. Shkoqur – ai shkroi rreth 180 pas K.

B. 2 Thesalonikasve.

1. Letra e 2 Thes. Nuk është pranuar gjithmonë si e shkruar prej Palit, madje është sulmuar për disa arsye:
 - a. Fjalori përbën një prej problemeve. Kjo letër përmban shumë fjalë që nuk gjenden në letrat e tjera të Palit.
 - b. “Stili i saj është stereotipik dhe, nganjëherë, çuditërisht formal” (Heard, f. 186).
 - c. Eskatologjia e të dyja letrave duket sikur nuk përputhet.
 - d. 2 Thes. përmban një pikëpamje për antikrishtin që nuk gjendet diku tjetër në DHR; për këtë arsye, disa kanë arritur në përfundimin se s’ mund të ketë qenë Pali autori i saj.
2. Vërtetësia e 2 Thes. bazohet në disa pika:
 - a. Polikarpi, Ignati dhe Justini e pranuan si letër të Palit;
 - b. Kanoni i Markionit e përmban;
 - c. Fragmenti Muratorian e përmban;
 - d. Ireneu e citoi me emër;
 - e. Fjalor, stili dhe teologjia e saj janë paliane, njësoj si 1 Thesalonikasve

C. Krahasimi i dy letrave

1. Të dyja letrat janë shumë të ngjashme, jo vetëm në ide, por edhe në frazat që përdoren. Nëse përjashtohet terminologjia hapëse dhe mbyllëse formulore, ngjashmëritë e tjera gjenden në një të tretën e materialit.
2. Toni i përgjithshëm i 2 Thesalonikasve ndryshon nga letra e parë, pasi është më i frohtë dhe më formal. Mirëpo kjo mund të kuptohet lehtësisht kur ke parasysh rrethanat emocionale që shoqëruan shkrimin e letrës së parë, si dhe problemet që u zhvilluan para letrës së dytë.

D. Rendi i letrave

1. Një tjetër hipotezë interesante është parashtruar nga F. W. Manson, i cili përdori shënimet e Johannes Weiss. Ata mendojnë se rendi i këtyre dy letrave është i përmbysur. Arsyet për këtë janë:
 - a. Sfidat dhe sprovat janë në pikën kulmore në 2 Thes., por konsiderohen të kaluara në 1 Thes.;
 - b. Në 2 Thesalonikasve, vështirësitë e brendshme përmenden si zhvillimi i ri, të cilin autori i letrës sapo e ka mësuar, kurse në 1 Thes., rrethanat ishin të njohura për të gjitha palët;
 - c. Pohimi se selanikasit s’kanë nevojë që t’i mësojë dikush për kohët dhe stinët (1 Thes. 5:1) është shumë kuptimplotë nëse ata e njihnin tashmë përmbajtjen e 2 Thes. 2;
 - d. Formula “Tani, në lidhje me...” në 1 Thes. 4:9, 13; 5:1 ngjason me atë në 1 Kor. 7:1, 25; 8:1; 12:1; 16:1, 12, ku shkruesi po u përgjigjet disa pikave që i janë dërguar me anë të një letre të mëparshme. Manson mendon se përgjigjet mund të kenë lidhje me disa pyetje që dolën nga thëniet e 2 Thes.
2. Ky argument mund të kundërshtohet nga disa pika të tjera:

- a. Problemet që rrokin vëmendjen e Palit thellohen dhe shtohen nga 1 Thes. në 2 Thes.;
- b. Pasazhet në 2 Thes përmendin një letër të Palit (2:2, 15; 3:17); nëse mendojmë se kjo letër nuk ishte 1 Thes., atëherë kemi problemi e një letre të humbur;
- c. Kujtimet personale që spikasin kaq shumë në letrën e parë mungojnë në të dytën; kjo ngjan e natyrshme nëse letra e 2 Thes. u shkrua pas së parës;
- d. Toni i letrave duket tejet i panatyrshëm në këtë situatë nëse rendi i tyre përmbysset.

III. DATA E LETRAVE

- A. Data e shkrimit të letrave të 1 dhe 2 Thesalonikasve është një nga më të sigurtat që kemi në lidhje me letrat e Palit. Shkruhet se Pali, “kur ishte në Korint, u arrestua dhe u çua para Galios, prokonsullit të Akaisë” Një mbishkrim i gjetur në Delfi i përgjigjet një pyetjeje që ky Galio i kishte bërë perandorit Klaud. Datohet në vitin e dymbëdhjetë të pushtetit tribun të perandorit dhe pas shpalljes së tij të njëzetegjashtë si perandor. Ky vit i dymbëdhjetë ishte nga 25 janar 52 pas K. deri në 27 janar 53 pas K. Ndonëse data e shpalljes së njëzetegjashtë nuk dihet me saktësi, viti i njëzeteshtatë ishte para 1 gushtit 52 pas K. Vendimi i Klaudit duhet t’i jetë dërguar Galios gjatë gjysmës së parë të 52 pas K. Zakonisht, prokonsujt e merrnin këtë post në fillim të verës dhe e mbanin për një vit. Prandaj, me sa duket, Galio e mori postin në fillim të verës së vitit 51” (Morris, f. 15).
- B. Ky datim sipas marrjes së postit të prokonsullit nuk i zgjidh të gjitha problemet e datimit të letrave të 1 dhe 2 Thesalonikasve. Pali ishte në Korint për 18 muaj (Veprat 18:11), por nuk dihet se kur doli para Galios. Shumica e komentuesve i datojnë 1 dhe 2 Thesalonikasve rreth 50-51 pas K.
- C. Kronologji e mundshme e shkrimeve të Palit, sipas F. F. Bruce dhe Murray Harris, me disa përshtatje të vogla.

<u>Libri</u>	<u>Data</u>	<u>Vendi i shkrimit</u>	<u>Lidhja me Veprat</u>
1. Galatasve	48	Antiokia e Sirisë	14:28; 15:2
2. 1 Thesalonikasve	50	Korint	18:5
3. 2 Thesalonikasve	50	Korint	
4. 1 Korintasve	55	Efes	19:20
5. 2 Korintasve	56	Maqedoni	20:2
6. Romakëve	57	Korint	20:3
7-10. Letrat e Burgut			
Kolosianëve	fillim '60		
Efesianëve	fillim '60	Romë	
Filemonit	fillim 60'		
Filipianëve	fund 62-63		28:30-31
11-13. Udhëtimi i Katërt Misionar			
1 Timoteut	63 (ose më vonë, Maqedoni)		
Titit	63 (por përpara	Efes (?)	
2 Timoteut	64 (68 pas K.)	Romë	

IV. NGJARJET QË LIDHEN ME LETRAT E THESALONIKASVE

- A. Ngjarjet që bënë që Pali të shkruante letrat e Thesalonikasve janë të koklavitura dhe të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Duhet vërejtur disa dallime, sidomos në lidhje me kontekstin fizik dhe atë emocional. Pali ishte detyruar të largohej nga besimtarët selanikas për shkak se judenjtë kishin nxitur turmën besëtyte dhe politeiste të qytetit që të shpërthente në trazira të shtëpia e Jasonit duke kërkuar Palin dhe shoqëruesit e tij. Pasi e nxorën në seancë gjyqësore para politarkëve, Jasoni dhe drejtuesit e tjerë të krishterë u detyruan të paguanin një garanci për të siguruar qetësinë në qytet. Kur dëgjoi për këtë, Pali e kuptoi se duhet të shkonte gjetiu dhe ta linte vetëm këtë kishë të re dhetë papjekur. Prandaj, shkoi në Bere me Timoteun dhe Silën. Timoteu, me sa duket, qëndroi pak më tepër në fillim (shih Veprat 17:10) dhe më vonë u bashkua me Silën dhe shkuan në Athinë (shih Veprat 17:15). Në fillim, pranimi i sinqertë që i bënë judenjtë në Bere ishte bekim për Palin duke patur parasysh

kundërshtinë e fortë prej judenjvë më herët. Mirëpo kjo nuk zgjati shumë. Judenjtë e Selanikut erdhën në Bere dhe nisën të shkaktonin telashe. Kështu, Pali u detyrua të largohej sërish.

- B. Kësaj here, Pali shkoi në Athinë, ku u prit ftohtë dhe me indiferencë. Filozofët akademikë e trajtuan thjesht si risi. Përvoja e tij në Maqedoni u karakterizua nga përndjekja dhe kundërshtitë. E rrahën, e zhveshën dhe e ndoqën nga qyteti natën. Dijetarët e tallën, ndërsa paganët dhe shumë bashkëkombas të tij e urrenin (shih 2 Kor. 4:7-11; 6:4-10; 11:23-29).
- C. Pali ishte detyruar që ta linte këtë kishë premtuese në Selanik në një kohë kyçe. Ata ishin të papjekur në besim dhe po përballeshin me mundime dhe përndjekje. Pali s'po e përballonte dot më angëshinë mendore. I shqetësuar për këtë besimtarë të rinj, diku mes Beresë dhe Athinës, Pali dërgoi Timoteun me Silën që t'i vizitonin sërish kishat maqedonase. Timoteu shkoi në Selanik. Shumë mendojnë se ai qëndroi dhe shërbeu aty gjashtë muaj deri në një vit. Kisha kishte nevojë të dëshpëruar për dikë që t'i mësonte, t'i ngushëllonte dhe t'i inkurajonte. Vetë Timoteu ishte besimtar pak a shumë i ri. Ai ishte kthyer në besim gjatë udhëtimit të parë të Palit, por me Palin kishte qenë vetëm që nga koha kur Pali shkoi në Lистра në udhëtimin e dytë misionar. Prandaj, Timoteu ishte i ri në shërbesë, por Pali kishte besim të madh tek ai. Kjo ishte detyra e parë e Timoteut si përfaqësuesi zyrtar i Palit.
- D. Pali shërbeu i vetëm në Athinë dhe u shkurajua e u mërzi shumë për shkak të mungesës së pranimit të ungjillit në Maqedoni, si dhe për shkak të preokupimit të tij të pareshtur për të krishterët e rinj aty. Në veçanti, shqetësohej për kishën selanikase. A mund të themelohej një kishë në një kohë kaq të shkurtër dhe në rrethana aty të vështira, dhe prapëseprapë të mbijetonte? (Carter, f. 115). Përpos kësaj, ai s'kishte marrë prej njëfarë kohe asnjë lajm nga Timoteu dhe Sila (gjashtë muaj deri në një vit, ndonëse disa thonë se kjo zgjati vetëm një ose dy muaj) (Farrar, f. 369). Kjo ishte gjendja mendore e Palit në kohën kur mbërriti në Korint.
- E. Në Korint, ndodhën dy gjërat që e inkurajuan së tepërmi Palin.
1. Vegimi se Perëndia kishte në Korint shumë njerëz që do ta pranonin ungjillin (Veprat 18:9-10).
 2. Timoteu dhe Sila arritën dhe i sollën lajme të mira (Veprat 18:5). Ajo që e shtyu Palin t'u shkruante selanikasve nga Korinti ishte mesazhi që ata i dërguan me Timoteun. Pali po u përgjigjej pyetjeve të kishës për disa çështje doktrinale dhe praktike.
- F. Shkrimi i 2 Thes. u krye jo shumë kohë pas 1 Thes., për shkak se letra e parë nuk përmbushi gjithë nevojat që kishte patur ndërmend Pali. Po kështu, mori vesh për disa probleme të tjera. Shumë studiues mendojnë se 2 Thes. u shkrua rreth gjashtë muaj pas 1 Thes.

V. QËLLIMI I LETRAVE

- A. Letrat selanikase kanë qëllim të trefishtë:
1. të bëjnë të ditur gëzimin dhe mirënjohjen e Palit ndaj Perëndisë për besnikërinë dhe karakterin e krishterë të selanikasve, pavarësisht përndjekjeve.
 2. për t'iu përgjigjur kritikave për qëllimet dhe karakterin e tij, të cilat ishin ngritur kundër tij.
 3. për të diskutuar për kthimin e Zotit. Ky element eskatologjik i predikimit të Palit ngriti dy pyetje në mendjen e të krishterëve në Selanik:
 - a. Çfarë do t'u ndodhte besimtarëve që kishin vdekur para kthimit të Zotit?
 - b. Çfarë do t'u ndodhte besimtarëve të asaj bashkësie që e kishin lënë punën dhe rrinin kot duke pritur për kthimin e zotit (Barclay, f. 21-22).
- B. Një pjesë e mirë e këtyre që vërejtëm më sipër mund të shpjegohet nga fakti se kjo kishë ishte e re dhe shumë e zellshme. Mirëpo, për shkak të rrethanave, ishin të patrajnuar dhe të padisiplinuar si duhet. Këto probleme janë simptoma të pritshme për një kishë të kësaj natyre: besimtarët e rinj, të dobëtit, të frikësuarit, përtacët, vizionarët dhe të pësjtjelluarit.

- C. Shkasi për shkrimin e 2 Thesalonikasve është ky: “kjo është një recetë e dytë për të njëjtën ‘sëmundje’, e shkruar pasi Pali zbuloi se disa simptoma kokëforta nuk ishin zhdukur nga trajtimi i parë” (Walker, f. 2968).

VI. BIBLIOGRAFI E BURIMEVE TË CITUARA

- Barclay, William. *The Letters and the Revelation. The New Testament*. 2 vol. New York: Collins, 1969.
- Carter, Thomas. *Life and Letters of Paul*. Nashville: Cokesbury Press, 1921.
- Farrar, Dean. *The Life and Work of St. Paul*. New York: Cassell and Company, Limited, 1904.
- Heard, Richard. *An Introduction to the New Testament*. New York: Harper and Row Publishers, 1950.
- Metzger, Bruce Manning. *The New Testament: Its Background, Growth and Content*. Nashville: Abingdon Press, 1965.
- Manson, T. W. *Studies in the Gospels and Epistles*. Philadelphia: Westminster, 1962.
- Morris, Leon. *The First and Second Epistles to the Thessalonians*. Grand Rapids: Eerdmans, 1991.
- Ramsay, W. M. *St. Paul the Traveller and Roman Citizen*. New York: G. P. Putnam's Sons, 1896.
- Shepard, J. W. *The Life and Letters of Paul*. Grand Rapids: Wm. B. Eerdmans Publishing Company, 1950.
- Walker, R. H. *The International Standard Bible Encyclopedia*. Vol. V. N. D.

VII. PËRVIJIM I PËRMBAJTJES *

- A. Përshëndetje, 1:1
- B. Lutje falënderimi, 1:2-4
- C. Kujtime, 1:5-2:16
1. Përgjigjja e selanikasve ndaj predikimit të parë të Palit, 1:5-10
 2. Predikimi i ungjillit në Selanik, 2:1-16
 - a. Pastërtia e qëllimeve të ekipit misionar, 2:1-6a
 - b. Ekipi nuk pranoi që të merrte mbështetje financiare, 2:6b-9
 - c. Sjellja e ekipit ishte e shkëlqyer, 2:10-12
 - d. Mesazhi i ekipit për Fjalën e Perëndisë, 2:13
 - e. Përndjekjet, 2:14-16
- D. Marrëdhënia e Palit me selanikasit, 2:17-3:13
1. Dëshira e tij për t’u kthyer, 2:17, 18
 2. Gëzimi i Palit për selanikasit, 2:19, 20
 3. Misioni i Timoteut, 3:1-5
 4. Raportimi i Timoteut, 3:6-8
 5. Kënaqja e Palit, 3:9, 10
 6. Lutja e Palit, 3:11-13
- E. Nxitje për jetesë të krishterë, 4:1-12
1. Të përgjithshme, 4:1, 2
 2. Pastërtia seksuale, 4:3-8
 3. Dashuria vëllazërore, 4:9, 10

4. Puna për bukën e gojës, 4:11, 12

F. Probleme që lidheshin me Ardhjen e Dytë, 4:13-5:11

1. Besimtarët që vdisnin para Parusia-s, 4:13-18
2. Koha e Parusia-s, 5:1-3
3. Fëmijët e ditës, 5:4-11

G. Nxitje të përgjithshme, 5:12-22

H. Përmbyllje, 5:23-28

* KY LIBËR NUK NDAHET DOT LEHTË NË DY PJESË, PRA, DOKTRINORE DHE PRAKTIKE, SIÇ MUND TË BËHET PËR SHUMICËN E LETRAVE TË PALIT. NËSE NDJEKIM MODELIN E PËRGJITHSHËM, DISKUTIMI I PALIT PËR ARDHJEN E DYTË NË 4:17-18 ËSHTË PJESA PRAKTIKE, JO DOKTRINORE! ARDHJA E DYTË E KRISHTIT NUK ËSHTË DOKTRINË QË DUHET PRANUAR VETËM ME MENDJE, POR EDHE NJË JETË QË DUHET JETUAR DUKE PRITUR KTHIMIN E TIJ NGA ÇASTI NË ÇAST.

VIII. FJALË DHE FRAZA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

1. “u bëtë imituesit tanë”, 1:6
2. “Perëndinë e gjallë dhe të vërtetë”, 1:9
3. “zemërimi që po vjen”, 1:10
4. “si mëndeshë”, 2:7
5. “armiq të gjithë njerëzve”, 2:15
6. “Satani na pengoi”, 2:18
7. “plotësoj atë që i mungon besimit tuaj”, 3:10
8. Shenjtërim, 4:3
9. Në gjumë, 4:13
10. “nuk do t’u paraprijnë atyre që kanë rënë në gjumë”, 4:15
11. “trumpeta e Perëndisë”, 4:16
12. “re”, 4:17
13. “kështu, do të jemi gjithmonë me Zotin”, 4:17
14. Gjumë, 5:6, 7
15. Esëll, 5:8
16. “parzmorja e besimit dhe dashurisë”, 5:8
17. “helmetë, shpresën e shpëtimit”, 5:8
18. Puthja e shenjtë, 5:26
19. Qëndresa, 2 Thes. 1:4
20. Shkatërrimi i përjetshëm, 2 T hes. 1:9
21. Femohimi, 2 Thes. 2:3
22. “Zoti do ta vrasë me frymën e gojës së tij”, 2 Thes. 2:8

IX. PERSONA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

1. Silvan, 2 Thes. 1:1
2. Kryeengjëlli, 1 Thes. 4:16
3. “teksta thoshin...”, 1 Thes. 5:3
4. “njeriu i paligjshmërisë”, 2 Thes. 2:3
5. “ai që e përmban tani”, 2 Thes. 2:7
6. “që bën jetë të çrregullt”, 2 Thes. 3:6

X. VENDNDODHJE QË DUHEN GJETUR NË HARTË

1. Selanik, 1:1
2. Maqedoni, 1:8
3. Akai, 1:8
4. Filipi, 2:2
5. Jude, 2:14
6. Athinë, 3:1

XI. PYETJE PËR DISKUTIM

1. Pali e përshkruan predikimin e vet në pesë mënyra në 2:3, 5. Renditi.
2. Pse nuk pranonte Pali para nga kishat të cilave u predikonte? (2:9)
3. Si lidhet 4:11 me situatën historike që e shtyu Palin të shkruante këtë letër? (shih dhe 2 Thes. 3:6-12)
4. Si lidhet 4:17 me Rrëmbimin?
5. Për çfarë bën fjalë 5:11?
6. Pse e përshkruan si Pali besimtarin si ushtar? (5:8)
7. Si duhet zbatuar 5:12-13 nga pastorët e sotëm?
8. Rendit gjërat për të cilat janë thirrur besimtarët në 5:14-22.
9. A është trikotomi njerëzimi në bazë të 5:23?
10. Cila është tema kryesore e 2 Thes. 1? Si ndryshon nga 1 Thes. 1?
11. A kërkon 2 Thes. 2:4 rindërtimin e tempullit të judenjve?
12. Si lidhet 2 Thes. 2:11 me vullnetin e lirë dhe përgjegjësinë njerëzore?
13. Si e drejtpeshon 2 Thes. 2:13-15 paracaktimin me vullnetin e lirë?

HYRJE PËR LETRAT PASTORALE: 1 & 2 TIMOTEUT dhe TITIT

I. SHËNIME HYRËSE

A. Vendet gjeografike të përmendura tek 1 Timoteut, Titit, dhe 2 Timoteut nuk përputhen me kronologjinë e Veprave dhe as letrave të tjera të Palit.

1. vizita në Efes (krh. 1 Tim. 1:3)
2. vizita në Troadë (krh. 2 Tim. 4:13)
3. vizita në Milet (krh. 2 Tim. 4:20)
4. misioni në Kretë (krh. Titit 1:5)
5. misioni në Spanjë (nga Klementi i Romës, viti 95 pas Krishtit dhe hyrja e Kanonit Muratorian, viti 180-200 pas Krishtit)

Prandaj, unë mendoj se Pali u lirua nga burgju (nga fillimi apo mesi i viteve 60-të, gjë që dokumentohet tek I Clement 5, shkruar rreth 95 pas Kr.) dhe ndërmoi një udhëtim të katërt misionar, u arrestua në atë kohë dhe u vra përpara vitit 68 (viti i vetëvrasjes së Neronit).

B. Qëllimi i këtyre letrave në përgjithësi mendohet se ka qenë administrativ (organizimi i kishës). Megjithatë, në *New International Biblical Commentary*, [Komentarin e Ri Biblik Nderkombëtar] Vëll. 13, mbi I dhe 2 Timoteut dhe Titit, Gordon Fee më bind që shkasi i shkrimit të letrave ishte mësimi i rremë që po shfaqej brenda kishave-shtëpi të Efesit (1 Timoteut) dhe në ishullin e Kretës (Titit).

C. Në disa mënyra, Letrat Pastorale paraqesin një model administrativ të ngjashëm me *Manualin e Disiplines* së Esenëve. Këto udhëzime ishin edhe më të nevojshme për shkak të shmangies së hershme dhe të përhapur nga forma dhe mësimet apostolike.

D. Ngjashmëria midis Letrave Pastorale dhe fjalorit të Lukës të Luka dhe Veprat mund të jetë ngaqë Pali e përdori Lukën si shkruar (krh. C. F. C. Moule, *The Problem of the Pastoral Epistles: A Reappraisal* [Problemi i letrave pastorale: një rivlerësim]). S. G. Wilson madje ka shprehur në librin *Luke and the Pastoral Epistles* [Luka dhe Letrat Pastorale] që këta tre libra mund të kenë qenë përpjekja e Lukës për të shkruar një vëllim të tretë ku të përvijohesh përhapja e ungjillit përtej Romës.

E. Pse grupohen bashkë këta tre libra? A është e mundur që të kenë të bëjnë me kohëra/ vende/çështje të ndryshme? Vetëm 1 Timoteut dhe Titit kanë të bëjnë me organizimin e kishës. Ajo që në të vërtetë I grupon bashkë këta libra është (1) fjalori i tyre; (2) mësuat e rremë; dhe (3) fakti që nuk gjejnë vend lehtë në kronologjinë e Veprave (nëse merren së bashku).

II. AUTORI

A. Letrat vetë pretendojnë të jenë nga Pali Apostulli (krh. 1 Tim. 1:1; 2 Tim. 1:1; dhe Titit 1:1) drejtuar dy përfaqësuesve të tij apostolikë, Timoteut dhe Titit.

B. Çështja e autorësisë së Letrave Pastorale filloi të debatohet në shekujt e 19-të dhe 20-të. Kundërshtimi i autorësisë së Palit bazohet zakonisht në

1. Organizimin e zhvilluar kishtar (cilësitë e udhëheqësve)
2. Gnosticizmin e zhvilluar (i dokumentuar në shekullin e dytë)
3. një teologji e zhvilluar (besoret)
4. një ndryshim në fjalor dhe stil (një e treta e fjalëve nuk janë përdorur në shkrimet e tjera të Palit)

C. Këto dallime mund të shpjegohen

1. këto janë shkrimet e fundit të Palit, duke përdorur ndoshta Lukën si shkruar

2. fjalori dhe stili varen nga rasti
 3. idetë Gnostike ishin një zhvillim i mendimit judaik të shekullit të parë (krh. Rrotullat e Detit të Vdekur)
 4. Pali ishte një teolog i shkëlqyer dhe shkrimtar krijues me një fjalor të gjerë
- D. Tani po kuptojmë gjithnjë e më shumë precedentin historik
1. Përdorimi nga Pali i një shkruesi të krishterë profesionist (në këtë rast, ndoshta Luka)
 2. Përdorimi nga Pali i bashkautorëve (d.m.th., pjesë e skuadrës së tij misionare, krh. 2 Tim. 4:11)
 3. Përdorimi nga Pali i citimeve liturgjike ose himnike (një përmbledhje e mirë gjendet në [*Fjalori i Palit dhe i letrave te tij*] *Dictionary of Paul and His Letters*, redaktuar nga Hawthorne dhe Martin, botuar nga IVP, fq. 664).
Sugjerimet që disa pjesë të Letrave Pastorale janë citime nga burime të tjera ndihmojnë në shpjegimin e numrit të *hapax legomena* (fjalëve të përdorura vetëm një herë në DHR), idiomave jo-Paliane, dhe përdorimit unik të termave Paliane.
 - a. doksologji (krh. 1 Tim. 1:17; 6:15-17)
 - b. listë vesesh (krh. 1 Tim. 1:9-10)
 - c. sjellja e duhur për bashkëshortet (krh. 1 Tim. 2:9-3:1a)
 - d. cilësitë për shërbëtorët e krishterë (krh. 1 Tim. 3:1b-13)
 - e. rrëfimet himnike (krh. 1 Tim. 2:5-6; 3:16; 2 Tim. 1:9-10; Titit 3:3-7)
 4. himnet (krh. 1 Tim. 6:11-12,15-16; 2 Tim. 2:11-13; Titit 2:11-14)
 - a. *midrash* i DHV (krh. 1 Tim. 1:9-10; 2:9-3:1a; 5:17-18; 2 Tim. 2:19-21; Titit 3:3-7)
 - b. formulat:
 - (1) “kjo fjalë është e sigurt/e besueshme” (krh. 1 Tim. 1:15; 2:9-3:1a; 2 Tim. 2:11-13; Titit 3:3-8)
 - (2) “duke ditur këtë që” (krh. 1 Tim. 1:9-10; 2 Tim. 3:1-5)
 - (3) “këto gjëra” (krh. 1 Tim. 4:6,11; 2 Tim. 2:14; Titit 1:15-16; 2:1)
 5. citim nga një poet grek (krh. Titit 1:12 [Epimenidi dhe/ose Euripidi])
- E. Është e habitshme që një "Palinist" gjoja i shekullit të dytë të përmendte detaje të tilla specifike si emra njerëzish (p.sh., Himeneu, 1 Tim. 1:20; 2 Tim. 2:17; Aleksandri, 1 Tim. 1:20; Zena, Titit 3:13) dhe ngjarje (Trofimi i sëmurë në Milet, 2 Tim. 4:20; apo roli i të vejave, 1 Tim. 5:9) që nuk përmenden tjetërkund në shkrimet e Palit. Këto gjëra nuk përputhen me supozimin e pseudografisë (autorësisë së rreme, shën i përkth).
- Për një artikull të mirë mbi pseudonimitetin e lidhur me letrat e DHR, shih *An Introduction to the New Testament*, [*Hyrje ne Dhiaten e Re*] nga Carson, Moo, dhe Morris, fq. 367-371.

III. DATA

- A. Nëse është e vërtetë që Pali u lirua nga burgu (pas mbylljes së librit të Veprave, ndoshta nga vitet 59-61 pas Kr.), atëherë a ka ndonjë traditë të hershme të veprimtarive të tij të pas burgut (d.m.th., predikimi në Spanjë, krh. Rom. 15:24,28)?
1. Letrat Pastorale (krh. 2 Tim. 4:10)
 2. *I e Klementit 5*
 - a. Pali predikoi në lindje dhe në perëndim (d.m.th., Spanjë)
 - b. Pali u vra nën "prefektët" (d.m.th., Tigelinin dhe Sabinin, që ishin në detyrë në vitin e fundit të mbretërimit të Neronit, viti 68 pas Kr.)
 3. hyrja e Fragmentit Muratorian (një listë me libra kanonikë nga Roma që u përket viteve 180-200 pas Kr.)
 4. *Historia e Kishës* e Euzebit 2:22:1-8, thotë që Pali u lirua nga burgu në Romë
- B. Duket se 1 Timoteut dhe Titit u shkruan afër me njëra-tjetrën përpara riarrestimit të Palit. 2 Timoteut është shkrimi dhe lamtumira e fundit e Palit nga burgu.

C. Kronologji e mundshme e shkrimeve të Palit, sipas F. F. Bruce dhe Murray Harris, me disa përshtatje të vogla.

<u>Libri</u>	<u>Data</u>	<u>Vendi i shkrimit</u>	<u>Lidhja me Veprat</u>
1. Galatasve	48	Antiokia e Sirisë	14:28; 15:2
2. 1 Thesalonikasve	50	Korint	18:5
3. 2 Thesalonikasve	50	Korint	
4. 1 Korintasve	55	Efes	19:20
5. 2 Korintasve	56	Maqedoni	20:2
6. Romakëve	57	Korint	20:3
7-10. Letrat e Burgut			
Kolosianëve	fillim '60		
Efesianëve	fillim '60	Romë	
Filemonit	fillim 60'		
Filipianëve	fund 62-63		28:30-31
11-13. Udhëtimi i Katërt Misionar			
1 Timoteut	63 (ose më vonë, Maqedoni		
Titit	63 (por përpara	Efes (?)	
2 Timoteut	64 (68 pas K.)	Romë	

IV. MARRËSIT

- A. Emri, Letrat Pastorale, vjen nga komentari i D. N. Berdot i vitit 1703. Ai flet për karakterin dhe përmbajtjen e tyre unike. Timoteu dhe Titi, megjithatë, nuk janë pastorë, por të dërguar apostolikë.
- B. Këto letra u shkruan për kishat, por nën formën letrare të letrave ndaj bashkëpunëtorëve të Palit, Timoteut dhe Titit. Pali u adresohet bashkësive ndërsa i adresohet skuadrës së tij udhëheqëse. Shenja të audiences më të gjerë të Palit janë
1. hyrjet formale që përmendin apostullimin e tij
 2. shumësi "ju" në mbylljen e të trija letrave
 3. mbrojtja që i bën Pali thirrje së tij (krh. 1 Tim. 2:7)
 4. fakti që Pali i shkruan Timoteut për gjëra që ai do t'i kishte ditur tashmë nga koha e tij me Palin (krh. 1 Tim. 3:15)

V. SHKASI/QËLLIMI

- A. Qëllimi kryesor ishte të luftoheshin herezitë që po dilnin (krh. 1 Tim. 1:3-7). Herezia specifike mund të ishte një kombinim i prirjeve judaike dhe gnostike (si mësuesit e rremë të Efesianëve dhe Kolosianëve). Ndoshta ishin dy grupe të dallueshme.
- B. DHV përmban udhëzime specifike për organizimin e komunitetit të besimit. DHR nuk përmban udhëzime specifike në lidhje me organizimin ose qeverisjen e kishës. Letrat Pastorale (1 Timoteut, 2 Timoteut, dhe Titit) janë forma më e afërt e udhëzimeve të tilla që gjendet në DHR.
- C. 1 Timoteut u shkrua:
1. për t'i kërkuar Timoteut të qëndronte në Efes (krh. 1 Tim. 1:3)
 2. për t'u marrë me mësuesit e rremë (krh. 1 Tim. 1:19-20; 4:1-5; 6:4-5,20-21)
 3. për të ndihmuar me organizimin e udhëheqjes (krh. 1 Tim. 3)
- D. Titit kishte një detyrë të ngjashme për Titin, për t'u marrë me herezinë dhe organizimin në Kretë (krh. Titit 1:5).
- E. 2 Timoteut e gjen Palin në burg me shpresë të pakët për lirim (krh. 2 Tim. 4:6-8, 16-18).

- F. Ka një ndjesi të fortë të "mësimi të shëndoshë" (d.m.th., doktrinë së drejtë) që tingëllon përgjatë këtyre letrave (krh. 1 Tim. 1:10; 4:6; 6:3; 2 Tim. 1:13; 4:3; Titit 1:9; 2:1) ose "të shëndoshë në besim" (krh. Titit 1:13; 2:2). Perëndia ia besoi këtë "mësim të shëndoshë" Palit (krh. 1 Tim. 1:11); Pali ia besoi Timoteut (krh. 1 Tim. 6:20), dhe Timoteu duhej t'ia besonte atë njerëzve besnikë (krh. 2 Tim. 2:2).

VI. MËSUESIT E RREMË

- A. Është e vështirë të diskutosh mësuesit e rremë për shkak të mungesës së informacionit specifik të shekullit të parë. Pali po u shkruan atyre që i njihnin këta mësues të rremë personalisht. Prandaj ai nuk e diskuton plotësisht teologjinë e tyre, por zakonisht dënon motivet dhe mënyrën e tyre të jetesës (siç bën edhe Juda).
- B. Çështja kryesore interpretuese lidhet me faktin nëse ata ishin
1. Judenj
 2. Grekë
 3. Kombinim i të dyve
- C. Mësuesit e rremë duhej se ishin një përzierje e elementëve judaikë dhe gnostikë. Por si u bashkuan këto lëvizje fetare krejt të kundërta?
1. Judaizmi gjithmonë kishte në vetvete disa elementë dualistë (krh. Rrotullat e Detit të Vdekur)
 2. Gnosticizmi i shekullit të dytë i zhvilloi këto motive teologjike/filozofike të përbashkëta të Lindjes së Mesme
 3. Judaizmi i diasporës ishte më shumë eklektik sesa e mendonin më parë studiuesit e sotëm
 4. ka një precedent të shekullit të parë për një herezi judaiko-gnostike në librin e Kolosianëve
- D. Disa nga elementët e mësuesve të rremë
1. Aspektet judaike
 - a. Mësuesit e rremë
 - (1) mësues të Ligjit (krh. 1 Tim. 1:7)
 - (2) grupi i rrethprerjes (krh. Titit 1:10)
 - b. mësuesit e rremë paralajmërohen në lidhje me përrallat judaike (krh. 1 Tim. 3:9; Titit 1:14)
 - c. mësuesit e rremë preokupohen me ligjet ushqimore (krh. 1 Tim. 4:1-5)
 - d. mësuesit e rremë preokupohen me gjenealogjitë (krh. 1 Tim. 1:4; 4:7; 2 Tim. 4:4; Titit 1:14-15; 3:9)
 2. Aspektet gnostike (Shih Temën e Veçantë të Titit 1)
 - a. asketizëm që ndalon dhe përjashton
 - (1) martesën (krh. 1 Tim. 2:15; 4:3)
 - (2) disa ushqime (krh. 1 Tim. 4:4)
 - b. shfrytëzim seksual (krh. 1 Tim. 4:3; 2 Tim. 3:6-7; Titit 1:11,15)
 - c. theksimi i njohurisë (krh. 1 Tim. 4:1-3; 6:20)

VII. KANONICITETI

- A. Letrat e Palit u mblodhën së bashku në një vëllim me titullin "Apostulli" dhe pastaj u qarkulluan midis kishave. I vetmi dorëshkrim në greqisht i letrave të Palit që nuk e ka I dhe 2 Timoteut dhe Titit (gjithashtu 2 Thesalonikasve dhe Filemonit) është një dorëshkrim në papirus nga vitet 200, i quajtur P46 (nga papiruset Chester Beatty). Edhe ky është hamendësim, sepse dorëshkrimi i mungojnë disa faqe në fund. Të gjithë dorëshkrimet e tjerë në greqisht përmbajnë ato që u quajtën me kalimin e kohës "Letrat Pastorale."
- B. Burime të lashta që citojnë, i referohen, ose përmendin Letrat Pastorale:
1. udhëheqësit e kishës së hershme
 - a. Pseudo-Barnaba (70-130 pas Kr.) citon 2 Timoteut dhe Titit

- b. Klementi i Romës (95-97 pas Kr.) i referohet 1 Timoteut dhe 2 Timoteut dhe citon Titit 3:1
 - c. Polikarpi (110-150 pas Kr.) i referohet 1 Timoteut, 2 Timoteut, dhe Titit
 - d. Hermas (115-140 pas Kr.) citon 1 Timoteut dhe 2 Timoteut
 - e. Ireneu (130-202 pas Kr.) citon shpesh nga 1 Timoteut, 2 Timoteut, dhe Titit
 - f. Diogneti (150 pas Kr.) citon Titit
 - g. Tertuliani (150-220 pas Kr.) citon 1 Timoteut, 2 Timoteut, dhe Titit
 - h. Origeni (185-254 pas Kr.) citon 1 Timoteut, 2 Timoteut, dhe Titit
2. lista të librave kanonikë që përfshijnë Letrat Pastorale:
 - a. Fragmenti Muratorian (nga Roma rreth 200 pas Kr.)
 - b. Barokokio (206 pas Kr.)
 - c. Lista Apostolike (300 pas Kr.)
 - d. Lista e Çeltenhamit [Cheltenham] (360 pas Kr.)
 - e. Letra e Athanasit (367 pas Kr.)
 3. versione të hershme që përmbajnë Letrat Pastorale
 - a. përkthimi në latinishten e vjetër (150-170 pas Kr.)
 - b. përkthimi në gjuhën siriake të vjetër (200 pas Kr.)
 - c. këshilla të kishës së hershme që pohuan statusin e frymëzuar të Letrave Pastorale
 - d. Nikea (325-340 pas Kr.)
 - e. Hipo (393 pas Kr.)
 - f. Kartagjena (397 dhe 419 pas Kr.)
- C. Kanoni u zhvillua nëpërmjet një procesi konsensusi midis bashkësive të hershme të krishtera të perandorisë romake. Ky konsensus u ndikua patjetër nga presione të brendshme dhe të jashtme shoqërore. Kriteret bazë për përfshirjen në kanon duket se kanë qenë
1. lidhja me një Apostull
 2. mesazhi në përputhje me shkrimet e tjera apostolike
 3. jetët e ndryshuara të atyre që i lexuan këto shkrime
 4. një dakordësi gjithnjë e më e madhe në lidhje me listën e shkrimeve të pranuar midis këtyre kishave të hershme
- D. Nevoja për një kanon doli për shkak të
1. vonimit të Ardhjes së Dytë
 2. distancës gjeografike midis kishave dhe apostujve
 3. vdekjes së apostujve
 4. shfaqjes së hershme të mësuesve të rremë
 - a. Judaizmi
 - b. filozofitë greke
 - c. përzierja e elementëve judaikë dhe gnostikë (Kolosianëve)
 - d. fetë e tjera greko-romake të misterit (p.sh. Mithra)
 Kjo ndodhi kur ungjilli u përhap ndër kultura të ndryshme.
- E. Çështja e kanonicitetit është historikisht e lidhur me autorësinë. Kisha e hershme i pranoi Letrat Pastorale si shkrime të Palit. Konceptet e mia për kanonicitetin mbajnë parasysh edhe përfshirjen e Frymës, jo vetëm në formulimin e Shkrimeve, por edhe në mbledhjen dhe në ruajtjen e tyre. Çështja e autorësisë së Palit (që unë e marr të mirëqenë) nuk e prek aspak negativisht frymëzimin dhe kanonizimin.

VIII. 1 TIMOTEUT – FJALË DHE FRAZA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

1. “fëmija im i vërtetë në besim”, 1:2
2. Blasfemues, 1:13
3. Amen, 1:17
4. Ndërmjetës, 2:5
5. Shpengim, 2:6

6. “ngrini duart e shenjta”, 2:8
7. “përtej qortimi”, 3:2
8. “të varur nga vera e shumtë”, 3:8
9. “misteri i besimit”, 3:9
10. “doktrina demonësh”, 4:1
11. “të damkosur në ndërgjegje”, 4:2
12. “fabula të botës”, 4:7
13. “vënia e duarve”, 4:14; 5:22
14. Pleqësia, 4:14
15. “ndero vejushat që janë vërtet vejusha”, 5:3
16. “zotimin e mëparshëm”, 5:12
17. “nderim i dyfishtë”, 5:17
18. Kënaqja, 6:6
19. Drita e paafreshme, 6:16

IX. 1 TIMOTEUT – PERSONA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

1. Ati, 1:2
2. “mësuesit e Ligjit”, 1:7
3. “Mbreti i përjetshëm”, 1:17
4. Himeneu dhe Aleksandri, 1:20
5. Mbikëqyrës, 3:2
6. Dhjakët, 3:8
7. Gratë, 3:11
8. Pleqtë, 5:17
9. Ponc Pilati, 6:13

X. 1 TIMOTEUT – VENDNDODHJE QË DUHEN GJETUR NË HARTË

1. Maqedoni, 1:3
2. Efes, 1:3

XI. 1 TIMOTEUT – PYETJE PËR DISKUTIM

1. Përshkruaj me fjalët e tua mësuesit e rremë që përmenden në 1:3-4.
2. A i pasqyron Dhjetë Urdhërimet pasazhi 1:9-11? Nëse po, cilat janë dallimet mes tyre?
3. Pse e konsideron Pali veten si mëkatarin më të madh? (1:15)
4. Për cilën ngjarje në jetën e Timoteut bën fjalë 1:18?
5. Ç’do të thotë që Pali ia dorëzoi dikë Satanit? (1:20)
6. Pse është varg kaq i rëndësishëm 2:4?
7. Shpjego 2:9 në bazë të kulturës së shekullit të parë.
8. Si gjen zbatim sot 2:12?
9. Shpjego 2:15 me fjalët e tua.
10. Rendit cilësitë e mbikëqyrësve. (3:1-7)
11. Pse mendohet se 3:16 është citim nga një himn i hershëm?
12. Pse e ndalonin martesën mësuesit e rremë? (4:3)
13. Si lidhet 4:4 me Romakëve 14?
14. Shpjego 4:10 me fjalët e tua.
15. Cilën ngjarje përshkruan 4:14?
16. Si pasqyrohet DHV në 5:19?
17. Për cilin problem kulturor e ka fjalën 5:23?
18. Shpjego 6:10 me fjalët e tua.
19. Nga vijnë titujt që përdoren për Jezusin në 6:15?

XII. 2 TIMOTEUT – FJALË DHE FRAZA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

1. “rindiz dhuntinë e Perëndisë”, 1:6
2. “thesarin që të është besuar”, 1:14
3. Gangrena, 2:17
4. “ka këtë vulë”, 2:19
5. Enë, 2:20
6. Të zotit, 2:21
7. “me kohë dhe pa kohë”, 4:2
8. Mite, 4:4
9. “librat... pergamenat”, 4:13
10. “goja e luanit”, 4:17

XIII. 2 TIMOTEUT – PERSONA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

1. Etërit e mi, 1:3
2. Loida, 1:5
3. Eunika, 1:5
4. Onesifor, 1:16
5. Himeneu, 2:17
6. Fileti, 2:17
7. Janesi dhe Jambresi, 3:8, 9
8. Ungjilltar, 4:5
9. Dema, 4:10
10. Luka, 4:11
11. Marku, 4:11
12. Tikiku, 4:12
13. Aleksandri, 4:14

XIV. 2 TIMOTEUT – VENDNDODHJE QË DUHEN GJETUR NË HARTË

1. Azi, 1:15
2. Romë, 1:17
3. Efes, 1:18; 4:12
4. Antioki, 3:11
5. Ikon, 3:11
6. Listra, 3:11
7. Selanik, 4:10
8. Galati, 4:10
9. Dalmaci, 4:10
10. Troadë, 4:13
11. Korint, 4:20
12. Milet, 4:20

XV. 2 TIMOTEUT – PYETJE PËR DISKUTIM

1. Ku u burgos Pali?
2. Shpjego 1:12 me fjalët e tua.
3. Si ngjason 1:9 me Titin 3:5a?
4. Çfarë bëri Onesifori për Palin në burg? (1:16-18)
5. 2 Timoteut 2:2 është varg shumë i rëndësishëm. Pse?
6. Pse mendohet se 2:11 është citim i një himni të hershëm?
7. Për çfarë bën fjalë 2:15?
8. A nënkupton 2:25 se Perëndia jep pendim? Nëse po, ç' domethënie ka kjo?

9. Rendit gjërat që duhet të bëjnë besimtarët për të ndihmuar “të joshurit”. (2:24-25)
10. Për çfarë dhe për kë bën fjalë 3:6-7?
11. Pse është varg shumë i rëndësishëm 3:16?
12. Pse nuk e shëroi Palin Trofinin?

HYRJE PËR TITIN

I. SHËNIME HYRËSE

- A. Titi bën pjesë në atë grup të letrave të Palit që njihen si “letrat pastorale”. Kjo ndodh për shkak se Timoteu, Titi dhe 2 Timoteut trajtojnë këshillat e Palit për bashkëpunëtorët e tij për (1) mënyrën si të sillen me mësuesit e rremë, (2) si të caktojnë drejtues për kishat lokale dhe (3) si të nxisin perëndishmërinë. Me sa duket, rendi kronologjik i letrave është ky: 1 Timoteut dhe/ose Titit dhe, më vonë, 2 Timoteut. Titi trajton të njëjtat tema si 1 Timoteut. Titit mund të jetë shkruar i pari, pasi hyrja e tij është e gjatë dhe e koklavitur nga ana teologjike, njësoj si Romakëve.
- B. Lëvizjet gjeografike të Palit dhe këtyre bashkëpunëtorëve nuk përputhen me lëvizjet gjeografike të Palit në Veprat. Prandaj, shumë mendojnë se kjo është provë që Pali u lirua nga burgu dhe kreu një udhëtim të katërt misionar.
- C. Datat për këtë udhëtim të katërt misionar duhet të kenë qenë dikur rreth fillimit të viteve 60’ deri në 68 pas K., për shkak se Palit iu pre koka në kohën e Neronit; Neroni vrau veten më 68 pas K. (shumë mendojnë se ekzekutimi i Pali ndodhi gjatë përndjekjes së 65 pas K.).

II. TITI SI PERSON

- A. Titi ishte një nga bashkëpunëtorët më të besuar të Palit. Kjo provohet dhe nga fakti se Pali e dërgoi në vendet e vështira, si Korinti dhe Kreta.
- B. Ishte plotësisht johebre (Timoteu ishte gjysmëgrek) dhe u kthye në besim nga predikimi i Palit. Pali nuk pranoi që ta rrethpriste (shih Gal. 2:3).
- C. Përmendet shpesh në letrat e Palit (shih 2 Kor. 2:13; 7:6-15; 8:6-24; 12:18; Gal. 2:1-3; 2 Tim. 4:10) dhe është shumë e habitshme që Luka nuk e përmend në Veprat. Disa komentarë paraqesin teorinë se:
 - 1. Titi mund të ketë qenë kushëri i Lukës (ndoshta, vëlla) dhe përfshirja e emrit të tij do të ishte konsideruar si veprim i papërshtatshëm nga ana kulturore për Lukën
 - 2. Titi ishte burim kryesor informacioni për Lukën në lidhje me jetën dhe shërbesën e Palit dhe, si rrjedhojë, ashtu si Luka, Titi nuk përmendet.
- D. Shoqëroi Palin dhe Barnabën në Këshillin tejet të rëndësishëm të Jerusalemit, që përmendet në Veprat 15, ku u debatua dhe u zgjidh problemi i marrëdhënies së re të besimtarëve johebrenj me ligjin e Moisiut.
- E. Ky libër përqendrohet në këshillat që Pali i jep Titit për shërbesën në Kretë. Titi po vepron si i dërguar/përfaqësues i Palit.
- F. Informacioni i fundit për Titin në DHR na thotë se Pali e dërgoi të shërbente në Dalmaci (shih 2 Tim. 4:10).

III. MËSUESIT E RREMË

- A. Qartazi, në Kretë ishte një grup mësuesish të rremë që i kundërviheshin ungjillit të Palit.
 - 1. Mësimet e tyre teologjike çuan në konflikt me jetesën e perëndishme që duhet të bënin besimtarët.
 - 2. Përmendet jetesa e perëndishme: 1:1, 16; 2:7, 14; 3:1, 8, 14
 - 3. Përmbledhje e cilësive të karakterit: 2:11-14; 3:4-7
- B. Qartazi, ky mësim i rremë përmbante disa elemente judaike (shih 1:10, 14; 3:8-9). Këto herezi janë kombinim i legalizmit judaik me mendimin hamendësues grek (gnosticismi, shih Temën e Veçantë në

1:1). Ngjasojnë me mësuesit e rremë që trajtohen në 1 Timoteut, Kolosianëve dhe Efesianëve. Fokusi i letrave pastorale është goditja e herezive, jo vetëm organizimi i kishës.

IV. FJALË DHE FRAZA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

1. Perëndishmëri, 1:1
2. “në shpresën e jetës së përjetshme”, 1:2
3. “të cilën, Perëndia që nuk mund të gënjejë”, 1:2
4. Mikpritës, 1:8
5. Mitet judaike, 1:14
6. Doktrina e shëndoshë, 2:1
7. Qëndresa, 2:2
8. “në epokën e tanishme”, 2:12
9. “shpresën e bekuar”, 2:13
10. Shpengoj, 2:14
11. “larja e ripërtëritjes”, 3:5

V. PERSONA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

1. Pleqtë, 1:5
2. Mbikëqyrës, 1:&
3. “ata të rrethprerjes”, 1:10
4. “një profet i tyre”, 1:12
5. “sundimtarëve, autoriteteve”, 3:1
6. Tikiku, 3:12
7. Apollo, 3:13

VI. VENDNDODHJE QË DUHEN GJETUR NË HARTË

1. Kretë, 1:5
2. Nikopojë, 3:12

VII. PYETJE PËR DISKUTIM

1. Pse është domethënëse që edhe Perëndia Atë, edhe Biri Jezus, quhen “Shpëtimtar” (3 herë secili) te letra e Titit?
2. Si lidhet 1:6 me mësuesit e rremë?
3. A bën fjalë 2:1-5 për drejtuesit e kishës, apo për anëtarët?
4. Pse është varg kaq i rëndësishëm 2:11?
5. A e quan 2:13 Jezusin Perëndi?
6. Pse 3:5a është temë bazë për Palin?
7. A na mëson 3:5b doktrinën e ripërtërimit nga pagëzimi?

HYRJE PËR FILEMONIN

I. SHËNIME HYRËSE

- A. Ky libër është shembull i një letre personale, diçka e zakonshme në botën greko-romake të shekullit të parë. Mund të shkruhej e gjitha brenda një flete të vetme papirusi (shih dhe 3 Gjonit). Është e paqartë se kujt i drejtohet së pari: (1) Filemonit, (2) Apfisë dhe Arikipit (shih Kol. 4:17), apo (3) në njëfarë mënyre, gjithë kishës së tyre, që mblidhej në shtëpi.
- B. Kjo letër na hap një dritare për të kuptuar
 - 1. metodat pastorale të apostullit Pal
 - 2. kishat lokale të shekullit të parë (shih Rom. 16:5; 1 Kor. 10:19; Kol. 4:15)
- C. Krishterimi, tashmë, po ndryshonte përbërjen shoqërore të botës mesdhetare. Pengesat shoqërore ndaj ungjillit po binin (shih 1 Kor. 12:13; Gal. 3:28; Kol. 3:11).

II. AUTORI

- A. Natyra personale e letrës ka bindur shumicën e lexuesve (me një përjashtim, F. C. Baur) se autori i saj është apostulli Pal.
- B. Filemoni dhe Kolosianëve janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin:
 - 1. e njëjta origjinë
 - 2. të njëjtët njerëz japin përshëndetjet e tyre
 - 3. e njëjta përmbyllje
 - 4. Tikiku ishte ai që e çoi letrën e Kolosianëve dhe udhëtoi me Onesimin (shih Kol. 4:7, 9). Nëse Filemoni është shkruar nga Pali, edhe Kolosianëve duhet të jetë shkruar prej tij (gjë që është hedhur në dyshim nga shumë studiues të sotëm).
- C. Renditet ndër letrat e Palit, si nga heretiku i hershëm Markion (që erdhi në Romë rreth viteve 140' pas K.), ashtu dhe nga lista e librave kanonikë, Fragmenti Muratorian (shkruar në Romë rreth 180-200 pas K.).

III. DATA

- A. Data e kësaj letre lidhet me një nga burgosjet e Palit (Efes, Filipi, Cezare, ose Romë). Burgosja në Romë përputhet më mirë me të dhënat e librit të Veprave.
- B. Nëse pranojmë Romën si vendin e burgosjes së Palit, del pyetja: në ç'kohë u shkrua? Pali ishte në burg në fillim të viteve '60 dhe kjo përmendet në Veprat. Megjithatë, u lirua dhe shkroi letrat pastorale (1 dhe 2 Timoteut; Titit) dhe, pastaj, u arrestua sërish dhe u vra para 9 qershorit, 68 (vetëvrasja e Neronit). Hamendësimi më i mirë është se Kolosianëve, Efesianëve dhe Filemonit u shkruan gjatë burgosjes së parë të Palit, në fillim të viteve '60. Filipianëve mund të jetë shkruar nga mesi i viteve '60.
- C. Tikiku, së bashku me Onesimin, ndoshta i çuan letrat e Kolosianëve, Efesianëve dhe Filemonit në Azinë e Vogël. Më vonë (ndoshta, disa vite më vonë), Epafroditi, pasi u shërua nga sëmundja që kishte, e çoi letrën e Filipianëve në kishën e tij të vendlindjes.

D. Kronologji e mundshme e shkrimeve të Palit, sipas F. F. Bruce dhe Murray Harris, me disa përshtatje të vogla.

<u>Libri</u>	<u>Data</u>	<u>Vendi i shkrimit</u>	<u>Lidhja me Veprat</u>
1. Galatasve	48	Antiokia e Sirisë	14:28; 15:2
2. 1 Thesalonikasve	50	Korint	18:5
3. 2 Thesalonikasve	50	Korint	
4. 1 Korintasve	55	Efes	19:20
5. 2 Korintasve	56	Maqedoni	20:2
6. Romakëve	57	Korint	20:3
7-10. Letrat e Burgut			
Kolosianëve	fillim '60		
Efesianëve	fillim '60	Romë	
Filemonit	fillim 60'		
Filipianëve	fund 62-63		28:30-31
11-13. Udhëtimi i Katërt Misionar			
1 Timoteut	63 (ose më vonë, Maqedoni)		
Titit	63 (por përpara	Efes (?)	
2 Timoteut	64 (68 pas K.)	Romë	

IV. SHKASI PËR SHKRIMIN E LETRËS (personat e përmendur në letrën e Filemonit)

- A. Filemoni ishte një skllavopronar nga Kolosi. Ishte kthyer në besim nga Pali, ndoshta gjatë kohës kur Pali shërbente në Efes.
- B. Onesimi ishte skllav në arrati. Edhe ai u kthye në besim nga Pali, gjatë kohës kur ishte i burgosur në Romë (61-63 pas K.). Është e paqartë si u takuan. Ndoshta (1) ishin të dy të burgosur, (2) ose Onesimi ishte dërguar me një detyrë për Palin, ose (3) Onesimi e kërkoi Palin që t'i jepte këshilla pasi ndërroi mendje pas arratisë.
- C. Epafrai ishte besimtar nga Azia e Vogël dhe themelues i kishave në luginën e lumit Likus (Kolosi, Laodice dhe Hierapol). Ai i sollti Palit në burg lajme për herezinë në Kolos dhe për besnikërinë e Filemonit.
- D. Tikiku ishte ai që çoi tre letra të Palit në këtë zonë: Kolosianëve, Efesianëve dhe Filemonit (shih Kol. 4:7-9; Efe. 6:21-22). Edhe Onesimi u dërgua me Tikikun që të përballej me padronin e vet (shih v. 11). Filemoni është një nga dy letrat personale të ruajtura në Dhiatën e Re (shih 3 Gjonit).
Rreth pesëdhjetë vjet më vonë (110 pas K.), Ignati, gjatë rrugës për në Romë për t'u martirizuar, i shkroi një letër (*Drejtuar Efesianëve*, 1:3) peshkopit të Efesit, që quhej Onesim! Ky mund të ketë qenë skllavi i kthyer në besim!

V. QËLLIMI I LETRËS

- A. Tregon sesi e përdorte Pali autoritetin apostolik dhe si jepte inkurajime pastorale.
- B. Tregon sesi krishterimi i bënte skllavërit dhe skllavopronarët, të pasurit dhe të varfrit, vëllezër e motra me njëri-tjetrin! Me kalimin e kohës, kjo e vërtetë do ta ndryshonte me themel perandorinë romake.
- C. Tregon bindjen e Palit se do të lirohej nga burgosja në Romë dhe do të kthehej në Azinë e Vogël.

VI. FJALË DHE FRAZA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

1. “kishës në shtëpinë tuaj”, v. 2
2. Fëmija im, Onesimi, v. 10
3. I padobishëm... i dobishëm, v. 11
4. “ti më ke borxh dhe veten tënde”, v. 19

VII. PERSONA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

1. Apfia, v. 1
2. Onesimi, v. 10
3. Epafrai, v. 23
4. Marku, v. 24

VIII. VENDNDODHJE QË DUHEN GJETUR NË HARTË – S’KA

IX. PYETJE PËR DISKUTIM

1. Si e thekson Pali autoritetin e vet apostolik në 1:8?
2. Si ndikon ky libër i vogël në problemin e skllavërisë?
3. A nënkupton v. 18 se Onesimi i kishte vjedhur diçka të zotit?
4. A nënkupton v. 19 se Pali, normalisht, përdoret sekretar për shkrimin e letrave?

HYRJE PËR LETRËN DREJTUAR HEBRENJVE

I. POHIM I RËNDËSISHËM HYRËS

Sa më shumë e kam studiuar këtë letër, aq më qartë kam kuptuar se teologjia ime është formuar sipas kallëpit të teologjisë së Palit. E kam shumë të vështirë që t'i lejoj shumësisë së autorëve të tjerë të DHR që të paraqesin mendimet e tyre të frymëzuara për shkak se prirem t'i fus në kategori paliane. Kjo del në pah posaçërisht te theksi i Hebrenjve për vazhdimin në besim. Në letrën e Hebrenjve, besimi nuk është pozicion ligjor (shfajësimi me anë të besimit), por një jetë besnike deri në fund (kapitujt 11-12).

Mendoj se shumë prej pyetjeve me të cilat has vështirësi kur lexoj letrën e Hebrenjve nuk do t'i kishte bërë kurrë autori i saj (as Pjetri, as Jakobi). Hebrenjve është letër e shkruar për një situatë të caktuar, njësoj si gjithë letrat e tjera të DHR. Duhet që t'i lejojmë autorit të flasë edhe kur na vë në siklet; edhe kur nuk përdor kategoritë tona të preferuara, ose edhe kur i ndërpret ato kategori. Nuk guxoj që ta zëvendësoj mesazhin e frymëzuar të autorit të DHR me teologjinë time sistematike.

Parapëlqej që të pendohem për dogmatizmin tim teologjik dhe të jetoj brenda një tensioni të DHR që nuk e kuptoj plotësisht, ose që nuk më pëlqen! Druaj se, shpesh, e shoh DHR nëpërmjet filtrit të kornizës ungjillore moderne. Dua që të pohoj premtimet biblike; premtimet e dashurisë, furnizimit dhe fuqisë ruajtëse të Perëndisë; por edhe goditem nga paralajmërimet dhe urdhërimet e fuqishme të autorëve të DHR. Kam nevojë të dëshpërueshme që të dëgjojë letrën e Hebrenjve, por ajo është shumë e dhimbshme! Kështu, ndonjëherë, përpiqem ta justifikoj tensionin me logjikën time. E kuptoj se duhet të pohoj konceptin e shpëtimit falas dhe jetës së krishterë, që të kushton gjithçka. Po ku ta vendos kufirin kur ideali nuk përmbushet? Çfarë është bashkësia e përjetshme me Perëndinë: një përgjigje fillestare me besim, apo një përgjigje e vazhdueshme me besim? Hebrenjve pohon qartë domosdoshmërinë e përgjigjes së vazhdueshme me besim. Jeta e krishterë shihet nga fundi, jo nga fillimi!

Me këtë nuk po them se bëhet fjalë për shpëtim të orientuar nga veprat, por për vërtetim të orientuar nga veprat. Besimi është prova, jo mekanizmi (që është hiri). Besimtarët nuk shpëtohen nga veprat, por për vepra. Veprat nuk janë mjete shpëtimi, por rezultat i shpëtimit. Ngjashmëria e perëndishme, besnike dhe e përditshme me Krishtin nuk është diçka që bëjmë, por diçka që jemi në Krishtin. Nëse nuk shohim një jetë besimi të ndryshuar dhe në ndryshim, nuk ekziston asnjë provë apo siguri shpëtimi. Vetëm Perëndia e njeh zemrën dhe rrethanat e njeriut. Siguria e besimit ka si synim të shoqërojë jetën e besimit, jo të jetë thjesht një pohim fillestar teologjike që nuk ka lidhje me provat në mënyrën e jetesës.

Lutja ime është që t'i lejojmë këtij autori të frymëzuar të DHR që të flasë qartë dhe të mos e katandisim letrën e Hebrenjve në një shënim teologjik në fund të faqes, brenda një kuadri sistematik teologjik, qoftë ky kalvinist apo arminian.

II. SHËNIME HYRËSE

- A. Kjo letër përdor pasazhe të DHV me hermeneutikë rabinike për të komunikuar mesazhin e vet. Për të kuptuar qëllimin e autorit fillestar, ky libër duhet interpretuar në dritën e judaizmit rabinik të shekullit të parë, jo sipas mendimit perëndimor modern.
- B. Ky libër nis si predikim (pa përshëndetjet normale) dhe përmbillet si letër (përmbyllja tipike paliane në kapitullin 13). Ka gjasa që të ketë qenë predikim sinagoge i kthyer në letër. Autori e quan letrën e vet “fjalë nxitjeje” në 13:22. E njëjta frazë përdoret dhe në Veprat 13:15 për një predikim.
- C. Hebrenjve është komentari i mençur i besëlidhjes mozaike sipas Besëlidhjes së Re:
 1. pikëpamje shumë e autoritetshme e DHV
 2. krahasim i besëlidhjes së re me atë të vjetër
 3. i vetmi libër i DHR që e quan Jezusin Kryepriftin tonë
- D. Ky libër është plot me paralajmërime kundër shkarjes nga besimi (“zmbropsjes”, shih 10:38), ose rikthimit në judaizëm (pra, kapitujt 2, 4, 5, 6, 10, 12; shih *No Easy Salvation*, R. C. Glaze, Jr., botuar nga Insight Press).

- E. Megjithëse mbipërgjithësim, është mirë që Palin, me theksin e tij te shpëtimi si vepër e përmbushur e Perëndisë sovran (pra, shfajësimi me anë të besimit), ta shohim si personin që thekson sigurinë e shpëtimit si të vërtetë fillestare. Nga ana tjetër, Pjetri, Jakobi dhe letrat e 1 dhe 2 Gjonit theksojnë përgjegjësitë e vazhdueshme të Besëlidhjes së Re dhe theksojnë se siguria e besimit është diçka e përditshme, e vërtetuar nga jeta e ndryshuar dhe në ndryshim të vazhdueshëm. Autori i Hebrenjve, që thekson jetën besnike (shih kapitullin 11), fokusohet te siguria e besimit nga pikëvështrimi i fundit të jetës. Mendimi racional perëndimor priret që t'i polarizojë këto pikëvështrime, kurse shkruarit e DHR, që janë frymëzuar nga i njëjti autor hyjnor (pra, nga Fryma), i mbajnë në tension këto të vërteta dhe i pohojnë të tria. Siguria e shpëtimit nuk është kurrë synimi përfundimtar, por produkt dytësor, i besimit vepëruar që bazohet në premtimet e Perëndisë.

III. AUTORËSIA

- A. Ndonëse autorësia e Hebrenjve është e paqartë, disa vepra të hershme gnostike (p.sh., *Ungjilli i së vërtetës*, *Ungjilli i Filipit* dhe *Apokrifja e Gjonit*) e citojnë disa herë, gjë që tregon se konsiderohej si pjesë e shkrimeve të autoritetshme të krishtera në shekullin e dytë (shih Andrea Helmbold, *The Nag Hammadi Gnostic Texts and the Bible*, f. 91).
- B. Kisha lindore (Aleksandri, Egjipt) mendonte se ishte shkruar nga Pali, gjë që shihet nga vendosja e Hebrenjve në grupin e shkrimeve të Palit në dorëshkrimin e hershëm prej papiruri P⁴⁶. Ky dorëshkrim është pjesë e Papiruseve të Chester Beatty-t dhe u shkrua në fund të shekullit të dytë. Ai e vendos Hebrenjve pas Romakëve. Disa krerë aleksandrinë i pranonin problemet letrare që lidhen me autorësinë paliane.
1. Klementi i Aleksandrisë (150-215 pas K., i cituar nga Euzebi) thotë se Pali e shkroi letrën në hebraisht, pastaj Luka e përktheu në greqisht.
 2. Origeni (185-253 pas K.) thoshte se mendimet janë të Palit, por se letra u shkrua nga një ndjekës i mëvonshëm, si Luka ose Klementi i Romës.
- C. Kjo letër nuk gjendet në listën e letrave të Palit të pranuar nga kisha perëndimore, e quajtur Fragmenti Muratorian (një listë librash kanonikë të DHR, e shkruar në Romë rreth 180-200 pas K.).
- D. Çfarë dimë për autorin:
1. Me sa duket, ishte i krishterë jude i brezit të dytë (2:3).
 2. Citon nga përkthimi greqisht i DHV, i quajtur Septuagintë.
 3. Përdor ritualet e lashta të tabernakullit, jo ritualet e tempullit të shekullit të parë.
 4. Shkruan duke përdorur gramatikën dhe sintaksën e greqishtes klasike (kjo nuk është letër platonike. Orientimi i saj fokusohet te DHV, jo te Filoja).
- E. Kjo letër është anonime, por marrësit e saj e njohnin mirë autorin (shih 6:9-10; 10:34; 13:7, 9).
- F. Pse vihet në dyshim autorësia e Palit:
1. Stili i letrës ndryshon shumë (me përjashtim të kapitullit 13) nga shkrimet e tjera të Palit.
 2. Fjalori është i ndryshëm.
 3. Ekzistojnë dallime ngjyrimesh në përdorimin dhe theksimin e fjalëve dhe frazave të ndryshme.
 4. Kur Pali i quanë miqtë dhe bashkëpunëtorët e vet “vëlla”, emri i personit në fjalë vihet gjithmonë i pari (shih Rom. 16:23; 1 Kor. 1:1; 16:12; 2 Kor. 1:1; 2:13; Fil. 2:25), por Hebrenjve 13:23 shprehet, “vëllai ynë Timote”.
- G. Teoritë e ndryshme për autorësinë
1. Klementi i Aleksandrisë, në librin e vet *Hipotiposes* (cituar nga Euzebi) mendonte se Luka e përktheu në greqisht letrën origjinale të Palit, të shkruar në hebraisht (Luka përdori një greqishte të shkëlqyer *koine*).
 2. Origjeni thoshte se e shkroi, ose Luka, ose Klementi i Romës, por duke ndjekur mësimin e Palit.

3. Jeronimi dhe Augustini e pranonin autorësinë e Palit vetëm që të mundësonin pranimin e kësaj letre në kanonin e kishës perëndimore.
4. Tertuliani (*De Pudic.* 20) mendonte se e shkroi Barnaba (një levit që shoqëronte Palin).
5. Martin Luteri tha se e shkroi Apollo, një intelektual i edukuar në Aleksandri, i cili shoqërohej me Palin (shih Veprat 18:24).
6. Kalvini thoshte se autori ishte Klementi i Romës (i pari që e citoi më 96 pas K.), ose Luka.
7. Adolf von Harnak thoshte se e shkroi Akuila me Priskën (ata i mësuuan Apollos ungjillin e plotë dhe shoqëroheshin me Palin dhe Timoteun, shih Veprat 18:26).
8. Sër Uilliam Ramsi mendonte se e shkroi Filipi (ungjilltari) për Palin, ndërkohë që Pali ishte në burg në Cezare.
9. Të tjerë kanë thënë se e shkroi Filipi ose Sila (Silvani).

IV. MARRËSIT

- A. Titulli “Hebrenjve” u drejtohet hebrenjve; prandaj, kjo letër iu shkrua gjithë judenjve (shih Klementin e Aleksandrisë, cituar nga Euzebi, *Hist. Kish.*, VI, 14).
- B. Provat e brendshme, sipas R. C. Glaze, Jr., *No Easy Salvation*, të japin idenë se letra i drejtohet një grupi të caktuar judenjsh besimtarë, ose një sinagoge (shih 6:10; 10:32-34; 12:4; 13:7, 19, 23).
 1. Duket se janë besimtarë judenj për shkak të citimeve të shumta nga DHV dhe temës së letrës (shih 3:1; 4:14-16; 6:9; 10:34; 13:1-25).
 2. Kishin kaluar njëfarë përndjekjeje (shih 10:32; 12:4). Judaizmi pranohej si fe e ligjshme nga autoritetet romake ndërsa, më vonë gjatë shekullit të parë, krishterimi u konsiderua i paligjshëm kur u veçua nga adhurimi në sinagogë.
 3. Kishin qenë besimtarë prej një kohe të gjatë, por ishin ende të papjekur (shih 5:11-14). Druheshin që të ndaheshin plotësisht prej judaizmit (shih 6:1-2).
- C. Teksti i paqartë i 13:24 ndoshta nënkupton se u shkrua (1) nga Italia, ose (2) për një grup judenjsh në Itali, ndoshta në Romë
- D. Vendndodhja e marrësve të letrës lidhet me teoritë e ndryshme për autorësinë.
 1. Aleksandria – Apollo
 2. Antiokia – Barnaba
 3. Cezarea – Luka ose Filipi
 4. Roma – Klementi i Romës dhe përmendja e Italisë në 13:24.
 5. Spanja – Kjo është teoria e Nikolës së Lirës (1270-1340 pas K.)

V. DATA

- A. Pak para shkatërrimit të Jerusalemit nga gjenerali romak (më vonë, perandori) Titi, më 70 pas K.
 1. Autori përmend me emër shoqëruesin e Palit, Timoteun (shih 13:23)
 2. Autori përmend faktin se flijimet vazhdonin (shih 8:13; 10:1-2) në tempull
 3. Autori përmend përndjekjen, gjë që mund të përputhet me kohën e Neronit (54-68 pas K.)
 4. Autori inkurajon lexuesit që të mos kthehen te judaizmi dhe ritualet e tij
- B. Pas 70 pas K.
 1. Autori përdor ritualet e tabernakullit, jo tempullit të Herodit
 2. Autori përmend përndjekjet
 - a. Ndoshta, në kohën e Neronit (shih 10:32-34)
 - b. Më vonë, ndoshta gjatë kohës së Domicianit (shih 12:4-13)
 3. Libri ndoshta bën fjalë për ripërtëritjen e judaizmit rabinik (shkrimet e Javnes), vonë në shekullin e parë
- C. Përpara vitit 95 pas K; Hebrenjve citohet nga Klementi i Romës.

VI. QËLLIMI

- A. Të krishterët judenj inkurajohen që ta lënë sinagogën dhe të identifikohen publikisht (plotësisht) me kishën (shih 13:13).
- B. Të krishterët judenj inkurajohen që të marrin përsipër porosinë misionare të ungjillizimit (shih Mat. 28:19-20; Veprat 1:8).
- C. Jobsimtarët judenj, që kishin bashkësi me këta të krishterët judenj, janë fokusi i kapitujve 6 dhe 10. Vini re praninë e tri grupeve: “ne”, “ju”, dhe “ata”. Ata paralajmërohen që t’u përgjigjen personalisht fakteve të shumta dhe të qarta në jetën e miqve dhe bashkëadhuruesve të tyre të krishterë.

D. Ky rindërtim i supozuar historik është marrë nga *No Easy Salvation* nga R. C. Glaze, Jr.

“Problemi nuk ishte tensioni mes shumicës së krishterë dhe pakicës jo të krishterë. E kundërta ishte e vërtetë. Të krishterët judenj të kësaj bashkësie e kishin komprometuar kaq shumë besimin dhe ndjenjën e shërbëtarisë sa që të dyja grupet adhurorin së bashku Zotin në një bashkësi të vetme. Asnjëri grup nuk e shqetësonte seriozisht ndërgjegjen e tjetrit. Predikimi i grupimit të krishterë nuk çonte më në bindje dhe vendim nga ana e anëtarëve të pashpëtuar të sinagogës. Të krishterët ishin në një gjendje plogështie për shkak se nuk pranonin të zbatonin kërkesat e plota të jetesës kurajoze të krishterë. Jobsimtarët ishin ngurtësuar nga refuzimi i vazhdueshëm i ungjillit, deri në pikën ku ishin bërë indiferentë. Këto grupe ishin bërë partnerë që shkonin mirë me njëri-tjetrin.

Mospranimi i grupit të krishterë që të “ecnin drejt përsosmërisë” (6:1) motivohej nga dy fenomene: respekti i madh për traditat e judaizmit dhe mosdëshira për të paguar çmimin e identifikimit të plotë me krishterimin, i cili po kthehej gjithnjë e më shumë në një lëvizje johebraike” (f. 23).

VII. PËRVIJIM I SHKURTËR I HEBRENJVE

1:1-3	Epërsia e Birit mbi profetët
1:4-2:18	Epërsia e Birit mbi engjëjt
3:1-4:13	Epërsia e Birit mbi ligjin e Moisiut
4:14-5:10; 6:13-7:28	Epërsia e Birit mbi priftërinë aronike
5:11-6:12	Epërsia e judenjve besimtarë mbi judenj të jobsimtarë
8:1-10:18	Epërsia e Birit mbi procedurat e ligjit të Moisiut
10:19-13:25	Epërsia e Birit zbulohet në besimtarët dhe mbrohet prej tyre

VIII. FJALË DHE FRAZA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

1. “në këto ditë të fundit”, 1:2
2. “shkëlqimi i lavdisë së tij”, 1:3
3. “përfaqësim i saktë i natyrës së tij”, 1:3
4. Madhështia, 1:3
5. “që të mos rrëshkasim prej tij”, 2:1
6. “fjala e folur përmes engjëjve”, 2:2
7. “duhet të shijonte vdekjen për të gjithë”, 2:9
8. “autori i përsosur i shpëtimit”, 2:10
9. “kryeprift”, 2:17; 4:15
10. Pajtimi, 2:17
11. Apostull, 3:1
12. Kryeprifti, 3:1
13. Rrëfimi, 3:1; 4:14
14. Sot, 3:13
15. “dita e shtatë”, 4:4
16. “pushimi i sabbatit”, 4⊕
17. “kaloi përmes qiejve”, 4:14

18. “por pa mëkat”, 4:15
19. “le t’i afrohemi”, 4:16
20. “parimet elementare”, 5:12
21. Larjet, 6:2
22. “premtimi”, 6:15
23. “perdja”, 6:19
24. “Jezusi është bërë garancia e një besëlidhjeje më të mirë”, 7:22
25. Ndërmjetësim, 7:25
26. Tabernakull, 8:2
27. “kopje dhe hije e gjërave qiellore”, 8:5
28. “besëlidhje e re”, 8:8, 13
29. “Shenjtërorja e shenjtëroreve”, 9:3
30. Shkopi i Aronit, 9:4
31. Pajtimorja, 9:5
32. “re kaq e madhe dëshmitarësh”, 12:1
33. “rrënjë hidhësie”, 12:15
34. “Jerusalemi qiellor”, 12:22

IX. PERSONA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

1. “i parëlinduri”, 1:6
2. “atij që kishte pushtetin e vdekjes”, 2:14
3. “të cilët e provkuan”, 3:16
4. Melkicedek, 5:6
5. Përmenden tre grupe në 5:11-6:8; “you”, “ata” dhe “ne”. Për kë bëhet fjalë?
6. Kerubinët, 9:5
7. Enok, 11:5
8. Rahaba, 11:31
9. “Bariu i madh”, 13:20
10. Timote, 13:23

X. VENDNDODHJE QË DUHEN GJETUR NË HARTË

1. Salem, 7:1
2. Jeriko, 11:30
3. Mali Sion, 12:22
4. Itali, 13:24

XI. PYETJE PËR DISKUTIM

1. Rendit aspektet e “birit”, të përmendura në 1:2-4.
2. Pse përmenden kaq shpesh engjëjt në kapitujt e parë të Hebrenjve?
3. Ç’lidhje kanë engjëjt me besimtarët? (1:14)
4. Si u bë Jezusi pak më i ulët se engjëjt? (2:9)
5. Cilat është e vërteta madhështore e 2:18; 4:15?
6. Si krahasohet Moisiu me Jezusin në 3:1-6?
7. Çfarë nënkupton 3:7 për Frymën?
8. Për çfarë bën fjalë 3:12?
9. Ç’kuptim ka shprehja “nuk do të hyjnë në pushimin tim” në 3:11?
10. Çfarë thotë 3:14 për sigurinë e të krishterit?
11. Shpjego 4:12 me fjalët e tua.
12. Pse e përmend autori priftin e lashtë kanaanit, Melkicedekun? (5:6-10)
13. Shpjego domethënien e 5:8-9.
14. Rendit doktrinën e 6:1-2. Janë mësimë judaike, apo të krishtera? Pse?

15. Pse fjala “e pamundur” në 6:6 kundërshton mendimin e atyre që besojnë se njeriu mund të shpëtohet, pastaj të humbasë, dhe pastaj të shpëtohet prapë?
16. Pse na thuhet se Melkicedeku ishte pa atë dhe pa nënë? (7:3)
17. Pse është e rëndësishme që Abrahami i dha të dhjetat Melkicedekut? (7:4-10)
18. Çfarë na thotë 8:13 dhe 10:4 për DHV?
19. Si e hedh poshtë 9:22 hinduizmin?
20. Si lidhet 10:25, 35 me kontekstin historik?
21. Si lidhet kapitulli 6 me kapitullin 10?
22. Përmbli dh kapitullin 11 me fjalët e tua.
23. Për çfarë bën fjalë 12:2?
24. Pse është kaq i rëndësishëm 13:8?

HYRJE PËR LETRËN E JAKOBIT

I. SHËNIME HYRËSE

- A. Ishte libri i parapëlqyer i Soren Kirkegardit në Dhiatën e Re për shkak se thekson krishterimin praktik dhe të përditshëm.
- B. Ishte libri më pak i pëlqyer i Martin Luterit në Dhiatën e Re për shkak se duket sikur bie ndesh me theksimin e “shfajësimit me anë të besimit” nga ana e Palit në Romakëve dhe Galatasve.
- C. Është gjini shumë e ndryshme letrare nga librat e tjerë të DHR
 - 1. Duket së tepërmi si versioni i Fjalëve të Urta (pra, letërsi urtësie) në besëlidhjen e re, e shprehur nga një profet i flaktë
 - 2. Qartazi, u shkrua pak kohë pas vdekjes së Jezusit dhe është ende tejet judaike dhe praktike

II. AUTORI

- A. Sipas traditës, autori është Jakobi (hebraisht, *Jakov*), gjysmëvëllai i Jezusit (një nga katër të tillë, shih Mat. 13:55; Marku 6:3; Veprat 1:14; 12:17; Gal. 1:19). Ishte udhëheqësi i kishës së Jerusalemit (48-62 pas K; shih Veprat 15:13-21; Gal. 2:9).
 - 1. Quhet “i Drejti Jakob” dhe, më vonë, u quajt “Gju-gamile” për shkak se lutej vazhdimisht në gjuhë (sipas Hegesipit, i cituar nga Euzebi).
 - 2. Jakobi besoi vetëm pas ringjalljes (shih Marku 3:21; Gjoni 7:5). Jezusi iu shfaq personalisht pas ringjalljes (shih 1 Kor. 15:7).
 - 3. Ishte i pranishëm në dhomën e sipërme bashkë me dishepujt (shih Veprat 1:14) dhe, ndoshta, ishte i pranishëm aty dhe kur zbriti Fryma në ditën e Rrëshajëve.
 - 4. Ishte i martuar (shih 1 Kor. 9:5).
 - 5. Pali e përmend si shtyllë të kishës (ndoshta, si apostull, shih Gal. 1:19), por nuk ishte ndër të Dymbëdhjetët (shih Gal. 2:9; Veprat 12:17; 15:13 e më tej).
 - 6. Në *Lashtësitë e judenjve*, 20:9:1, Jozefusi thotë se Jakobi u vra me gurë më 62 pas K., me urdhër të saducenjve të Sinedrit, ndërsa një traditë tjetër (sipsa shkruesve të shekullit të dytë, Klementit të Aleksandrisë ose Hegesipit) thotë se e hodhën nga muri i tempullit.
 - 7. Për shumë breza pas vdekjes së Jezusit, drejtues i kishës së Jerusalemit zgjidhej një i afërm i Jezusit.
- B. Në *Studies in the Epistle of James*, A. T. Robertson pohon autorësinë e Jakobit:

“Ka shumë prova se letrën e shkroi autori i fjalimit në Veprat 15:13-21—përmban ngjashmëri mendimi dhe stili, që janë tepër të holla për t’u imituar apo kopjuar lehtësisht. E njëjta ngjashmëri shfaqet dhe mes letrës së Jakobit dhe letrës drejtuar Antiokisë, që ndoshta u shkrua nga Jakobi (Veprat 15:23-29). Përveç kësaj, ka ngjashmëri të dukshme me Predikimn në Mal, që Jakobi mund ta ketë dëgjuar personalisht, ose të paktën mund të ketë dëgjuar një përmbledhje të saj. Letra përmban të njëjtën gjallëri figurash letrare që karakterizonte dhe mësimet e Jezusit” (f. 2).

A.T. Robertson këtu ndjek mendimin e J. B. Mayor, *The Epistle of St. James*, f. iii-iv.
- C. Ka dy burra të tjerë që quheshin Jakob në grupin e apostujve në DHR. Mirëpo Jakobi, vëllai i Gjonit, u vra herët në vitin 44 pas K. nga Herod Agripa I (shih Veprat 12:1-2). Jakobi tjetër, “i pakti”, ose “i riu” (shih Marku 15:40), nuk përmendet kurrë jashtë listës së apostujve. Autori i letrës së Jakobit, me sa duket, ishte i mirënjohur.
- D. Ka tre teori për marrëdhënien e Jezusit me Jakobin:
 - 1. Jeronimi mendonte se ishte kushëri me Jezusin (djali i Alfeut dhe Marisë së Klopës). Këtë përfundim e arriti duke krahasuar Mat. 27:56 me Gjoni 19:25.
 - 2. Tradita katolike e Romës shprehet se ishte gjysmëvëlla i Jezusit nga një martësë e mëparshme e Jozefit (shih komentet e Origenit në Mat. 13:55 dhe Epifanit në *Herezitë*, 78).

3. Tertuliani (160-220), Helvidi (366-384 pas K.) dhe shumica e protestantëve mendojnë se ishte gjysmëvëlla i vërtetë i Jezusit pasi ishte djalë i Jozefit dhe Marisë (shih Marku 6:3; 1 Kor. 9:5).
4. Mundësitë #1 dhe #2 u formuan për të mbrojtur doktrinën katolike për virgjërinë e përgjeshme të Marisë.

III. DATA

- A. Nëse pranohet autorësia e mësipërme, ka dy data të mundshme:
 1. Herët, përpara këshillit të Jerusalemit (Veprat 15) më 49 pas K. (nëse kjo datë është e saktë, atëherë Jakobi është libri më i herët i DHR në qarkullim).
 2. Më vonë, pak para vdekjes së Jakobit më 62 pas K.
- B. Data e hershme ka në favor të vet këto argumente:
 1. Përdorimi i fjalës “sinagogë” në 2:2
 2. Mungesa e organizimit kishtar
 3. Përdorimi i fjalës “plak” në kuptimin judaik në 5:14
 4. Mospërmendja e debatit për misionin ndër johebrenjtë (shih Veprat 15)
 5. Jakobi duket se po u shkruan komuniteteve të hershme me besimtarë judenj, që ishin larguar nga Jerusalemit dhe, ndoshta, Palestina (shih 1:1)
- C. Data e mëvonshme ka në favor të vet këto argumente:
 1. Reagimi i mundshëm i Jakobit (shih 2:14-20) ndaj letrës së Palit drejtuar Romakëve (shih 4:1 e më tej); Jakobi shfaq qasjen e kundërt me qëllim që të korrigjojë përdorimin e gabuar që i bënin heretikët kësaj letre (shih 2 Pje. 3:15-16). Nëse kjo është e vërtetë, një titull i mirë për Jakobin do të ishte “korrigjim në mes të rrugës”.
 2. Me sa duket, ky libër i merr si të mirëqena doktrinën bazë të krishterimit, pasi ato nuk përmenden asnjëherë shkoqur në të.

IV. MARRËSIT

- A. Përmendja e “dymbëdhjetë fiseve, që janë shpërndarë në mbarë botën” (1:1) është aludim i rëndësishëm. Po kështu, përfshirja e letrës ndër “letrat katolike” (pra, letrat që u drejtohen disa kishave në të njëjtën kohë) pasqyron natyrën e saj si letër qarkore. Me sa duket, nuk bëhet fjalë për një kishë, por për një grup të caktuar prej individësh të shpërndarë në botë, dhe këta duket se ishin të krishterë judenj që jetonin jashtë Palestinës.
- B. Frazja e 1:1 ka tri interpretime të mundshme:
 1. Judenj. Kjo duket e pagjasë për shkak se përdoret vazhdimisht fjala “vëllezër”, mospërmendja e të vërtetave kryesore të ungjillit për Jezusin, si dhe për shkak se besimi në Krishtin përmendet qartë në 2:1. Po kështu, pas robërisë në Babiloni, shumë prej dymbëdhjetë fiseve të Izraelit nuk u kthyen kurrë në Izrael. E njëjta metafore përdoret simbolikisht dhe për besimtarët në Zbu. 7:4-8.
 2. Judenj të krishterë. Kjo duket më e mundshme për shkak se libri përmban një ngjyrim judaik, si dhe për shkak se Jakobi kishte pozitë udhëheqëse në kishën e Jerusalemit.
 3. Kisha si Izrael shpirtëror. Kjo është e mundshme për shkak se fjala “diasporë/shpërndarje” përmendet në 1 Pje. 1:1 dhe në aludimet e Palit për kishën (judenjtë dhe johebrenjtë e krishterë) si Izraeli shpirtëror (shih Rom. 2:28-29; 4:16 e më tej; Gal. 3:29; 6:16; 1 Pje. 2:5, 9).

V. SHKASI – Ka dy teori kryesore:

- A. Është përpjekje për ta zbatuar Besëlidhjen e Re në mënyrë të veçantë për jetën e të krishterëve judenj të shekullit të parë, që jetonin në kontekste pagane.

- B. Disa mendojnë se bëhet fjalë për disa judenj të pasur që përndiqnin judenjtë e krishterë. Po kështu, ka mundësi që të krishterët e hershëm ishin bërë objekt sharjes nga paganët antisemitë. Qartazi, kjo ishte një periudhë nevojash fizike dhe përndjekjesh (shih 1:2-4, 12; 2:6-7; 5:4-11, 13-14).

VI. GJINIA LETRARE

- A. Kjo letër/ky predikim tregon njohjen e letërsisë së urtësisë, si kanonike (Jobi-Kënga e Këngëve) ashtu dhe ndërbiblike (*Ekleziasti*, rreth 180 para K.). Theksi vihet te jetesa praktike: besimi në veprim (shih 1:3-4).
- B. Në disa mënyra, stili i letrës ngjason së tepërmi me mësuesit e urtësisë judaike, por edhe me mësuesit moralë shëtitës, qofshin grekë ose romakë, si stoikët. Disa shembuj:
1. strukturë e lirshme (kalimi nga një temë në tjetrën)
 2. shumë forma urdhërore (54 të tilla)
 3. diatribe (një kundërshtues i supozuar shtron pyetje, shih 2:18; 4:13). Kjo shihet dhe te Malakia, Romakëve dhe 1 Gjonit.
- C. Ndonëse ka vetëm disa citime të drejtpërdrejta nga DHV (shih 1:11; 2:8, 11, 23; 4:6), ky libër, ashtu si dhe Zbulesa, përmban shumë aludime nga DHV.
- D. Përvijimi i Jakobit është pothuajse më i gjatë se vetë letra. Kjo pasqyron teknikën rabinike të kalimit nga njëra temë në tjetrën me qëllim që të ruajë vëmendjen e dëgjuesve. Rabinët e quanin “gjerdan perlash”.
- E. Jakobi duket se përbën një kombinim gjinish të ndryshme letrare të DHV: (1) të urtët (mësuesit e urtësisë) dhe (2) profetët (si Amosi ose Jeremia). Ai përdor të vërteta nga DHV, por i vesh me mësimet e Jezusit nga Predikimi në Mal. (Shih pjesën B, nën “Përmbajtja” më poshtë).

VII. PËRMBAJTJA

- A. Jakobi përdor më shumë aludime për fjalët e Jezusit, që gjenden në ungjijtë sinoptikë, sesa librat e tjerë të DHR (shih 1:5, 6, 22; 2:5, 8, 13; 3:12, 18; 4:10, 12; 5:12). Madje, ka gjasa që Jakobi përmban dhe citime nga Jezusi (shih 1:27; 2:13; 3:18; 4:11-12, 17).

- B. Jakobi të kujton Predikimin në Mal.

JAKOBI

1:2
1:4
1:5
1:12
1:20
1:22-25
2:5
2:8
2:13
3:6
3:12
3:18
4:4
4:11-12
4:13
5:2
5:10-11
5:12

PREDIKIMI NË MAL

Mat. 5:1-2
Mat. 5:48
Mat. 7:7 (21:26)
Mat. 5:3-11
Mat. 5:22
Mat. 7:24-27
Mat. 5:3 (25:34)
Mat. 5:43; 7:12
Mat. 5:7 (6:14-15; 18:32-35)
Mat. 5:22, 29, 30
Mat. 7:16
Mat. 5:9; 7:16-17
Mat. 6:24
Mat. 7:1
Mat. 6:34
Mat. 6:19-20
Mat. 5:12
Mat. 5:34-37

- C. Kjo letër përbën një teologji të zbatuar (besimi pa vepra është i vdekur). Nga 108 vargje, 54 prej tyre përmbajnë folje në formën urdhërore.

VIII. KANONIZIMI

A. Përfshirja e Jakobit u krye vonë dhe hasi në vështirësi.

1. Jakobi nuk jepet në listën kanonike të shkruar në Romë rreth 200 pas K., të quajtur “Fragmenti Muratorian”.
2. Nuk ishte në listën kanonike të Afrikës së Veriut, 360 pas K., të quajtur “Lista e Çeltenhamit” (ose, katalogu i Karl Mommsen).
3. Nuk u përfshi në versionin e vjetër latinisht të DHR.
4. Euzebi e rendit ndër librat e debatuar (Hebrenjve, Jakobi, 2 Pjetrit, 2 dhe 3 Gjonit, Juda dhe Zbulesa), *Hist. Kish.* II:23;24-24; III:25:3.
5. Kisha perëndimore e pranoi vetëm në shekullin e katërt; nuk dokumentohet as në kishën lindore deri në kohën e rishikimit të përkthimit siriak të shekullit të pestë, që quhet Peshita.
6. Teodori i Mopsuestias (392-428 pas K.) e hodhi poshtë; ai ishte kreu i shkollës antiokase të interpretimit biblik (i hodhi poshtë të gjitha letrat katolike).
7. Erazmi shprehu dyshimet e veta; të njëjtën gjë bëri dhe Martin Luteri, që e quajti “letër prej kashte” pasi mendonte se Jakobi binte në kundërshtim me theksimin e “shfajësimit me anë të besimit” në letrat e Romakëve dhe Galatasve.

B. Të dhëna për vërtetësinë e Jakobit:

1. U përfshi në shkrimet e Klementit të Romës (95 pas K.) dhe, më vonë gjatë shekullit të dytë, përmendet nga Ignati, Polikarpi, Justin Martiri dhe Ireneu.
2. Aludohet në shkrimin e krishterë jokanonik, por të mirënjohur, *Bariu i Hermës*, shkruar rreth 130 pas K.
3. Citohet drejtpërdrejt nga Origeni (185-245 pas K.) në komentarin e tij për Gjonin, IXI:23.
4. Në *Hist. Kish.* 2:23, Euzebi e rendit ndër librat “e debatuar”, por shton se shumica e kishave e kishin pranuar.
5. Përfshihet në rishikimin e përkthimit siriak të vitit 412 pas K. (që quhet Peshita).
6. Origeni dhe Gjoni i Damaskut në lindje, si dhe Jeromi me Augustinin në perëndim, e përkrahën përfshirjen e kësaj letre në kanon. Mori status zyrtar kanonik në Këshillin e Hipos, 393 pas K., atë të Kartagenës, 397 pas K., dhe sërish më 419 pas K.
7. Pranohej nga Gojarti (345-407 pas K.) dhe Theodoret (393-457 pas K.), të dy drejtues të shkollës antiokase të interpretimit biblik.

IX. FJALË DHE FRAZA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

1. “dymbëdhjetë fiset”, 1:1
2. Të shpërndarë, 1:1
3. “konsiderojeni”, 1:2
4. Aprovuar, 1:12
5. Kurorën e jetës, 1:12
6. “asnjë ndryshim hijeje”, 1:17
7. “bërësit e fjalës”, 1:22
8. Ligji i përsosur, 1:25
9. “edhe demonët besojnë”, 2:19
10. “gjykim më të rreptë”, 3:1
11. Ferr, 3:6
12. “mos u betoni për qiellin ose për tokën”, 5:12
13. Vajosja, 5:14
14. “rrëfejëni mëkatet njëri-tjetrit”, 5:16

X. PERSONA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

1. “njeriu me dy mendje”, 1:8
2. “Ati i dritave”, 1:17
3. Rahaba, 2:25
4. “Zoti i Sabaotit”, 5:4
5. Jobi, 5:11
6. Pleqtë, 5:14
7. Elijahu, 5:17

XI. VENDNDODHJE QË DUHEN VENDOSUR NË HARTË – ASNJË

XII. PYETJE PËR DISKUTIM

1. Si mund të jetë i vërtetë vargu 1:2?
2. Si kufizohet lutja? (1:5-8; 4:1-5)
3. Si e përmbys 1:9-11 pritshmërinë e rolit kulturor?
4. Si krahasohet 1:13 me Mat. 6:13?
5. Në ç’mënyrë është 1:22 tema e letrës?
6. Për çfarë bën fjalë 2:1-7: për një kontekst adhurimi, apo gjyqi kishtar? Pse?
7. Për çfarë ngjarje në jetën e krishterë bën fjalë 2:7?
8. Pse është e vërtetë e rëndësishme 2:10?
9. Pse ka shkaktuar kaq konflikte në kishë vargu 2:17? (shih 2:20)
10. Si e përdorin Pali dhe Jakobi Abrahamin si shembull, por në mënyra të ndryshme? (2:18-26)
11. Shpjego me fjalët e tua identë kryesore të 3:1-5.
12. Përshkruaj dallimin mes urtësisë së botës dhe asaj të Perëndisë. (3:15-17)
13. Pse është e vështirë të interpretohet 4:5?
14. Pse duhet t’i ketë habitur besimtarët judenj pasazhi 5:1-6?

HYRJE PËR 1 PJETRIN

I. AUTORËSIA

A. Të dhënat e brendshme për autorësinë e apostullit Pjetër

1. e shprehur qartë te 1 Pje. 1:1
2. aludime për fjalët dhe përjetimet e jetës së Jezusit me të Dymbëdhjetët
 - a. shembuj të marrë nga E. G. Selëyn, *The First Epistle of St. Peter*, 1946
 - (1) 1 Pje. 1:3 – Gjoni 21:27
 - (2) 1 Pje. 1:7-9 – Luka 22:31; Marku 8:29
 - (3) 1 Pje. 1:10-12 – Luka 24:25 e më tej; Veprat 15:14 e më tej
 - (4) 1 Pje. 3:15 – Marku 14:29, 71
 - (5) 1 Pje. 5:2 – Gjoni 21:15 e më tej
 - b. shembuj të marrë nga Alan Stibbs, *The First General Epistle of Peter*, 1971
 - (1) 1 Pje. 1:16 – Mat. 5:48
 - (2) 1 Pje. 1:17 – Mat. 22:16
 - (3) 1 Pje. 1:18 – Marku 10:45
 - (4) 1 Pje. 1:22 – Gjoni 15:12
 - (5) 1 Pje. 2:4 – Mat. 21:42 e më tej
 - (6) 1 Pje. 2:19 – Luka 6:32; Mat. 5:39
 - (7) 1 Pje. 3:9 – Mat. 5:39
 - (8) 1 Pje. 3:14 – Mat. 5:10
 - (9) 1 Pje. 3:16 – Mat. 5:44; Luka 6:28
 - (10) 1 Pje. 3:20 – Mat. 24:37-38
 - (11) 1 Pje. 4:11 – Mat. 5:16
 - (12) 1 Pje. 4:13 – Mat. 5:10 e më tej
 - (13) 1 Pje. 4:18 – Mat. 24:22
 - (14) 1 Pje. 5:3 – Mat. 20:25
 - (15) 1 Pje. 5:7 – Mat. 6:25 e më tej
3. fjalë dhe fraza të ngjashme me predikimet e Pjetrit në Veprat
 - a. 1 Pje. 1:20 – Veprat 2:23
 - b. 1 Pje. 2:7-8 – Veprat 4:10-11
 - c. 1 Pje. 2:24 – Veprat 5:30; 10:39 (sidomos përdorimi i fjalës greke *ksilon* për kryqin)
 - d. 1 Pje. 4:5 – Veprat 10:45
4. krahasime me misionarë të tjerë të shekullit të parë
 - a. Silvani (Sila) – 1 Pje. 5:12
 - b. Marku (Gjon Marku) – 1 Pje. 5:13.

B. Të dhënat e jashtme për autorësinë e apostullit Pjetër

1. e pranuar herët dhe gjerësisht nga kisha e hershme
 - a. fraza të ngjashme, ndoshta citime, nga Klementi i Romës në *Letrën drejtuar korintasve* (rreth 95 pas K.)
 - b. fraza të ngjashme, ndoshta citime, në *Letrën e Barnabës* (130 pas K.)
 - c. aludim nga Papia, peshkopi i Hieropolit (140 pas K.) në një citim nga libri i Euzebit *Historia e Kishës*
 - d. cituar nga Polikarpi në *Letrën drejtuar filipianëve* 8:1, por ai nuk e përmend 1 Pjetrin me emër (Polikarpi vdiq më 155 pas K.)
 - e. cituar nga Ireneu (140-203 pas K.)
 - f. cituar nga Origeni (185-253 pas K.). Origeni besonte se 1 Pje. 5:13, ku Pjetri e thërret Markun “biri im”, nënkupton se ai shkroi ungujillin e Pjetrit.
 - g. cituar nga Tertuliani (150-222 pas K.)

- C. Arsye për vënien në dyshim të autorësisë së apostullit Pjetër
1. nuk renditet në Fragmentin Muratorian, një listë me libra kanonikë e përpiluar në Romë mes viteve 180-200 pas K.
 2. greqishtja e letrës është e mirë, madje greqishte *koine* elegante, që është e habitshme për një peshkatar galileas (të paarsimuar) (*agrammatos*, shih Veprat 4:13)
 3. ngjason së tepërmi me shkrimet e Palit në Romakëve dhe Efesianëve
 4. përshkrimi i përndjekjes të 1 Pjetrit përputhet më mirë me një datë më të vonët
 - a. Domiciani (81-96 pas K.)
 - b. Trajani (98-117 pas K.)
- D. Përgjigje të mundshme për preokupimet e studiuesve të sotëm
1. Fragmenti Muratorian është i dëmtuar dhe mungon me të paktën një rresht (shih B. F. Eestcott, *A General Survey of the History of the Canon of the New Testament*, bot. 6, f. 289).
 2. Pjetri nuk ishte i paarsimuar (shih Veprat 4:13), por thjesht i paedukuar në një shkollë të pranuar rabinike. Me sa dihet, shumica e judenjve në Galile ishin dygjuhësh që nga lindja. Problemi tjetër madhor në këtë diskutim është përdorimi i një letërshkruesi nga Pjetri. Fjalët e 1 Pje. 5:12 nënkuptojnë se ai mund të ketë përdorur Silvanin (Silën).
 3. Si Pjetri, ashtu dhe Pali, citonin shpesh materiale liturgjike ose edukative (dokumente katekizmi) që njiheshin në kishën e hershme. Po kështu, patën kontakt me njëri-tjetrin gjatë viteve (shih Veprat, Galatasve dhe 2 Pje. 3:15-16).
Për mua, arsyeja më e mundshme për ngjashmërinë mes shkrimeve të Pjetrit dhe Palit është fakti se Pjetri mund të ketë përdorur si letërshkrues Silën (Silvanin), shoqëruesin misionar të Palit.
 4. 1 Pjetrit nuk reflekton medoemos një përndjekje në mbarë perandorinë romake. Fakti se Pjetri do që besimtarët t'i nënshtrohen qeverisë (1 Pje. 2:13-17) do të ishte diçka e pazakontë në kohën e përndjekjes zyrtare të të krishterëve në mbarë perandorinë.
Sëmundja mendore në rritje (pra, pretendimet megalomaniake) e Neronit (54-68 pas K.) nxiti kultet lokale të perandorit, sidomos në Azinë e Vogël, gjë që nxiti dhe përndjekjet lokale. 1 Pjetrit përputhet më mirë me kohën e Neronit sesa me atë të Domicianit (81-96 pas K.) apo të Trajanit (98-117 pas K.). Madje, ka mundësi që një pjesë e përndjekjeve të ketë ardhur nga grupimet judaike, jo vetëm nga zyrtarët e qeverisjes lokale apo kultet perandorake.
- E. 1 Pjetri vetë nuk përmban asgjë që të kërkojë një periudhë ose autor të mëvonshëm.

II. DATA

- A. Data lidhet qartazi me autorësinë e letrës.
- B. Tradita i lidh vdekjet e Pjetrit dhe Palit në Romë me kohën e Neronit, ndoshta rreth 65 pas K. Nëse është kështu, 1 Pjetri duhet të jetë shkruar rreth vitit 63-64 pas K.
- C. Një datim i mesit të shekullit të parë është i mundshëm nëse 1 Pjetri aludohet nga Klementi i Romës (shih 95 pas K.).
- D. A. T. Robertson beson se Pjetri vdiq më 67-68 pas K. dhe se e shkroi 1 Pjetrit më 65-66 pas K. Unë mendoj se ai vdiq më 64-65 pas K. dhe se letrën e shkroi pak para vdekjes.

III. MARRËSIT E LETRËS

- A. Siç ndodh rëndom në letrat e shekullit të parë, marrësit përmenden në 1 Pje. 1:1 si “ata që banojnë si të huaj të shpërndarë në mbarë Pontin, Galatinë, Kapadokinë, Azinë dhe Bitininë”. Këto provinca romake (nëse supozojmë se Galatia është Galatia etnike e veriut) ndodhen në Turqinë e sotme veriore. Këto zona, me sa duket, ishin vende të paungjillizuara nga Pali (shih Veprat 16:6) apo nga Pjetri (shih

1 Pje. 1:12). Ndoshta, këto kisha u mbollën nga judenjtë e krishterë që ishin kthyer në shtëpi pas Rrëshajëve (shih Veprat 2:9-11).

- B. Ndonëse këto kisha, në fillim, mund të jenë mbjellë nga besimtarë judenj, në kohën e letrës së Pjetrit ishin kthyer në kisha kryesisht me johebrenj
1. më parë nuk e njihnin Perëndinë (1:14)
 2. mënyra të kota jetese, të trashëguara nga paraardhësit (1 Pje. 1:18)
 3. tani janë populli i Perëndisë (1 Pje. 2:9-10, lojë fjalësh me Osea 1:9-10; 2:23)
 4. ishin ndër johebrenjtë (1 Pje. 2:12)
 5. listat me veset e johebrenjve (1 Pje. 4:3-4)
- C. Kjo letër përmban dhe elemente judaike
1. përdorimi i fjalëve “të huaj” dhe “diasporë” nënkupton një kontekst judaik (shih Gjoni 7:35; Veprat 7:6)
 2. përdorimi i Shkrimeve të DHV
 - a. Eksodi 19 (shih 1 Pje. 2:5, 9)
 - b. Isaia 53 (shih 1 Pje. 1:19; 2:22, 24, 25)
Megjithatë, këto shembuj nuk reflektojnë medoemos një kishë judaike, por
 3. transferimin e titujve të DHV nga Izraeli te kisha (p.sh., “mbretëri priftërinjsh”)
 - a. 1 Pje. 2:5
 - b. 1 Pje. 2:9
 4. një dokument trajnimi për kishën (pra, materiale katekizmi për besimtarët e rinj), që përdorte pasazhe mesianike nga DHV
 - a. 1 Pje. 1:19 – Isaia 53:7 (pra, Qengji)
 - b. 1 Pje. 2:22 – Isaia 53:5
 - c. 1 Pje. 2:24 – Isaia 53:4, 5, 11, 12
 - d. 1 Pje. 2:25 – Isaia 53:6
- D. Ndonëse Pjetri ishte thirrur në veçanti për t’u shërbyer judenjve (shih Gal. 2:8), ai, ashtu si dhe Pali, punonte, edhe me judenjtë, edhe me johebrenjtë (shih Veprat 10). Kthimi në besim i Kornelit i tregoi Pjetrit natyrën rrënjësisht përfshirëse të ungjillit! 1 Pjetrit e reflekton këtë botëkuptim të ri.

IV. QËLLIMI

- A. 1 Pjetrit ka edhe një aspekt doktrinor, edhe një aspekt praktik. Megjithatë, ndërsa Pali i ndante letrat e veta në një pjesë fillimi doktrinore dhe një pjesë përmyllëse zbatuese, Pjetri i bashkon këto të dyja. Libri i tij është shumë më i vështirë që ta përvijosh. Në shumë mënyra, i ngjan më tepër një predikimi se një letre.
- B. Çështja kryesore që diskutohet është vuajtja dhe përndjekja. Kjo bëhet në dy mënyra.
1. Jezusi paraqitet si shembulli absolut i vuajtjes dhe refuzimit (shih 1 Pje. 1:11; 2:21, 23; 3:18; 4:1, 13; 5:1).
 2. Ndjekësit e Jezusit thirren ta imitojnë modelin dhe sjelljen e Jezusit (shih 1 Pje. 1:6-7; 2:19; 3:13-17; 4:1, 12-19; 5:9-10).
- C. Në dritën e vuajtjes dhe përndjekjeve, që ishin kaq të përhapura në vitet e hershme të krishterimit, nuk është e habitshme që Ardhja e Dytë përmendet kaq shpesh. Ky libër, ashtu si dhe shumica e shkrimeve të DHR është eskatologjik fund e krye.

V. GJINIA LETRARE

- A. Ky libër përmban një hapje dhe përmyllje tipike për letrat greko-romake të shekullit të parë
1. 1 Pje. 1:1-2
 - a. Autori

- b. Marrësit
- c. Lutja
- 2. 1 Pje. 5:12-14
 - a. Përshëndetjet përmbyllëse
 - (1) nga kush
 - (2) për kë
 - b. Lutja

- B. Trupi kryesor i letrës i ngjan më tepër një predikimi sesa një letre. Disa mendojnë se, në fillim, ishte
 - 1. një predikim
 - 2. një liturgji pagëzimore
 - 3. pjesë të kombinuara të një materiali katekizmi nga kisha e hershme
- C. Letra duket se përmbillet në 1 Pje. 4:11 me një doksologji, por asnjë dorëshkrim grek nuk përfundon në këtë pikë. Ka gjasa që 1 Pje. 4:12-5:11 të jetë një përmbledhje e qëllimshme e gjithë letrës.
- D. Unë, personalisht, besoj se 1 Pjetrit funksionon si letër qarkore për kishat që nuk i kishte mbjellë personalisht Pjetri; i ngjan Kolosianëve të Palit (që iu dërgua kishave në Kolos, Laodicea dhe Hierapolis, shih Kol. 4:13), por shërben dhe si inkurajim i përgjithshëm për besimtarët që t'u ruhen problemeve të ardhshme, njësoj si letrat e Galatasve dhe Efesianëve të Palit.

Kjo gjini e letrave qarkore shpjegon mungesën e një hyrjeje dhe përmbylljeje personale të kësaj letre. Po kështu, shpjegon mungesën e shembujve të shkoqur të përndjekjes.

VI. KANONIZIMI

- A. Unë përmend dhe kategorinë e kanonizimit të 1 Pjetrit për shkak se kjo çështje është tejet e polemizuar në rastin e 2 Pjetrit.
- B. 1 Pjetrit renditet nga Euzebi në *Historinë e Kishës* 3:3:25 si pjesë e “librave të padiskutueshëm”. Në kishën e hershme, ajo nuk u dyshua kurrë si letër e vërtetë e apostullit Pjetër.
- C. Çështja e kanonizimit koklavitet për shkak të numrit të shkrimeve të rreme që i atribuohen Pjetrit. Kisha e hershme nuk i pranoi kurrë këto letra, por pranoi vetëm 1 Pjetrin dhe letrën e debatuar të 2 Pjetrit si të shkruara vërtet nga apostulli Pjetër.
 - 1. *Veprat e Pjetrit*
 - 2. *Veprat e Pjetrit dhe Andreas*
 - 3. *Veprat e Pjetrit dhe Palit*
 - 4. *Mundimi i Pjetrit dhe Palit*
 - 5. *Veprat e Pjetrit dhe të Dymbëdhjetëve*
 - 6. *Apokalipsi i Pjetrit*
 - 7. *Ungjilli i Pjetrit*
 - 8. *Mundimi i Pjetrit*
 - 9. *Predikimi i Pjetrit*
 - 10. *Veprat Sllavonike të Pjetrit*

(Për një diskutim të secilës prej këtyre shkrimeve pseudonimike, shih *Zondervan Pictorial Encyclopedia of the Bible*, vëll. 4; f. 721-723, 732-733, 740). Asnjëra prej këtyre shkrimeve, që gjoja i shkroi Pjetrit, nuk u konsiderua ndonjëherë seriozisht si pjesë e kanonit të DHR. Kjo, në vetvete, është tregues i fortë i përfshirjes së 1 dhe 2 Pjetrit në DHR.

PJETRI SI PERSON

I. FAMILJA

- A. Familja e Pjetrit jetonte në Galilenë e johebrenjve, në qytetin e Betsaidës, në bregun verior të Detit të Galilesë (ose Detit të Tiberiadës, shih Gjoni 1:44), por, me sa duket, në një moment të caktuar, u transferuan në Kapernaum (shih Marku 1:21, 29).
- B. I ati i Pjetrit quhej Jona (shih Mat. 16:17), ose Gjon (shih Gjoni 1:42; 21:15-17).
- C. Emrin e parë e kishte Simon (shih Marku 1:16, 29, 30, 36), që ishte i përhapur në Palestinën e shekullit të parë. Kjo ishte forma judaike e emrit Simeon (shih Veprat 15:14; 2 Pje. 1:1), që ishte emri i njërit prej dymbëdhjetë fiseve të Izraelit (shih Zan. 29:33; Eks. 1:1).
Jezusi i vuri emrin Pjetër (*Petros*, që do të thotë “shkëmb,” që synonte të përshkruante qëndrueshmërinë dhe forcën e tij të mëvonshme në Mat 16:18; Marku 3:16; Luka 6:14; Gjoni 1:42). Forma aramaike është *Kefa* (shih Gjoni 1:42; 1 Kor. 1:12; 3:22; 9:5; 15:5; Gal. 1:18; 2:9, 11, 14). Shpesh, në DHR, këta dy emra jepen së bashku (Mat. 16:16; Luka 5:8; Gjoni 1:40; 6:8,68; 13:6,9,24,36; 18:10,15,25; 20:2,6; 21:2-3,7,11,15).
- D. Vëllai i Pjetrit quhej Andrea (shih Marku 1:16). Ai ishte dishepull i Gjon Pagëzorit (shih Gjoni 1:35, 40) dhe, më vonë, u bë besimtar dhe ndjekës i Jezusit (shih Gjoni 1:36-37). Ai e solli Simonin te Jezusi (shih Gjoni 1:41). Muaj më vonë, Jezusi i takoi përbri Detit të Galilesë dhe i thirri të bëheshin zyrtarisht dishepuj të tij me kohë të plotë (shih Mat. 4:18-20; Marku 1:16-18; dhe Luka 5:1-11).
- E. Ishte i martuar (shih Marku 1:30; 1 Kor. 9:5), por nuk përmendet të ketë patur fëmijë.

II. PROFESIONI

- A. Familja e Pjetrit zotëronte disa barka peshkimi, madje punësonte dhe mëditës.
- B. Familja e tij mund të ketë qenë partnere biznesi me Jakobin, Gjonin dhe babain e tyre, Zebedeun (shih Luka 5:10).
- C. Pjetri iu rikthye shkurtimisht peshkimit pas vdekjes së Jezusit (shih Gjoni 21).

III. PERSONALITETI

- A. Pikat e forta të Pjetrit
1. Ishte ndjekës i përkushtuar, por tejet i nxituar (shih Marku 9:5; Gjoni 13:4-11).
 2. Ndërmori të kryente vepra besimi, por shpesh dështoi (p.sh., ecja mbi ujë, shih Mat. 14:28-31).
 3. Ishte trim dhe i gatshëm të vdiste (shih Mat. 26:51-52; Marku 14:47; Luka 22:49-51; Gjoni 18:10-11).
 4. Pas ringjalljes, Jezusi iu drejtua personalisht si drejtuesit të turpëruar të të dymbëdhjetëve (Gjoni 21) dhe i dha mundësinë të pendohej dhe të rimerrte udhëheqjen.
- B. Dobësitë e Pjetrit
1. Në fillim, kishte prirje legaliste judaike
 - a. të ngrënit me johebrenjtë (Gal. 2:11-21)
 - b. ligjet për ushqimin (Veprat 10:9-16)
 2. Si gjithë apostujt, Pjetri nuk i kuptonte plotësisht mësimet rrënjësisht të reja të Jezusit, si dhe rrjedhojat e tyre
 - a. Marku 9:5-6
 - b. Gjoni 13:6-11; 18:10-11
 3. Jezusi e qortoi personalisht dhe rëndë (Mark 8:33; Mat. 16:23)

4. U gjet në gjumë, në vend që të ishte duke u lutur në orën e rëndësishme kur Jezusi kishte nevojë në Gjetseman (Marku 14:32-42; Mat. 26:36-46; Luka 22:40-60)
5. Mohoi në mënyrë të përsëritur se njihte Jezusin (Marku 14:66-72; Mat. 26:69-75; Luka 22:56-62; Gjoni 18:16-18, 25-27)

IV. DREJTIMI I GRUPIT APOSTOLIK NGA PJETRI

- A. Ka katër lista apostujsh (shih Mat. 10:2-4; Marku 3:16-19; Luka 6:14-16; Veprat 1:13). Pjetri renditet gjithmonë i pari. Të Dymbëdhjetët ndaheshin në tre grupe katërshe. Besoj se kjo u lejonte të shkonin me radhë në shtëpi për të vizituar familjen.
- B. Shpesh, Pjetri shërben si folës për grupin e apostujve (shih Mat. 16:13-20; Marku 8:27-30; Luka 9:18-21). Këto pasazhe janë përdorur edhe për të theksuar autoritetin e Pjetrit brenda grupit (shih Mat 16:18). Megjithatë, brenda të njëjtit konteksti, ai edhe qortohet nga Jezusi si mjet i Satanit (shih Mat. 16:23; Marku 8:33).
Po kështu, kur dishepujt po debatonin se kush ishte më i madhi, nuk e morën si fakt të kryer se këtë pozicion e mbante Pjetri (shih Mat. 20:20-28, sidomos v. 24; Marku 9:33-37; 10:35-45).
- C. Pjetri nuk ishte drejtuesi i kishës së Jerusalemit. Kjo detyrë iu caktua Jakobit, gjysmëvëllait të Jezusit (shih Veprat 12:17; 15:13; 21:18; 1 Kor. 15:7; Gal. 1:19; 2:9, 12)..

V. SHËRBESA E TIJ PAS RINGJALLJES SË JEZUSIT

- A. Roli udhëheqës i Pjetrit shihet qartë në kapitujt e parë të Veprave
 1. Kryesoi në zgjedhjen e zëvendësuesit të Judës (shih Veprat 1:15-26).
 2. Bëri predikimin e parë në ditën e Rrëshajëve (shih Veprat 2).
 3. Shëroi një ulok dhe bëri predikimin e dytë të regjistruar në Veprat (shih Veprat 3:1-10; 3:11-26).
 4. Foli guximshëm para Sinedrit në Veprat 4.
 5. Luajti rol kryesues në disiplinimin kishtar të Ananias dhe Safirës te Veprat 5.
 6. Foli para këshillit të Jerusalemit në Veprat 15:7-11.
 7. Veprat e Apostujve i atribuojnë një sërë ngjarjesh dhe mrekullish të tjera.
- B. Gjithsesi, Pjetri nuk i mishëroi gjithmonë parimet e ungjillit
 1. Mbajti mendësinë e Dhiatës së Vjetër (shih Gal. 2:11-14).
 2. U desh të merrte zbulësë të veçantë që të përfshinte Kornelin (Veprat 10) dhe johebrenjtë e tjerë.

VI. VITET E HESHTJES

- A. Për Pjetrin ka pak, ose aspak, të dhëna pas Këshillit të Jerusalemit (Veprat 15)
 1. Galatasve 1:18
 2. Galatasve 2:7-21
 3. 1 Korintasve 1:12; 3:22; 9:5; 15:5
- B. Tradita e kishës së hershme
 1. Martirizimi i Pjetrit në Romë përmendet në letrën e Klementit të Romës drejtuar kishës në Korint më 95 pas K.
 2. Edhe Tertuliani (rreth 150-222 pas K.) e përmend martirizimin e Pjetrit në Romë nën Neronin (54-68 pas K.).
 3. Klementi i Aleksandrisë (200 pas K.) thotë se Pjetri u vra në Romë.
 4. Origeni (252 pas K.) thotë se Pjetri u martirizua i kryqëzuar kokëposhtë në Romë.

VII. FJALË DHE FRAZA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

1. paranjohje, 1:2
2. “të spërkatur me gjakun e tij”, 1:2
3. “të rilindur”, 1:3
4. Sprova të ndryshme, 1:6
5. “prova e besimit tuaj”, 1:7
6. “zbulesa e Jezu Krishtit”, 1:7, 13
7. Shpirtrat, 1:9
8. “qengj i panjollë dhe patëmetë”, 1:19
9. “ai ishte i paranjohur përpara themelimit të botës”, 1:20
10. “fjala e gjallë dhe e qëndrueshme e Perëndisë”, 1:23
11. “qumështin e pastër të fjalës”, 2:2
12. “gur i gjallë”, 2:4
13. “priftëri e shenjtë”, 2:5
14. Guri i qeshoes, 2:6
15. “gur pengese”, 2:8
16. Nënshtrijuni, 2:13
17. “vdisni ndaj mëkatit dhe jetoni ndaj drejtësisë”, 2:24
18. “me anë të plagëve të tij jeni shëruar”, 2:24
19. Zemërmirë, 3:8
20. Mbrojtje, 3:15
21. “pagëzimi tani ju shpëton”, 3:21
22. Sprovimi, 4:12
23. “bëni qëndresë ndaj tij”, 5:9

VIII. PERSONA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

1. “i Shenjti”, 1:5
2. “Bariu dhe Ruajtësi i shpirtrave tuaj”, 2:25
3. Pleqtë, 5:1
4. Kryebariu, 5:4
5. Silvani, 5:12
6. Marku, 5:13

IX. VENDNDODHJE QË DUHEN GJETUR NË HARTË

1. Pont, 1:1
2. Galati, 1:1
3. Kapadoki, 1:1
4. Azi, 1:1
5. Bitini, 1:1
6. Sion, 2:6
7. Babiloni, 5:13

X. PYETJE PËR DISKUTIM

1. Përshkruaj trashëgiminë e besimtarëve (1:4-5).
2. Shpjego 1:11 me fjalët e tua.
3. Çfarë dëshirojnë të dinë engjëjt? (1:12)
4. Si duhet t'i binden të krishterët vargut 1:16?
5. Si rritet njeriu në lidhje me shpëtimin? (2:2)
6. Pse janë të rëndësishëm vargjet 2:5 dhe 9?
7. Si lidhet 2:16 me Romakëve 14?

8. Si zbatohet 3:3 sot?
9. A mund të ndikojë në jetën e lutjes marrëdhënia e burrit me gruan? (3:7)
10. Ku shkoi Jezusi që t'u predikonte shpirtrave në burg? (3:19)
11. Shpjego 3:22 në bazë të teologjisë gnostike.
12. Cila është tema e përgjithshme e 1 Pjetrit?

HYRJE PËR 2 PJETRIN

I. THËNIE HYRËSE

- A. Qëllimi ose synimi i kësaj hyrjeje nuk është të diskutojë në hollësi problemet që lidhen me autorësinë e 2 Pjetrit. Unë, personalisht, kam arritur në përfundimin se nuk ka asnjë arsye të fortë për ta mohuar autorësinë e Pjetrit. Tri burime kanë qenë të dobishme për procesin e vendimmarrjes sime në këtë çështje.
1. Artikulli i Bruce M. Metzger, "Literary Forgeries and Canonical Pseudepigrapha" në *The Journal of the Society of Biblical Literature*, 1972, f. 3-24.
 2. Artikulli i Michael J. Kruger, "The Authenticity of 2 Peter", në *The Journal of the Evangelical Theological Society*, vëll. 42, nr. 4, f. 645-671.
 3. Libri i E. M. B. Green, *2 Peter Reconsidered*, Tyndale Press, 1961.
- B. Kur mendoj për mundësinë se 2 Pjetri nuk u shkrua nga Pjetri, shumë gjëra më shkojnë në mendje.
1. Fakti se kush e shkroi 2 Pjetrin nuk ma ndryshon mendimin se është i frymëzuar dhe i besueshëm. Autorësia prek hermeneutikën, jo frymëzimin; frymëzimi është presupozim besimi dhe proces i dokumentuar historik.
 2. Pse të shqetësohem nga pseudonimiteti? Me sa duket, bota greko-romake e shekullit të parë ishte mësuar me pseudonimitetin (shih artikullin e Metzger).
 3. A jam ngurrues që ta lejoj pseudonimitetin në këtë letër për shkak të preferencave të mia, apo jam në gjendje t'i vlerësoj ndershmërisht të dhënat historike dhe tekstuale? Mos, ndoshta, tradita më ka predispozuar që të arrij në një përfundim të caktuar?
 4. Kisha e hershme e vuri në dyshim autorësinë e Pjetrit, por jo mesazhin e kësaj letre (përveç kishës siriane). Ky është një mesazh ortodoks, në unitet teologjik me librat e tjerë të DHR; ka shumë ngjashmëri me predikimet e Pjetrit në Veprat.
- C. Euzebi përdori tri kategori për të përshkruar shkrimet e krishtera:
1. të pranuar
 2. të debatuar
 3. të rreme
- Ai e përfshiu 2 Pjetrin bashkë me Jakobin, Judën, 2 Gjonin dhe 3 Gjonin në kategorinë e dytë (të debatuar). Euzebi e pranoi 1 Pjetrin, kishte dyshim për 2 Pjetrin, por hodhi poshtë si të rreme shkrimet e tjera të supozuara të Pjetrit: (1) *Veprat e Pjetrit*; (2) *Ungjillin e Pjetrit*; (3) *Predikimin e Pjetrit*; dhe (4) *Apokalipsin e Pjetrit*.

II. AUTORËSIA

- A. Ky është një nga librat më të debatuar të DHR për sa i përket autorësisë tradicionale.
- B. Arsyet për këto dyshime janë të brendshme (stili dhe përmbajtja) dhe të jashtme (pranimi i vonët nga kisha)
1. Të jashtme
 - a. Nuk gjendet në listën e Markionit (145 pas K.) dhe atë të Fragmentit Muratorian (170 pas K.)
 - b. Gjendet në Papirusin e Bodamerit P72, herët në shekullin e tretë
 - c. Nuk citohet drejtpërdrejt nga shkruesit e kishës së hershme deri në shekullin e tretë (Origeni dhe Metodi)
 - d. U pranua zyrtarisht në Kanon vetëm pas këshillit të Kartagjenës më 397 pas K., me sa duket pas letrës së Athanasit më 367 pas K. Nuk u pranua nga kisha lindore deri në shekullin e gjashtë
 - e. Nuk gjendet në përkthimin siriak (Peshita) të shekullit të pestë.
 - f. Euzebi, që shkroi rreth 325 pas K. (*Historia e Kishës* 3:25:3), e vendosi ndër librat e dyshuar (2 Pjetrit, Juda, Jakobi, 2 Gjonit, 3 Gjonit)
 2. Të brendshme

- a. Stili është shumë i ndryshëm nga ai i 1 Pjetrit (1 Pjetri përdor greqishte sintaksore, ndërsa 2 Pjetri, jo; Jeronimi ia atribuon këtë ndryshim stili dy sekretarëve të ndryshëm)
- b. 2 Pjetrit duket se ndjek një lloj letrar të quajtur “aziatizëm”, që ishte karakteristik për një pjesë të letërsisë së Azisë së Vogël
- c. Aludimi për disa burime jashtëkanonike ka shkaktuar probleme të mëdha, por edhe 1 Pjetri duket se aludon për 1 Enokun
- d. 2 Pjetrit dhe Juda kanë njëfarë lidhjeje letrare (2 Pjet. 2:1-8 dhe Juda 4-13 si dhe 2 Pjet. 3:1-3 dhe Juda 17-18); kush kopjoi tjetrin nuk dihet
- e. Libri pretendohet se u shkrua nga apostulli Pjetër; 1:1, 14, 16-18; 3:1, 15

C. Gjinia letrare

1. A është kjo një letër tipike e shekullit të parë?
 - a. Ka një hyrje dhe përmbyllje tipike
 - b. Megjithatë, duket se është letër ciklike për disa kisha, si Galatasve, Efesianëve, Jakobi dhe 1 Gjonit
 - c. Mund të jetë një gjini e specializuar judaike, e quajtur “testament”, që karakterizohet nga
 - (1) Ligjërim lamtumire
 - a. Ligji i Përtërirë 31-33
 - b. Jozueu 24
 - c. *Testamenti i Dymbëdhjetë Patriarkëve*
 - d. Gjoni 13-17
 - e. Veprat 20:17-28
 - (2) Parashikim i vdekjes së afërt të shkruarit (shih 2 Timoteut)
 - (3) Këshillë për dëgjuesit që të vazhdojnë në traditën e tij
2. Marrëdhënia mes 2 Pjetrit 2 dhe Judës
 - a. Qartazi, ka ndodhur një huazim letrar mes të dyve.
 - b. Aludimi për burime jokanonike ka bërë që shumë ta hedhin poshtë, edhe Judën, edhe 2 Pjetrin; mirëpo, edhe 1 Pjetri aludon për 1 *Enokun*, kurse Pali citon dhe poetë grekë.
3. Vetë libri pretendon se u shkrua nga apostulli Pjetër
 - a. Ai përmendet me emër në 2 Pje. 1:1. Ai quhet Simeon Pjetër. Pjetri është emri që ia dha Jezusi (shih Mat. 16). Simeoni (jo Simoni) është emër i rrallë dhe i pazakontë. Nëse dikush do të përpiquej të shkruante në emër të Pjetrit, përzgjedhja e këtij shqiptimi semit është shumë e habitshme, madje kundërproduktive për pseudonimitetin.
 - b. Ai pretendon se ishte dëshmitar okular i Shpërfytyrimit në Mal (shih Mat. 17:1-8; Marku 9:2-8; Luka 9:28-36) në 2 Pje. 1:16-18.
 - c. Ai pretendon se ka shkruar dhe një letër të parë (shih 2 Pje. 3:1), që nënkupton 1 Pjetrin.
4. Ortodoksia
 - a. Nuk ka asgjë në këtë letër që të kundërshtojë ndonjë mësim apostolik të DHR.
 - b. Ka disa elemente unike (p.sh., që bota do të shkatërrohet me zjarr, dhe që letrat e Palit shihen si Shkrim), por asgjë gnostike, ose adopsioniste, ose qartazi heretike.

PROBLEME TË JASHTME

1. Euzebi i rendit shkrimet e krishtera të shekujve të parë dhe të dytë në tre kategori:
 - a. të pranuar
 - b. të debatuar
 - c. të rreme
 2 Pjetri, bashkë me Hebrenjve Jakobin, 2 dhe 3 Gjonin, renditen në kategorinë e debatuar.
2. 2 Pjetrit nuk shfaqet në kanonin e Markionit (154 pas K.), por Markioni refuzoi dhe shumë libra të tjerë të DHR.
3. 2 Pjetrit nuk shfaqet në Fragmentin Muratorian (rreth 180-200 pas K.), por kjo listë duket se ishte e dëmtuar; po kështu, ajo nuk përmend as Hebrenjve, Jakobin dhe 1 Pjetrin.
4. U refuzua nga kisha lindore (siriane)
 - a. Nuk gjendet në Peshita (gjysma e parë e shekullit të pestë)

- b. U përfshi në Filokseniana (507 pas K.) në Irak, dhe në versionin Harklean (616 pas K.) në Afrikën e veriut
- c. Krizostomi dhe Teodori i Mopsuestias (pra, drejtuesit e kishës antiokene të interpretimit) i refuzuan të gjitha letrat e përgjithshme.
5. 2 Pjetrit duke se citohet në “Ungjillin e së Vërtetës” dhe “Apokrifonin e Gjonit”, që gjenden në tekstet gnostike të Nag Hammadit (shih *The Nag Hammadi Gnostic Sects and the Bible*, nga Andreë K. Helmbold, f. 91). Këto shkrime në gjuhën kopte janë përkthime të teksteve të mëparshme greqisht. Nëse 2 Pjetrit aludohet aty, atëherë është e pamundur që të jetë shkruar në shekullin e dytë.
6. Përfshihet në P72 e datuar nga UBS4 (f. 8) si në shekullin e tretë ose të katërt.
7. Aludohet ose citohet nga Klementi i Romës (95 pas K.)
 - a. *I Klementi* (9:2 – 2 Pjetrit 1:17)
 - b. *I Klementi* (23:3 – 2 Pjetrit 3:4)
 - c. *I Klementi* (35:5 – 2 Pjetrit 2:2)
8. Ndoshta, aludohet në *Dialogun me Trifon* (82:1 – 2 Pje. 2:1), e shkruar nga Justin Martiri (115-165 pas K.). Këto janë të vetmet dy vende në shkrimet e lashta të krishtera, ku përdoret fjala greke *pseudoprofetai*.
9. Ireneu (130-200 pas K.) ndoshta aludon për 2 Pjetrin (citohet nga Euzebi në *Hist. Kish.* 5:32:2 – 2 Pje. 3:8; dhe 3:1:1 – 2 Pje. 1:15).
10. Klementi i Aleksandrisë (150-215 pas K.) shkroi komentarin e parë (ndonëse tani ka humbur) për 2 Pjetrin.
11. Përmendet në letrën e Pashkës së Athanasit (367 pas K.), që është një listë e librave kanonikë të kohës.
12. U pranua si kanonike nga këshillat e kishës së hershme në Laodice (372 pas K.) dhe Kartagenë (397 pas K.).
13. Është interesante se shkrimet e tjera të supozuara të Pjetrit (pra, *Veprat e Pjetrit*, *Veprat e Andreas dhe Pjetrit*, *Veprat e Pjetrit dhe Palit*, *Mundimi i Pjetrit dhe Palit*, *Veprat e Pjetrit dhe Dymbëdhjetë Apostujve*, *Apokalipsi i Pjetrit*, dhe *Predikimi i Pjetrit*) u refuzuan pa përjashtim nga kishat e hershme si të rreme (pra, jo të frymëzuara).

III. DATA

- A. Kjo varet nga autorësia.
- B. Nëse jemi të bindur për autorësinë e Pjetrit, atëherë u shkrua përpara vdekjes së tij (shih 2 Pje. 1:14).
- C. Tradita e kishës thotë se apostulli Pjetër vdiq në Romë kur Cezar ishte Neroni. Neroni urdhëroi përndjekjen e të krishterëve rreth 64 pas K. Ai vrau veten më 68 pas K.
- D. Nëse letrën e shkroi një ndjekës i Pjetrit në emër të apostullit, atëherë bëhet e mundshme një datim i vonët deri në 130-150 pas K., për shkak se 2 Pjetrit citohet në *Apokalipsin e Pjetrit* si dhe në *Ungjillin e së Vërtetës* dhe në *Apokrifonin e Gjonit*.
- E. Arkeologu i shquar amerikan W. F. Albright thotë se u shkrua përpara vitit 80 pas K. për shkak të ngjashmërive që ka më Pergamenat e Detit të Vdekur.

IV. MARRËSIT E LETRËS

- A. Nëse 1 Pjetrit përmendet në 2 Pjetrit 3:1, atëherë marrësit e letrës ishin të njëjtit njerëz (pra, jetonin në Turqinë veriore).

- B. 2 Pjetrit mund të jetë dëshmi për të inkurajuar gjithë besimtarët që të bëjnë qëndresë nën sprovë, t'i kundërshtojnë mësuesit e rremë dhe të jetojnë besnikërisht në traditën e ungjillit duke pritur Ardhjen e Dytë.

V. THEKSI

- A. Të luftojë herezinë, ndoshta gnosticizmin antinomian që sapo kishte filluar (2:1-22; 3:15-18)
- B. Të diskutojë për vonimin e ardhjes së dytë të Krishtit (3:3-4). Në atë kohë, mësuesit e rremë dhe mëkatarët e tjerë do të gjykohen ndërsa fëmijët e Perëndisë do të përlëvdohen.

VI. SHKASI

- A. Ndërsa 1 Pjetrit flet për përndjekjen dhe vuajtjen, 2 Pjetrit flet për mësuesit e rremë.
- B. Natyra e saktë e mësimit të rremë nuk është e qartë, por ndoshta kishte lidhje me gnosticizmin antinomian (shih 2 Pje. 2:1-22; 3 :15-18). Ky libër përdor një fjalor teknik, i përdorur nga proto-gnosticizmi dhe nga fetë e misterit. Ndoshta, kjo ishte teknikë e qëllimshme apologjetike për të sulmuar teologjinë e tyre.
- C. Ky libër, ashtu si 2 Thesalonikasve trajton temën e Ardhjes së Dytë, që ndonëse e vonuar, është e sigurt; atëherë, fëmijët e Perëndisë do të përlëvdohen dhe jobesimtarët do të gjykohen (shih 2 Pje. 3:3-4). Është interesante se 1 Pjetrit, në mënyrë karakteristike, përdor fjalën *apokalupsis* për t'iu referuar kthimit të Jezusit, ndërsa 2 Pjetrit përdor fjalën *parousia*. Ndoshta, kjo reflekton përdorimin e letërshkruesve të ndryshëm (kështu mendon Jeronimi).

VII. FJALË DHE FRAZA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

1. Skllavi, 1:1
2. Fuqia hyjnore, 1:3
3. Perëndishmëri, 1:3
4. “pjesëmarrës në natyrën hyjnore”, 1:4
5. “mbretërinë e përjetshme”, 1:11
6. “zhveshja e banesës sime tokësore është e afërt”, 1:14
7. “ardhja e Zotit tonë Jezu Krisht”, 1:16
8. “ne ishim dëshmitarë të madhështisë së tij”, 1:16
9. “Biri im i dashur”, 1:17
10. “ylli i mëngjesit të lindë”, 1:19
11. Profetët e rremë, 2:1
12. Mësuesit e rremë, 2:1
13. “engjëjt, kur mëkatuan”, 2:4
14. Ferri (pra, Tartari), 2:4
15. “përçmojnë autoritetin”, 2:10
16. Fyejnë autoritetet engjëllorë”, 2:10
17. “urdhërimi i shenjtë”, 2:21
18. “duke shpejtuar ardhjen e Zotit”, 3:12
19. “qiejt e rinj dhe një tokë e re”, 3:13
20. “të panjollë dhe të patëmetë”, 3:14

VIII. PERSONA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

1. Noeu, 2:5
2. Loti, 2:7
3. Balaami, 2:15

IX. VENDNDODHJE QË DUHEN GJETUR NË HARTË – ASNJË

X. PYETJE PËR DISKUTIM

1. A e quan 1:1 Jezusin Perëndi?
2. Çfarë thotë 1:10 për sovranitetin e Perëndisë dhe vullnetin e lirë njerëzor?
3. Kur i foli Jezusi Pjetrit për vdekjen e tij? (1:14)
4. Rendit mënyrat sesi kapitulli 1 reflekton ditët e fundit të Pjetrit me Jezusin.
5. Cila e vërtetë madhështore pohohet nga pasazhi 1:20-21?
6. Rendit tiparet e mësuesve të rremë në kapitullin 2.
7. Pse është kaq shqetësues 2:1, “mohojnë Zotëirne që i bleu”?
8. Pse është i habitshëm vargu 2:8? (2:20)
9. Shpjego 2:20 me fjalët e tua.
10. Çfarë thonë mësuesit e rremë në 3:4?
11. Pse thuhet se toka u formua nga uji? (3:5)
12. Cila është domethënia e 3:8?
13. Si lidhet 3:9b me 1 Tim. 2:4?
14. Ku tjetër na jepet në Bibël e vërteta e 3:10?
15. Pse është e rëndësishme që Pjetri përmend Palin?
16. Cila është tematika qendrore e 2 Pjetrit?

HYRJE PËR 1 GJONIN

I. NATYRA UNIKE E LIBRIT

- A. Libri i 1 Gjonit nuk është letër personale, as letër drejtuar një kishe të caktuar, por më tepër është një “Memorandum i Flaktë Zyre nga Selia Qendrore” (letër kolektive).
1. Nuk ka hyrje tradicionale (prej kujt, drejtuar kujt).
 2. Nuk ka përshëndetje personale, as mesazh përmyllës.
- B. Nuk përmenden emra të përveçëm. Kjo është tejet e pazakontë dhe shfaqet vetëm në librat që u shkruhen shumë kishave, si letra e Efesianëve dhe Jakobi. E vetmja letër e DhR që nuk përfshin emrin e autorit është ajo e Hebrenjve. Megjithatë, është e qartë se 1 Gjoni u shkrua besimtarëve që, në atë kohë, po përballeshin si kishë me problemin e brendshëm të mësuesve të rremë (gnostikët).
- C. Kjo letër është trajtesë e fuqishme teologjike
1. Pozicioni qendror i Jezusit
 - a. plotësisht Perëndi dhe plotësisht njeri
 - b. shpëtimi vjen me anë të besimit në Jezu Krishtin, jo nga një përjetim mistik apo një njohuri e fshehtë (mësuesit e rremë)
 2. Kërkesa për një stil jetese të krishterë (tre provat e krishterimit të vërtetë)
 - a. Dashuria vëllazërore
 - b. Bindja
 - c. Refuzimi i sistemit të rënë botëror
 3. Siguria e shpëtimit të përjetshëm përmes besimit në Jezusin e Nazaretit (“di” përdoret 27 herë)
 4. Si të dallosh mësuesit e rremë
- D. Shkrimet e Gjonit (sidomos 1 Gjonit) janë shkruar në greqishten më pak të koklavitur *koine*, të përdorur nga shkrimtarët e DhR; gjithsesi, librat e tij, si kurrkush tjetër, përshkojnë thellësitë e të vërtetave të thella e të përjetshme të Perëndisë në Jezu Krishtin (pra, Perëndia është Dritë, 1 Gjonit 1:5; Perëndia është Dashuri, 1 Gjonit 4:8, 16; Perëndia është frymë, Gjoni 4:24).
- E. Ka gjasa që 1 Gjonit të jetë shkruar si letër sqaruese për ungjillin e Gjonit. Herezia gnostike e shekullit të parë përbën sfondin për të dy këta libra. Ungjilli i Gjonit ka thelb ungjillizues, ndërsa 1 Gjonit u shkruar për besimtarët (pra, për dishepullizim).
Komentuesi i shquar Westcott u shpreh se ky ungjill pohon natyrën hyjnore të Jezusit, ndërsa 1 Gjonit thekson natyrën e tij njerëzore. Këta libra shkojnë dorë për dorë!
- F. Gjoni shkruan me terma bardhezi (dualistë). Kjo është karakteristike për Rrotullat e Detit të Vdekur dhe për mësuesit e rremë gnostikë. Dualizmi i strukturuar letrar i 1 Gjonit është, edhe verbal (drita kundrejt errësirës), edhe stilistikor (një pohim negativ vijohet nga një pohim pozitiv). Kjo ndryshon nga ungjilli i Gjonit, i cili përdor dualizmin vertikal (Jezusi nga lart kundrejt gjithë njerëzve nga poshtë).
- G. Është shumë e vështirë që ta përvijosh 1 Gjonin për shkak të përdorimit të përsëritur të tematikave nga ana e Gjonit. Ky libër është si një tapiceri të vërtetash, që janë thurur së bashku me motive të përsëritura (shih Bill Hendricks, *Tapestries of Truth, The Letters of John [Tapiceri të vërtetash: letrat e Gjonit]*).

II. AUTORI

- A. Autorësia e 1 Gjonit është pjesë e debatit për autorësinë e shkrimeve të Gjonit: ungjilli, 1 Gjonit, 2 Gjonit, 3 Gjonit dhe Zbulesa.

- B. Ekzistojnë dy pozicione bazë
1. Tradicionali
 - a. Tradita ndër etërit e hershëm të kishës ishte unanime se Gjoni, apostulli i dashur, ishte autori i 1 Gjonit.
 - b. Përmbledhja e të dhënave nga kisha e hershme
 - (1) Klementi i Romës (90 pas K.) aludon për 1 Gjonin
 - (2) Polikarpi i Smirnës, *Filipianëve* 7 (110-140 pas K.), citon 1 Gjonin
 - (3) Justin Martiri, *Dialogu* 123:9 (150-160 pas K.) citon 1 Gjonin
 - (4) Aludimet për 1 Gjonin bëhen edhe në shkrimet e
 - (a) Ignacit të Antiokisë (data e shkrimeve të tij është e paqartë, por në fillim të viteve 100 pas K.)
 - (b) Papiasit të Hierapolisit (lindur mes 50-60 pas K. dhe i martirizuar rreth 155 pas K.)
 - (5) Ireneu i Lionit (130-202 pas K.) ia atribuon 1 Gjonin apostullit Gjon. Tertuliani, një apolog i hershëm, që shkroi 50 libra kundër heretikëve, e citonte shpesh 1 Gjonin
 - (6) Shkrime të tjera të hershme që ia atribuojnë apostullit Gjon autorësinë e kësaj letre janë Klementi, Origeni dhe Dionisi, të tre nga Aleksandria, Fragmenti Muratorian (180-200 pas K.) dhe Euzebi (shekulli i tretë).
 - (7) Jeronimi (gjysma e dytë e shekullit të katërt) pohoi autorësinë e Gjonit, por pranoi se disa në kohën e tij e mohonin.
 - (8) Theodori i Mopsuestias, peshkopi i Antiokisë nga 392-428 pas K., e mohonte autorësinë e Gjonit.
 - c. Nëse ishte Gjoni, çfarë dimë për apostullin Gjon?
 - (1) Ishte i biri i Zebedeut dhe Salomesë
 - (2) Ishte peshkatar në detin e Galilesë, bashkë me të vëllanë, Jakobin (ndoshta zotëronin disa barka)
 - (3) Disa besojnë se e ëma e tij ishte motra e Marisë, nënës së Jezusit (shih Gjoni 19:25; Marku 15:20)
 - (4) Me sa duket, ishte i pasur, pasi kishte
 - (a) shërbëtorë me pagesë (shih Marku 1:20)
 - (b) disa barka
 - (c) shtëpi në Jerusalem
 - (5) Gjoni kishte mundësi hyrjeje në shtëpinë e Kryepriutit në Jerusalem, gjë që tregon se ishte njeri me njëfarë emri (shih Gjoni 18:15-16)
 - (6) Pikërisht Gjonit iu besua përkujdesja për Marinë, nënën e Jezusit
 - d. Tradita e kishës së hershme dëshmon njëzëri se Gjoni jetoi më shumë se të gjithë apostujt e tjerë dhe, pas vdekjes së Marisë në Jerusalem, ai u transferua në Azinë e vogël dhe u vendos në Efes, qyteti më i madh i asaj zone. Nga ky qytet, u syrgjynos në ishullin e Patmosit (afër vijë bregdetare) dhe, më vonë, u lirua dhe u kthye në Efes (Euzebi citon Polikarpin, Papiasin dhe Ireneun).
 2. Studiuesit e sotëm
 - a. Shumica dërmuese e studiuesve të sotëm pranojnë ngjashmërinë e të gjitha shkrimeve johanine me njëra-tjetrën, sidomos në frazat, fjalorin dhe format gramatikore. Shembull i qartë i kësaj është kontrasti i fortë që karakterizon këto shkrime: jeta kundrejt vdekjes, e vërteta kundrejt rremes. E njëjta dikotomi e thekët mund të shihet edhe në shkrime të tjera të kohës, si në Rrotullat e Detit të Vdekur ose në shkrimet e gnosticizmit që po lindte.
 - b. Ka patur një sërë teorish për marrëdhënien e ndërthurur të pesë librave që i janë atribuar tradicionalisht Gjonit. Disa grupe pohojnë autorësinë e një personi, të dy personave, të tre personave, e kështu me radhë. Duket se pozicioni më i pranueshëm është se të gjitha shkrimet johanine janë rezultat i mendimeve të një njeriu të vetëm, edhe nëse janë shkruar me gjasë nga disa prej dishepujve të tij.
 - c. Bindja ime personale është se Gjoni, apostulli i moshuar, i shkroi të pestë këta libra nga fundi i shërbesës së vet në Efes.
 3. Çështja e autorësisë është çështje hermeneutike, jo frymëzimi. Në fund fare, autori i Shkrimit është Perëndia!

III. DATA – Qartazi, kjo lidhet me autorësinë

- A. Nëse këto letra, dhe posaçërisht 1 Gjonit, u shkruan nga apostulli Gjon, bëhet fjalë për një kohë diku nga fundi i shekullit të parë. Kjo do të lejonte kohë për zhvillimin e sistemeve të rreme teologjike/filozofike gnostike, si dhe do të përputhej me terminologjinë e 1 Gjonit (“fëmijë të vegjël”), që duket se nënkupton se një i moshuar po i flet një grupi më të ri me besimtarë. Jeronimi thotë se Gjoni jetoi 68 të tjera pas kryqëzimit të Jezusit. Kjo duket se përputhet me këtë traditë.
- B. A. T. Robertson mendonte 1 Gjonit u shkrua midis 85-95 pas K., ndërsa ungjilli i Gjonit u shkrua diku nga viti 95.
- C. *The New International Commentary Series on 1 John* [Seria e Komentareve të Rinj Ndërkombëtare: 1 Gjonit], e shkruar nga I. Howard Marshall, shprehet se një datë mes 60-100 pas K. është gjëja më e sigurt që mund të shprehë bota e sotme studimore në vlerësimin e datës së shkrimeve johanine.

IV. MARRËSIT

- A. Tradita pohon se ky libër u shkrua për provincën romake të Azisë së vogël (Turqia perëndimore), ku Efesi ishte zona kryesore metropolitane.
- B. Kjo letër duket se i është shkruar një grupi të veçantë kishash në Azinë e Vogël, të cilat po përballeshin me problemin e mësuesve të rremë (si Kolosianët dhe Efesianët), veçanërisht me
 1. Gnostikët docetikë, të cilët mohonin natyrën njerëzore të Krishtit, por pohonin natyrën e tij hyjnore
 2. Gnostikët antinomianë, të cilët e ndanin teologjinë nga etika/morali
- C. Augustini (shekulli i katërt pas K.) thotë se iu shkrua partëve (Babiloni). Ai ndiqet nga Kasidori (fillimi i shekullit të gjashtë pas K.). Ndoshta, kjo vjen nga ngatërrimi i frazës “zonja e zgjedhur”, 2 Gjonit 1, me frazën “ajo që është në Babiloni”, 1 Pjetrit 5:13.
- D. Fragmenti Muratorian, një listë e hershme kanonike librash të DhR, e shkruar mes 180-200 pas K. në Romë, pohon se kjo letër u shkrua “pas nxitjes që i bënte Gjonit bashkëdishepujt dhe peshkopët e tjerë” (në Azinë e Vogël).

V. HEREZIA

- A. Vetë letra është qartazi reagim ndaj një lloji mësimi të rremë (p.sh., “Nëse themi...” 1:6 e më tej dhe “ai që thotë...” 2:9; 4:20 [diatriba]).
- B. Ne mund të mësojmë disa nga parimet bazë të kësaj herezie nga të dhënat e brendshme të 1 Gjonit.
 1. Mohimi i mishërimit të Jezu Krishtit
 2. Mohimi i rolit qendror të Jezu Krishtit në shpëtim
 3. Mungesa e një stili të përshtatshëm të krishterë të jetesës
 4. Theksimi i njohurisë (shpesh, i fshehtë)
 5. Priorja drejt ekskluzivizmit
- C. Konteksti i shekullit të parë
Bota romake e shekullit të parë ishte një kohë eklektizmi ndër fetë lindore dhe perëndimore. Perënditë e panteonit grek dhe atij romak po kalonin ditë të këqija. Fetë e “mistershme” ishin shumë të përhapura për shkak të theksimit që i bënin marrëdhënies personale me hyjninë dhe njohurisë së fshehtë. Filozofia laike greke ishte e përhapur dhe po shkrihej me botëkuptime të tjera. Në këtë botë fesh eklektike erdhi natyra përjashtuese e besimit të krishterë (Jezusi është e vetmja udhë te Perëndia,

shih Gjoni 14:6). Cilido të ketë qenë sfondi i saktë i herezisë, ajo ishte një përpjekje për ta bërë të pranueshme natyrën në dukje të ngushtë të krishterimit dhe të pranueshme nga ana intelektuale për një audiencë më të gjerë greko-romake.

D. Alternativa të mundshme se për cilin grup gnostikësh e ka fjalën Gjoni

1. Gnosticizmi që po lindte

a. Mësimi bazë i gnosticizmit që po lindte në shekullin e parë duket se ishte theksimi i dualizmit ontologjik (të përjetshëm) midis shpirtit dhe materies. Shpirti (Perëndia i lartë) konsiderohej i mirë, ndërsa materia ishte qenësisht e ligë. Kjo dikotomi i ngjan idealeve të platonizmit kundrejt fizikes, qiellores kundrejt tokësore, të padukshmes kundrejt të dukshmes. Po kështu, mbitheksiohej rëndësia e njohurisë së fshehtë (fjalëkalimet ose kodet e fshehta, që i lejojnë shpirtit të kalojë përmes sferave engjëjlore [*aeon*] deri te perëndia i lartë) si e domosdoshme për shpëtim.

b. Gnosticizmi që po lindte kishte dy forma, të cilat me sa duket përbëjnë sfondin e 1 Gjoni:

(1) Gnosticizmi docetik, që mohonte natyrën e vërtetë njerëzore të Jezusit për shkak se materia është e ligë

(2) Gnosticizmi kerintian, që thotë se Krishti ishte një nga *aeon*-et, ose nivelet engjëjlore, të shumta midis perëndisë së mirë e të lartë dhe materies së ligë. Ky “Shpirt Krisht” brendabanoi njeriun Jezusi në momentin e pagëzimit dhe e braktisi para kryqëzimit.

(3) Nga këto dy grupe, disa praktikonin asketizmin (nëse trupi do diçka, është e ligë), ndërsa të tjerët antinomianizmin (nëse trupi do diçka, jepja). Nuk ka të dhëna me shkrim për një sistem të zhvilluar gnosticizmin në shekullin e parë. Për informacione të mëtejshme për “gnosticizmin” shih

(a) *The Gnostic Religion [Feja gnostike]*, nga Hans Jonas, botuar nga Beacon Press

(b) *The Gnostic Gospels [Ungjijtë gnostikë]*, nga Elaine Pagels, botuar nga Random House

(c) *The Nag Hammadi Gnostic Texts and the Bible [Tekstet gnostike të Nag Hamadit dhe Bibla]*, nga Andreë Helmbold

2. Ignaci shpreh një tjetër burim të mundshëm herezie në shkrimet e veta në letrën drejtuar smirneasve iv-v. Ata mohanin mishërimin e Jezusit dhe bënë një stil jetese antinomia.

3. Një tjetër mundësi më pak e mundshme për burimin e herezisë ishte Meandri i Antiokisë, i cili njihet nga shkrimet e Ireneut, *Kundër Herezive XXIII*. Ai ishte ndjekës i Simon Samaritanit dhe ishte përkrahës i njohurisë së fshehtë.

E. Herezia sot

1. Fryma e kësaj herezie është e pranishme ndër ne edhe sot, kur njerëzit përpiqen ta kombinojnë të vërtetën e krishterë me sisteme të tjera mendimi.

2. Fryma e kësaj herezie është e pranishme ndër ne edhe sot, kur njerëzit theksojnë doktrinën e “saktë”, por e shkëpusin nga marrëdhënia personale dhe nga besimi që çon në një stil të krishterë jetese.

3. Fryma e kësaj herezie është e pranishme ndër ne edhe sot, kur njerëzit e kthejnë krishterimin në një grup elitare dhe intelektual përjashtues.

4. Fryma e kësaj herezie është e pranishme ndër ne edhe sot, kur njerëzit fetarë i kthehen asketizmit ose antinomianizmit.

VI. QËLLIMI

A. Ka një fokus praktik për besimtarët

1. që t’u japë gëzim (shih 1:4)

2. që t’i inkurajojë të bëjnë jetë të perëndishme (shih 1:7; 2:1)

3. që t’i urdhërojë (dhe t’u kujtojë) të duan njëri-tjetrin (shih 4:7-21) dhe jo botën (shih 2:15-17)

4. që t’u japë sigurinë e shpëtimit të tyre në Krishtin (shih 5:13)

B. Ka një fokus doktrinor për besimtarët

1. që të refuzojnë gabimin e natyrës hyjnore dhe njerëzore të Jezusit
2. që të refuzojnë gabimin e ndarjes së botës shpirtërore në një intelektualizëm që është i boshatisur nga jetesa e perëndishme
3. që të refuzojnë gëzimin se njeriu mund të shpëtohet, si i shkëputur nga njerëzit e tjerë

VII. FJALË DHE FRAZA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

1. Nga fillimi, 1:1
2. Fjala e jetës, 1:1
3. Jeta e përjetshme, 1:2
4. Bashkësi (*koinonia*), 1:3
5. Perëndia është dritë, 1:5
6. Ec, 1:6, 7
7. Gjaku i Jezusit, 1:7
8. Fëmijët e mi të vegjël, 2:1
9. Pajtim, 2:2; 4:10
10. Njoh, 2:3, 4, 18, 20, 21, etj.
11. Banon, 2:6, 17, 24, 25, 27, etj.
12. Urdhërim i ri, 2:7
13. Për hir të emrit të tij, 2:12
14. Bota, 2:15
15. Ora e fundit, 2:18
16. Vajosja, 2:20, 27
17. Rrëfej, 2:23; 4:2, 3, 15, etj.
18. Sprovoni frymërat, 4:1
19. Dita e gjykimit, 4:17
20. Fryma, uji dhe gjaku”, 5:8
21. Mëkati që çon në vdekje, 5:16
22. Lindur nga Perëndia, 5:18
23. Ruani veten nga idhujt, 5:21

VIII. PERSONA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

1. Avokat, 2:1
2. Gënjeshtar, 2:4, 22
3. Antikrisht, 2:18; 4:3
4. Antikrishtër, 2:18
5. Ata që po mundohen t’ju mashtrojnë, 2:26
6. Djalli, 3:8, 10
7. Kaini, 3:12
8. I ligu, 5:18

IX. VENDNDODHJE QË DUHEN GJETUR NË HARTË – Asnjë

X. PYETJE PËR DISKUTIM

1. Pse përdor 1 Gjonit 1:1-4 kaq shumë folje që lidhen me shqisat (dmth., dëgjuam, pamë, vështruam, prekëm, pamë, dëgjuam)?
2. Pse mund të thoshte dikush që s’kishte mëkat? (1:8)
3. Pse është varg kaq i rëndësishëm 1:9? Për kë bën fjalë?
4. Si lidhet 1:10 me 3:6 dhe 9?
5. Si lidhet 2:2 me Gjonin 3:16?
6. Pse përdoret kaq shpesh fjala “njoh” në 1 Gjonit? Përcakto ngjyrimin e saj kuptimor hebraisht.
7. Ç’do të thotë ose ç’nënkupton fraza e shpeshtë, “nëse themi se...”?

8. Kush janë mësuesit e rremë që po kundërshton Gjoni? Shpjego bindjet e tyre që janë në kundërshtim me krishterimin biblik.
9. Për ç'doktrinë bën fjalë 3:2?
10. Pse janë kaq të vështira për t'u interpretuar vargjet 3:6 dhe 9?
11. Çfarë u thotë 4:8 të krishterëve që luftojnë me të tjerët?
12. Koncepti i Trinisë shfaqet në 4:13-14. Shpjegoje me fjalët e tua.
13. Shpjego 4:19 me fjalët e tua.
14. I Gjonit jep tri prova për t'i siguruar besimtarët që janë të krishterë. Renditi këto tri prova.
15. Pse është varg kaq i rëndësishëm 5:13?
16. A u premtun 5:14-15 besimtarëve se lutjet e tyre do të marrin gjithmonë përgjigje pozitive?
17. Çfarë është mëkati që çon në vdekje? (5:16)
18. A u premtun 5:18 besimtarëve se nuk do të sprovohen ose tundohen kurrë nga Satani? Pse, ose pse jo?
19. Ç'kuptim ka shprehja: "gjithë bota dergjet nën pushtetin e të ligut"?

HYRJE PËR 2 dhe 3 GJONIN

I. SHËNIME HYRËSE

- A. Kjo letër e shkurtër titullohet “3 Gjonit” vetëm për shkak se është paksa më e shkurtër se 2 Gjonit. Unë mendoj se 2 Gjonit dhe 3 Gjonit përbëjnë një mesazh të ekuilibruar për një kishë lokale, ndoshta diku në provincën romake të Azisë së Vogël, nga fundi i shekullit të parë.
- B. 2 Gjonit trajton problemin e predikuesve heretikë dhe shëtitës, ndërsa 3 Gjonit trajton nxitjen për të ndihmuar predikuesit shëtitës të krishterë.
- C. Në letrën e 3 Gjonit përmenden me emër tre burra.
1. Gaji (njeri i perëndishëm në kishën që mori letrën)
 - a. Ka tre Gaj të ndryshëm që përmenden në pjesë të tjera të Biblës: Gaji i Maqedonisë (Veprat 19:29); Gaji i Derbës (Veprat 20:4); dhe Gaji i Korintit (Rom. 16:23; 1 Kor. 1:14).
 - b. Shkrimet e njohura me titullin “Kushtetuta apostolike” e përmendin Gajin e 3 Gjonit si peshkop të Pergamit, i caktuar nga Gjoni.
 2. Diotrefi (një njeri problematik dhe i paperëndishëm në kishën që mori letrën)
 - a. Kjo është përmendja e vetme e këtij njeriu në DhR. Emri i tij është shumë i rrallë dhe do të thotë “i ushqyer nga Zeusi”. Sa ironik është fakti që ai që kishte emrin “Zeus” ishte kundër udhëtarëve, ndonëse “Zeusi” ishte “mbrojtësi i udhëtarëve”.
 - b. Qëndrimi i tij demaskohet në vargjet 9-10.
 3. Demetri (korrieri që ia çoi kësaj kishe lokale letrën e Gjonit)
 - a. Me sa duket, ai ishte një nga misionarët rrugëtues dhe mbartësi i letrës nga apostulli Gjon në Efes.
 - b. Tradita e quajtur “Kushtetuta apostolike” e rendit Demetrin si peshkop të Filadelfias, i caktuar nga apostulli Gjon.
- D. Kisha e hershme përballej me problemin sesi të vlerësonte dhe të mbështeste predikuesit/mësuesit/ungjilltarët shëtitës. Një shkrim i hershëm jokanonik nga shekulli i dytë, i quajtur *Didakeja*, ose *Mësimi i Dymbëdhjetë Apostujve*, jep këto udhëzime:

KAPITULLI 11: PËR MËSUESIT, APOSTUJT DHE PROFETËT

“Prandaj, kushdo që vjen dhe ju mëson të gjitha këto gjëra që janë thënë më parë, pranoheni. Por, nëse vetë mësuesi kthehet dhe mëson një doktrinë tjetër, që e shkatërron këtë, mos e dëgjoni; por nëse mëson gjëra që rrisin drejtësinë dhe njohurin e Zotit, pranoheni si vetë Zotin. Por, në lidhje me apostujt dhe profetët, sipas porosisë së ungjillit, bëni kështu: çdo apostull që vjen te ju duhet ta pranoni si Zotin. Por ai nuk duhet të rrijë më tepër se një ditë; dhe, nëse është e nevojshme, edhe të nesërmen; por, nëse qëndron tri ditë, është profeti rremë. Dhe, kur apostulli largohet, të mos marrë asgjë me vete përveç bukës, derisa të gjejë vend tjetër për të qëndruar; por, nëse kërkon para, është profet i rremë” (f. 380).

KAPITULLI 12: PRITJA E TË KRISHTERËVE

“Por kushdo që thotë në Frymë: “më jepni para, ose diçka tjetër”, mos e dëgjoni; por nëse ju thotë të jepni për hir të ndonjë tjetri që është nevojtar, askush të mos e gjykojë. Por kushdo që vjen në emër të Zotit duhet mikpritur dhe, më pas, do ta provoni dhe do ta njihni; sepse kështu do ta njihni në hollësi. Nëse ai që vjen është udhëtar, ndihmoheni me aq sa mundeni; por nuk duhet të qëndrojë te ju, përveç dy-tri ditë, nëse është e nevojshme. Por, nëse dëshiron të jetojë me ju, dhe është zanatçi, le të punojë e të hajë; por, nëse s’ka zanat, sipas situatave tuaja, përpiquni që, si i krishterë, ai të mos jetojë dembel mes jush. Por, nëse nuk dëshiron të punojë, është matrapaz i Krishtit. Ruhuni që të tillëve t’u qëndroni larg” (f. 381).

II. FJALË DHE FRAZA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

1. “nga fillimi”, 1:1
2. “Perëndia është dritë”, 1:5
3. Rrëfej, 1:9
4. “fëmijët e mi të vegjël”, 2:1
5. Avokat, 2:1
6. Pajtim, 2:2
7. Njoh, 2:3
8. “banon në të”, 2:6
9. “nuk e do botën”, 2:15
10. “ora e fundit”, 2:18
11. Vajosja, 2:27
12. “Fryma, gjaku dhe uji”, 5:8
13. “mëkati që çon në vdekje”, 5:16
14. “ruani veten nga idhujt”, 5:21

III. PERSONA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

1. Fjala e Jetës, 1:2
2. Antikrisht, 2:18 (2 Gjonit v. 7)
3. Antikrishtër, 2:18
4. Zonja e zgjedhur, 2 Gjonit v. 1
5. Fëmijët e saj, 2 Gjonit v. 1
6. “fëmijët e motrës suaj të zgjedhur”, 2 Gjonit v. 13
7. Gaji, 3 Gjonit v. 1
8. Diotrefi, v. 9
9. Demetri, v. 12

IV. VENDNDODHJET QË DUHEN GJETUR NË HARTË – ASNJË

V. PYETJE PËR DISKUTIM

1. Pse përmban 1:1-5 kaq shumë folje që lidhen me pesë shqisat?
2. Pse mund të thoshte dikush që s’kishte mëkat? (1:8)
3. Si lidhet 2:2 me Gjonin 3:16?
4. Shpjego 2:7-8 me fjalët e tua.
5. A bën fjalë 2:12-14 për grupmoshta të ndryshme në kishë, apo për gjithë të krishterët?
6. Shpjego 2:22-23 në dritën e teologjisë gnostike.
7. Cila është e vërteta qendrore e paragrafit 2:28-3:3?
8. Pse është i vështirë interpretimi i 3:6 dhe 9?
9. Si lidhet 3:15 me predikimin në mal?
10. Shpjego 3:20 me fjalët e tua.
11. Si sprovohen frymërat? (4:1-6)
12. A bën fjalë 4:2 për teologjinë gnostike? (shih dhe 2 Gjonit)
13. Cila është e vërteta qendrore e 4:7-24?
14. Në ç’mënyrë funksionon 5:13 si një nga temat e gjithë librit?
15. A u përgjigjet Perëndia të gjitha lutjeve? (5:14-15)
16. Për çfarë bën fjalë 2 Gjonit 10: për familjen, apo për kishën? Pse?
17. A është 3 Gjonit vargu 2 një tekst që premtion shëndet dhe begati financiare?

HYRJE PËR JUDËN

I. SHËNIME HYRËSE

- A. Juda është një letër e frikshme për rrezikun e vazhdueshëm të gabimit, rebelimit dhe gjykimit. Besimtarët duhet të jenë gjithmonë vigjilentë. Mbrojtja e tyre është
1. Thirrja, dashuria dhe fuqia ruajtëse e Atit
 2. Njohja e Shkrimeve, jetesa e përndishme dhe mëshira ndaj bashkëbesimtarëve të lënduar.
- B. Sidoqoftë, pavarësisht paralajmërimeve që përmban, përmbyllja e Judës përbën një nga lutjet më të fuqishme që pohojnë fuqinë ruajtëse të Perëndisë.
- C. Marrëdhënia mes Judës dhe 2 Pjetrit është e paqartë:
1. Cila letër u shkrua e para
 2. Pse janë kaq të ngjashme, por edhe të ndryshme
 3. Si e përshkruan njëra letër herezinë që po vjen, ndërsa tjetra përshkruan herezinë që ka ardhur
 4. Mos ndoshta ekzistonte një letër tjetër e kishës së hershme, ku u bazuan të dy këta autorë?
 5. A përfshihen besimtarët të shembujt e përmendur të rebelimit?
- D. Ky libër tregon drejtpeshimin teologjik mes
1. fuqisë ruajtëse të Perëndisë (v. 1, 24)
 2. dhe detyrës që besimtarët të ruajnë veten (v. 21)

II. AUTORI

- A. Juda (hebraisht *Judah*, ose greqisht, *Judas*) e karakterizon veten me dy shprehje:
1. “skllavi i Jezu Krishtit” – Kjo nuk është e njëjta me atë që përdor zakonisht Pali, ndonëse në anglisht mund të ngjajnë njësoj. Pali vendos gjithmonë në fillim emrin “skllav”, i nejdur nga një frazë përshkruese në rasën gjinore. Këtë gjë bën dhe 2 Pjetrit.
Në dallim nga kjo, rendi i fjalëve te Juda është njësoj si rendi i fjalëve te Jakobi (frazja përshkruese gjinore vendoset e para).
 2. “vëlla i Jakobit” – në DHR ka shumë persona që quhen Jakob, por ky emër në vetvete, pa asnjë cilësim tjetër, na kujton personin e përmendur të Jakobit 1:1. Ai ishte gjysmëvëllai i Jezusit dhe drejtoi kishën e Jerusalemit gjatë udhëtimeve misionare të Palit (shih Veprat 15). Është hamendësuar se, për shkak të përulësisë, të dy këta gjysmëvëllezër të Jezusit zgjodhën të mos identifikoheshin hapur si të lidhur biologjikisht me Jezusin.
- B. Hyrja e thjeshtë e letrës tregon një njeri të mirënjohur dhe aktiv (shih 1 Kor. 9:3) në kishën e hershme, por për të cilin nuk ka mbijetuar asnjë e dhënë tjetër. Nëse këtë letër do ta kishte shkruar dikush në një periudhë të mëvonshme, i cili donte të zgjidhte emrin e një personi të famshëm nga e kaluara (pseudepigrafia), Juda nuk do të kishte qenë kandidat i mirë.
- C. Tradita e hershme se Juda ishte i krishterë hebre dhe gjysmëvëlla i Jezusit (shih Mat. 13:55; Marku 6:3) bazohet në disa supozime:
1. Lidhja familjare me Jakobin (shih Jakobi 1:1)
 2. Përdorimi i shpeshtë i DHV
 3. Përdorimi karakteristik letrar hebre i tresheve:
 - a. tre ngjarje femohimi nga DHV
 - b. tre personazhe nga DHV
 - c. përshëndetja hyrëse
 - (1) tri folje: “thirrur”, “të dashur”, “të ruajtur”
 - (2) tri kërkesa lutjeje: “mëshirë”, “paqe”, “dashuri”

D. Stili dhe forma gjuhësore e Judës është ajo e greqishtes *koine*, të shkruar saktë. Juda duhet të ketë patur njëfarë kulture kozmopolite (shih 1 Kor. 9:5).

Për sa i përket personaliteti, ai ngjason shumë me Jakobin; përdor një qasje të drejtpërdrejtë dhe pa zbulime për të dhënë urdhërimin e jetesës së perëndishme në këtë botë me mëkat dhe rebelim.

III. DATA

A. Nuk ka të dhëna të sigurta, por vetëm hamendësime.

B. Le të rendisim disa nga parametrat:

1. U shkrua gjatë jetës së Judës, nëse ai ishte vëllai i vogël i Jakobit dhe gjysmëvëllai i Jezusit
2. Marrëdhënia e letrës së Judës me 2 Pjetrin. Nga 25 vargjet e Judës, 16 prej tyre (v. 3-18) kanë njëfarë lidhjeje me 2 Pje. 2:1-18. Nëse Pjetri ishte vërtet autori i 2 Pjetrit, atëherë data e Judës është dikur afër jetës së tij (ai vdiq më 64 pas K.). Gjithsesi, është e paqartë se cili citon tjetrin:
 - a. 2 Pjetri citon Judën
 - b. Juda citon 2 Pjetrin
 - c. Të dy përdorin dokumente të hershme katekizmi, ose traditën e kishës

C. Përmbajtja e letrës nënkupton një datë në mes të shekullit të parë. Kishte kaluar kohë e mjaftueshme për shfaqjen e herezive. Prania fizike e apostujve sapo kishte kaluar (v. 18-19). Megjithatë, nuk ishte zhvilluar ende një doktrinë uniforme herezie. Juda përmend problemet morale të mësuesve të rremë, por nuk diskuton për gabime doktrinale. Ai përdor shembuj nga DHV, jo mësimet e Jezusit (citime ose histori të tij).

D. Në *Historia e Kishës* III:19:1-20:6, Euzebi përmend një traditë.

1. Sikur nipërit e Judës u çuan në Romë për të dalë para Domicianit nën akuzën e tradhtisë së lartë
 2. Se ishin pasardhës mbretërorë judenj
 3. Se ishin të afërt të Jezusit të Nazaretit
- Domiciani mbretëroi nga 81-96 pas K.

E. Është e mundshme që data e shkrimit të jetë diku mes viteve '60 dhe '80.

IV. MARRËSIT E LETRËS DHE SHKASI I SHKRIMIT

A. Kisha e hershme nuk ishte monolite nga ana teologjike: edhe vetë apostujt theksonin aspekte të ndryshme të ungjillit. Kur apostujt filluan të vdisnin (ose, të paktën, ishin tepër të paktë në numër dhe tepër larg për t'u konsultuar) dhe Ardhja e Dytë po vonohej, kisha e hershme u përball me sfidën e "standardizimit" të parametrave të pranueshëm për mësimet e ungjillit. DHV, fjalët dhe historitë e Jezusit, si dhe predikimi i apostujve u bënë standardi i kishës.

B. Juda u shkrua në një periudhë të paqëndrueshme dhe paqartësie për sa i përket qartësisë së autoritetit. Besimtarët (një kishë lokale, ose një zonë gjeografike) po përballeshin me një mësimje të madhe gabimi përmes teologjisë/filozofisë hamendësuese. Çfarë dimë për atë herezi:

1. Heretikët ishin pjesë e takimeve të kishës ("festat e dashurisë", shih v. 12)
2. Heretikët ishin mësues të shturur dhe manipulues, që po shkaktonin ndasi mes popullit të Perëndisë (shih v. 19)
3. Heretikët duket se përdornin ose diskutonin për "engjëjt" në teologjinë e tyre
4. Heretikët duket se theksonin "njohurinë" (*gnosis*)

Me atë që sa njohim botën greko-romake të shekujve të parë dhe të dytë, këto tipare nënkuptojnë lëvizjen teologjike/filozofike të quajtur "gnosticism". Sigurisht, fillesat e këtyre heretikëve të shekullit të dytë ishin një element që ekzistonte në një pjesë të mirë të botëkuptimit të Lindjes së Afërt. Elementet e dualizmit, që karakterizon gnosticizmin, janë të pranishme dhe në Pergamenat e

Detit të Vdekur. Shumë nga librat e DHR (Ef.-Kol, letrat pastorale, 1 dhe 2 Gjonit) u shkruan për të goditur një lloj të ngjashëm mësuesish/mësimi të rremë.

V. QËLLIMI

- A. Autori dëshironte të shkruante për shpëtimin e tyre të përbashkët (shih v. 3).
- B. Mësymja e mësimëve dhe mësuesve të rremë në takimet e bashkësisë së brendshme të kishave (shih v. 12) bënë që autori i letrës të trajtojë çështjen përvëluese të “besimit, që iu përçua një herë e përgjithmonë kishës” (shih v. 3, 20). Synimi i tij ishte ortodoksia, por këtë temë e trajtoi nëpërmjet jetesës së perëndishme (ortopraksisë), jo doktrinës (shumë i ngjashëm me Jakobin 2:14-24). Jeta e njerëzve tregon teologjinë e tyre.
- C. Autori dëshiron të inkurajojë besimtarët
 - 1. që të rriten shpirtërisht (shih v. 20)
 - 2. të kenë siguri shpëtimi (shih v. 21, 24-25)
 - 3. të ndihmojnë të rënë (shih v. 22-23)

VI. KANONIZIMI

- A. Në fillim kjo letër u pranua (shih citimin e Klementit të Romës, rreth 94 pas K.), por më vonë u vu në dyshim dhe, në fund, u pranua plotësisht (Këshilli i Nikesë, 325 pas K., dhe Kartagjena, 397 pas K.).
- B. Problemi kryesor për statusin kanonik të këtij libri ishte se citon libra jokanonikë (*1 Enokun* dhe *Ngjijtjen e Moisiut*). Këto libra, sidomos *1 Enokut*, qarkullonin gjerësisht ndër besimtarët e shekullit të parë dhe kishin ndikim teologjik.
 - 1. Pse përbën problem kjo? Mos, ndoshta, nënkupton se librat jokanonikë janë të autoritetshëm?
 - a. DHV citon shkrimet jo të frymëzuara (shih Num. 21:14-15, 26-30 [profecitë e Balaamit në Num. 22-23]; Joz. 10:13; 2 Sam. 1:18 e më tej; 1 Mbre. 11:41; 14:19, 29; 15:7, 23, 31)
 - b. Jezusi përdori burime jokanonike si materiale ilustruese (shih Mat. 23:55)
 - c. Stefani përdori burime jokanonike (shih Veprat 7:4, 14-16)
 - d. Pali përdorte ndonjëherë burime jokanonike
 - (1) Midrashi rabinik, që e përshkruante Krishtin/Mesinë si shkëmb që ndoqi fëmijët e Izraelit gjatë periudhës së endjes në shkretëtirë (shih 1 Kor. 10:4)
 - (2) Emrat e magjistarëve të faraonit në Eks. 7:11, 22; 8:7 (shih 2 Tim. 3:8) janë marrë nga disa shkrime judaike të periudhës ndërthjatore
 - (3) Shkrimtarë grekë
 - a) Poeti Arat (Veprat 17:28)
 - b) Poeti Menandër (1 Kor. 15:33)
 - c) Poeti Epimenid, ose Eurip (Titi 1:12)
 - e. Jakobi përdori traditën rabinike në Jak. 5:17
 - f. Gjoni përdori mitologjinë e kozmologjive të Lindjes së Afërt në Zbu. 12:3
 - 2. Pse i përdori këto burime jokanonike Juda?
 - a. Ndoshta sepse përdorëshin së tepërmi nga mësuesit e rremë
 - b. Ndoshta sepse respektoheshin dhe lexoheshin nga marrësit e letrës së tij
- C. Mbështetja për kanonicitetin e Judës:
 - 1. Citohet ose aludohet nga
 - a. Klementi i Romës (94-97 pas K.)
 - b. Polikarpi (110-50 pas K.)
 - c. Ireneu (130-202 pas K.)
 - d. Tertuliani (150-220 pas K.)
 - e. Athenagora (177 pas K.)
 - f. Origeni (185-254 pas K.)

(Këto janë marrë nga *International Critical Commentary*, f. 305-308)

2. Përmendet me emër në
 - a. Klementi i Aleksandrisë (150-215 pas K.)
 - b. Kirili i Jerusalemit (315-386 pas K.)
 - c. Jeronimi (340-420 pas K.)
 - d. Augustini (400 pas K.)
 3. Renditet në listat kanonike të
 - a. Fragmentit Muratorian (200 pas K.)
 - b. Barokokios (206 pas K.)
 - c. Athanasit (367 pas K.)
 4. Pranohet nga këshillat kishtarë
 - a. Nikea (325 pas K.)
 - b. Hipo (393 pas K.)
 - c. Kartagjena (397 dhe 419 pas K.)
 5. Është i pranishëm në përkthimet
 - a. Latinishtja e Vjetër (150-170 pas K.)
 - b. Rishikimi Siriak, Peshita (shekulli i pestë pas K.)
- D. Kisha e mëvonshme ishte e pasigurt për statusin kanonik (të frymëzuar) të Judës. Euzebi e renditi ndër librat e diskutuar (*Hist.Kish.* III:25). Si Gojarti, ashtu dhe Jeronimi, e përmendin faktin se Juda citoi nga burime jokanonike dhe thanë se kjo ishte arsyeja pse disa e vinin në dyshim kanonicitetin e letrës. U hodh poshtë nga kisha e hershme siriake, së bashku me 2 Pjetrint, 2 dhe 3 Gjonin. Ndoshta, kjo ndodhi për shkak se kjo ishte ajo zonë e perandorisë që u ndikua nga përdorimi gnostik i angjelologjisë judaike. Si rrjedhojë, Juda dhe 1 Pjetri u shtonin zjarrin argumenteve të mësuesve të rremë.
- E. Një fjalë shkurt për *1 Enokun*. U shkrua së pari në hebraisht (por tani ka humbur, me përjashtim të disa pjesëve në aramaisht ndër Pergamenat e Detit të Vdekur), pastaj u përkthye në greqisht (vetëm disa pjesë kanë mbijetuar) dhe, më 600 pas K., u kopjua në etiopisht (vetëm një kopje ka mbijetuar). Ky libër u shkrua në periudhën ndërthjatore, por u redaktua shumë herë, siç e tregon dhe kopja në etiopisht. Pati ndikim të gjerë në kishën e hershme; Tertuliani e citon si shkrim biblik. U citua dhe në *Letrën e Barnabës* (si shkrim biblik), si dhe nga Ireneu dhe Klementi i Aleksandrisë. E humbi pëlqimin e kishës së hershme rreth shekullit të katërt.

VII. FJALË DHE FRAZA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

1. “shpëtimin tonë të përbashkët”, v. 3
2. “besimi, që iu transmetua një herë e përgjithmonë shenjtorëve”, v. 3
3. Shthurje, v. 4
4. “vendi që u takon atyre”, v. 6
5. “vargonjtë e përjetshëm nën errësirë”, v. 6
6. “mishi i huaj”, v. 7
7. “zjarri i përjetshëm”, v. 7
8. Festat e dashurisë, v. 12
9. Të shenjtët, v. 14
10. Lutja në Frymën e Shenjtë, v. 20
11. “i vetmi Perëndi”, v. 25

VIII. PERSONA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

1. “disa njerëz kanë depërtuar tinëzisht”, v. 4
2. “engjëjt, që nuk qëndruan në vendin e tyre”, v. 6
3. Mikael, v. 9
4. Balaam, v. 11

5. Kora, v. 11
6. Enok, v. 14
7. “Atij që është në gjendje”, v. 24

IX. VENDNDODHJE QË DUHEN GJETUR NË HARTË

1. Egjipt, v. 5
2. Sodoma dhe Gomorra, v. 7

X. PYETJE PËR DISKUTIM

1. Për çfarë mësuesish të rremë bën fjalë Juda? (shih 8-13)
2. Pse citon Juda disa libra jokanonikë? (9, 14-15)
3. Si mund ta ruajë besimtari veten në dashurinë e Perëndisë? (21)
4. Cila është tema kryesore e Judës?
5. Cila është marrëdhënia e Judës me 2 Pjetrin?

HYRJE PËR PROFECINË E DHIATËS SË VJETËR

I. HYRJE

A. Shënime hyrëse:

1. Komuniteti besimtar nuk bie dakord për mënyrën si interpretohet profecia. Të vërtetat e tjera janë pranuar si pozicion ortodoks gjatë shekujve, por interpretimi i profecisë, jo.
2. Profecia e DHV ka disa faza të mirëpërcaktuara:
 - a. paramonarkike:
 - (1) individët e quajtur profetë
 - (a) Abrahami – Zan. 20:7
 - (b) Moisiu – Num. 12:6-8; LiP. 18:15; 34:10
 - (c) Aaroni – Eks. 7:1 (zëdhënës i Moisiut)
 - (d) Miriami – Eks. 15:20
 - (e) Medadi dhe Eldadi – Num. 11:24-30
 - (f) Debora – Gjyq. 4:4
 - (g) Anonim – Gjyq. 6:7-10
 - (h) Samueli – 1 Sam. 3:20
 - (2) përmendjet e profetëve si grup – LiP. 13:1-5; 18:20-22
 - (3) grupi ose gida profetike – 1 Sam. 10:5-13; 19:20; 1 Mbre. 20:35, 41; 22:6, 10-13; 2 Mbre. 2:3, 7; 4:1, 38; 5:22; 6:1, etj.
 - (4) Mesia quhet profet – LiP. 18:15-18
 - b. monarkike, por jo me shkrim (ata i drejtohen mbretit):
 - (1) Gadi – 1 Sam. 22:5; 2 Sam. 24:11; 1 Kro. 29:29
 - (2) Natani – 2 Sam. 7:2; 12:25; 1 Mbre. 1:22
 - (3) Ahijahu – 1 Mbre. 11:29
 - (4) Jehu – 1 Mbre. 16:1, 7, 12
 - (5) Anonim – 1 Mbre. 18:4, 13; 20:13, 2
 - (6) Elija – 1 Mbre. 18—2 Mbre. 2
 - (7) Milkajahu – 1 Mbre. 22
 - (8) Elizeu – 2 Mbre. 2:8, 13
 - c. profetët klasikë, që shkruan libra (i drejtohen jo vetëm mbretit, por edhe kombit): Isaiiah-Malakia (me përjashtim të Danielit)

B. Fjalët biblike

1. *Ro'eh* – “shikues”, 1 Sam. 9:9. Vetë kjo fjalë tregon kalimin të fjala *Nabi*. *Ro'eh* vjen nga fjala e përgjithshme “shoh”. Ky person i kuptonte mënyrat dhe planet e Perëndisë, dhe populli shkonte tek ai për t’u siguruar për vullnetin e Perëndisë për një çështje të caktuar.
2. *Hozeh* = “shikues”, 2 Sam. 24:11. Në thelb, është sinonim i *Ro'eh*. Vjen nga një fjalë më e rrallë, “shoh”. Forma si pjesore përdoret më shpesh për të nënkuptuar profetët.
3. *Nabi'* = “profet”, nga rrënja e ngjashme e fjalës akademike *Nabu* = “thërras” dhe arabisht *Naba'a* = “shpall”. Kjo është fjala më e përhapur në Dhiatën e Vjetër për të përshkruar një profet. Përdoret mbi 300 herë. Etimologjia e saktë është e paqartë, por “thërras” duket se është përgjigjja më e mirë deri tani. Ndoshta, kuptimi i saj vjen nga përshkrimi që i bën JHVH marrëdhënies së Moisiut me faraonin nëpërmjet Aronit (shih Eks. 4:10-16; 7:1; LiP. 5:5. Profeti është dikush që i flet popullit në emër të Perëndisë (Amosi 3:8; Jer. 1:7, 17; Ezek. 3:4).
4. Të tria këto fjalë përdoren për ofiqin e profetit në 1 Kro. 29:29; Samueli – *Ro'eh*; Natani – *Nabi'*, dhe Gadi – *Hozeh*.
5. Fraza, *ish ha-'elohim*, “burri i Perëndisë”, është përcaktim më i gjerë për zëdhënësin e Perëndisë. Përdoret rreth 76 herë në DHV në kuptimin e fjalës “profet”.
6. Fjala “profet” ka origjinë nga gjuha greke. Vjen nga fjalët: (1) pro = “përpara” ose “për”; (2) femi = “flas”.

II. PËRCAKTIMI I PROFECISË

- A. Fjala “profeci” ka fushë më të gjerë kuptimore në hebraisht sesa në shqip. Librat historikë, nga Jozueu tek Mbretërit (me përjashtim të Ruthi), quhen “profetët e hershëm” nga judenjtë. Si Abrahami (Zan. 20:7; Psa. 105:5) ashtu dhe Moisiut (LiP. 18:18) quhen profetë (si dhe Miriami, Eks. 15:20). Prandaj, ruhuni nga një përcaktim i presupozuar shqip!
- B. “Profetizmi mund të përcaktohet me të drejtë si ai botëkuptim për historinë që pranon kuptim vetëm në kuadër të preokupimit, qëllimit dhe pjesëmarrjes hyjnore”, *Interpreter’s Dictionary of the Bible*, vëll. 3, f. 896.
- C. “Profeti nuk është, as filozof, as teolog sistematik, por ndërmjetës besëlidhjeje që i përçon popullit të Perëndisë fjalën e tij në mënyrë që t’ua formësojë të ardhmen nëpërmjet reformimit të së tashmes”, “Prophets and Prophecy,” *Encyclopedia Judaica* vëll. 13, f. 1152.

III. QËLLIMI I PROFECISË

- A. Profecia është një mënyrë sesi Perëndia i flet popullit të tij, duke i siguruar drejtim në kontekstin e tyre të momentin, si dhe shpresë në faktin se ai kontrollon jetën e tyre dhe ngjarjet në botë. Mesazhi i profetëve, në thelb, është kolektiv. Synon të qortojë, inkurajojë, nxisë besim dhe pendim, dhe ta informojë popullin e Perëndisë për të dhe për planet e tij. Kësaj i duhet shtuar se, shpesh, profecia përdoret për të zbuluar qartë faktin se Perëndia ka zgjedhur dikë si zëdhënës (LiP. 13:1-3; 18:20-22). Në fund fare, profeti absolut do të jetë Mesia.
- B. Shpesh, profeti merrte një krizë historike ose teologjike të kohës dhe e projektonte në një kontakt eskatologjik. Kjo pikëpamje e historisë në lidhje me fundin botës është unike për Izraelin dhe për mënyrën si Izraeli e kuptonte zgjedhjen hyjnore dhe premtimet e besëlidhjes.
- C. Ofiqi i profetit duket se drejtpeshon (Jer. 18:18) ose zëvendëson ofiqin e kryepriftit si mënyrë për të mësuar vullnetin e Perëndisë. Urimi dhe Thumimi tejkaloheh nga një mesazh gojor nëpërmjet zëdhënësit të Perëndisë. Po kështu, ofiqi i profetit duket se u zhduk në Izrael pas Malakisë. Nuk rishfaqet më për 400 derisa lind Gjon Pagëzori. Është e paqartë sesi lidhet dhuntia e “profecisë” së Dhiatës së Re me Dhiatën e Vjetër. Profetët e Dhiatës së Re (Veprat 11:27-28; 13:1; 14:29, 32, 37; 15:32; 1 Kor. 12:10, 28-29; Efe. 4:11) nuk janë zbulues të një zbuluese të re për Shkrimin, por janë shpallës dhe parashpallës të vullnetit të Perëndisë në situata të besëlidhjes.
- D. Profecia nuk është vetëm ose kryesisht parashikuese nga natyra. Parashikimi është vetëm një mënyrë për të vërtetuar ofiqin dhe mesazhin e profetit, por duhet vënë re se “më pak se 2% e profecive në DHV janë mesianike. Më pak se 5% përshkruajnë në mënyrë të veçantë Epokën e Besëlidhjes së Re. Më pak se 1% prej tyre kanë të bëjnë me ngjarjet e ardhshme”. (Fee & Stuart, *How to Read the Bible For All Its Worth*, f. 166)
- E. Profetët përfaqësojnë Perëndinë para popullit, ndërsa priftërinjtë përfaqësojnë popullin para Perëndisë. Ky është një pohim i përgjithshëm. Ka dhe përjashtime, si Habakuku, që i shtron pyetje Perëndisë.
- F. Një arsye pse është e vështirë të kuptojmë profetët është se nuk e dimë sesi janë strukturuar librat e tyre. Nuk kanë rend kronologjik. Duken si libra tematikë, por jo gjithmonë në mënyrën siç e presim. Shpesh, duket se nuk kemi një kontekst të qartë historik, apo periudhë të caktuar, apo ndarje të qartë mes profecive. Këta libra janë të vështirë: (1) që të lexohen me një të ulur; (2) që t’i përvijojmë sipas tematikës; dhe (3) që të themi me siguri të vërtetën qendrore apo synimin e autorit për çdo profeci të dhënë.

IV. TIPARET E PROFECISË

- A. Në Dhiatën e Vjetër duket se kemi një zhvillim të konceptit të “profetit” dhe “profecisë”. Në Izraelin e lashtë, u zhvillua një grupim profetësh, të udhëhequr nga një drejtues i fortë karizmatik, si Elija ose Elizeu. Nganjëherë, fraza “bijtë e profetëve” përdorej për të përcaktuar pikërisht këtë grupim (2 Mbre. 2). Profetët karakterizoheshin nga forma të ndryshme ekstaze (1 Sam. 10:10-13; 19:18-24).
- B. Megjithatë, kjo periudhë kaloi shpejt dhe u zëvendësua nga profetët si individë. Këta ishin ata profetë (të vërtetë ose të rremë) që i bashkoheshin mbretit, dhe jetonin në pallatin mbretëror (Gadi, Natani). Po kështu, kishte dhe syresh që ishin të pavarur, nganjëherë plotësisht të palidhur me gjendjen e ndenur të shoqërisë izraelite (Amosi). Ata ishin meshkuj ose femra (2 Mbre. 22:14).
- C. Shpesh, profeti ishte zbulues i së ardhmes, e kushtëzuar nga reagimi i atypëratyshëm i njeriut. Shpesh, detyra e profetit ishte të shpaloste planin universal të Perëndisë për krijimin e tij, që nuk mund të ndikohet nga reagimi njerëzor. Ky plan universal eskatologjik është unik në profetët e Lindjes së Afërt. Parashikimi dhe besnikëria ndaj besëlidhjes janë dy pikat kyçe të mesazheve profetike (shih Fee dhe Stuart, f. 150). Kjo nënkupton se profetët kishin, pikësepari, fokus kolektiv. Zakonisht, por jo në mënyrë përjashtuese, ata i drejtohen kombit.
- D. Shumica e materialeve profetike paraqitej gojarisht. Më vonë, kombinohej me anë të tematikës, kronologjisë ose motiveve të tjera të letërsisë së Lindjes së Afërt, që tani nuk janë më të disponueshme për ne. Për shkak se ishte gojore, nuk strukturohej si prozë e shkruar. Kjo i bën këta libra të vështirë për t’u lexuar nga fillimi në fund, dhe të vështirë për t’u kuptuar pa patur një kontekst të caktuar historik.
- E. Profetët përdorin motive të ndryshme për të përçuar mesazhet e tyre:
1. Skena e Gjyqit – Perëndia e thërret popullin e vet në gjyq; shpesh, bëhet fjalë për një çështje gjyqësore divorci, ku JHVH refuzon gruan e vet (Izraelin) për besnikërinë e saj (Osea 4; Mikea 6).
 2. Vajtimit Funerali – metrika e veçantë e këtij lloji mesazhi dhe fjala tipike e tij “Vaj medet!” e veçon si formë të veçantë (Isaia 5; Habakuku 2).
 3. Shpalja e Bekimit të Besëlidhjes – theksohet natyra e kushtëzuar e besëlidhjes dhe shpallen pasojat (negative ose pozitive) të kësaj për të ardhmen (LiP. 27-28).

V. CILËSITË BIBLIKE PËR VËRTETIMIN E PROFETIT TË VËRTETË

- A. Ligji i Përtërirë 13:1-5 (parashikime/shenja)
- B. Ligji i Përtërirë 18:9-22 (profetët e rremë/profetët e vërtetë)
- C. Si burrat, ashtu dhe gratë, thirren dhe përcaktohen si profetë ose profetesha
1. Miriami – Eks. 15
 2. Debora – Gjyq. 4:4-6
 3. Hulda – 2 Mbre. 22:14-20; 2 Kro. 34:22-28
- D. Në kulturat përreth, profetët vërtetoheshin me anë të yshtjes. Kurse në Izrael kjo bëhej me anë të:
1. një prove teologjike – emri i JHVH
 2. një prove historike – parashikime të sakta.

VI. UDHËZIME TË DOBISHME PËR INTERPRETIMIN E PROFECISË

- A. Gjej synimin e profetit (ose redaktorit të librit) duke vërejtur kontekstin historik dhe kontekstin letrar të çdo profecie. Zakonisht, bën fjalë për shkeljen që i bën Izraeli në mënyra të ndryshme besëlidhjes së Moisiut.

- B. Lexo dhe interpreto gjithë profecinë, jo vetëm një pjesë të saj; përvijojë sipas përmbajtjes. Shih sesi lidhet ajo me profecitë e tjera në kontekst. Përpiqu të përvijosh gjithë librin.
- C. Bëj interpretim të fjalëpërfjalshëm të pasazhit derisa një element i vetë tekstit të të drejtojë tek përdorimi i figurshëm; pastaj, shkruajë gjuhën e figurshme në formë proze.
- D. Analizo veprimin simbolik në kuadër të kontekstit historike dhe të pasazheve paralele. Mos harro se kjo letërsi e Lindjes së Afërt nuk është letërsi perëndimore, apo moderne.
- E. Trajtoje me kujdes profecinë parashikuese:
 1. A ka vlerë vetëm për kohën e autorit?
 2. A u përmbush më vonë në historinë e Izraelit?
 3. Apo bëhet fjalë për ngjarje që do të ndodhin në të ardhmen?
 4. A ka kjo profeci një përmbushje të kohës, apo një përmbushje në të ardhmen?
 5. Lejo që përgjigjet e tua të udhëhiqen nga autorët e Biblës, jo nga autorët modernë.
- F. Preokupime të veçanta:
 1. A ndikohet parashikimi nga përgjigja e kushtëzuar e njeriut?
 2. A është e qartë se kujt i drejtohet profecia (dhe pse)?
 3. A është e mundur, si biblikisht ashtu dhe/ose historikisht, që të kemi përmbushje të shumëfishta?
 4. Autorët e DHR, nën frymëzim, ishin në gjendje ta shihnin Mesinë në shumë pasazhe të DHV që s'janë të qarta për ne. Ata duket se përdorin tiplogjinë, ose lojën e fjalëve. Meqë ne s'jemi të frymëzuar, më mirë t'ua lemë atyre këtë qasje.

VII. LIBRA TË DOBISHËM

- A. *A Guide to Biblical Prophecy*, Carl E. Armerding dhe W. Ward Gasque
- B. *How to Read the Bible for All It Is Worth*, Gordon Fee dhe Douglas Stuart
- C. *My Servants the Prophets*, Edward J. Young
- D. *The Expositor's Bible Commentary*, vëll. 6 "Isaiah - Ezekiel," Zondervan
- E. *The Prophecies of Isaiah*, nga J. A. Alexander, 1976, Zondervan
- F. *Exposition of Isaiah*, H. C. Leupold, 1971, Baker
- G. *A Study Guide Commentary, "Isaiah"* nga D. David Garland, 1978, Zondervan

ARTIKULL HYRËS KYÇ – ZBULESA

(Pse të krishterët kanë kaq shumë interpretime dogmatike për Zbulesën)

Përgjatë këtyre viteve të studimit tim të eskatologjisë, kam mësuar se shumica e të krishterëve nuk kanë ose nuk dëshirojnë një kronoloji të zhvilluar, të sistemuar të kohëve të fundit. Ka disa të krishterë të cilët fokusohen ose diplomohen në këtë zonë të krishterimit për arsye teologjike, psikologjike ose denominacionale. Këta të krishterë duket se fiksohen pas mënyrës si do të përfundojë gjithçka, dhe në njëfarë mënyre humbasin urgjencën e ungjillit! Besimtarët nuk mund të ndikojnë tek plani eskatologjik i Perëndisë (plani i fundit të kohërave), por mund të marrin pjesë në mandatin e ungjillit (shih Mate. 28:19-20; Luka 24:46-47; Vep. e Apost. 1:8). Shumica e besimtarëve pranojnë se do të ketë një ardhje të dytë të Krishtit dhe një kulm të kohëve të fundit të premtimeve të Perëndisë. Problemet interpretuese lindin nga mënyra se si e kuptojmë këtë kulm të përkohshëm nga disa paradokse biblike (shih Special Topic: Paradox in Scripture [Temë e Veçantë: Paradokse në Shkrime]).

1. Tensioni midis modeleve profetike të Besëlidhjes së Vjetër dhe modeleve apostolike të Dhjatës së Re
 2. Tensioni midis monoteizmit të Biblës (një Perëndi për të gjithë) dhe zgjedhjes së Izraelit (një popull i veçantë)
 3. Tensioni midis aspekteve të kushtëzuara të besëlidhjeve dhe premtimeve biblike (“nëse...atëherë”) dhe besnikërisë së pakushtëzuar të Perëndisë ndaj shpengimit të njerëzimit të rënë
 4. Tensioni midis zhanreve letrarë të Lindjes së Afërme dhe modeleve letrare moderne perëndimore
 5. Tensioni midis mbretërisë së Perëndisë si të tashme, por edhe të ardhme
 6. Tensioni midis besimit në rikthimin e pashmangshëm të Krishtit dhe besimit se duhet të ndodhin më parë disa ngjarje.
- Le t'i diskutojmë këto tensione sipas radhës.

TENSIONI I PARË (kategoritë raciale, kombësore dhe gjeografike të Dhjatës së Vjetër përkundrejt të gjithë besimtarëve në të gjithë botën)

Profetët e Dhjatës së Vjetër parashikojnë rimëkëmbjen e një mbretërie hebraike në Palestinë të qëndëruar në Jerusalem ku të gjitha kombet e tokës të mbledhen për të lavdëruar dhe për t'i shërbyer një drejtuesi Davidik, por as Jezusi dhe as apostujt e Dhjatës së Re nuk fokusohen në këtë axhendë. A nuk është e frymëzuar Dhjata e Vjetër (shih Mate. 5:17-19)? A kanë lënë jashtë autorët e Dhjatës së Re ngjarje thelbësore të kohëve të fundit? Këto janë disa burime informacioni mbi fundin e botës.

1. Profetët e Dhjatës së Vjetër (Isaia, Mikea, Malakia)
2. Shkrimtarët apokaliptikë të Dhjatës së Vjetër (shih Ezekieli 37-39; Danieli 7-12; Zakaria)
3. Shkrimtarët apokaliptikë hebraikë jo-kanonikë, të periudhës midis dy dhjatave (si [1 *Enokut*, për të cilin aludohet tek Juda])
4. Vetë Jezusi (shih Mate. 24; Mark 13; Luka 21)
5. Shkrimet e Palit (shih 1 Kor. 15; 2 Kor. 5; 1 Thes. 4-5; 2 Thes. 2)
6. Shkrimet e Gjonit (1 Gjoni dhe Zbulesa)

A mësojnë të gjitha këto qartazi mbi një plan të kohëve të fundit (ndodhitë, kronologjia, personat)? Nëse jo, pse? A nuk janë ato të gjitha të frymëzuara (përveç shkrimeve hebraike të periudhës midis dy dhjatave)?

Fryma iu zbuloi të vërteta shkrimtarëve të Dhjatës së Vjetër në terma dhe kategori që ata mund të kuptonin. Megjithatë, përmes zbulesave progresive, Fryma i ka zgjeruar këto koncepte eskatologjike të Dhjatës së Vjetër në një qëllim universal (“misteri i Krishtit”, shih Efes. 2:11-3:13). Këtu janë disa shembuj:

1. Qyteti i Jeruzalemit në Dhjatën e Vjetër përdoret si një metaforë për popullin e Perëndisë (Zion), por është projektuar në Dhjatën e Re si një term i cili shpreh pranimin e Perëndisë ndaj të gjithë njerëzve të penduar dhe besimtarë (“Jeruzalemi i ri” i Zbulesës 21-22). Zgjerimi teologjik i një qyteti të vërtetë fizik në një popull të ri të Perëndisë (hebrej dhe johebrej besimtarë) paralajmërohet në premtimin e Perëndisë për të shpenguar njerëzimin e rënë në Zan. 3:15, edhe përpara se të kishte ndonjë hebre apo kryeqytet hebre. Edhe thirrja e Abrahamit (shih Zan. 12:1-3) përfshinte johebrejtë (shih Zan. 12:3; Eksod. 19:5). Shih Temë e Veçantë: Plani i Përrjetshëm Shpengues i YHËH.
2. Në Dhjatën e Vjetër armiqtë e popullit të Perëndisë janë kombet rrethuese të Lindjes së Afërme Antike, por në Dhjatën e Re ata të gjithë janë zgjeruar tek të gjithë popujt jobesimtarë, kundër-Perëndisë, të frymëzuar nga Satani. Beteja ka lëvizur nga një konflikt gjeografik, rajonal në një konflikt mbarëbotëror, kozmik (shih Kolosianëve).

3. Premtimi i një toke e cila është kaq integrale në Dhjatën e Vjetër (premtimet e patriarkëve në Zanafillë, shih Zan. 12:7; 13:15; 15:7,15,16; 7:8) tanimë është bërë e gjithë toka. Jeruzalemi i ri zbrit poshtë tek një tokë e rikrijuar, jo vetëm apo ekskluzivisht tek Lindja e Afërme (shih Zbulesa 21-22).

4. Disa shembuj të tjerë të koncepteve profetike të Dhjatës së Vjetër të cilët zgjerohen janë: (1) Fara e Abrahamit tanimë është rrethprerja shpirtërore (shih Rom. 2:28-29); (2) Populli i besëlidhjes tani përfshin johebrenjtë (shih Hos. 1:10; 2:23, cituar tek Rom. 9:24-26; gjithashtu Lev. 26:12; Eksod. 29:45, cituar tek 2 Kor. 6:16-18 dhe Eksod. 19:5; Ligji i Për. 14:2, cituar tek Titit 2:14); (3) Tempulli është tani Jezusi (shih Mate. 26:61; 27:40; Gjoni 2:19-21) dhe përmes Tij dhe kishës lokale (shih 1 Kor. 3:16) ose besimtarëve individualë (shih 1 Kor. 6:19); (4) Edhe Izraeli dhe frazat karakteristike përshkruese për të tek Dhjata e Vjetër tani i referohen të gjithë popullit të Perëndisë (psh., "Izraeli", shih Rom. 9:6; Gal. 6:16, "mbretëri priftërinjsh," shih 1 Pjet. 2:5, 9-10; Zbu. 1:6).

Modeli profetik është përmbushur, zgjeruar dhe tani është më përfshirës. Jezusi dhe shkrimtarët apostolikë nuk e prezantojnë fundin e kohërave në të njëjtën mënyrë si profetët e Dhjatës së Vjetër (shih Martin Ëyngaarden [Martin Vingardën], *The Future of The Kingdom in Prophecy and Fulfillment* [E Ardhmja e Mbretërisë në Profeci dhe Përmbushje]). Interpretuesit modernë të cilët përpiqen ta bëjnë modelin e Dhjatës së Vjetër të drejtpërdrejtë ose normativ e kthejnë librin e Zbulesës në një libër tërësisht hebraik dhe e sforcjnë kuptimin e tij në fraza të atomizuara dhe të paqarta të Jezusit dhe Palit! Shkrimtarët e Dhjatës së Re nuk mohojnë profetët e Dhjatës së Vjetër, por e tregojnë nënkuptimin e tyre përfundimtar dhe universal. Nuk ka asnjë sistem të organizuar e logjik për eskatologjinë e Jezusit apo të Palit. Qëllimi i tyre është kryesisht shpengues ose pastoral.

Megjithatë, edhe brenda Dhjatës së Re ka një tension. Nuk ka një sistemizim të qartë të ndodhive eskatologjike. Në shumë mënyra Zbulesa çuditërisht përdor aludime të Dhjatës së Vjetër për të përshkruar fundin në vend të mësimëve të Jezusit (shih Mateu 24; Mark 13)! Ajo ndjek zhanrin letrar të nisur nga Ezekieli, Danieli dhe Zakaria, por të zhvilluar gjatë periudhës midis dy dhjatave (literatura hebraike apokaliptike). Kjo mund të ketë qënë mënyra e Gjonit për të lidhur Besëlidhjen e Re dhe të Vjetër. Ajo tregon modelin e vjetër të rebelimit njerëzor dhe të përkushtimit të Perëndisë për shpengim! Por duhet theksuar se pavarësisht se Zbulesa përdor gjuhën, personat dhe ndodhitë e Dhjatës së Vjetër, ajo i ri-interpreton ato në dritën e Romës së shekullit të parë (shih Zbulesa 17).

TENSIONI I DYTË (monoteizmi përkundrejt një populli të zgjedhur)

Theksi biblik është në një Perëndi personal, shpirtëror, krijues-shpengues (shih Eksod. 8:10; Isa. 44:24; 45:5-7,14,18,21-22; 46:9; Jer. 10:6-7). Veçantia e Dhjatës së Vjetër në kohën e saj ishte tek monoteizmi i saj. Të gjitha kombet rreth e përqark ishin politeiste. Një-jësia e Perëndisë është zemra e zbulesës së Dhjatës së Vjetër (shih Ligji i Përt. 6:4). Krijimi është një skenë për qëllimin e marrëdhënies midis Perëndisë dhe njerëzimit, të krijuar në imazhin dhe shëmbëlltyrën e Tij (shih Zan. 1:26-27). Megjithatë, njerëzimi u rebelua, duke mëkatuar kundër dashurisë, drejtimit dhe qëllimit të Perëndisë (shih Zanafilla 3). Dashuria dhe qëllimi i Perëndisë ishin aq të forta dhe të sigurta sa Ai premtoi të shpengonte njerëzimin e rënë (shih Zan. 3:15)!

Tensioni rritet kur Perëndia zgjedh që të përdorë një njeri, një familje, një komb për të arritur pjesën tjetër të njerëzimit. Zgjedhja e Perëndisë për Abrahamin (shih Zanafilla 12; 15; 17; 18) dhe për hebrenjtë si një mbretëri priftërinjsh (shih Eksod. 19:4-6) shkaktoi krenari në vend të shërbesës, përjashtim në vend të përfshirjes. Thirrja e Perëndisë për Abrahamin përfshinte bekimin e qëllimshëm të të gjithë njerëzimit (shih Zan. 12:3). Duhet të mbajmë mend dhe të theksojmë se zgjedhja e Dhjatës së Vjetër ishte për shërbesë, jo për shpëtim. I gjithë Izraeli nuk ishte kurrë në drejtësi me Perëndinë, nuk ishte kurrë i shpëtuar përjetësisht bazuar vetëm tek e drejta e tyre e dhënë në lidhje (shih Gjoni 8:31-59; Mate. 3:9), por me besimin personal dhe bindjen personale (shih Zan. 15:6, cituar tek Rom. 4:3,9,22; Gal. 3:6). Izraeli e humbi misionin e tij (kisha tani është një mbretëri priftërinjsh, shih Zbu. 1:6; 1 Pjet.2:5,9) dhe e ktheu mandatin në një privilegj, shërbesën në një qëndrim të veçantë! Perëndia zgjodhi një për të zgjedhur të gjithë!

TENSIONI I TRETË (besëlidhje të kushtëzuara përkundrejt besëlidhjeve të pakushtëzuara)

Gjendet një tension ose paradoks teologjik midis besëlidhjeve të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara. Është me siguri e vërtetë që qëllimi / plani shpengues i Perëndisë është i pakushtëzuar (shih Zan. 15:12-21). Megjithatë, përgjigja e mandatuar njerëzore është gjithnjë e kushtëzuar!

Forma e përsëritur "nëse... atëherë" shfaqet si në Dhjatën e Vjetër ashtu edhe në Dhjatën e Re. Perëndia është besnik; njerëzimi nuk është besnik. Ky tension ka shkaktuar shumë paqartësi. Interpretuesit janë prirur të

fokusohen vetëm tek një nga “brirët e dilemës”, besnikëria e Perëndisë ose përpjekjet njerëzore, sovraniteti i Perëndisë ose vullneti i lirë i njerëzimit. Të dyja janë biblike dhe të nevojshme.

Kjo lidhet me eskatologjinë, premtimin e Perëndisë në Dhjatën e Vjetër ndaj Izraelit. Nëse Perëndia e premtoi, është e vendosur! Perëndia është i lidhur me premtimet e Tij; reputacioni i Tij është në mes (shih Ezek. 36:22-38). Besëlidhjet e pakushtëzuara dhe të kushtëzuara takohen tek Krishti (shih Isaia 53), jo tek Izraeli! Besnikëria përfundimtare e Perëndisë shtrihet në shpengimin e të gjithëve të cilët do të pendohen dhe do të besojnë, jo në atësinë apo mëmësinë e personit! Krishti, jo Izraeli, është çelësi për të gjitha besëlidhjet dhe premtimet e Perëndisë. Nëse ka një parantezë teologjike në Bibël, ajo nuk është kisha por Izraeli (shih Veprat e Apostujve 7 dhe Galatasve 3).

Misioni botëror i shpalljes së ungjillit ka kaluar tek Kisha (shih Mate. 28:19-20; Luka 24:47; Veprat e Apo. 1:8). Ajo është ende një besëlidhje e kushtëzuar! Kjo nuk nënkupton se Perëndia i ka refuzuar plotësisht hebrenjtë (shih Romakëve 9-11). Mund të ketë një vend dhe qëllim për Izraelin besimtar të fundit të kohërave (shih Zak. 12:10).

TENSIONI I KATËRT (modele të drejtëpërdrejta të Lindjes së Afërme përkundrejt modeleve perëndimore)

Gjinia letrare është një element kritik në interpretimin e saktë të Biblës. Kisha u zhvillua në rrethana kulturore (greke) perëndimore. Literatura lindore është shumë më tepër figurative, metaforike dhe simbolike se sa modelet letrare të kulturës perëndimore moderne. Ajo fokusohet tek njerëzit, takimet dhe ndodhitë më tepër se sa në të vërteta të përmbledhura. Të krishterët kanë qënë fajtorë që kanë përdorur historinë dhe modelet e tyre letrare për të interpretuar profecinë biblike (të dyja, Dhjatën e Vjetër dhe Dhjatën e Re). Çdo brez dhe entitet gjeografik ka përdorur kulturën, historinë dhe veçorinë e vet për të interpretuar Zbulesën. Secili prej tyre ka gabuar! Është arrogante të mendosh se kultura moderne perëndimore është fokusi i profecisë biblike!

Gjinia letrare në të cilin autori original i frymëzuar zgjedh të shkruajë është një kontratë letrare me lexuesin. Libri i Zbulesës nuk është një narrativë historike. Ai është një kombinim i një letre (kapitujt 1-3), profecisë dhe më së shumti letërsisë apokaliptike. Ta bësh Biblën të thotë më shumë nga çfarë ka pasur për qëllim autori original është po aq e gabuar sa ta bësh atë të thotë më pak nga çfarë ka pasur ai për qëllim! Arroganca dhe dogmatizma e interpretuesve janë edhe më të papërshtatshme në një libër si Zbulesa.

Kisha nuk ka rënë kurrë dakord në një interpretim të saktë të Zbulesës. Shqetësimi im është që të dëgjoj dhe të merrem me të gjithë Biblën, jo me disa pjesë të zgjedhura. Botëkuptimi lindor i Biblës prezanton të vërteta në çifte të mbushura me tension. Trendi ynë perëndimor drejt së vërtetës propozicionale nuk është i pavlefshëm, por i paekuilibruar! Unë mendoj se është e mundur të largosh të paktën disa nga rrugët pa krye në interpretimin e Zbulesës duke vënë re qëllimin e saj të ndryshueshëm ndaj brezave pasardhës të besimtarëve. Është e dukshme për shumicën e interpretuesve se Zbulesa duhet të interpretohet nën dritën e ditës së saj dhe zhanrit të saj. Një përfaqje historike ndaj Zbulesës duhet të merret me atë që lexuesit e parë do të kishin apo mund të kishin kuptuar. Në shumë mënyra interpretuesit modernë e kanë humbur kuptimin e shumë simboleve të librit. Shtysa kryesore fillestare e librit të Zbulesës ishte të inkurajonte besimtarët e persekutuar. Ajo tregonte kontrollin që ka Perëndia në histori (siç bënë dhe profetët e Dhjatës së Vjetër); ajo pohonte se historia po lëviz drejt një përmbyllje, gjykimi apo bekimi të përcaktuar (siç bënë profetët e Dhjatës së Vjetër). Ajo pohonte dashurinë, praninë, fuqinë dhe sovranitetin e Perëndisë në terma apokaliptikë hebraikë të shekullit të parë!

Ky libër funksionon në këto mënyra të njëjta teologjike ndaj çdo brezi besimtarësh. Ai përshkruan përlëshjen kozmike midis së mirës dhe së keqes. Detajet e shekullit të parë mund të kenë humbur për ne, por jo të vërtetat e fuqishme dhe ngushëlluese. Kur interpretuesit modernë perëndimorë përpriqen që t'i sforcjnë detajet e Zbulesës në historinë e tyre bashkëkohore, rrjedha e interpretimeve të gabuara vazhdon!

Është mjaft e mundur që detajet e librit të mund të bëhen sërish të drejtëpërdrejta në mënyrë të habitshme (siç ishte Dhjata e Vjetër në lidhje me lindjen, jetën dhe vdekjen e Krishtit) për brezin e fundit të besimtarëve ndërsa ata përballen me sulmin e furishëm të një lideri dhe kulture anti-Perëndi (shih 2 Thesalonikasve 2). Asnjë nuk mund t'i shohë këto përmbushje të drejtëpërdrejta të Zbulesës deri sa edhe fjalët e Jezusit (shih Mateu 24; Marku 13 dhe Luka 21) dhe Palit (shih 1 Korintasve 15; 1 Thesalonikasve 4-5 dhe 2 Thesalonikasve 2) të bëhen të dukshme historikisht. Hamendësimi, spekulimi dhe dogmatizma, janë të gjitha të papërshtatshme. Letërsia apokaliptike e lejon këtë fleksibilitet. Falenderojmë Perëndinë për pamjet dhe simbolet që e tejkalojnë narrativën historike! Perëndia ka gjithçka nën kontroll; Ai sundon; Ai vjen!

Pjesa më e madhe e komentareve modernë e humbasin qëllimin e zhanrit! Interpretuesit modernë shpesh kërkojnë një sistem të qartë dhe logjik të teologjisë dhe nuk janë larg të qenit të drejtë me një zhanër të paqartë, simbolik dhe dramatik të letërsisë apokaliptike hebraike. Kjo e vërtetë është shprehur mire nga Ralph P. Martin

[Ralf Pi Martin] në artikullin e tij: “Approaches to New Testament Exegesis [Përjasje ndaj Eksegjezës së Dhjatës së Re],” në librin *New Testament Interpretation [Interpretime të Dhjatës së Re]*, të redaktuar nga I. Howard Marshall [Aj Houërd Marshëll]:

“Nëse ne nuk e dallojmë cilësinë dramatike të këtij shkrimi dhe nuk e rikujtojmë mënyrën në të cilën gjuha po përdoret si një mjet për të shprehur të vërtetën fetare, ne do të gabojmë rëndë në të kuptuarin tonë të Apokalipsit, dhe do të përpiqemi gabimisht të interpretojmë vizionet e tij si të ishte një libër me prozë të drejtëpërdrejtë dhe të kishte për qëllim të përshkruante ndodhi të historisë empirike dhe të datueshme. Të përpiqesh të arrish rrjedhën e dytë është të rendësh tek të gjitha llojet e problemeve të interpretimit. Edhe më seriozisht ajo shpie në një deformim të qëllimit thelbësor të apokalipsit dhe në këtë mënyrë humbet vlera e madhe e kësaj pjese të Dhjatës së Re si një pranim dramatik në gjuhën mitopoetike të sovranitetit të Perëndisë në Krishtin dhe paradoksin e sundimit të tij i cili përzien së bashku fuqinë dhe dashurinë (shih Zbu. 5:5,6; Luani është Qengji)”, (fq. 235).

W. Randolph Tate [Dabëllju Rendolf Tejt] në librin e tij *Interpretime Biblike*:

“Asnjë zhanër tjetër i Biblës nuk është lexuar kaq me zell me rezultate kaq depresuese si apokalipsi, sidomos librat e Danielit dhe të Zbulesës. Ky zhanër ka vuajtur nga një histori shkatërruese keqinterpretimi për shkak të një keqkuptimi themelor të formave, strukturës dhe qëllimit të tij letrar. Për shkak të pretendimit të tij për të zbuluar atë që do të ndodhë së shpejti, apokalipsi është parë si një hartë treguese për në të ardhmen dhe një plan i së ardhmes. Gabimi tragjik në këtë pikëpamje është supozimi se kuadri i referencës së librave është epoka e lexuesit bashkëkohor dhe jo ajo e autorit. Kjo përjasje e keqdrejtuar tek apokalipsi (sidomos tek Zbulesa) i trajton veprat si të ishin një kriptogramë, me anë të së cilës ndodhitë bashkëkohore mund të përdoren për të interpretuar simbolin e tekstit. Së pari, interpretuesi duhet të dallojë se apokalipsi komunikon mesazhin e tij përmes simbolizmit. Të interpretosh një simbol fjalë për fjalë kur ai është metaforik është thjesht të keqinterpretosh. Çështja nuk është nëse ndodhitë në apokalips janë historike. Ndodhitë mund të jenë historike; mund të kenë ndodhur vërtetë, ose mund të ndodhin, por autori prezanton ndodhitë dhe komunikon kuptimin përmes pamjeve dhe prototipëve” (fq. 137).

Nga *Dictionary of Biblical Imagery* [Fjalori i Pamjeve Biblike], redaktuar nga Ryken [Rajkën], Wilhost [Uillhost] dhe Longman [Longmën] III:

“Lexuesit e sotëm shpesh ngatërrohen dhe acarohen nga ky zhanër. Pamjet e papritura dhe eksperiencat jashtë kësaj bote duken të çuditshme dhe jashtë rrjedhës së pjesës tjetër të Shkrimeve. Ta marrësh këtë letërsi në vlerë faktike i le shumë lexues duke debatuar për të përcaktuar ‘çfarë do të ndodhë kur’, dhe kështu humbasin të gjithë qëllimin e mesazhit apokaliptik” (fq. 35).

TENSIONI I PESTË (Mbretëria e Perëndisë si e tashme e megjithatë e ardhme)

Mbretëria e Perëndisë është e tashme, por edhe e ardhme. Ky paradoks teologjik fokusohet tek pika e eskatologjisë. Nëse dikush pret një përmbushje të drejtëpërdrejtë të të gjitha profecive të Dhjatës së Vjetër për Izraelin atëherë Mbretëria bëhet një restaurim i Izraelit në një lokalitet gjeografik dhe para-famë teologjike! Kjo do të shpinte në nevojën që kisha të rrëmbehej në mënyrë sekrete në kapitullin 5 dhe kapitujt e tjerë të lidheshin me Izraelin (por vini re Zbu. 22:16).

Megjithatë, nëse fokusi është tek mbretëria që inaugurohet nga Mesia i premtuar i Dhjatës së Vjetër, atëherë ai është i tashëm me ardhjen e parë të Krishtit, dhe më pas fokusi bëhet mishërimi, jeta, mësimdhëniet, vdekja dhe ringjallja e Krishtit. Theksi teologjik është mbi shpëtimin aktual. Mbretëria ka ardhur, Dhjata e Vjetër është përmbushur në ofrimin e Krishtit për shpëtim të të gjithëve, jo për sundimin e Tij mijëvjeçar mbi disa!

Është sigurisht e vërtetë se Bibla flet për të dyja ardhjet e Krishtit, por ku duhet vendosur theksi? Mua me duket se profecitë më të shumëta të Dhjatës së Vjetër fokusohen tek ardhja e parë, themelimi i mbretërisë mesianike (shih Danielin 2). Në shumë mënyra kjo është analoge me sundimin e përjetshëm të Perëndisë (shih Danielin 7). Në Dhjatën e Vjetër fokusi është tek sundimi i përjetshëm i Perëndisë, por mekanizmi për manifestimin e këtij sundimi është shërbesa e Mesias (shih 1 Kor. 15:25-27). Nuk është një pyetje se cila është e vërtetë; të dyja janë të vërteta, por ku është theksi? Duhet theksuar se disa interpretues fokusohen kaq shumë tek sundimi mijëvjeçar i Mesias (shih Njohuri Kontekstuale për Zbulesën 20) sa ata e kanë humbur fokusin biblik mbi sundimin e përjetshëm të Atit. Sundimi i Krishtit është një ndodhi pararendëse. Sikurse dy ardhjet e Krishtit nuk ishin të dukshme në Dhjatën e Vjetër, ashtu nuk është as sundimi i përkohshëm i Mesias!

Çelësi i predikimit dhe mësimin të Jezusit është mbretëria e Perëndisë. Ajo është edhe e tashme (në shpëtimin dhe shërbesën), edhe e ardhme (në përhapje dhe fuqi). Zbulesa, nëse fokusohet në një sundim

mijëvjeçar të Mesias (shih Zbulesa 20), është paraprak, jo përfundimtar (shih Zbulesa 21-22). Nuk është e dukshme nga Dhjata e Vjetër se sundimi i përkohshëm është i nevojshëm; në fakt, sundimi mesianik i Danielit 7 është i përrjetshëm, jo mijëvjeçar.

TENSIONI I GJASHTË (rikthimi i pashmangshëm i Krishtit përkundrjet *Parousia*-s të vonuar)

Pjesa më e madhe e besimtarëve kanë marrë mësim se Jezusi do të vijë së shpejti, papritmas dhe në mënyrë të papritur (shih Mate. 10:23; 24:27,34,44; Mark 9:1; 13:30; Zbu. 1:1,3; 2:16; 3:11; 22:7,10,12,20). Por çdo brez besimtarësh pritës derimë tani ka gabuar! Koha e shkurtër (menjëhershmeria) e rikthimit të Jezusit është një shpresë e fuqishme e premtuar për çdo brez, por një realitet vetëm për një (dhe ky realitet është i persekutuar). Besimtarët duhet të jetojnë si Ai të vinte nesër, por të planifikojnë dhe të zbatojnë Urdhërimin e Madh (shih Mate. 28:19-20) sikur Ai të vonohej.

Disa pasazhe tek Ungjijtë dhe 1 dhe 2 Thesalonikasve bazohen në një Ardhje të Dytë të vonuar (*Parousia*). Ka disa ndodhi historike të cilat duhet të ndodhin të parat:

1. Ungjillizimi mbarë-botëror (shih Mate. 24:14; Mark 13:10)
2. Zbulesa e “njeriut të Mëkatit” (shih Mate. 24:15; 2 Thesalonikasve 2; Zbulesa 13)
3. Persekutimi i madh (shih Mate. 24:21,24; Zbulesa 13)

Kjo është një paqartësi e qëllimtë (shih Mate. 24:42-51; Mark 13:32-36)! Jetoni çdo ditë si të ishte dita juaj e fundit por planifikoni dhe trajtohuni për shërbesën tuaj të ardhme!

VETËPËRPUTHJA DHE EKUILIBRI

Duhet thënë se shkolla të ndryshme të interpretimit modern eskatologjik të gjitha përmbajnë gjysëm të vërteta. Ato kuptojnë dhe interpretojnë mire disa tekste. Problemi qëndron tek përputhja dhe ekuilibri. Shpesh ka një set presupozimesh të cilat përdorin tekstin biblik për të mbushur tek skeleti teologjik i paravendosur. Bibla nuk na zbulon një eskatologji logjike, kronologjike, sistematike. Ajo është si një album familjeje. Fotografitë janë të vërteta, por jo gjithmonë në rendin e duhur, në kontekst, apo në një rrjedhë logjike. Disa nga fotografitë kanë rënë nga albumi dhe breza të mëvonshëm të anëtarëve të familjes nuk e dinë saktësisht se si t'i rivendosin ato sërish. Çelësi për një interpretim të saktë të Zbulesës është qëllimi i autorit origjinal siç është zbuluar përmes zgjedhjes së tij të zhanrit letrar. Pjesa më e madhe e interpretesve përpiqen të përdorin instrumentet dhe procedurat e tyre ekzegjetike nga zhanrat e tjerë të Dhjatës së Re në interpretimet e tyre të Zbulesës. Ata fokusohen tek Dhjata e Vjetër, në vend që të lejojnë mësimet e Jezusit dhe të Palit të vendosin strukturën teologjike dhe të lejojnë Zbulesën të veprojë si ilustrim.

Unë duhet ta pranoj se unë e përqsas këtë komentari mbi Zbulesën me pak frikë dhe ankth, jo për shkak të mallkimit të Zbu. 22:18-19, por për shkak të nivelit të polemikës që interpretimi i këtij libri ka shkaktuar dhe vazhdon të shkaktojë tek populli i Perëndisë. Unë e dua zbulesën e Perëndisë. Ajo është e vërtetë kur të gjithë njerëzit gënjëjnë (shih Rom. 3:4)! Ju lutem, perdoreni këtë komentari si një përpjekje për të qënë provokues mendimesh dhe jo përfundimtar, si një shenjë postare dhe jo si një hartë, si të ishte një “po sikur” dhe jo një “kështu thotë Zoti”. Unë jam gjendur ballë për ballë me papërshtatshmëritë e mia, paragjykimet e mia dhe planin tim teologjik. Unë gjithashtu kam parë dhe ato të interpretesve të tjerë. Duket sikur njerëzit gëjnë tek Zbulesa atë që presin të gëjnë. Zhanri e lejon vetë abuzimin! Gjithsesi, është në Bibël për një qëllim. Vendosja e saj si një “fjalë” përmbyllëse nuk është një aksident. Ajo ka një mesazh nga Perëndia për fëmijët e Tij të çdo brezi. Perëndia dëshiron që ne të kuptojmë! Le të bashkojmë duart, dhe jo të formojmë kampe; le të pohojmë atë që është e qartë dhe qëndrore, jo gjithçka që mund të jetë, ka mundësi të jetë, apo mund të ishte e vërtetë! Perëndia na ndihmoftë të gjithëve!

Përdor hapësirën e mëposhtme për të renditur presupozimet e tua për mënyrën si duhet interpretuar Zbulesa. Të gjithë sjellim anësitë tona kur interpretojmë këtë libër. Identifikimi i tyre na ndihmon që ta mposhtim ndikimin e tyre dhe t'i vëmë fre dogmatizmit.

HYRJE PËR ZBULESËN

I. SHËNIME HYRËSE

A. Në pjesën më të madhe të jetës sime akademike / teologjike unë kam supozuar se ata që besojnë tek Bibla, e marrin atë “fjalë për fjalë” (dhe kjo është patjetër e vërtetë për ngjarjet historike). Megjithatë, për mua është bërë gjithnjë e më e qartë se që të marr profecinë, poezinë, shëmbëlltyrat dhe literaturën apokaliptike fjalë për fjalë do të thotë që të humbas thelbin e tekstit të frymëzuar. Qëllimi i autorit, dhe jo marrja fjalë për fjalë e librit, është çelësi për një të kuptuar të mirë të Biblës. Për ta bërë Biblën që të thotë më shumë (specifika doktrinale) është po aq e rrezikshme dhe çorientuese sa ta interpretosh atë në një mënyrë që të thotë më pak nga çfarë kishte për qëllim shkruesi origjinal dhe i frymëzuar. Fokusi duhet të jetë konteksti i madh, rrethanat historike dhe qëllimi që autori ka shprehur në vetë tekstin dhe zgjedhja e tij e zhanrit. Zhanri është një kontratë letrare midis autorit dhe lexuesit. Nëse humbasim këtë lidhje, me siguri do të shkojmë në keqinterpretim!

Libri i Zbulesës është patjetër i vërtetë, por nuk është një narrativë historike, nuk duhet marrë fjalë për fjalë. Vetë zhanri na e kërkon këtë duke na e bërë të qartë nëse do ta dëgjojmë. Kjo nuk do të thotë se libri nuk është i frymëzuar apo i vërtetë; është thjesht figurativ, lakonik, simbolik, metaforik dhe imagjativ. Hebrenjtë dhe të krishterët e shekullit të parë ishin të familiarizuar me këtë lloj literature, por ne nuk jemi! Simbolika e krishterë në *The Lord of the Rings* [Zoti i Unazave] apo *Chronicles of Narnia* [Kronikat e Narnias] mund të jenë paralelizma modernë.

B. Zbulesa është një zhanër letrar, apokaliptik hebraik. Shpesh përdorej në kohëra të mbushura me tension (p.sh., Izraeli i sunduar nga fuqi johebraike) për të shprehur bindjen se Perëndia kishte nën kontroll historinë dhe do të sillte çlirim tek populli i Tij. Ky lloj letersie karakterizohet nga

1. një sens i fortë i sovranitetit universal të Perëndisë (monoteizëm dhe determinizëm)
2. një luftë midis së mirës dhe së keqes, kësaj kohe të keqe dhe kohës së dretësisë e cila do të vijë (dualizëm)
3. përdorimi i fjalëve sekrete të kodifikuara (zakonisht nga Dhjata e Vjetër ose letërsia apokaliptike hebraike e shkruar midis dy Dhjatave)
4. përdorimi i ngjyrave, numrave, kafshëve dhe ndonjëherë kafshëve / njerëzve
5. përdorimi i ndërmjetësimeve ëngjëjllore me anë të vegjimeve dhe ëndrrave, por zakonisht përmes interpretimit ëngjëllor
6. përqëndrimet kryesore në ndodhitë klimatike dhe të ardhshme të kohëve të fundit (epoka e re)
7. përdorimi i një grupi të caktuar simbolesh, dhe jo realitetin, për të komunikuar mesazhin e fundit të kohërave nga Perëndia
8. disa shembuj të këtij lloji zhanri janë:
 - a. Dhjata e Vjetër
 - (1) Isaia 13-14; 24-27; 56-66
 - (2) Ezekieli 1; 26-28; 33-48
 - (3) Danieli 7-12
 - (4) Joeli 2:28-3:21
 - (5) Zakaria 1-6, 12-14
 - b. Dhjata e Re
 - (1) Mateu 24, Marku 13, Luka 21 dhe 1 e Korintasve 15 (në disa mënyra)
 - (2) 2 Thesalonikasve 2 (në shumë mënyra)
 - (3) Zbulesa (kapitujt 4-22)
 - c. Danieli 7-12 dhe Zbulesa 4-22 janë shembujt klasikë të këtij zhanri në Bibël
9. Librat johanonikë (marrë nga D.S. Russell, *The Method and Message of Jewish Apocalyptic*, pp. 37-38 [D.S. Rasëll, *Metoda dhe Mesazhi i Veprave Apokaliptike Hebraike*, fq. 37-38])
 - a. *I Enokut, 2 Enokut* (*Sekretet e Enokut*)
 - b. *The Book of Jubilees* [Libri i Jubileut]
 - c. *The Sibylline Oracles III, IV, V* [Orakujt Profetikë III, IV, V]
 - d. *The Testament of the Twelve Patriarchs* [Dhjata e Dymbëdhjetë Patriarkëve]
 - e. *The Psalms of Solomon* [Psalmet e Solomonit]

- f. The Assumption of Moses [Supozimet e Moisiut]
 - g. The Martyrdom of Isaiah [Martirizimi i Isaia]
 - h. The Apocalypse of Moses (Life of Adam and Eve) [Apokalipsi i Moisiut (Jeta e Adamit dhe Evës)]
 - i. The Apocalypse of Abraham [Apokalipsi i Abrahamit]
 - j. The Testament of Abraham [Dhjata e Abrahamit]
 - k. II Esdras (IV Esdras) [Ezdra II (Ezdra IV)]
 - l. II & III Baruch [Baruku II dhe III]
10. Ekziston një sens dualiteti në këtë zhanër. Ai e sheh realitetin si një seri dualizmash, kontrastesh apo tensionesh (diçka që është kaq e zakonshme në shkrimet e Gjonit) midis:
- a. Tokës – qiellit
 - b. Epokës së keqe (njerëzve të këqij dhe ëngjëjve të këqij) – epokës së re të drejtësisë (njerëzve të perëndishëm dhe ëngjëjve të perëndishëm)
 - c. Ekzistencës aktuale – ekzistencës së ardhshme
- Të gjitha këto lëvizin drejt një plotësimi të sjellë nga Perëndia. Kjo nuk është bota që Perëndia kishte në plan, por Ai vazhdon të planifikojë, punojë dhe të projektojë vullnetin e Tij për një restaurim të marrëdhënies intime të nisur në Kopështin e Edenit. Ndodhia e Krishtit është çasti vendimtar i planit të Perëndisë, por dy ardhjet kanë sjellë dualizmin aktual.

- C. Këto vepra apokaliptike nuk janë prezantuar kurrë gojarisht; ato kanë qënë gjithmonë të shkruara. Ato janë vepra letrare tejet të strukturuar. Struktura është thelbësore për një interpretim të saktë. Një pjesë e konsiderueshme e strukturës së planifikuar të librit të Zbulesës janë shtatë njësitë letrare, të cilat janë në paralel me njëra-tjetrën në një farë mase (p.sh., shtatë vulat, shtatë boritë dhe shtatë enët). Në çdo cikël, gjykimi rritet: vulat, 1/4 shkatërrim; boritë, 1/3 shkatërrim; enët, shkatërrim total. Brenda çdo njësie letrare Ardhja e Dytë e Krishtit ose një ndodhi eskatologjike ndodh: (1) vula e gjashtë, Zbu. 6:12-17; (2) boria e shtatë, Zbu. 11:15-18; një gjykim i kohërave të fundit nga ëngjëlli në Zbu. 14:14-20; (3) ena e shtatë, Zbu. 16:17-21 dhe sërish në Zbu. 19:11-21 dhe përsëri në Zbu. 22:6-16 (dhe gjithashtu vini re titullin e trefishtë për Perëndinë në Zbu. 1:4,8 dhe Krishtin në Zbu. 1:17,18, “që është dhe që ishte dhe që do të vijë,” vini re aspektin e së ardhmes të lënë jashtë në Zbu. 11:17 dhe Zbu. 16:5 që do të thotë se e ardhmja ka ardhur [dmth, ardhja e dytë]). Kjo tregon se libri nuk ndjek rrjedhën kronologjike, por është një pjesë teatrale me disa akte e cila parasheh të njëjtën periudhë kohore në motivet e dhunës në rritje të gjykimit në Dhjatën e Vjetër (shih James Blevins, *Revelation as Drama* and “The Genre of Revelation” in *Review and Expositor*, Sept. 1980, pp. 393-408 [Xhejms Blevins, *Zbulesa si Pjesë Teatrale* dhe “Zhanri i Zbulesës” në *Recensim dhe Shtjellues*, Shtator 1980, fq. 393-408]).

Ka shtatë seksione letrare plus një prolog dhe një epilog

1. Prologu, Zbu. 1:1-8
2. Zbu. 1:9-3 (Krishti dhe shtatë kishat)
3. Zbu. 4-8:1 (qielli dhe shtatë vulat [Zbu. 2:1-17 ndërthurje midis vulës së gjashtë dhe të shtatë])
4. Zbu. 8:2-11 (shtatë ëngjëjt me bori [Zbu. 10:1-11:13 ndërthurje midis borisë së gjashtë dhe të shtatë])
5. Zbu. 12-14 (dy komunitetet dhe udhëheqësit e tyre)
6. Zbu. 15-16 (shtatë ëngjëjt me enë)
7. Zbu. 17-19 (Babilonia dhe gjykimi i saj)
8. Zbu. 20-22:5 (gjykimi dhe qielli i ri dhe toka)
9. Epilogu, Zbu. 22:6-21

Një tjetër autor që besonte në teorinë e rikapitullimit është William Hendriksen [Uilliam Hendriksen]. Në librin e tij, *More Than Conquerors* [Më shumë se fitimtarë], ai e skicon librin në këtë mënyrë:

1. Zbu. 1-3 (Krishti në mes të Shtatë Shandanëve)
2. Zbu. 4-7 (Libri me Shtatë Vulat)
3. Zbu. 8-11 (Shtatë Boritë e Gjykimit)
4. Zbu.12-14 (gruaja dhe fëmija i persekutuar nga Dragoi dhe Ndihmuesit e Tij [Bisha dhe Harloti])
5. Zbu. 15-16 (Shtatë Enët e Zemërimit)
6. Zbu. 17-19 (rënia e Harlotit të Madh dhe e Bishave)

7. Zbu. 20-22 (grykimi mbi Dragoin (Satanin) i ndjekur nga Qielli dhe Toka e Re, Jeruzalemi i Ri), fq. 28

Në librin *More Than Conquerors* [Më Shumë Se Fitimtarë], William Hendriksen [Uilliam Hendriksen] thotë se Zbulesa ka shtatë seksione: Zbu. 1-3, 4-7; 8-11; 12-14; 15-16; 20-22 dhe se secili nga këto është paralel dhe mbulon periudhën midis ardhjes së parë të Krishtit dhe ardhjes së Tij të dytë. Secili përfundon me disa aspekte të lidhura me grykimin dhe me Ardhjen e Dytë (fq. 22-31).

Edhe pse sigurisht jam dakord me paralelizmin dramatik të vulave, borive dhe enëve, gjithashtu më tërheqin mjaft kapitujt 17-19 të cilët janë në paralel me kapitujt 20-22 (ardhja e dytë është në Zbu. 19:11-21 dhe një ardhje tjetër e dytë në Zbu. 22:6-15; vini re veçanërisht v. 15; e keqja nuk është hequr ende, dmth Zbu. 19:14-15), nuk mund të shoh se ku përfundon secili nga shtatë seksionet në *Parousia* [Ardhja e dytë e Jezusit], veçanërisht kapitujt 1-3, vetëm nëse ka një aspekt grykimi i cili shihet si një ndodhi eskatologjike (shih Zbu. 2:5,7,11,16-17,25-26; 3:5,10,12,18-21). Megjithatë, për mua, ky rikapitullim i shtatë-fishtë bëhet gjithnjë e më shumë një mundësi për të kuptuar strukturën paralele të të gjithë librit.

- D. Është e dukshme se numri “shtatë” luan një rol të rëndësishëm në strukturën e librit siç mund të shihet nga shtatë kishat, shtatë vultat, shtatë boritë, dhe shtatë enët. Disa shembuj të tjerë të “shtatës” janë:

1. 7 bekimet, Zbu. 1:3; 14:13; 16:15; 19:9; 20:6; 22:7,14
2. 7 shandanët, Zbu. 1:12
3. 7 frymërat e Perëndisë, Zbu. 1:4; 3:1; 4:5; 5:6
4. 7 yjet, Zbu. 1:16, 20; 2:1
5. 7 llambat e zjarrit, Zbu. 4:5
6. 7 vultat e dorëshkrimeve, Zbu. 5:1
7. 7 brirët, 7 sytë e qengjit, Zbu. 5:6
8. 7 atributet e Jezusit të lavdëruar, Zbu. 5:12
9. 7 shenjat në natyrë, Zbu. 6:12-14
10. 7 llojet e njerëzve, Zbu. 6:15
11. 7 atributet e Perëndisë të lavdëruar, Zbu. 7:12
12. 7 ëngjëjt e Perëndisë, Zbu. 8:2,6
13. 7 boritë e mbajtura nga shtatë ëngjëjt, Zbu. 8:6 (Zbu. 15:1,6,7,8; 17:1; 21:9)
14. 7 shenjat, Zbu. 12:1,3; 13:13,14; 15:1; 16:14; 19:20
15. 7 kokat, 7 diademat e dragoit të kuq, Zbu. 12:3
16. 7 kokat e bishës së detit, Zbu. 13:1; 17:3,7
17. 7 ëngjëjt, Zbu. 14:6-20
18. 7 plagët, Zbu. 15:1; 21:9
19. 7 kodrat, Zbu. 17:9
20. 7 mbretërit Zbu. 17:10
21. 7 gjërat që nuk janë më në kapitujt 21-22 (Zbu. 21:1,4[katër herë]; Zbu. 21:25; 22:3)

- E. Interpretimi i librit është mbi baza teologjike dhe të cënueshme. Supozimet e lexuesit drejtojnë interpretimin e detajeve të paqarta. Këto supozime teologjike funksionojnë mbi disa nivele:

1. Origjina e simboleve
 - a. Aludimet e Dhjatës së Vjetër
 - (1) Tematikat e Dhjatës së Vjetër si krijimi, rënia, përmytja, eksodi, Jeruzalemi i restauruar
 - (2) Qindra aludime (jo citime të drejtpërdrejta) nga profetët e Dhjatës së Vjetër
 - b. Letërsi hebraike e shkruar midis dy Dhjatave (I Enoch, II Baruch, Sibylline Oracles, II Esdras [Enoku I, Baruku III, Orakujt Profetikë, II Ezdra])
 - c. Bota Greko-Romake e shekullit të parë
 - d. Rregjistrimet kosmologjike të krijimitë antik të Lindjes së Afërme (sidomos Zbu. 12)
2. Hapësira kohore e librit
 - a. Shekulli i parë
 - b. Çdo shekull
 - c. Brezi i fundit

3. Linja teologjike sistematike
 - a. preterist
 - b. historicist
 - c. futurist
 - d. idealist
4. Pozicionet teologjike të kapitullit 20
 - a. një mijëvjeçar
 - b. pas mijëvjeçarit
 - c. para mijëvjeçarit
 - d. dispensational para mijëvjeçarit

Në perspektivën e divergjencës hermeneutike (përfaqset e ndryshme ndaj interpretimit) dhe dogmatizmave të pasakta (qëndrimi që “unë i di të gjitha”), si duhet të vazhdojë një interpretues?

1. Le ta pranojmë se të krishterët modernë perëndimorë nuk e kuptojnë zhanrin dhe nuk i njohin aludimet historike që të krishterët e shekullit të parë do t’i kishin kuptuar menjëherë.
 2. Le të pranojmë se çdo brez i të krishterëve e ka vendosur me forcë Zbulesën në rrethanat e veta historike dhe të gjithë kanë gabuar deri më tani.
 3. Le të lexojmë Biblën përpara se të lexojmë sistemet teologjike. Kërkoni kontekstin letrar të secilit vizion / orakull dhe pohoni të vërtetën qëndrore në një fjali shpallëse. E vërteta qëndrore do të jetë e njëjta për çdo brez besimtarësh ndërkohë që specifika e detajeve mund të jetë e aplikueshme vetëm për brezin e parë dhe / ose të fundit të besimtarëve. Detajet mund të lidhen, por historia, dhe jo teologjia, do të zbulojnë përmbushjen e tyre.
 4. Le të mbajmë mend se ky libër është kryesisht një fjalë ngushëlluese dhe inkurajuese për besnikërinë e besimtarëve në mes të persekutimit nga jo besimtarët. Ky libër nuk ka për qëllim që t’i përgjigjet kuriozitetit të çdo brezi besimtarësh, as të skicojë një plan të detajuar të ndodhive të kohëve të fundit.
 5. Jemi të sigurtë që mund të pohojmë se shoqëria njerëzore e rënë është në një rrjedhë përplasjeje me mbretërinë e Perëndisë. Në fillim do të duket sikur bota ka fituar (si në Kalvar), por prisni; Perëndia është sovran, Ai ka nën kontroll historinë, të jetës dhe të vdekjes. Populli i Tij është fitimtar në Të!
- F. Përveç vështirësisë dhe paqartësisë së interpretimit, ky libër ka një mesazh dhe është një fjalë të frymëzuar nga Perëndia për popullin e Tij në çdo epokë. Ia vlen që të bësh përpjekjet shtesë që nevojiten për të studjuar këtë libër unik. Pozicionimi i tij strategjik në librin kanonik të Dhjatës së Re flet për mesazhin e tij themeltar. Alan Johnson, *The Expositor's Bible Commentary* [Alen Xhonsion, *Komentari i Biblës së Ekspozitorit,*] vol. 12 thotë: “Në të vërtetë, mund të jetë që, me përjashtim të Ungjijve, Apokalipsi përmban mësimin më të thellë dhe më prekës të doktrinës dhe dishepullizimit të krishterë të gjendur ndonjëherë në Shkrimet e Shenjta. As fanaticizmi i disave të cilët e kanë fiksuar vëmendjen e tyre tek profecia dhe jo tek Krishti, dhe as larmishmëria e pikëpamjeve interpretuese nuk duhet të na dekurajojnë nga të kërkuarit e së vërtetës së krishterë në këtë libër të mrekullueshëm” (fq. 399).
- Mbani mend, këto janë me të vërtetë fjalët e fundit të Jezusit ndaj kishës së Tij! Kisha moderne nuk duhet të guxojë t’i shpërfillë apo t’i minimizojë ato! Ato janë për të përgatitur besimtarët për persekutimin dhe konfliktin nën dritën e sovranitetit të Perëndisë (monoteizëm), realitetit të të ligut (dualizëm i kushtëzuar), rezultateve të vazhdueshme të rënies (rebelimit njerëzor) dhe premtimeve të Perëndisë për të shpenguar njerëzimin (besëlidhje e pakushtëzuar, shih Zan. 3:15; 12:1-3; Eksod. 19:5-6; Gjon 3:16; 2 Kor. 5:21).

II. AUTORI

- A. Prova të brendshme për autorësinë e apostullit Gjon
 1. Autori e quan veten e tij katër herë Gjon (shih Zbu. 1:1,4,9; 22:8)
 2. Ai gjithashtu e quan veten e tij
 - a. Një shërbëtor i vet (shih Zbu. 1:1, 22: 6)

- b. Një vëlla dhe një pjesëtar në pikëllim (shih Zbu. 1:9)
 - c. Një profet (shih Zbu. 22:9) dhe ai e quan librin e tij një profeci (shih Zbu. 1:3, 22:7,10,18,19)
 - 3. Ai e njuh Dhjatën e Vjetër (nuk përdor LXX, por Targumet) dhe gjithashtu edhe periudhën e endjes në shkretëtirë, procedurat e Tabernakullit dhe të Sinagogës së atëherëshme.
- B. Prova të jashtme për autorësinë e apostullit Gjon nga autorë të hershëm të krishterë
1. Apostulli Gjon, biri i Zebedeut
 - a. Justin Martri (Rome A.D. 110-165) in *Dialogue ÷ith Trypho* 81.4 [Justin Martir (Romë 110-165 pas Krishtit) në *Dialog me Trifo* 81.4]
 - b. Ireneu (Lyons A.D. 120-202) in *Against Heresies* IV.14.2; 17.6; 21.3; V.16.1; 28.2; 30.3; 34.6; 35.2 [Ireneasi (Lions 120-202 pas Krishtit) në *Kundër Heresive* IV.14.2; 17.6; 21.3; V.16.1; 28.2; 30.3; 34.6; 35.2]
 - c. Tertuliani (Afrika e Veriut A.D. 145-220) in *Against Praxeas* 27 [Tertuliani (Afrika e Veriut 145-220 pas Krishtit) në *Kundër Prakseasit* 27]
 - d. Origen (Alexandria A.D. 181-252) in [Origen (Aleksandri 181-252 pas Krishtit) në
 - (1) *On the Soul*, L:8:1 [*Mbi Shpirtin*, L:8:1]
 - (2) *Against Marcion*, II:5 [*Kundër Marcionit*, II:5]
 - (3) *Against Heretics*, III:14, 25 [*Kundër Heresive*, III:14, 25]
 - (4) *Against Celsus*, VI:6, 32; VIII:17 [*Kundër Celsiusit*, VI:6, 32; VIII:17]
 - e. The Muratorian Canon (Rome A.D. 180-200) [Kanoni Muratorian (Romë 180-200 pas Krishtit)]
 2. Kandidatë të tjerë
 - a. Gjon Marku – Ky u përmend për herë të parë nga Dionisi, Peshkopi i Aleksandrisë (247-264 pas Krishtit), i cili mohoi autorësinë e Apostullit Gjon por ende i qëndroi mendimit se vepra është kanonike. Ai e bazoi kundërshtimin e tij mbi fjalorin dhe stilin sikurse dhe mbi natyrën anonime të shkrimeve të tjera të Gjonit. Ai bindi Eusebiusin e Cesareas.
 - b. Gjoni nga pleqësia – Kjo vjen nga një citim në Eusebius të Papias (*Eccl. His.* 3.39.1-7 [Pred. His. 3.39.1-7]). Megjithatë, citimi i Papias me shumë mundësi përdori këtë titull për Apostullin Gjon në vend që të hamendësonte për një autor tjetër.
 - c. Gjon Pagëzori – (me shtesa të tjera të mëvonshme editoriale) është sugjeruar nga J.Massyngberde Ford [J. Mesingberd Ford] në komentarin Anchor Bible [Bibla Spirancë], bazuar kryesisht në përdorimin e Gjon Pagëzorit të “qengjit” për Jezusin. I vetmi rast tjetër kur përmendet ky titull gjendet në Zbulesë.
- C. Dionisi, peshkopi i Aleksandrisë (247-264 pas Krishtit) dhe studenti i Origenit, ishte i pari i cili shprehu dyshime (libri i tij është humbur, por ai është cituar nga Eusebiusi i Cesareas, i cili ra dakord me të) mbi autorësinë e Apostullit Gjon, bazuar mbi
1. Apostulli Gjon nuk i referohet vetes së tij si Gjoni në Ungjill apo në letrat e tij, por Zbulesa është nga “Gjoni”
 2. Struktura e Zbulesës është e ndryshme nga Ungjilli dhe letrat
 3. Fjalori i Zbulesës është i ndryshëm nga Ungjilli dhe letrat

4. Stili gramatikor i Zbulesës është i një cilësie më të ulët në krahasim me Ungjillin dhe letrat

- D. Me shumë mundësi sfida më serioze moderne e bërë ndaj autorësisë së Apostullit Gjon vjen nga R. H. Charles në *Saint John*, Vol. I p.xxxixff [R. H. Çarls në *Shën Gjoni*, Vol.I p.xxxixff].
- E. Pjesa më e madhe e studiuesve modernë kanë refuzuar autorësinë tradicionale të shumë prej librave të Dhjatës së Vjetër. Një shembull i mirë i këtij trendi lidhur me autorësinë e Zbulesës mund të jetë Raymond E. Brown [Rejmond E. Braun], një studiues i njohur katolik i Gjonit. Volumi hyrës i serisë së Komentareve të Anchor Bible [Biblës Spirancë] thotë: “shkruar nga një profet jude i krishterë i quajtur Gjon i cili nuk ishte as Gjoni, biri i Zebedeut, as shkruesi i Ungjillit apo i letrave të Gjonit” (fq.774).
- F. Në shumë mënyra autorësia është e pasigurtë. Ka disa paralelizma të habitshme me shkrimet e tjera të Apostullit Gjon dhe gjithashtu disa ndryshime të habitshme. Çelësi për të kuptuar këtë libër nuk është autorësia e tij njerëzore por autorësia e tij Hyjnore! Autori besonte se ishte një profet i frymëzuar (shih Zbu. 1:3; 22:7,10,18,19).

III. DATA

- A. Kjo është me siguri e lidhur në mënyrë të integrueshme me autorësinë dhe perspektivën e interpretimit (shih Teoritë Historike C.).
- B. Disa data të mundshme:
 - 1. Data tradicionale është gjatë sundimit Domician (81-96 pas Krishtit) sepse ajo i përshtatet provës së persekutimit
 - a. Ireneu (cituar nga Eusebiusi) në *Against Heresies* [*Kundër Heresive*], 5.30.3. “Ai (ky persekutim) nuk u pa shumë kohë më parë, pothuajse në brezin tonë, në më të afërtën gjatë sundimit të Domicianit.”
 - b. Klementi i Aleksandrisë
 - c. Origjeni i Aleksandrisë
 - d. Eusebiusi i Caseares, *Church History*, iii.23.1 [*Historia e Kishës*, iii.23.1]
 - e. Viktorini, *Apocalypse* x.11 [*Apokalipsi* x.11]
 - f. Jeronimi
 - 2. Epifani, një shkrimtar i shekullit të tretë, në *Haer*, 51.12, 32, thotë se Gjoni e shkroi atë nga Patmos i cili ishte gjatë sundimit të Claudius (41-54 pas Krishtit).
 - 3. Të tjerë kanë supozuar se u bë gjatë sundimit të Neronit (54-68 pas Krishtit) për shkak të:
 - a. Rrethanave të dukshme të persekutimit të kultit të Perandorit
 - b. *Cezar Nero* [*Cezar Nero*], shkruar në hebraisht, është i njëjtë me numrin e bishës, 666
 - c. Nëse preteristët janë të saktë që Zbulesa e Gjonit i referohet shkatërrimit të Jeruzalemit, atëherë që libri të jetë profeci, duhet të jetë shkruar përpara vitit 70 pas Krishtit

IV. MARRËSIT

- A. Nga Zbu. 1:4 është e qartë që dëgjuesit e parë ishin shtatë kishat në provincën romake të Azisë. Këto kisha adresohen në një mënyrë të tillë që nënkupton shtegun e udhëtimit të mbajtësit të letrës.
- B. Mesazhi i Zbulesës në mënyrë unike lidhet me të gjitha kishat dhe besimtarët që janë duke përjetuar persekutim nga një sistem i një bote të rënë.
- C. Si konkluzioni kanonik për Dhjatën e Re ky libër është një mesazh përmbushjeje për të gjithë besimtarët e të gjitha kohërave.

V. SHKASI

- A. Rrethanat ishin persekutimi i shkaktuar nga ndarja e kishave lokale nga mbrojtja ligjore që Roma i jepte judaizmit. Kjo ndarje ndodhi zyrtarisht në vitin 70 pas Krishtit kur rabinët nga Jamnia themeluan një formulë betimi e cila kërkonte që anëtarët e sinagogës lokale të mallkonin Jezusin e Nazaretit.
- B. Dokumentet romake tregojnë se adhurimi i perandorit u bë një konflikt kryesor me kishën nga sundimi i Neros (54-68 pas Krishtit) deri tek ai Domicianit (81-96 pas Krishtit). Megjithatë, nuk ka asnjë dokumentacion të një persekutimi zyrtar në mbarë perandorinë. Me sa duket, Zbulesa reflektonte masën e madhe të adhurimit nga kultet ndaj perandorit në provincat lindore të Perandorisë Romake (shih “Rishikimi Arkeologjik Biblik,” Maj/Qershor 1993 fq. 29-37).

VI. SINTAKSA

- A. Ka shumë probelme gramatikore në tekstin grek.
- B. Disa shkaqe të mundshme të këtyre problemeve
 1. Mënyra e të menduarit të Gjonit në gjuhën aramaike.
 2. Ai nuk kishte asnjë skrib në Patmos që të shkruante për të.
 3. Ngazëllimi prej vegimeve ishte shumë i madh.
 4. Ato janë bërë qëllimisht për efekt.
 5. Zhanri (apokaliptik) ishte tejet figurativ.
- C. Veçanti të ngjashme gramatikore gjenden në shkrimet e tjera hebraike apokaliptike. Prandaj Zbulesa nuk është shkruar në një stil të mangët gramatikor, por në një zhanër me veçanti gramatike.

VII. KANONICITETI

- A. U refuzua nga kisha lindore e hershme; libri nuk shfaqet në Peshita (versioni i sirian i shekullit të pestë).
- B. Në fillim të shekullit të katërt Eusebiusi, duke ndjekur Dionisin e Aleksandrisë në fund të shekullit të tretë, thoshte që Zbulesa nuk është shkruar nga Apostulli Gjon. Ai e listonte atë si një nga librat “e debatuar” por e përfshinte atë në listën e tij të librave kanonikë (shih *Ecclesiastical History* [*Historia Ekleziastike*], III.24.18; III.25.4; dhe III.39.6).
- C. Këshilli i Laodicesë (rreth vitit 360 pas Krishtit) e hoqi atë nga lista e librave kanonikë. Jeromi e refuzoi atë si kanonik, por Këshilli i Kartagës (viti 397 pas Krishtit) e përfshiu atë. Zbulesa u pranua me anë të një kompromisi midis kishave të lindjes dhe të perëndimit me anë të së cilit u përfshinë letra e Hebrenjve dhe Zbulesa në librin kanonik të Dhjatës së Re.
- D. Ne duhet ta pranojmë atë si një supozim besimi të besimtarëve që Fryma e Shenjtë e ka udhëhequr procesin historik të zhvillimit të një libri kanonik të krishterë.
- E. Dy teologët kryesorë të Reformacionit Protestant e refuzuan vendin e tij në doktrinën e krishterë
 1. Martin Luteri nuk e quajti atë as profetik dhe as apostolik, duke refuzuar në thelb frymëzimin e tij.
 2. Gjon Kalvini, i cili shkroi një komentari mbi çdo libër të Dhjatës së Re përveç Zbulesës, në thelb refuzoi rëndësinë e tij.

VIII. TEORI HISTORIKE TË INTERPRETIMIT

- A. Ka qënë dukshëm i vështirë për t'u interpretuar; prandaj, dogmatizmi është i papërshtatshëm!
- B. Simbolet nxirren nga
1. Pasazhet apokaliptike të Dhjatës së Vjetër tek
 - a. Danieli
 - b. Ezekieli
 - c. Zakaria
 - d. Isaia
 2. Letërsia hebraike apokaliptike e shkruar midis dy Dhjatave
 3. Rrethanat historike greko-romake të shekullit të parë (sidomos Zbulesa 17)
 4. Rrëfimet e lashta mitologjike të Lindjes së Afërme në lidhje me krijimin (sidomos Zbulesa 12)
- C. Në përgjithësi ka katër rrjete interpretuese ose supozime
1. PRETERIST – ky grup e sheh librin si kryesisht ose ekskluzivisht të lidhur me kishat e shekullit të parë në provincën romake të Azisë. Të gjitha detajet dhe profecitë u përmbushën në shekullin e parë (shih John L. Bray, *Matheë 24 Fulfilled* [Xhon L. Brej, *Mateu 24 i Përmbushur*]).
 2. HISTORICIST – ky grup e sheh librin si një përbledhje historike, kryesisht të qytetërimit perëndimor dhe në një farë kuptimi të kishës katolike. Shpesh letrat ndaj shtatë kishave të kapitujve 2 dhe 3 përdoren si një përshkrim i caktuar i periudhave të kohës. Disa i shohin ato si përkohësisht të sinkronizuara dhe të tjerë si kronologjikisht vijuese.
 3. FUTURIST – ky grup e sheh librin si t'i referohej ndodhive të menjëhershme pararendëse dhe pasuese të *Parousia* (Ardhja e Dytë e Krishtit) e cila do të përmbushet në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe historike (shih *Progressive Dispensationalism*, nga Craig A. Blaising dhe Darrell L. Bock [*Dispensacionalizmi Progresiv*, nga Kreig A. Blleising dhe Darell L. Bok]).
 4. IDEALIST – ky grup e sheh librin si tërësisht simbolikë të luftës midis së mirës dhe së keqes në të cilën nuk ka asnjë referencë historike (shih Ray Summers, *Worthy Is the Lamb* [Rej Samërs, *I Denjë Është Qengji*; William Hendriksen, *More Than Conquerors* [Uilliam Hendriksen, *Më Shumë se Fitimtarë*]).
Të gjitha këto kanë pak vlefshmëri, por ato e humbasin paqartësinë e qëllim të zgjedhjes së zhanrit dhe të figurave nga Gjoni. Problemi është ekuilibri, jo se cila prej tyre është e saktë.

IX. QËLLIMI I LIBRIT

- A. Qëllimi i Zbulesës është që të tregojë sovranitetin e Perëndisë në histori dhe premtimin e arritjes së kulmit në të gjitha gjërat tek Ai. Besnikët duhet të qëndrojnë në besim dhe shpresë në mes të persekutimit dhe agresionit të sistemit të kësaj bote të rënë. Fokusi i librit është persekutimi (adhurimi i Perandorit në provincën lindore) dhe besnikëria (mësuesit e rremë dhe kompromisi kulturor) e besimtarëve në shekullin e parë dhe në çdo shekull (shih 2:10). Mbani mend, profetët folën për të ardhmen duke u përpjekur që të reformojnë të tashmen. Zbulesa nuk ka të bëjë vetëm me se si do të përfundojë, por edhe se si po ecën. Në artikullin e tij *The Expositors Bible Commentary*, Vol. I i titulluar, "The Eschatology of the Bible," Robert L. Sancy [*Komentari i Biblës së Ekspozitorit*, Vol. I i titulluar "Eskatologjia e Biblës", Robert L. Sensi] thotë: "profetët biblikë nuk ishin të shqetësuar kryesisht me kohën dhe me sistemimin kronologjik të ndodhive të së ardhmes. Për ta gjendja shpirtërore e bashkëkohësve të tyre ishte pika më e rëndësishme dhe vizita madhështore eskatologjike e Perëndisë për gjykimin e të padrejtëve dhe bekimin e besimtarëve ndërkallej për ndikimin etik në të tashmen" (fq. 104).
- B. Qëllimi i përgjithshëm përmbledhet mirë në hyrjen e shkurtër për tek përkthimet TEV dhe NJB
1. TEV, fq.1122: "Zbulesa ndaj Gjoni është shkruar në një kohë kur të krishterët po persekutoheshin për shkak të besimit të tyre në Jezus Krishtin si Zot. Shqetësimi kryesor i shkrimtarit është që t'ju japë shpresë dhe inkurajim lexuesve të tij dhe që t'i nxisë ata që të qëndrojnë besnikë gjatë kohëve të vuajtjeve dhe persekutimit."

2. NJB, fq.1416, “Bibla përmbledhet në mesazhin e shpresës dhe të simbolikës së pasur të këtij libri. Është një vizion i shpëtimit nga provat të cilat mësojnë popullin e Perëndisë, dhe një premtim për një të ardhme të lavdishme. Mesazhi shprehet me anë të imazheve të cilat tërheqin të gjithë Biblën, në mënyrë të tillë që çdo karakteristikë, kafshë, ngjyrë, numër, është ndjellëse dhe plot me mbitonë për një lexues që është i njohur me Dhjatën e Vjetër. Në këtë mënyrë ajo është një zbuluesë sekrete dhe aludive e asaj që do të vijë, edhe pse simbolizmi natyror i veprave të mëdha të adhurimit dhe të vegimit final të madhështisë mesianike të Qytetit të Ri të Shenjtë janë mjaftueshëm të qarta. Ishte një traditë për shkrime të tilla në Judaizëm nga Danieli e në vazhdim, që të forconin popullin e Perëndisë që gjendej në persekutim duke iu dhënë sigurinë për çlirim dhe triumf përfundimtar.”

C. Është thelbësore që interpretuesi t’i japë temës së shpengimit prioritet.

1. Perëndia ka sjellë shpëtim individual, korporativ dhe kozmik përmes Krishtit.
2. Shpengimi i Perëndisë është shpirtëror dhe fizik. Kisha u shpëtua, por ajo nuk është në rrethana të sigurta! Një ditë ajo do të jetë e tillë!
3. Perëndia ende e do njerëzimin e rënë, rebel dhe të vetë-qendëruar. Zemërimi i Perëndisë në vulat dhe boritë është për shpengim (shih Zbu. 9:20-21; 14:6-7; 16:9,11; 21:6b-7; 22:17).
4. Perëndia jo vetëm restauron njerëzimin e rënë, por edhe krijimin e rënë (shih Rom.8:18-25). E keqja në çdo nivel do të spastrohet!

Përpjekja e vazhdueshme e Perëndisë për të arritur njerëzimin e humbur me ungjillin lavdëron karakterin e hirshëm të Perëndisë. Gjykimet e enëve janë rezultat i së keqes kokëforte, jo të një Perëndie jodashës. Perëndia vetëm gjykon dhe izolon të keqen kur ajo refuzon sërish e sërish që të pendohet. Në shumë mënyra libri justifikon gjykimin e Perëndisë mbi njerëzimin e rënë dhe të papajtueshëm. Libri përfundon me një ftesë ungjilli (shih Zbu.22:17).

D. Ky libër nuk duhet të shihet si një diagramë kronologjike e ndodhive, kohëve dhe mënyrave të Ardhjes së Dytë. Ai shpesh është interpretuar si “sekreti” i historisë perëndimore (shtatë kishat shihen si epoka). Çdo brez ka imponuar historitë e veta në simbolet apokaliptike; deri tani të gjithë kanë gabuar.

Detajet e këtyre profecive do të jenë shumë më të dukshme ndaj vuajtjeve të brezit të fundit të besimtarëve nën Anti-Krishtin (shih 2 Thesalonikasve 2). Një interpretim fjalë për fjalë ka bërë që ky libër të shpërfillet nga disa (Calvin [Kalvini]), nënvlerësohet nga të tjerë (Luther [Luteri], “as apostolik , as profetik”) dhe të mbitheksohet nga të tjerët (milenialistët).

X. ÇELËSAT E BOBIT PËR INTERPRETIMIN

A. Ne kemi nevojë që të marrim parasysh aspektin e Dhjatës së Vjetër

1. Zhanri apokaliptik i Dhjatës së Vjetër është një lloj tejet simbolik letrar.
2. Aludime të numërta janë nxjerrë nga Dhjata e Vjetër (disa vlerësojnë se nga 404 vargje 275 përfshijnë aludime ndaj teksteve të Dhjatës së Vjetër); kuptimi i këtyre simboleve është riinterpretuar nën dritën e situatës romake të shekullit të parë.
3. Paralajmërimi profetik përdor ndodhitë aktuale për të paralajmëruar ndodhitë eskatologjike. Shpesh këto përmbushje historike të shekullit të parë tregojnë për përmbushjet finale historike të kohëve të fundit.

B. Struktura e përgjithshme e librit na ndihmon të shohim qëllimin e autorit

1. Vulat, boritë dhe enët mbulojnë në thelb të njëjtën periudhë kohore (kapitujt 6-16). Zbulësia është një dramë me akte vijuese.
2. Ekziston mundësia që kapitujt në Zbu.17-19 të jenë paralel me Zbu. 20-22. Pjesë të kapitullit 19 (p.sh., Zbu.19:11-21) janë të përmbledhura tek Zbu.20:7-10.
3. Shih shtatë njësitë letrare tek Pohimet Hyrëse, C.

C. Konteksti historik duhet të merret parasysh në çdo interpretim të librit

1. Prania e adhurimit të perandorit

2. Persekutimi lokal në provincat lindore
 3. Bibla nuk mund të thotë atë që nuk ka pasur kurrë për qëllim të thotë. Interpretimi i Zbulesës duhet të lidhet me ditën e parë të Gjonit. Mund të ketë përmbushje apo aplikime të shumëfishta, por ato duhet të themelohen në shekullin e parë.
- D. Kuptimi i disa prej termave lakonikë është humbur për shak të rrethanave tona kulturore, gjuhësore dhe ekzistenciale. Me shumë mundësi vetë ndodhitë e fundit të kohërave do të hedhin dritë tek interpretimi i duhur i këtyre simboleve. Kini kujdes që të mos shihni të gjitha detajet e kesaj drame apokaliptike. Interpretuesit modernë duhet të kërkojnë të vërtetën kryesore në secilin nga këto vegime.
- E. Me lejoni të përmbledh disa nga elementët kyç interpretues
1. Origjinat historike të simbolizmit
 - a. Temat e Dhjatës së Vjetër, aludimet e Dhjatës së Vjetër
 - b. Mitologjia antike e Lindjes së Afërme
 - c. Letërsia apokaliptike e shkruar midis dy Dhjatave
 - d. Rrethanat greko-romake të shekullit të parë
 2. Mënyrat e autorit për të përkufizuar simbolizmin e tij
 - a. Bisedat me udheheqësit ëngjëjllor
 - b. Himni i korit qiellor
 - c. Vetë autori pohon kuptimin
 3. Struktura e librit (paralelizmi dramatik)
- F. Ndhimë e mëtejshme
1. Dy komentatorët e mi të preferuar mbi Zbulesën janë George Eldon Ladd [Xhorxh Elldon Led] dhe Alan F. Johnson [Allan F. Xhonson]. Ata nuk bien dakord. Ka shumë mosdakordësim midis studiuesve të perëndishëm, të edukuar, të sinqertë saqë nevojitet një fjalë paralajmërimi. Më lejoni të citoj Alan Johnson [Allan Xhonson] në librin e tij *Commentary on Revelation [Komentarin mbi Zbulesën]* të publikuar nga Zondervan:

“Nën dritën e përdorimit të përpunuar të imazheve dhe të vegimeve nga Zbu. 4:1 deri në fund të librit të Zbulesës dhe pyetja është se si ky material lidhet me kapitujt 1-3, nuk është e habitshme që komentatorët ndryshojnë shumë në mënyrën e tyre të trajtimit të këtyre kapitujve. Një problem është ai i interpretimit: *Çfarë* domethënie kanë imazhet dhe vizionet? Një problem tjetër përfshin kronologjinë: *Kur* ndodhin këto ngjarje? Me tej, a i interpreton Gjoni imazhet e tij të shpeshta të Dhjatës së Vjetër në përputhje të plotë me ato të burimeve të tyre të Dhjatës së Vjetër, apo i interpreton ai këto imazhe në mënyrë të lirë? Çfarë është simbolike dhe çfarë është e drejtëpërdrejtë? Përgjigje për pyetje të tilla do të përcaktojnë përqsasjen e interpretuesit. Duke qenë se pak nga këto pyetje janë përgjigje të mundshme dogmatike, ka nevojë për tolerancë në përqsasjet divergjente duke shpresuar që Fryma të mund të përdorë diskutimet me mendje të hapura për të na drejtuar edhe më tej tek kuptimi i Apokalipsit” (fq.69).
 2. Për një hyrje të përgjithshme tek marrëdhënia e Zbulesës me Dhjatën e Vjetër, unë rekomandoj librat e John P. Milton *Prophecy Interpreted* [Xhon P. Millton *Profecia e Interpretuar*] dhe John Bright *The Authority of the Old Testament* [Xhon Brajt *Autoriteti i Dhjatës së Vjetër*]. Për një diskutim të mirë të marrëdhënies së Zbulesës me Palin, unë rekomandoj librin e James S. Stewart *A Man In Christ* [Xhejms S. Stjuart *Një Njeri në Krishtin*].

XI. FJALË DHE FRAZA QË DUHEN PËRCAKTUAR SHKURTIMISHT

1. “gjërat që duhet të ndodhin së shpejti”, 1:1, 3
2. “duke ardhur në re”, 1:7
3. Amen, 1:7
4. “Alfa dhe Omega”, 1:8
5. “nga goja i dilte një shpatë me dy tehe”, 1:16
6. “çelësat e vdekjes dhe Hadesit”, 1:18

7. “e ke braktisur dashurinë e parë”, 2:4
8. “atij që triumfon”, 2:7
9. “pema e jetës në Kopshtin e Perëndisë”, 2:7
10. “sinagogë e Satanit”, 2:9; 3:9
11. “vdekja e dytë”, 2:11
12. “gjërat e thella të Satanit”, 2:24
13. “libri i jetës”, 3:5
14. “çelësi i Davidit”, 3:7
15. Jerusalemi i ri, 3:12
16. “Isha në Frymë”, 4:2
17. Det i xhamtë, 4:6
18. Libër, 5:1
19. Shtatë vulat, 5:1
20. “një Qengj që rrinte në këmbë si i therur”, 5:6
21. “shtatë brirë dhe shtatë sy”, 5:6
22. “mundimi i madh”, 7:14
23. “temjanicë e artë”, 8:3
24. “honi i pafund”, 9:2
25. Haleluja, 19:1
26. “darka e dasmës së Qengjit”, 19:9
27. “shtrydhësen e verës së zemërimit të Perëndisë”, 19:15
28. “e lidhi për një mijë vjet”, 20:2
29. Jerusalemi i ri, 21:1
30. “ylli vezullues i mëngjesit”, 22:16

XII. PERSONA QË DUHEN IDENTIFIKUAR SHKURTIMISHT

1. “përçar nga engjëlli i tij”, 1:1
2. Gjoni, 1:1
3. “shtatë shpirtrat”, 1:4
4. I Plotfuqishmi, 1:8
5. Kush përshkruhet në 1:12-16? Nga vjen ky përshkrim?
6. Nikolaitasit, 2:6, 15
7. Jezebela, 2:20
8. Pleqtë, 4:4, 10
9. Luani që vjen nga fisi i Judës, 5:5
10. “një kalë i bardhë, dhe ai që ishte ulur mbi të kishte një hark”, 6:2
11. “nën altar, shpirtrat e atyre që ishin therur”, 6:9
12. “vuri vulën... mbi ballin e tyre”, 7:3
13. “një turmë e madhe”, 7:9
14. “një yll nga qielli”, 9:1
15. “një tjetër engjëll i fuqishëm”, 10:1
16. “dy dëshmitarët”, 11:3
17. Një grua, 12:1
18. “një dragua i madh dhe i kuq”, 12:3
19. “një bir, një fëmijë mashkull”, 12:5
20. “një bishë doli nga deti”, 13:1
21. “një tjetër bishë doli nga toka”, 13:11
22. Babiloni, 14:8
23. Lavirja e madhe, 17:1
24. “një kalë i bardhë, dhe ai që rrinte ulur mbi të”, 19:11
25. Gogu dhe Magogu, 20:8

XIII. VENDNDODHJE QË DUHEN GJETUR NË HARTË

1. Patmos, 1:9
2. Efes, 1:11
3. Smirna, 1:11
4. Pergam, 1:11
5. Thiatira, 1:11
6. Sarda, 1:11
7. Filadelfia, 1:11
8. Laodicea, 1:11
9. Mali Sion, 14:1

XIV. PYETJE PËR DISKUTIM

1. Çfarë gjinie letrare është Zbulesa? Rëndit tiparet e tij.
2. Pse përmenden shtatë kisha në kapitujt 2 dhe 3?
3. Pse do të vajtojnë gjithë fiset e tokës për të? (1:7)
4. Rëndit gjithë “shtatat” në kapitullin 1.
5. Ç’do të thotë që Jezusi do t’ia heqë shandanin kësaj kishe? (2:5)
6. Rëndit gjërat e përbashkëta që gjenden në mesazhin e secilës prej shtatë kishave.
7. Cili është konteksti i kapitujve 4-5?
8. Cila është marrëdhënia mes shtatë vulave, shtatë borive dhe shtatë kupave?
9. Cilët janë shtatë kalorësit e kapitullit 6? Nga vjen kjo lloj simbolike?
10. Kush janë 144,000 vetët? Pse fiset judaike renditen në mënyrë “të pasaktë”?
11. Pse rriten gjykimet, nga 1/4 në vulat tek 1/3 në boritë, për ta përmbushur shkatërrimin në kupat?
12. Për kë bën fjalë ushtria me 200,000,000 vetë në 9:1-19?
13. Përshkruaj luftën në qiell në 12:7-10.
14. Pse lejon Perëndia që bisha të luftojë kundër shenjtorëve? (13:7)
15. Si e imiton bisha Krishtin?
16. Kush do të marrë pjesë në ringjalljen e parë? (2:4-6). Kush do të marrë pjesë në ringjalljen e dytë?
17. Cila është domethënia e 22:3?
18. Si lidhet 22:5 me 20:4?
19. Shpjego 22:18-19 me fjalët e tua.
20. Cila është tema kryesore e Zbulesës?

SHTOJCA NJË FJALORTH

Adopsionizmi. Ishte një nga pikëpamjet e hershme për marrëdhënien e Jezusit me hyjninë. Në thelb, pohonte se Jezusi ishte njeri normal në të gjitha mënyrat dhe se u birësua në mënyrë të veçantë nga Perëndia në çastin e pagëzimit (shih Mat. 3:17; Marku 1:11), ose në ringjalljen e tij (Rom. 1:4). Jezusi bëri një jetë kaq shembullore saqë Perëndia, në një pikë të caktuar, (në pagëzim, ose në ringjallje) e adoptoi si “birin” e vet (shih Rom. 1:4; Fil. 2:9). Kjo ishte një pikëpamje pakice në kishën e hershme në shekullin e tetë. Në vend që Perëndia të bëhet njeri (Mishërimi), kjo pikëpamje e përmbys radhën dhe, tani, njeriu bëhet Perëndi!

Është e vështirë të shprehim sesi Jezusi, Biri i perëndisë, hyjni paraekzistuese, u shpërblye ose u përlëvduar për jetën e tij shembullorë. Nëse ishte tashmë Perëndi, si mund të shpërblehej? Nëse kishte lavdi paraekzistuese hyjnore, si mund të nderohej më tepër se kaq? Ndonëse e kemi vështirë ta rrokim këtë, Ati në njëfarë mënyre e nderoi Jezusin në mënyrë të veçantë për përmbushjen e përsosur të vullnetit të Atit.

Alegori. Ky është një lloj interpretimi biblik që, së pari, u zhvillua brenda judaizmit aleksandrian. U popullarizua nga Filoja i Aleksandrisë. Thelbi bazë i alegorisë është dëshira për t'i dhënë Shkrimit peshë aktuale në sistemin filozofik ose kulturor të kohës duke anashkaluar sfondin historik dhe/ose kontekstin letrar të Biblës. Ajo kërkon një kuptim të fshehur ose shpirtëror pas çdo teksti të Shkrimit. Duhet pranuar se Jezusi, në Mateu 13, dhe Pali, në Galatasve 4, përdorën alegori për të përçuar të vërtetën. Sidoqoftë, këtë e bënë në formë tipologjie, jo ngushtësisht alegorie.

Aleksandrinus. Ky dorëshkrim greqisht i shekullit të pestë nga Aleksandria, në Egjipt, përfshin Dhiatën e Vjetër, Apokrifët dhe shumicën e Dhiatës së Re. Ai është një nga dëshmitarët tanë kryesorë për gjithë Dhiatën e Re në greqisht (me përjashtim të disa pjesëve të Mateut, Gjonit dhe 2 Korintasve). Kur ky dorëshkrim, që emërtohet me shkronjën “A”, përkon me dorëshkrimin e emërtuar “B” (Vatikanus) për ndonjë variant të caktuar teksti, konsiderohet si teksti origjinal nga shumica e studiuesve në shumicën e rasteve.

Analogjia e Shkrimit. Kjo frazë përdoret për të përshkruar pikëpamjen se gjithë Bibla është frymëzuar nga Perëndia dhe se, si rrjedhojë, nuk është kontradiktore, por plotësuese, në vetvete. Ky pohim parasupozues është baza për përdorimin e pasazheve paralele për të interpretuar pjesët biblike.

Anësi. Ky është një term që përdoret për të përshkruar një predispozitë të fortë kundrejt një objekti ose pikëpamjeje. Është një mendësi ku paanësia është e pamundur në lidhje me një objekt ose pikëpamje të caktuar. Anësia është një pozicion i paragjykuar.

Antitetik. Ky është një nga tre termat përshkrues që përdoren për të përcaktuar marrëdhënien mes rreshtave të poezisë hebraike. Ajo përshkruan ato rreshta poezie që janë të kundërt në kuptim me njëra-tjetrën (shih Prov. 10:1; 15:1).

Antropomorfik. Ky term do të thotë “të kesh karakteristika që shfaqen në qeniet njerëzore” dhe përdoret për të përshkruar terminologjinë tonë fetare në lidhje me Perëndinë. Ai vjen nga fjala greke “njerëzim”. Do të thotë se ne flasim për Perëndinë si të ishte njeri. Perëndia përshkruhet me fjalë fizike, sociologjike dhe psikologjike që lidhen me qeniet njerëzore (shih Zan. 3:8; 1 Mbret. 22:19-23). Sigurisht, kjo është thjesht analogji. Sidoqoftë, s’kemi ç’kategori ose fjalë të tjera të përdorim përveç atyre njerëzore. Si rrjedhojë, ndonëse e vërtetë, njohuria jonë për Perëndinë është e kufizuar.

Apolog (Apologjetikë). Kjo vjen nga rrënja e fjalës greke “mbrojtje ligjore”. Përbën një disiplinë të veçantë brenda teologjisë, e cila përpiket të japë fakte dhe argumente racionale për besimin e krishterë.

A priori. Në thelb, ky është sinonim i termit “presupozim”. Nënkupton arsyetim mbi bazën e përcaktimeve, parimeve, ose pozicioneve të pranuar më parë, të cilat merren si të vërteta. Pra, nënkupton atë që pranohet pa shqyrtim ose analizë.

Arianizëm. Ari ishte presbiter në kishën e Aleksandrisë, në Egjipt, në shekullin e tretë dhe në fillim të shekullit të katërt. Ai thoshte se Jezusi ishte paraekzistues, por jo hyjnor (jo i së njëjtës substance si Ati), ndoshta duke ndjekur Fjalët e Urta 8:22-31. Ai u sfidua nga peshkopi i Aleksandrisë, i cili (më 318 pas K.) nisi një polemikë që zgjati shumë vjet. Arianizmi u bë kredoja zyrtare e kishës lindore. Këshilli i Nikesë, më 325 pas K., e dënoi Arin dhe pohoi barazinë e plotë të Birit me Atin si dhe natyrën e tij të plotë hyjnore.

Aristoteli. Ishte një nga filozofët e Greqisë së lashtë, nxënës i Platonit dhe mësues i Aleksandrit të Madh. Edhe sot, ndikimi i tij depërton në shumë fusha të studimeve moderne. Kjo ndodh për shkak se ai theksonte njohurinë përmes vëzhgimit dhe klasifikimit. Ky është një nga parimet bazë të metodës shkencore.

Autografet. Ky është një emër që u jepet shkrimeve origjinale të Biblës. Të gjitha këto dorëshkrime origjinale, të shkruara me dorë, kanë humbur. Kanë mbetur vetëm kopjet e kopjeve. Ky është burimi i shumë varianteve tekstuale në dorëshkrimet hebraisht dhe greqisht dhe në versionet e lashta.

Autori fillestar. Me këtë, kuptojmë autorët/shkruesit realë të Shkrimit.

Autoriteti biblik. Ky term përdoret në një kuptim shumë të specializuar. Përcaktohet si përpjekja për të kuptuar atë që tha autori fillestar në kohën e vet dhe për ta zbatuar këtë të vërtetë në kohën tonë. Zakonisht, autoriteti Biblik përcaktohet si “konsiderimi i Biblës vetë si udhërrëfyesi ynë i vetëm me autoritet”. Sidoqoftë, në dritën e disa interpretimeve të papërshtatshme të kohës sonë, këtë koncept e kam kufizuar për të nënkuptuar interpretimin e Biblës sipas parimeve të metodës historiko-gramatikore.

Beza. Ky është një dorëshkrim greqisht dhe latinisht i shekullit të gjashtë pas K. Emërtohet “D”. Përmban ungjijtë, Veprat dhe disa nga letrat e përgjithshme. Karakterizohet nga shumë shtesa shkruesish. Përbën bazën e “Textus Receptus”, tradita kryesore e dorëshkrimeve greqisht që qëndron pas King James Version.

Deduktive. Kjo metodë logjike ose arsyetimi kalon nga parimet e përgjithshme në zbatime të veçantë me anë të arsyes. Është e kundërta e arsyetimit induktiv, i cili reflekton metodën shkencore duke kaluar nga elementet e veçanta të vëzhguara në përfundime të përgjithshme (teori).

Dialektike. Kjo është metoda arsyetuese me anë të së cilës ajo që duket kontradiktore ose paradoksale mbahet e bashkuar brenda një tensioni, duke kërkuar një përgjigje të unifikuar që përfshin të dyja anët e paradoksit. Shumë doktrina biblike kanë çifte dialektike, paracaktimi-vullneti i lirë; siguria-qëndresa; besimi-veprat; vendimi-dishepullizimi; liria e krishterë-përgjegjësia e krishterë.

Diaspora. Ky është termi teknik që përdorej nga judenjtë e Palestinës për të përshkruar judenjtë e tjerë që jetonin jashtë kufijve gjeografikë të Tokës së Premtuar.

Disa parime të shprehura të gnosticizmit valentinian dhe kerintian në shekullin e dytë janë: (1) materia dhe shpirti janë të bashkëpërbërshme (dualizmi ontologjik). Materia është e keqe, shpirti është i mirë. Perëndia, i cili është shpirt, nuk mund të merret drejtpërdrejt me modelimin e materies së ligë; (2) midis Perëndisë dhe materies ekzistojnë “rrezatime” (*eon-et*, ose nivelet engjëlllore). I fundmi dhe më i ulëti i tyre ishte Jahve i DhV, i cili formoi universin (*kozmos*); (3) Jezusi ishte një rrezatim si Jahve, por i një shkalle më të lartë, më pranë Perëndisë së vërtetë. Disa e vendosnin në shkallën më të lartë, por gjithsesi, si më të ulët se Perëndia dhe sigurisht jo si Hyjni të mishëruar (shih Gjoni 1:14). Meqë materia është e ligë, Jezusi nuk mund të kishte trup njerëzor dhe të mbetej prapëseprapë hyjnor. Ai ishte një fantazmë shpirtërore (shih 1 Gjonit 1:1-3; 4:1-6); dhe (4) shpëtimi sigurohej me anë të besimit në Jezusin plus një njohuri të veçantë, e cilat njihet vetëm nga persona të veçantë. Nevojitej njohuri (fjalëkalimet) për të kaluar përmes sferave qiellore. Për të arritur te Perëndia nevojitej dhe legalizmi judaik.

Disa shembuj të kësaj gjinie janë (1) në Dhiatën e Vjetër, Ezekieli (kapitujt 36-48), Danieli (7-12), Zakaria, dhe (2) në Dhiatën e Re, Mateu 24, Marku 13; 2 Thesalonikasve 2; dhe Zbulesa.

Dorëshkrim. Ky term ka të bëjë me kopjet e ndryshme të Dhiatës së Re në greqisht. Zakonisht, ato ndahen në lloje të ndryshme sipas (1) materialit ku janë shkruar (papyrus, lëkurë), ose (2) formës së vetë shkrimit (shkrim me shkronja të mëdha, ose me shkronja të lidhura kursive). Shkurtimi i saj është “MS” (njëjës), ose “MSS” (shumës).

Dyktimësia. Kjo ka të bëjë me pasigurinë që rezulton në një dokument të shkruar kur ka dy ose më tepër kuptime të mundshme, ose kur përmenden dy ose më tepër gjëra në të njëjtën kohë. Ka gjasa që Gjoni të ketë përdorur dyktimësinë e qëllimshme (fjalë më kuptim të dyfishtë).

Eisegjezë. Kjo është e kundërta e eksegezës. Nëse eksegeza është “nxjerrja jashtë” e synimit të autorit fillestar, ky term nënkupton “futjen” e një ideje ose mendimi të huaj në tekst.

Eklektik. Ky term përdoret në lidhje me kritikën e tekstit. Nënkupton praktikën e përzgjedhjes së varianteve nga dorëshkrime të ndryshme greqisht me qëllim që të arrijmë te një tekst që supozohet se është pranë autografeve origjinalë. Ai refuzon pikëpamjen se një familje e caktuar dorëshkrimesh greqisht përmban tekstin origjinal.

Eksegezë. Ky është një term teknik për praktikën e interpretimit të një pasazhi të caktuar. Do të thotë “të nxjerrësh jashtë” (nga teksti), që nënkupton se synimi ynë është të kuptojmë synimin e autorit fillestar në dritën e sfondit historik, kontekstit letrar, sintaksës dhe kuptimit të fjalëve në kohën që u shkruan.

Ekuivalenca dinamike. Kjo është një teori e përkthimit të Biblës. Përkthimi i Biblës mund të shihet si një vijë e vazhduar, nga përkimi “fjalë për fjalë”, ku për çdo fjalë hebraisht ose greqisht jepet një fjalë në gjuhën e përkthyesit, e deri te “parafraza”, ku përkthehet vetëm mendimi, pa u kujdesur shumë për fjalët ose frazat origjinale. Midis këtyre dy teorive qëndron “ekuivalenca dinamike”, e cila përpiket të marrë seriozisht tekstin origjinal, por e përkthen me forma dhe idioma gramatikore të sotme. Një diskutim shumë i mirë për këto teori të ndryshme përkthimi gjendet në librin e Fee dhe Stuart, *How to Read the Bible For All Its Worth*, f. 35, dhe në Hyrjen e Robert Bratcher për versionin TEV.

Etimologji. Ky është një aspekt i studimit të fjalëve që përpiket të sigurojë kuptimin fillestar të fjalëve. Nga ky kuptim rrënje, identifikohen më lehtë përdorimet e specializuara të fjalëve. Në interpretim, fokusin kryesor nuk e përbën etimologjia, por kuptimi dhe përdorimi i fjalëve në kohën e autorit.

Është e vështirë të shpjegojmë me fjalë sesi Jezusi, Perëndia Bir, një hyjni paraekzistues, u shpërblye ose u lartësua për jetën shembullore që kreu. Nëse ai ishte tashmë Perëndi, si mund të shpërblehej? Nëse kishte lavdinë hyjnore paraekzistuese, si mund të nderohej më tepër? Ndonëse e kemi të vështirë që ta kuptojmë, Ati në njëfarë mënyre e nderoi Jezusin në një kuptim të veçantë për përmbushjen e përsosur që ai i bëri vullnetit të Atit.

Fragmenti Muratorian. Kjo është një listë e librave kanonikë të Dhiatës së Re. U shkrua në Romë përpara vitit 200 pas K. Jep po ata njëzet e shtatë libra që kemi në DhR protestante. Kjo tregon qartazi se, praktikisht, kishat lokale në pjesë të ndryshme të perandorisë romake e kishin përcaktuar kanonin përpara këshillave të mëdhenj të kishës në shekullin e katërt.

Frymëzim. Ky është koncepti se Perëndia i ka folur njerëzimit duke udhëhequr autorët biblikë që të shënojnë saktë dhe qartë zbulesën e tij. Zakonisht, koncepti i plotë shprehet me tre terma: (1) zbulesë – Perëndia ka vepruar në historinë njerëzore; (2) frymëzim – ai ua ka dhënë interpretimin e duhur të veprimeve të tij, si dhe kuptimin e tyre, disa njerëzve të zgjedhur që ta shkruanin për njerëzimin; dhe (3) përndritje – ai na ka dhënë Frymën e vet që të ndihmojë njerëzimin të kuptojë vetëzbulesën e tij.

Fushë semantike. Ka të bëjë me gamën e plotë të kuptimeve që shoqërohen me një fjalë të caktuar. Në thelb, nënkupton ngjyrimet e ndryshme që ka një fjalë në kontekste të ndryshme.

- Gnosticizëm.** Shumica e njohurisë sonë për këtë herezi vjen nga shkrimet gnostike të shekullit të dytë. Sidoqoftë, idetë fillestare të tij ishin të pranishme në shekullin e parë (dhe më herët).
- Gjini letrare.** Kjo ka të bëjë me format e veçanta që mund të marrë komunikimi njerëzor, si poezia ose narrativa historike. Secili lloj letërsie ka procedurat e veta të veçanta nga ana hermeneutike, përpos parimeve të përgjithshme që vlejné për çdo letërsi të shkruar.
- Gjinia.** Vjen nga një term francez (“zhanër”) që nënkupton llojet e ndryshme të letërsisë. Thelbi i këtij termi është ndarja e formave letrare në kategori që kanë karakteristika të përbashkëta: narrativa historike, poezia, fjalët e urta, apokaliptikja dhe legjislacioni.
- Gjuhë përshkrimi.** Kjo përdoret në lidhje me idiomat ku është shkruar Dhiata e Vjetër. I flet botës sonë në kuadër të mënyrës sesi na shfaqen gjërat ndaj pesë shqisave. Nuk është përshkrim shkencor, dhe as nuk synon të jetë i tillë.
- Hermeneutikë.** Ky është term teknik për parimet që i prijné eksegjezës. Ajo është edhe një grup parimesh të veçanta, edhe art. Hermeneutika biblike, ose e shenjtë, zakonisht ndahet në dy kategori: parimet e përgjithshme dhe parimet e veçanta. Ato lidhen me llojet e ndryshme të literaturës që gjendet në Bibël. Secili lloj (gjini) i veçantë ka parimet e veta unike, por ndan edhe disa supozime dhe procedura të përbashkëta interpretimi.
- I fjalëpërfjalshëm.** Ky është një emër tjetër i metodës historike dhe me fokus tekstin, që erdhi nga Antiokia. Do të thotë se interpretimi përfshin kuptimin normal dhe të dukshëm të gjuhës njerëzore, ndonëse pranon gjithsesi dhe praninë e gjuhës së figurshme.
- Idiomë.** Kjo fjalë përdoret për frazat që gjenden në kultura të ndryshme, të cilat kanë kuptim të specializuar që nuk lidhet me kuptimin e zakonshëm të termave në vetvete. Disa shembuj të sotëm janë: “ishte tmerrësisht e shkëlqyer”, ose “ti më heq trurin”. Edhe Bibla përmban këto lloj frazash.
- Induktive.** Kjo është një metodë logjike ose arsyetuese që kalon nga elementet e veçanta te tërësia. Është metoda empirike e shkencës moderne. Në thelb, është qasja e Aristotelit.
- JHVH.** Ky është emri i Besëlidhjes i Perëndisë në Dhiatën e Vjetër. Përcaktohet në Eksodi 3:14. Është forma KAUZATIVE e termit hebraisht “jam”. Judenjtë druheshin të shqiptonin emrin, që të mos e merrnin më kot; prandaj, e zëvendësonin me termin hebraisht *Adonai*, “zot”. Kështu u përkthye në anglisht ky emër besëlidhjeje.
- Judaizmi rabinik.** Kjo fazë e jetës së popullit jude filloi me robërinë babilonase (586-538 para K.). Me humbjen e ndikimit të priftërinjve dhe Tempullit, sinagogat lokale u bënë fokusi i jetës judaike. Këto qendra lokale të kulturës, bashkësisë, adhurimit dhe studimit biblik jude u bënë fokusi i jetës fetare të kombit. Në kohën e Jezusit, kjo “fe e skribëve” ishte paralele me atë të priftërinjve. Pas rënies së Jerusalemit më 70 pas Krishtit, forma skribale, e mbizotëruar nga farisenjtë, vuri nën kontroll drejtimin e jetës fetare judaike. Karakterizohet nga interpretimi praktik dhe legalist i Torahut, i cili shpjegohet nga tradita gojore (Talmudi).
- Kanon.** Ky është një term i përdorur për të përshkruar ato shkrime që besohet se janë frymëzuar në mënyrë unike. Përdoret për Shkrimet e Dhiatës së Vjetër dhe asaj të Re.
Këta njerëz të urtë guxuan të bënin pyetjet e vështira të jetës. Shpesh, ata i sfidonin pikëpamjet fetare tradicionale (Jobi dhe Predikuesi). Ata formojné një ekuilibër dhe tension ndaj përgjigjeve të lehta për tragjeditë e jetës.
Kjo kategori teologjike po ritheksohet nga lëvizja e “tokës së vjetër” ndër shkencëtarët e krishterë (p.sh., shkrimet e Hugh Ross). Ata e përdorin këtë kategori për të pohuar se gjithë e vërteta është e vërteta e Perëndisë. Natyra është derë e hapur për njohurinë rreth Perëndisë; është e ndryshme nga zbulesa e

veçantë (Bibla). Ajo i jep shkencës moderne lirinë që të hulumtojë rendin natyror. Për mendimin tim, ajo përbën një mundësi të re të shkëlqyer për t'i dëshmuar botës së sotme shkencore në perëndim.

Komentar. Ky është një lloj i specializuar libri kërkimor. Ai jep një sfond të përgjithshëm për librin biblik. Pastaj, përpiqet të shpjegojë kuptimin e çdo pjese të librit. Disa komentare fokusohen te zbatimi, ndërsa të tjerë e trajtojnë tekstin në mënyrë më teknike. Këta libra janë të dobishëm, por duhen përdorur pasi të kesh përfunduar studimin paraprak personal. Interpretimet e komentuesit nuk duhen pranuar kurrë me symbyllur. Zakonisht, krahasimi i disa komentareve që japin pikëvështrime të ndryshme teologjike është diçka e dobishme.

Kristocentrik. Ky është një term që përdoret për të përshkruar natyrën dhe rolin qendror të Jezusit. Unë e përdor në lidhje me konceptin se Jezusi është Zoti i gjithë Biblës. Dhjata e Vjetër dëfton drejt tij dhe ai është përbushja dhe synimi i saj (shih Mat. 5:17-48).

Kritika e lartë. Kjo është ajo procedurë e interpretimit biblik që fokusohet te sfondi historik dhe te struktura letrare e një libri të veçantë biblik.

Kritika e ulët. Shih “kritika e tekstit”.

Kritikë e tekstit. Ky është studimi i dorëshkrimeve të Biblës. Kritika e tekstit është e domosdoshme pasi nuk ekziston asnjë dorëshkrim origjinal dhe kopjet ndryshojnë nga njëra-tjetra. Ajo përpiqet të shpjegojë variantet dhe të arrijë (sa më tepër të mundet) te fjalët origjinale të autografeve të Dhiatës së Vjetër dhe asaj të Re. Shpesh, quhet “kritika e ulët”.

Legalizëm. Ky qëndrim karakterizohet nga mbitheksimi i rregullave ose ritualeve. Priret të bazohet në zbatimet njerëzore të rregullave si mjet pranimit nga Perëndia. Priret të nënvlerësojë marrëdhënien dhe lartëson veprat, ndonëse këto janë të dyja aspekte të rëndësishme të marrëdhënies së besëlidhjes mes Perëndisë së shenjtë dhe njerëzimit të mëkatshëm.

Leksik analitik. Ky është një lloj mjeti kërkimor që të lejon të identifikosh çdo formë greqisht në Dhiatën e Re. Leksiku është një përmbledhje, në rendin alfabeti greqisht, e formave dhe përcaktimeve bazë. Në kombinim me një përkthim ndërlinear, u mundëson besimtarëve që s’lexojnë dot greqisht që të analizojnë format gramatikore dhe sintaksore greqisht të Dhiatës së Re.

Letërsia apokaliptike. Kjo ishte në masën mbizotëruese (ndoshta, edhe në mënyrë unike) një gjini judaike. Ishte një lloj kriptik shkrimi që përdorej në kohë pushtimi dhe okupimi të judenjve nga fuqitë e huaja botërore. Supozimi i saj është se ngjarjet botërore janë krijuar dhe kontrollohen nga një Perëndi personal dhe shpengues, dhe se Izraeli ka rëndësi të veçantë për të dhe për përkuajdesjen e tij. Kjo literaturë premton fitoren përfundimtare përmes përpjekjes së veçantë të Perëndisë.

Letërsia e urtësisë. Kjo ishte një gjini letërsie e përhapur në lindjen e afërt në lashtësi (si dhe në botën moderne). Në thelb, ishte përpjekje për të udhëzuar brezin e ri me udhëzime për jetë të suksesshme përmes poezisë, fjalëve të urta, ose eseve. I drejtohej më tepër individit sesa shoqërisë si kolektiv. Nuk përdorte aludime për historinë, por bazohej në përvojën dhe vëzhgimet nga jeta. Në Bibël, Jobi e deri te kënga e Këngëve merrnin si të sigurt praninë dhe adhurimin e JHVH, por ky botëkuptim fetar nuk është i shkoqur çdo herë, apo në çdo përjetim njerëzor.

Metonimia. Kjo është një figurë letrare, ku emri i diçkaje përdoret për të paraqitur diçka tjetër që shoqërohet me të. Për shembull, “po zien çajniku” do të thotë “po zien uji në çajnik”.

Mësuesit e rremë gnostikë përkrahnin dy sisteme të kundërta etike: (1) për disa, stili i jetesës s’kishte fare lidhje me shpëtimin. Sipas tyre, shpëtimi dhe spiritualiteti përmbledhen në një njohuri të fshehtë (fjalëkalime) për të kaluar përmes sferave engjëjlore (*eon-eve*); ose (2) për disa të tjera, mënyra e jetesës ishte kyçe për shpëtim. Ata theksonin një stil asket jetese si provë spiritualiteti të vërtetë.

Ndërlineare. Ky është një lloj mjeti kërkimor, i cili u lejon atyre që nuk njohin gjuhën biblike që të arrijnë të analizojnë kuptimin dhe strukturën e saj. Kjo metodë e vendos përkthimin në gjuhën tonë në nivelin “fjalë për fjalë”, poshtë gjuhës origjinale biblike. Ky mjet, i kombinuar me “leksikun analitik”, jep format dhe përcaktimet bazë të hebraishtes dhe greqishtes.

Nestorianizëm. Nestori ishte patriarku i Kostandinopojës në shekullin e petë. Ishte edukuar në Antioki të Sirisë dhe pohonte se Jezusi kishte dy natyra, një plotësisht njerëzore dhe një plotësisht hyjnore. Kjo pikëpamje shmangej nga pikëpamja ortodokse e Aleksandrisë se Krishti ka një natyrë. Preokupimi kryesor i Nestorit ishte titulli “nëna e Perëndisë”, që i ishte dhënë Marisë. Nestori (dhe, rrjedhimisht, edukimi i tij antiokas) u kundërshtua nga Kirili i Aleksandrisë. Antiokia ishte qendra e qasjes historiko-gramatikore dhe tekstuale ndaj interpretimit biblik, ndërsa Aleksandria ishte qendra e shkollës së katërfishtë (alegorike) të interpretimit. Në fund, Nestorin e hoqën nga posti dhe e çuan në syrgjyn.

Njësi letrare. Ka të bëjë me ndarjet kryesore të mendimit në librat biblikë. Mund të përbëhet nga disa vargje, paragrafë ose kapituj. Ajo përbën një njësi të vetëpërmbajtur me temë qendrore.

Papirus. Ky është një lloj materiali nga Egjipti mbi të cilin mund të shkruhej. Bëhej nga kallamet e lumit. Papirusi është materiali në të cilin janë shkruar kopjet më të hershme të Dhiatës së Re në greqisht.

Paradoks. Ka të bëjë me ato të vërteta që duket sikur janë kontradiktore, por janë të dyja të vërteta, ndonëse në tension me njëra-tjetrën. Ato e inkuadrojnë të vërtetën duke e paraqitur nga anë të kundërta. Një pjesë e mirë e së vërtetës biblike paraqitet në formë dyshesh paradoksale (ose dialektike). Të vërtetat biblike nuk janë yje të izoluar, por janë njësi që përbëhen nga formacione yjesh.

Parafrazë. Ky është emri i një teorie të përkthimit të Biblës. Përkthimi i Biblës mund të shihet si një vijë e vazhduar, nga përkimi “fjalë për fjalë”, ku për çdo fjalë hebraisht ose greqisht jepet një fjalë në gjuhën e përkthyesit, e deri te “parafraza”, ku përkthehet vetëm mendimi, pa u kujdesur shumë për fjalët ose frazat origjinale. Midis këtyre dy teorive qëndron “ekuivalenca dinamike”, e cila përpiket të marrë seriozisht tekstin origjinal, por e përkthen me forma dhe idioma gramatikore të sotme. Një diskutim shumë i mirë për këto teori të ndryshme përkthimi gjendet në librin e Fee dhe Stuart, *How to Read the Bible For All Its Worth*, f. 35.

Paragraf. Kjo është njësi interpretuese bazë në prozë. Përmban një mendim qendror dhe zhvillimin e tij. Nëse qëndrojmë te mesazhi i tij kryesor, nuk do të përqendrohemi te pikat anësore, as nuk do të humbasim synimin e autorit fillestar.

Pasazhet paralele. Ato janë pjesë e konceptit se gjithë Bibla është e dhënë nga Perëndia dhe, si rrjedhojë, është interpretuesja më e mirë e vetes si dhe drejtpeshuesja e të vërtetave paradoksale. Kjo është e dobishme edhe kur përpiqemi të interpretojmë një pasazh të paqartë ose të dykuptimtë. Pasazhet paralele na ndihmojnë edhe që të gjejmë pasazhin më të qartë për një temë të dhënë, si dhe gjithë aspektet e tjera biblike të një teme të dhënë.

Pergamenat e Detit të Vdekur. I referohet një serie me tekste të lashta, të shkruara në hebraisht dhe aramaisht, që u gjetën pranë Detit të Vdekur më 1947. Ato ishin bibliotekat fetare të judaizmit sektar të shekullit të parë. Trysnia e pushtimit romak dhe luftërat zelote të viteve '60 i shtynë që t'i fshihnin pergamenat në qypa qeramike të mbyllur hermetikisht, duke i vendosur në shpella ose vrime. Ato na kanë ndihmuar të kuptojmë sfondin historik të Palestinës së shekullit të parë dhe kanë vërtetuar se Teksti Masoretik është shumë i saktë, të paktën që nga fundi i periudhës para Krishtit. Ato emërtohen me shkurtimin “DSS”.

Përkues. Ky është një lloj mjeti kërkimor për studimin e Biblës. Ai rendit çdo përdorim të çdo fjale në Dhiatën e Vjetër dhe atë të Re. Na ndihmon në një sërë mënyrash: (1) përcakton fjalën hebraisht ose greqisht që qëndron pas çdo fjale të caktuar në gjuhën tonë; (2) krahason pasazhet ku është përdorur e njëjta fjalë në greqisht ose hebraisht; (3) tregon se ku dy terma të ndryshëm hebraisht ose greqisht janë përkthyer me të njëjtën fjalë në gjuhën tonë; (4) tregon shpeshësinë e përdorimit të disa fjalëve në libra ose autorë të

caktuar; (5) na ndihmon të gjejmë një pasazh të caktuar në Bibël (shih Walter Clark, *How to Use New Testament Greek Study Aids*, f. 54-55).

Përndritja. Ky është emri që i jepet konceptit se Perëndia i ka folur njerëzimit. Zakonisht, koncepti i plotë shprehet me tre terma: (1) zbulues – Perëndia ka vepruar në historinë njerëzore; (2) frymëzim – ai ua ka dhënë interpretimin e duhur të veprimeve të tij, si dhe kuptimin e tyre, disa njerëzve të zgjedhur që ta shkruanin për njerëzimin; dhe (3) përndritje – ai na ka dhënë Frymën e vet që të ndihmojë njerëzimin të kuptojë vetëzbuluesën e tij.

Përshkrimi simbolik i botës dhe botëkuptimi. Këta terma janë shoqërues të njëri-tjetrit. Të dy janë koncepte filozofike të lidhur me krijimin. Termi “përshkrim simbolik i botës” lidhet me “si-në” e krijimit, ndërsa “botëkuptimi” lidhet me “Kush-in”. Këta terma gjejnë përdorim në interpretimin se Zanafilla 1-2 trajton kryesisht “Kush-in”, jo “si-në”, e krijimit.

Platoni. Ishte një nga filozofët e Greqisë së lashtë. Filozofia e tij pati ndikim të jashtëzakonshëm në kishën e hershme përmes studiuesve nga Aleksandria e Egjiptit dhe, më vonë, nga Augustini. Platoni besonte se gjithçka në tokë ishte iluzion dhe thjesht kopje e një arketipi shpirtëror. Më vonë, teologët i barazuan “format/idetë” e Platonit me sferën shpirtërore.

Presupozim. Ka të bëjë me mënyrën e parakonceptuar si kuptojmë diçka. Shpesh, mendimet ose gjykimet tona për çështje të ndryshme i formojmë përpara se të shkojmë te vetë Bibla. Kjo predispozitë njihet edhe si anësi, si pozicion *a priori*, si supozim, ose si botëkuptim paraprak.

Provincializëm. Ka të bëjë me anësitë e rrënjësura në një sfond lokal teologjik/kulturor. Ai nuk e njeh natyrën ndërkulturore të së vërtetës biblike, apo zbatimin e saj.

Septuagintë. Ky është emri që iu dha përkthimit greqisht të Dhiatës së Vjetër hebraike. Tradita thotë se u shkrua në shtatëdhjetë ditë nga shtatëdhjetë studiues judenj për bibliotekën e Aleksandrisë në Egjipt. Data tradicionale është rreth 250 para K. (në të vërtetë, u deshën mbi njëqind vjet që të përfundonte). Ky përkthim është i rëndësishëm pasi (1) na jep një tekst të lashtë për ta krahasuar me tekstin hebraisht Masoretik; (2) na tregon gjendjen e interpretimit judaik në shekullin e tretë dhe të dytë para K.; (3) na jep botëkuptimin mesianik të judenjve përpara se të refuzonin Jezusin. Shkurtimi i tij është “LXX”.

Si gjini, ajo shprehte të vërtetën të përgjithshme. Sidoqoftë, kjo gjini nuk mund të përdoret në çdo situatë të veçantë. Këto janë pohime të përgjithshme që nuk zbatohen gjithmonë në çdo situatë individuale.

Sinaitikus. Ky është një dorëshkrim greqisht i shekullit të katërt pas K. U gjet nga studiuesi gjerman, Tischendorf, në manastirin e shën Katerinës në Xhebel Musa, vendi tradicional i malit Sinai. Ky dorëshkrim u emërtua me shkronjën e parë të alfabetit hebraik “alef” [א]. Përmban Dhiatën e Vjetër dhe atë të Re. Është një nga dorëshkrimet tona më të lashta unciale.

Sinonimik. Ka të bëjë me terma që kanë kuptime të njëjta ose shumë të ngjashme (ndonëse, në realitet, dy fjalë nuk kanë kurrë mbivendosje të plotë semantike). Ato janë të lidhura kaq ngushtë sa që mund të zëvendësojnë njëra-tjetrën në fjali pa i humbur kuptimin. Ky term përdoret edhe për të përcaktuar një nga tri format e paralelizmit poetik hebre. Në këtë kuptim, u referohet dy rreshtave poetikë që shprehin të njëjtën të vërtetë (shih Psa. 103:3).

Sintaksë. Ky është një term greqisht që i referohet strukturës së fjalisë. Lidhet me mënyrat sesi bashkohen pjesë e fjalisë për të dhënë një mendim të plotë.

Sintetik. Ky është një nga tri termat që lidhet me llojet poezisë hebraike. Ky term bën fjalë për ata rreshta poetikë që ndërtohen mbi njëri-tjetrin në mënyrë shtuese, nganjëherë, e quajtur “kulmore” (shih Psa. 19:7-9).

Shkolla aleksandriane. Kjo metodë e interpretimit biblik u zhvillua në Aleksandri të Egjiptit në shekullin e dytë pas Krishtit. Ajo përdor parimet interpretuese bazë të Filos, i cili ishte ndjekës i Platonit. Shpesh, ajo quhet metoda alegorike. Ajo mbizotëroi në kishë deri në kohën e Reformacionit. Përkrahësit më të aftë të saj ishin Origeni dhe Augustini. Shih Moises Silva, *Has The Church Misread The Bible?* (Academic, 1987).

Shkolla antiokase. Kjo metodë interpretimi biblik u zhvillua në Antioki të Sirisë në shekullin e tretë pas Krishtit si reagim ndaj metodës alegorike të Aleksandrisë në Egjipt. Thelbi bazë i saj ishte përqendrimi te kuptimi historik i Biblës. Ajo e interpretonte Biblën si letërsi normale dhe njerëzore. Kjo shkollë u përfshi në polemikën nëse Krishti kishte dy natyra (nestorianizmi) apo një natyrë (plotësisht Perëndi dhe plotësisht njeri). U shpall heretike nga kisha katolike e Romës dhe u zhvendos në Persi, por shkolla pati pak peshë. Më vonë, parimet e saj hermeneutike bazë u bënë parime interpretuese të reformatorëve klasikë të protestantizmit (Luteri dhe Kalvini).

Shpirtërizim. Ky term është sinonimik me alegorizimin, në kuptimin se përjashton kontekstin historik e letrar të pasazhit dhe interpreton në bazë të kriterëve të tjera.

Talmudi. Ky është titulli i kodifikimit të traditës gojore judaike. Judenjtë besojnë se Perëndia ia dha Moisiut në malin Sinai. Në të vërtetë, Talmudi duket se është urtësia kolektive e mësuesve judenj ndër vite. Ekzistojnë dy versione të ndryshme të shkruara të Talmudit: versioni babilonas dhe versioni më i shkurtër dhe i papërfunduar palestinas.

Teksti Masoretik. Kjo u referohet dorëshkrimeve hebraisht të Dhiatës së Vjetër në shekullin e nëntë, të prodhuara nga breza studiuesish judenj, të cilat përmbajnë pikësime zanoresh dhe të tjera shënime tekstuale. Ai përbën tekstin bazë për Dhiatën e Vjetër në gjuhën tonë. Teksti i tij është vërtetuar historikisht nga dorëshkrimet në hebraisht, sidomos Isaia, të njohura si Pergamenat e Detit të Vdekur. Shkurtohet si “MT”.

“Teksti provë”. Kjo është praktika e interpretimit të Shkrimit duke cituar një varg pa patur parasysh kontekstin e tij të atypëratyshëm apo kontekstin më të gjerë të njësisë së tij letrare. Kjo i largon vargjet nga synimi i autorit fillestar dhe, zakonisht, përfshin përpjekjen për të provuar një mendim personal duke pretenduar autoritet biblik.

Tekstus Receptus. Ky përcaktim u zhvillua në botimin e DhR greqisht prej Elzevirit më 1633 pas K. Në thelb, kjo është një formë e DhR greqisht që u prodhua nga disa dorëshkrime të vona greqisht dhe versione latinisht të Erazmit (1510-1535), Stefanusit (1546-1599) dhe Elzevirit (1624-1678). Në *An Introduction to the Textual Criticism of the New Testament*, f. 27, A. T. Robertson thotë: “praktikisht, teksti bizantin është Textus Receptus”. Teksti bizantin është më pak i vlefshmi nga tre familjet e dorëshkrimeve të hershme greqisht (perëndimore, aleksandriane dhe bizantine). Ai përmban gabimet e akumuluar prej shekujsh të teksteve të kopjuara me dorë. Megjithatë, edhe A. T. Robertson thotë: “Textus Receptus ka ruajtur për ne një tekst, në thelb, të saktë” (f. 21). Kjo traditë e dorëshkrimeve greqisht (sidomos botimi i tretë i Erazmit i 1522) përbën bazën e përkthimit të King James Version më 1611.

Teologji sistematike. Kjo është një fazë interpretimi që përpiqet t’i lidhë të vërtetat e Biblës në mënyrë të unifikuar dhe logjike. Ajo përbën një paraqitje logjike, jo thjesht historike, të teologjisë së krishterë nëpërmjet kategorive (Perëndia, njeriu, mëkati, shpëtimi, etj.).

Tipologjik. Ky është një lloj i specializuar interpretimi. Zakonisht, nënkupton të vërtetën e Dhiatës së Re që gjendet në pasazhet e Dhiatës së Vjetër me anë të një simboli analogjik. Kjo kategori e hermeneutikës është element kryesor i metodës aleksandriane. Për shkak të abuzimit me këtë lloj interpretimi, duhet që përdorimin e tij t’ia rezervojmë vetëm shembujve të veçantë të regjistruar në Dhiatën e Re.

Torah. Ky është term hebraisht, që do të thotë “mësim”. U bë titulli zyrtar për shkrimet e Moisiut (Zanafilla deri te Ligji i Përtërirë). Për judenjtë, është pjesa më e autoritetshme e kanonit hebre.

Vatikanus. Ky është dorëshkrimi greqisht i shekullit të katërt pas K. U gjend në bibliotekën e Vatikanit. Në fillim, përmbante gjithë Dhiatën e Vjetër, Apokrifët dhe Dhiatën e Re. Sidoqoftë, disa pjesë humbën (Zanafilla, Psalmet, Hebrenjve, letrat pastorale, Filemoni dhe Zbulesa). Është dorëshkrim shumë i dobishëm për përcaktimin e fjalëve origjinale të autografeve. Është emërtuar me shkronjën e madhe “B”.

Vulgata. Ky është emri i përkthimit të Biblës në latinisht nga Jeronimi. Ai u bë përkthimi bazë, ose “i përbashkët”, i kishës katolike të Romës. U bë në vitet 380 pas K.

Zbulesa e natyrshme. Kjo është një kategori e vetëzbulesës së Perëndisë ndaj njeriut. Ajo përfshin rendin e natyrshëm (Rom. 1:19-20) dhe ndërgjegjen morale (Rom. 2:14-15). Përmendet në Psa. 19:1-6 dhe Rom. 1-2. Duhet dalluar nga zbulesa e veçantë, e cila është vetëzbulesa e veçantë e Perëndisë në Biblën dhe, epërsisht, në Jezusin e Nazaretit.

Zbulesë. Ky është emri që i jepet konceptit se Perëndia ka folur me njerëzimin. Zakonisht, koncepti i plotë shprehet me tre terma: (1) zbulesë – Perëndia ka vepruar në historinë njerëzore; (2) frymëzim – ai ua ka dhënë interpretimin e duhur të veprimeve të tij, si dhe kuptimin e tyre, disa njerëzve të zgjedhur që ta shkruanin për njerëzimin; dhe (3) përndritje – ai na ka dhënë Frymën e vet që të ndihmojë njerëzimin të kuptojë vetëzbulesën e tij.

SHTOJCA DY

KRITIKA E TEKSTIT

Kjo temë do të trajtohet në mënyrë të tillë që të shpjegojmë shënimet tekstuale që gjenden në këtë komentari. Do të përdorim përvijimin e mëposhtëm:

- I. Burimet tekstuale të Biblës anglisht
 - A. Dhiata e Vjetër
 - B. Dhiata e Re
- II. Shpjegim i shkurtër i problemeve dhe teorive të “kritikës së ulët”, e quajtur edhe ‘kritika e tekstit’.
- III. Burime të sugjeruara për lexim të mëtejshëm

I. Burimet tekstuale të Biblës anglisht

A. Dhiata e Vjetër

1. Teksti Masoretik (MT) – teksti bashkëtingëllor hebraisht u përcaktua nga rabini Akiva më 100 pas K. Pikat e zanoreve, thekset, shënimet anësore, pikësimi dhe pikat e aparatusit filluan të shtoheshin në shekullin në shekullin e gjashtë pas K. dhe u përfunduan në shekullin e nëntë pas K. Kjo u bë nga një familje studiuesish judenj të njohur si Masoretët. Forma tekstuale që përdorën ata ishte e njëjta që përdoret në Mishnah, Talmud, Targumet, Peshita dhe Vulgatë.
2. Septuaginta (LXX) – Tradita thotë se Septuaginta u prodhua nga 70 studiues judenj në 70 ditë për bibliotekën e Aleksandrisë, me sponsorizimin e mbretit Ptoleme II (285-246 pas K.). Me gjasë, përkthimi u kërkua nga një udhëheqës jude që jetonte në Aleksandri. Kjo traditë vjen nga “Letra e Aristeeas”. Shpesh, LXX bazohet në një traditë tekstuale hebraisht që ndryshon nga teksti i rabinit Akiva (MT).
3. Pergamenat e Detit të Vdekur (DSS) – Pergamenat e Detit të Vdekur u shkruan në periudhën romake para Krishtit (200 para K. deri më 70 pas K.) nga një sekt separatisësh judenj të quajtur “esenë”. Dorëshkrimet hebraisht, të gjetura në vendndodhje të ndryshme përreth Detit të Vdekur, tregojnë një familje tekstuale hebraisht disi të ndryshme nga ajo e MT dhe LXX.
4. Disa shembuj të veçantë për mënyrën sesi krahasimi i këtyre teksteve ka ndihmuar interpretuesit që të kuptojnë Dhiatën e Vjetër
 - a. LXX ka ndihmuar përkthyesit dhe studiuesit që të kuptojnë MT-në
 - (1) LXX, në Isa. 52:14: “ashtu si shumë do të mahnitën me të”.
 - (2) MTT, në Isa. 52:14: “ashtu si shumë u habitën me ty”.
 - (3) Në Isa. 52:15 konfirmohet dallimi përemëror i LXX
 - (a) LXX, “kështu dhe shumë kombe do të mrekullohen prej tij”
 - (b) MT, “kështu ai spërkat shumë kombe”
 - b. DSS kanë ndihmuar përkthyesit dhe studiuesit që të kuptojnë MT-në
 - (1) DSS, në Isa. 21:8: “atëherë vrojtuesi bërtiti, ‘Mbi një kullë roje po qëndroj’...”
 - (2) MT, në Isa. 21:8: “dhe unë bërtita, një luan! Zoti im, unë do të qëndroj gjithmonë në kullën e rojës ditën...”
 - c. Si LXX, ashtu dhe DSS, kanë ndihmuar për qartësimin e Isa. 53:11
 - (1) LXX & DSS, “pas mundimit të shpirtit të tij, ai do të shohë dritë dhe do të kënaqet”
 - (2) MT, “ai do të shohë... e mundimit të shpirtit të tij, do të kënaqet”

B. Dhiata e Re

1. Kanë mbijetuar mbi 5,300 dorëshkrime të gjithë Dhiatës së Re, ose të pjesëve të saj. Rreth 85 janë shkruar në papirus ndërsa 268 prej tyre janë shkruar vetëm me shkronja të mëdha (unciale). Më vonë, rreth shekullit të nëntë pas K., u zhvillua një shkrim i lidhur (minuskul). Dorëshkrimet greqisht, në formë të shkruar, numërojnë rreth 2,700. Po kështu, kemi dhe rreth 2,100 kopje me lista pasazhesh biblike që përdorëshin në adhurim, të cilat i quajmë leksionarë.
2. Rreth 85 dorëshkrime greqisht, që përmbajnë pjesë të Dhiatës së Re të shkruara në papirus, gjenden në muze. Disa datojnë nga shekulli i dytë pas K., por shumica janë nga shekujt e tretë dhe të katërt pas K. Asnjë prej këtyre MSS nuk e përmban gjithë Dhiatën e Re. Thjesht fakti se ato janë kopjet më

të lashta të Dhiatës së Re nuk do të thotë automatikisht se kanë më pak variante. Shumë prej tyre u kopjuan me shpejtësi për përdorim lokal. Nuk u ushtrua kujdes në këtë proces. Si rrjedhojë, ato përmbajnë shumë variante.

3. Kodiku Sinaitikus, i njohur me shkronjën hebraisht **א** (*alef*), ose (01), i gjetur në manastirin e shën Katerinës në malin Sinai nga Tischendorf. Daton nga shekulli i katërt pas K. dhe përmban, si LXX-në e DhV, ashtu dhe Dh.R. greqisht. Është i llojit të “tekstit aleksandrian”.
4. Kodiku Aleksandrinus, i njohur si “A”, ose (02), një dorëshkrim greqisht i shekullit të pestë, i cili u gjet në Aleksandri të Egjiptit.
5. Kodiku Vatikanus, i njohur si “B”, ose (03), i gjetur në bibliotekën e Vatikanit në Romë dhe daton nga mesi i shekullit të katërt pas K. Përmban si LXX-në e Dhiatës së Vjetër, ashtu dhe Dhiatën e Re greqisht. Është i llojit të “tekstit aleksandrian”.
6. Kodiku Ephraemi, i njohur si “C”, ose (04), një dorëshkrim greqisht i shekullit të pestë, i cili është shkatërruar pjesërisht.
7. Kodiku Bezae, i njohur si “D”, ose (05), një dorëshkrim greqisht i shekullit të pestë ose të gjashtë. Është përfaqësuesi kryesor i atij që quhet “tekst perëndimor”. Përmban shumë shtesa dhe është dëshmitari kryesor në greqisht për përkthimin e King James Version.
8. Dorëshkrimet e DhR mund të grupohen në tre, ndoshta dhe katër, familje që ndajnë disa karakteristika.
 - a. Teksti aleksandrian nga Egjipti
 - (1) P⁷⁵, P⁶⁶ (rreth 200 pas K.), që përmbajnë ungjijtë
 - (2) P⁴⁶ (rreth 225 pas K.), që përmban letrat e Palit
 - (3) P⁷² (rreth 225-250 pas K.), që përmban Pjetrin dhe Judën
 - (4) Kodiku B, i quajtur Vatikanus (rreth 325 pas K.), që përfshin gjithë DhV dhe DhR
 - (5) Origeni citon nga ky lloj teksti
 - (6) Dorëshkrime të tjera që shfaqin këtë lloj teksti janë **א**, C, L, W, 33
 - b. Teksti perëndimor nga Afrika veriore
 - (1) Citime nga etërit e kishës në Afrikën veriore, Tertuliani, Qipriani dhe përkthimi i “Vjetër Latin”
 - (2) Citime nga Ireneu
 - (3) Citime nga Tatiani dhe përkthimi “i Vjetër Siriak”
 - (4) Kodiku D, “Beza”, ndjek këtë lloj teksti
 - c. Teksti bizantin i lindjes, nga Kostandinopoja
 - (1) Ky lloj teksti reflektohet në mbi 80% të 5,300 dorëshkrimeve
 - (2) Citohet nga etërit e kishës në Antioki të Sirisë, Kapadokianët, Gojarti dhe Theodoret
 - (3) Kodiku A, vetëm në ungjijtë
 - (4) Kodiku E (shekulli i tetë) për gjithë DhR
 - d. Lloji i katërt i mundshëm është ai “cezareas”, nga Palestina
 - (1) Kryesisht, shihet vetëm te Marku
 - (2) Disa dëshmitarë të tij janë P⁴⁵ dhe W

II. Problemet dhe teoritë e “kritikës së ulët”, ose “kritikës së tekstit”.

A. Si u shfaqën variantet

1. të paqëllimshëm ose aksidentalë (shumica dërrmuese e tyre)
 - a. shkarje syri në kopjimin me dorë, ky syri lexon rastin e dytë të dy fjalëve të ngjashme dhe, në këtë mënyrë, lë pa shkruar të gjitha fjalët e ndërmjetme (homoioteleuton)
 - (1) shkarje syri, duke lënë pa shkruar një shkronjë, fjalë, ose frazë, që duhej shkruar dy herë (haplografi)
 - (2) shkarje mendjeje, duke përsëritur një frazë ose rresht të tekstit greqisht (ditografi)
 - b. shkarje veshi, që ndodhte në kopjimin me diktim gojor, ku ndodh një keqshqiptim (itacizëm). Shpesh, keqshqiptimi nënkupton ose shqipton një fjalë tjetër greqisht, që tingëllon në mënyrë të ngjashme.

- c. teksti më i hershëm greqisht nuk kishte ndarje në kapituj apo vargje, pak ose aspak pikëzim dhe asnjë ndarje mes fjalëve. Është e mundur që t'i ndash shkronjat në vende të ndryshme, duke formuar fjalë të ndryshme.
 2. të qëllimshëm
 - a. bëheshin ndryshime për të përmirësuar formën gramatikore të tekstit të kopjuar
 - b. bëheshin ndryshime për ta përpëthur një pasazh/varg me pasazhe/vargje të tjera biblike (harmonizim paralelesh)
 - c. bëheshin ndryshime duke kombinuar dy ose më tepër variante të ndryshme në një tekst të gjatë e të kombinuar (bashkëshkrim)
 - d. bëheshin ndryshime për të korrigjuar ndonjë problem të perceptuar në tekst (shih 1 Kor. 11:27 dhe 1 Gjonit 5:7-8)
 - e. disa informacione shitesë në lidhje me sfondin historik ose interpretimin e duhur të tekstit vendoseshin në anë të faqes nga njëri kopjues, ndërsa një kopjues i dytë i fuste në tekst (shih Gjoni 5:4)
 - B. Parimet bazë të kritikës së tekstit (udhërrëfytes logjike për përcaktimin e leximit origjinal të një teksti kur ekzistojnë forma variante)
 1. Teksti më i vështirë, ose më i pazakontë nga ana gramatikore, ka gjasa të jetë origjinali
 2. Teksti më i shkurtër ka gjasa të jetë origjinali
 3. Tekstit më të vjetër i jepet më tepër peshë për shkak të afërsisë së tij historike me origjinalin, në rast se gjithçka tjetër është në ekuilibër
 4. MSS që janë të larmishme nga ana gjeografike zakonisht kanë leximin origjinal
 5. Duhet preferuar tekstet më të dobët nga ana doktrinale, sidomos ato që lidhen me diskutimet kryesore teologjike të periudhës së ndryshimeve në dorëshkrime, si Trinia në 1 Gjonit 5:7-8.
 6. Teksti që arrin të shpjegojë më mirë origjinën e varianteve të tjerë
 7. Dy citime që ndihmojnë për të treguar ekuilibrin për këto variante shqetësuese
 - a. Libri i J. Harold Greenlee, *Introduction to New Testament Textual Criticism*, f. 68:

“Asnjë doktrinë e krishterë nuk varet nga një tekst i debatueshëm; dhe studiuesi i DhR duhet të ketë kujdes që të mos dëshirojë që teksti i tij të jetë më ortodoks, ose më i fortë nga ana doktrinale, sesa vetë origjinali i frymëzuar”.
 - b. W. A. Criswell i tha Greg Garrisonit të *The Birmingham News* se ai (Criswell) nuk besonte se çdo fjalë në Bibël është e frymëzuar, “të paktën jo çdo fjalë që i është dhënë publikut të sotëm nga shekuj përkthyesish”. Criswell tha: “unë jam besimtar i fortë në kritikë e tekstit. Si i tillë, unë mendoj se gjysma e fundit e kapitullit 16 të Markut është herezi: nuk është e frymëzuar, por thjesht e shpikur.... Kur e krahason me dorëshkrimet më të lashta, nuk ekziston diçka e tillë si përmbyllja e librit të Markut. Dikush e shtoi...”
- Patriarku i atyre të SBC-së që besojnë në pagabueshmërinë e Biblës pohoi gjithashtu se “ndërhyrja” është e dukshme edhe në Gjoni 5, në rrëfimin e Jezusit te pellgu i Betezdës. Po kështu, ai diskuton për dy rrëfimet e ndryshme të vetëvrastjes së Judës (shih Mat. 27 dhe Veprat 1): “Këtu kemi thjesht një pikëpamje të ndryshme të vetëvrastjes”, tha Criswell. “Nëse është në Bibël, ka një shpjegim për këtë. Dhe dy rrëfimet e vetëvrastjes së Judës janë në Bibël”. Criswell shtoi: “Kritika e tekstit është një shkencë e mrekullueshme në vetvete. Nuk është kalimtare, nuk është e pacipë. Ajo është dinamike dhe qendrore...”

III. Problemet në dorëshkrime (kritika e tekstit)

A. Burime të sugjeruara për lexim të mëtejshëm

1. *Biblical Criticism: Historical, Literary and Textual (Kritika e Biblës: historike, letrare dhe tekstuale)*, nga R. H. Harrison
2. *The Text of the New Testament: Its Transmission, Corruption, and Restoration (Teksti i Dhiatës së Re: transmetimi, shprishja dhe ndreqja e tij)*, nga Bruce M. Metzger

3. *Introduction to New Testament Textual Criticism (Hyrje në kritikën e tekstit të Dhiatës së Re)*, nga J. H. Greenlee

SHTOJCA TRE

PËRCAKTIVE TË SHKURTRA TË TERMAVE GRAMATIKORE GREQISHT

Grequishtja *koine*, shpesh e quajtur grequishtja heleniste, ishte gjuha e përbashkët e botës mesdhetare, duke filluar që nga pushtimi i Aleksandrit të Madh (336-323 para K.) dhe duke zgjatur rreth tetëqind vjet (300 para K. – 500 pas K.). Ajo nuk ishte thjesht greqishte klasike e thjeshtëzuar, por, në shumë mënyra, ishte një formë më e re e greqishtes, e cila u bë gjuha e dytë e Lindjes së mesme dhe botës mesdhetare në lashtësi.

Grequishtja e Dhiatës së Re ishte unike në shumë mënyra pasi përdoruesit e saj, përjashto Lukën dhe autorin e Hebrenjve, ndoshta përdornin aramaishten si gjuhë të parë. Si rrjedhojë, shkrimet e tyre u ndikuan nga idiomat dhe format strukturore të aramaishtes. Po kështu, ata lexonin dhe citonin Septuagintën (përkthimin greqisht të DhV), e cila ishte shkruar gjithashtu në greqishten *koine*. Mirëpo edhe Septuaginta ishte shkruar nga studiues judenj, gjuha amtare e të cilëve nuk ishte greqisht.

Kjo na shërben si kujtesë se nuk mund ta futim forcërisht Dhiatën e Re brenda një strukture të ngushtë gramatikore. Ajo është unike, por, megjithatë, ka shumë të përbashkëta me (1) Septuagintën; (2) shkrimet judaike si ato të Jozefit; dhe (3) papiruset e gjetura në Egjipt. Po atëherë, si duhet t'i qasemi analizës gramatikore të Dhiatës së Re?

Tiparet gramatikore të greqishtes *koine* dhe greqishtes *koine* të Dhiatës së Re janë të paqëndrueshme. Në shumë mënyra, bëhet fjalë për një periudhë thjeshtëzimi të gramatikës. Si udhërrëfyes kryesor do të kemi kontekstin. Fjalët kanë kuptim vetëm në një kontekst më të gjerë, prandaj, struktura gramatikore mund të kuptohet vetëm në dritën e (1) stilit individual të autorit; dhe (2) kontekstit të veçantë. Asnjë përcaktim përfundimtar i formave dhe strukturave greke nuk është i mundshëm.

Grequishtja *koine* ishte kryesisht një gjuhë foljore. Shpesh, çelësi drejt interpretimit është lloji dhe forma e trajtave FOLJORE. Në shumicën e rasteve, FOLJA shfaqet e para, duke treguar epërsinë e saj. Në analizën e FOLJES greke, duhen vërejtur tre pjesë informacioni: (1) theksimi bazë i KOHËS, DIATEZËS dhe MËNYRËS (eptimi, ose morfologjia); (2) kuptimi bazë i FOLJES (leksikografia); dhe (3) rrjedha e kontekstit (sintaksa).

I. KOHA

- A. Koha ose aspekti ka të bëjë me marrëdhënien e FOLJEVE me veprimin e përfunduar ose të papërfunduar. Shpesh, ai quhet “I KRYER”, ose “I PAKRYER”.
1. KOHËT E KRYERA përqendrohen te kryerja e një veprimi. Asnjë informacion i mëtejshëm nuk jepet përveç faktit se diçka ka ndodhur! Nuk trajtohet fillimi, vazhdimi, apo kulmimi i veprimit.
 2. KOHËT E PAKRYERA përqendrohen te procesi i vazhduar i një veprimi. Mund të përshkruhet në kuadër të veprimit linear, veprimit durativ, veprimit progresiv, etj.
- B. Kohët mund të kategorizohen sipas mënyrës sesi autori sheh përparimin e veprimit
1. Ndodhi = AORIST
 2. Ndodhi, dhe rezultatet vazhdojnë = E KRYER
 3. Po ndodhte në të kaluarën dhe rezultatet po vazhdonin, por jo tani = E KRYER E TEJSHKUAR
 4. Po ndodh = E TASHME
 5. Po ndodhte = E PAKRYER
 6. Do të ndodhë = E ARDHME
- Një shembull konkret sesi ndihmojnë këto KOHË në interpretim do të ishte fjala “shpëtoj”. Ajo përdoret në disa kontekste të ndryshme për të treguar, si procesin, ashtu dhe kulmimin e tij:
1. AORISTI = “shpëtoi” (shih Rom. 8:24)
 2. E KRYER = “jemi shpëtuar dhe rezultati vazhdon” (shih Efe. 2:5, 8)
 3. E TASHME = “po shpëtohem” (shih 1 Kor. 1:18; 15:2)
 4. E ARDHME = “do të shpëtohem” (shih Rom. 5:9; 10: 9)
- C. Kur përqendrohet te KOHËT E FOLJES, interpretuesi kërkon arsyen pse autori fillestar zgjodhi të shprehej në një KOHË të caktuar. Koha standarde, “pa lajlelule”, ishte AORISTI. Kjo ishte forma e rregullt FOLJORE “e paspecifikuar”, “e paklasifikuar”, ose “e pashënuar”. Ajo mund të përdoret në një

larmi të madhe mënyrash, të cilat duhet t'i qartësojë konteksti. Kjo kohë thjesht pohon se diçka ka ndodhur. Aspekti i kohës së shkuar përdoret vetëm në MËNYRËN DËFTORE. Nëse përdoret një KOHË tjetër, po theksohej diçka më e veçantë. Por çfarë?

1. KOHA E KRYER. Bën fjalë për një veprim të përfunduar, por me rezultate që vazhdojnë. Në disa mënyra, ky ishte një kombinim i KOHËS AORISTE me atë TË TASHME. Zakonisht, fokusi është te rezultatet e vazhdueshme, ose te plotësimi i një veprimi (shembull: Efe. 2:5 dhe 8: “ju jeni shpëtuar dhe po vazhdoni të shpëtoheni”).
2. KOHA E KRYER E TEJSHKUAR. Kjo ishte si E KRYERA, përveçse këtu rezultatet e vazhduara kanë përfunduar. Për shembull: Gjoni 18:16, “Pjetri kishte qëndruar përjashta te porta”.
3. KOHA E TASHME. Flet për një veprim të papërfunduar ose të pakryer. Zakonisht, fokusi është te vazhdimi i ngjarjes. Shembull: 1 Gjoni 3:6 dhe 9, “Kushdo që banon në të nuk vazhdon të mëkatojë”. “Kushdo që është lindur nga Perëndia nuk vazhdon të kryejë mëkat”.
4. KOHA E PAKRYER. Në këtë kohë, marrëdhënia me KOHËN E TASHME është e ngjashme me marrëdhënien mes TË KRYERËS dhe TË KRYERËS SË TEJSHKUAR. E PAKRYERA flet për një veprim të paplotë që po ndodhte por që, tani, ka përfunduar, ose për fillimin e një veprimi në të shkuarën. Shembull: Mateu 3:5, “atëherë gjithë Jerusalemi po vazhdonte të shkonte tek ai”, ose, “atëherë, gjithë Jerusalemi filloi të shkonte tek ai”.
5. KOHA E ARDHME. Bën fjalë për një veprim që, zakonisht, vendoset në një kornizë kohore në të ardhmen. Fokusohej te mundësia e një ndodhie, sesa te një ndodhi aktuale. Shpesh, flet për sigurinë e ngjarjes. Shembull: Mat. 5:4-9, “Të bekuar janë... Ata do të...”.

II. DIATEZA

- A. DIATEZA përshkruan marrëdhënien mes veprimit të FOLJES dhe KRYEFJALËS së saj.
- B. DIATEZA VEPRORE ishte mënyra normale, e pritshme dhe e patheksuar për të pohuar se kryefjala po kryente veprimin e FOLJES.
- C. DIATEZA PËSORE do të thotë se kryefjala po merrte veprimin e FOLJES të kryer nga një veprues i jashtëm. Vepruesi i jashtëm që kryente veprimin tregohet në DhR greqisht me anë të këtyre PARAFJALËVE dhe rasave:
 1. Një veprues personal i drejtpërdrejtë, nga *hupo* me RASËN RRJEDHORE (shih Mat. 1:22; Veprat 22:30).
 2. Një veprues personal i ndërmjetëm, nga *dia* me RASËN RRJEDHORE (shih Mat. 1:22).
 3. Një veprues jopersonal, zakonisht nga *en* me RASËN MJETORE.
 4. Nganjëherë, një veprues personal ose jopersonal, vetëm me anë të RASËS MJETORE.
- D. DIATEZA MESORE tregon se kryefjala prodhon veprimin e FOLJES dhe, gjithashtu, është e përfshirë drejtpërdrejt në veprimin e FOLJES. Shpesh, ajo quhet diateza e interesit të shtuar vetjak. Ky konstrukt theksonte në njëfarë mënyre kryefjalën e fjalisë ose periudhës. Ky konstrukt nuk gjendet në anglisht. Ka një mundësi të gjerë kuptimesh dhe përkthimesh në greqisht. Disa shembuj të kësaj forme janë:
 1. VETVETORE – veprimi i drejtpërdrejtë i kryefjalës mbi veten. Shembull: Mat. 27:5: “vari veten”.
 2. INTENSIVE – kryefjala e kryen veprimin për vete. Shembull: 2 Kor. 11:14: “vetë Satani e maskon veten si engjëll drite”.
 3. E NDËRSJELLË – veprimi i ndërsjellë i dy vepruese. Shembull: Mat. 26:4: “ata këshillonin njëri-tjetrin”.

III. MËNYRA (ose “MODALITETI”)

- A. Greqishtja *koine* ka katër MËNYRA. Ato tregojnë marrëdhënien e FOLJES me realitetin, të paktën në mendjen e autorit. MËNYRAT ndahen në dy kategori të përgjithshme: ajo që tregonte realitetin (DËFTORE) dhe ajo që tregonte mundësinë (LIDHORE, URDHËRORE dhe DËSHIRORE).

- B. MËNYRA DËFTORE ishte forma normale për të shprehur një veprim që kishte ndodhur ose që po ndodhte, të paktën në mendjen e autorit. Ishte e vetmja mënyrë greqisht që shprehte një kohë të përcaktuar, ndonëse edhe këtu ky aspekt ishte dytësor.
- C. MËNYRA LIDHORE shprehte veprim të ardhshëm të mundshëm. Diçka nuk kishte ndodhur ende, por kishte mundësi që të ndodhte. Kishte shumë të përbashkëta me DËFTOREN E ARDHME. Dallimi ishte se LIDHORJA shpreh njëfarë mase dyshimi. Shpesh, në anglisht, shprehet me termat “mund të”, “do të”, “mund”.
- D. MËNYRA DËSHIRORE shprehte një dëshire që ishte teorikisht e mundshme. Konsiderohej si një hap më larg realitetit nga LIDHORJA. DËSHIRORJA shprehte mundësi në disa kushte të caktuara. DËSHIRORJA është e rrallë në Dhiatën e Re. Përdorimi i saj më i shpeshtë është në frazën e famshme të Palit, “Kurrë mos qoftë!” (KJV, “Mos e dhëntë Zoti”), e përdorur pesëmbëdhjetë herë (shih Rom. 3:4, 6, 31; 6:2, 15; 7:7, 13; 9:14; 11:1, 11; 1 Kor. 6:15; Gal. 2:17; 3:21; 6:14). Shembuj të tjerë gjenden te Luka 1:38; 20:16; Veprat 8:20; dhe 1 Thes. 3:11.
- E. MËNYRA URDHËRORE theksonte një urdhër që ishte i mundshëm, por theksin e vinte te synimi i folësit. Ajo theksonte vetëm një mundësi dëshirore dhe kushtëzohej nga zgjedhjet e tjetrit. URDHËRORJA përdorej në mënyrë të veçantë në lutjet dhe në kërkesat e vetës së tretë. Këto urdhra gjenden vetëm në KOHËN E TASHME dhe atë AORISTE në DhR.
- F. Disa gramatika kategorizojnë edhe PJESORET si një tjetër lloj MËNYRE. Ato janë shumë të zakonshme në DhR greqisht, dhe zakonisht përcaktohen si MBIEMRA FOLJORË. Ato përkthehen në lidhje me FOLJEN kryesoren me të cilën kanë të bëjnë. Ekzistonte një larmi e madhe mundësish për përkthimin e PJESOREVE. Gjëja më e mirë është të konsultosh disa përkthime të Biblës në anglisht. *The Bible in Twenty Six Translations (Bibla në 26 përkthime)*, e botuar nga Baker, është shumë e dobishme në këtë pikë.
- G. DËFTORJA AORISTE VEPRORE ishte mënyra normale, ose “e paklasifikuar”, për të shënuar një veprim. Çdo KOHË, DIATEZË, ose MËNYRË tjetër kishte një domethënie të veçantë interpretuese që dëshironte të komunikonte autori fillestar.
- IV. Për ata që nuk e njohin greqishtes, ndihmat e mëposhtme studimore do t’u sigurojnë informacionet e nevojshme:
- A. Friberg, Barbara dhe Timothy. *Analytical Greek New Testament (Dhiata e Re analitike në greqisht)*. Grand Rapids: Baker, 1988.
- B. Marshall, Alfred. *Interlinear Greek-English New Testament (Dhiata e Re ndërlineare greqisht-anglisht)*. Grand Rapids: Zondervan, 1976.
- C. Mounce, William D. *The Analytical Lexicon to the Greek New Testament (Leksiku analitik i Dhiatës së Re greqisht)*. Grand Rapids: Zondervan, 1993.
- D. Summers, Ray. *Essentials of New Testament Greek (Elementet bazë të greqishtes së Dhiatës së Re)*. Nashville: Broadman, 1950.
- E. Kurse greqishteje *koine* me korrespondence, të akredituar nga ana akademike, janë të disponueshme përmes Institutit Biblik Moody në Çikago, Illinois

V. EMRAT

- A. Nga ana sintaksore, EMRAT klasifikohen sipas RASËS. RASA ishte forma e eptuar e EMRIT, që tregonte marrëdhënien e tij me FOLJEN dhe me pjesë të tjera të fjalisë. Në greqishten *koine*, shumë prej funksioneve të RASËS tregoheshin nga PARAFJALËT. Meqë forma e RASËS ishte në gjendje të identifikonte një sërë marrëdhëniesh të ndryshme, u zhvilluan PARAFJALËT për t'u dhënë një ndarje më të qartë këtyre funksioneve të mundshme.
- B. RASAT greke kategorizoheshin në tetë mënyrat e mëposhtme:
1. RASA EMËRORE përdorej për të emërtuar dhe, zakonisht, ishte KRYEFJALA e fjalisë ose periudhës. Po kështu, përdorej edhe për EMRAT KALLZUESORË dhe MBIEMRAT me FOLJET lidhëse “jam” ose “bëhem”.
 2. RASA GJINORE përdorej për përshkrim dhe, zakonisht, i caktonte një cilësi ose sasi fjalës me të cilën lidhej. I përgjigjej pyetjes, “Çfarë lloji?” Shpesh, shprehet me përdorimin e PARAFJALËS “i/e [dikujt]”.
 3. RASA RRJEDHORE përdoret të njëjtën formë të eptuar si GJINORJA, por përdoret për të përshkruar ndarje. Zakonisht, shënonte ndarje nga një pikë në kohë, hapësirë, burim, origjinë ose shkallë. Shpesh, shprehej me përdorimin e PARAFJALËS “nga/prej”.
 4. RASA DHANORE përdorej për të përshkruar interes vetjak. Mund të shënonte një aspekt pozitiv, ose negativ. Shpesh, ajo ishte KUNDRINORI I ZHDREJTË. Shpesh, në anglisht shprehet me PARAFJALËN “to”.
 5. RASA VENDORE kishte të njëjtën formë të eptuar si DHANORJA, por përshkruante pozicionin ose vendndodhjen në hapësirë, kohë, ose kufij logjikë. Shpesh, shprehet me PARAFJALËT “në, mbi, mes, gjatë, me anë të, përbri”.
 6. RASA MJETORE kishte të njëjtën formë të eptuar si DHANORJA dhe VENDORJA. Shprehte mjete ose shoqërime. Shpesh, shprehet me PARAFJALËT “nga” ose “me”.
 7. RASA KALLËZORE përdorej për të përshkruar përfundimin e një veprimi. Shprehte kufizim. Kryesisht, përdorej për KUNDRINORIN E DREJTË. I përgjigjej pyetjes, “Sa larg?”, ose “Deri në çfarë mase?”
 8. RASA THIRRORE përdorej për thirrjen e drejtpërdrejtë.

VI. LIDHËZAT DHE LIDHËSET

- A. Greqishtja është gjuhë shumë precize, për shkak se ka një numër shumë të madh fjalësh lidhëse. Ato lidhin mendimet (PERIUDHAT, FJALITË dhe PARAGRAFËT). Janë kaq të zakonshme saqë, shpesh, mungesa (asindetit) e tyre ka rëndësi nga ana ekzegjetike. Në fakt, këto LIDHËZA dhe LIDHËSE tregojnë drejtimin e mendimit të autorit. Shpesh, kanë rol kyç në përcaktimin e saktë të asaj që po përpiqet të përçojë ai.
- B. Ja një listë me disa prej LIDHËZAVE dhe LIDHËSEVE, si dhe kuptimet e tyre (ky informacion është qëmtuar kryesisht nga libri i H. E. Dana dhe Julius K. Mantey, *A Manual Grammar of the Greek New Testament [Gramatikë praktike e Dhiatës së Re greqisht]*).
1. Fjalët lidhëse kohore
 - a. *epei, epeidē, hopote, hōs, hote, hotan* (LIDH.) – “kur”
 - b. *heōs* – “ndërsa”
 - c. *hotan, epan* (LIDH.) – “kurdo”
 - d. *heōs, achri, mechri* (LIDH.) – “derisa”
 - e. *prin* (PASK.) – “përpara”
 - f. *hōs* – “që kur”, “kur”, “ndërsa”
 2. LIDHËZA logjikë
 - a. Qëllim
 - (1) *hina* (LIDH.), *hopōs* (LIDH.), *hōs* – “me qëllim që”, “që”
 - (2) *hōste* (PASKAJORE KALLËZORE NYJORE) – “që”

- (3) *pros* (PASKAJORE KALLËZORE NYJORE) ose *eis* (PASKAJORE KALLËZORE NYJORE) – “që”
- b. Rezultat
- (1) *hōste* (PASKAJORE, kjo është më e përhapura) – “me qëllim që”, “kështu”
 - (2) *hina* (LIDH.) – “në mënyrë që”
 - (3) *ara* – “kështu”
- c. Shkakore, ose arsye
- (1) *gar* (shkak/efekt, ose arsye/përfundim) – “sepse,” “pasi”
 - (2) *dioti, hoti* – “sepse”
 - (3) *epei, epeidē, hōs* – “meqë”
 - (4) *dia* (me kallëzore) dhe (me pask. nyjore) – “për shkak”
- d. Rrjedhimore
- (1) *ara, poinun, hōste* – “prandaj”
 - (2) *dio* (LIDHËZA më e fortë rrjedhimore) – “për shkak të kësaj”, “si rrjedhojë”, “prandaj”
 - (3) *oun* – “prandaj”, “kështu”, “atëherë”, “rrjedhimisht”
 - (4) *toinoun* – “në këtë mënyrë”
- e. Kundërshtore, ose kontrast
- (1) *alla* (KUNDËRSHTORE e fortë) – “por”, “përveç”
 - (2) *de* – “por”, “megjithatë”, “gjithsesi”, “nga ana tjetër”
 - (3) *kai* – “por”
 - (4) *mentoi, oun* – “sidoqoftë”
 - (5) *plēn* – “gjithsesi” (kryesisht te Luka)
 - (6) *oun* – “megjithatë”
- f. Krahasim
- (1) *hōs, kathōs* (prezanton FJALITË KRAHASUESE)
 - (2) *kata* (në fjalë të përbëra, *katho, kathoti, kathōsper, kathaper*)
 - (3) *hosos* (te Hebrenjve)
 - (4) *ē* – “sesa”
- g. Vazhduese, ose seri
- (1) *de* - “dhe”, “tani”
 - (2) *kai* – “dhe”
 - (3) *te* – “dhe”
 - (4) *hina, oun* – “që”
 - (5) *oun* – “atëherë” (te Gjoni)
3. Përdorimet theksuese
- a. *alla* – “sigurisht”, “po”, “madje”
 - b. *ara* – “me të vërtetë”, “sigurisht”, “vërtet”
 - c. *gar* – “por me të vërtetë”, “sigurisht”, “vërtet”
 - d. *de* – “me të vërtetë”
 - e. *ean* – “madje”
 - f. *kai* – “madje”, “me të vërtetë”, “vërtet”
 - g. *mentoi* – “me të vërtetë”
 - h. *oun* – “vërtetë”, “patjetër”

VII. PERIUDHA KUSHTORE

- A. PERIUDHA KUSHTORE është ajo që përmban një ose më tepër fjali të varura kushtore. Kjo strukturë gramatikore i vjen në ndihmë interpretimit për shkak se jep kushtet, arsyet, ose shkaqet pse ndodh ose pse nuk ndodh veprimi i FOLJES kryesore. Ka katër lloje PERIUDHASH KUSHTORE. Ato variojnë nga ajo që supozohet si e vërtetë nga pikëvështrimi i autorit (ose për synimet e tij) tek ajo që është vetëm dëshirë.
- B. PERIUDHA KUSHTORE E KLASIT TË PARË shprehte veprim ose qenie që supozohej si e vërtetë nga pikëvështrimi i shkrimtarit (ose për synimet e tij), ndonëse shprehej me “nëse”. Në një sërë kontekstesh, mund të përkthehet “meqë” (shih Mat. 4:3; Rom. 8:31). Sidoqoftë, me këtë nuk nënkuptojmë se të gjitha

KLASET E PARË përrputhen me realitetin. Shpesh, ato përdoren për të vërtetuar një argument ose për të theksuar një ide të gabuar (shih Mat. 12:27).

- C. PERIUDHA KUSHTORE E KLASIT TË DYTË shpesh quhet “kundër fakteve”. Ajo shpreh diçka që ishte e pavërtetë ndaj realitetit, në mënyrë që të argumentonte diçka. Shembuj:
1. “Po të ishte vërtet profet, dhe nuk është i tillë, do të dinte se kush dhe ç’karakter është kjo gruaja që po varet tek ai, por ja që nuk e di” (Luka 7:39)
 2. “Po t’i kishit besuar vërtet Moisiut, por ju nuk i besoni, do të besonit edhe në mua, por ja që nuk po e bëni” (Gjoni 5:46)
 3. “Po të përpiquesha ende që të kënaqja njerëzit, gjë që nuk po e bëj, nuk do të isha aspak skllav i Krishtit, por ja që jam i tillë” (Gal. 1:10).
- D. KLASI I TRETË bën fjalë për një veprim të mundshëm në të ardhmen. Shpesh, supozon probabilitetin e veprimit. Zakonisht, nënkupton kushtëzim nga rrethanat. Veprimi i FOLJES kryesore varet nga veprimi në fjalinë e varur që fillon me “nëse”. Shembuj nga 1 Gjoni: 1:6-10; 2:4, 6, 9, 15, 20, 21, 24, 29; 3:21; 4:20; 5:14, 16.
- E. KLASI I KATËRT është më i largëti për sa i përket mundësisë. Është i rrallë në DhR. Në të vërtetë, nuk ekziston asnjë PERIUDHË e plotë KUSHTORE E KLASIT TË KATËRT, ku të dyja pjesët e kushtit të përrputhen me këtë përcaktim. Një shembull i KLASIT TË KATËRT të pjesshëm në fjalinë hapëse është 1 Pje. 3:14. Një shembull i KLASIT TË KATËRT të pjesshëm në fjalinë përrbyllëse është Veprat 8:31.

VIII. NDALIMET

- A. URDHËRORJA E TASHME me PJESËZËN MË shpesh (por jo ekskluzivisht) thekson ndalimin e një veprimi që është tashmë në kryerje e sipër. Disa shembuj: “mos mblidhni më pasuri në tokë...” (Mat. 6:19); “mos u shqetësoni më për jetën tuaj...” (Mat. 6:25); “mos i ofroni më mëkatit gjymtyrët e trupit tuaj si mjete keqbërje...” (Rom. 6:13); “duhet të ndalni së fyeri Frymën e Shenjtë të Perëndisë...” (Efe. 4:30); dhe “ndalni së u dehuri me verë...” (5:18).
- B. LIDHORJA AORISTE me PJESËZËN MË ka këtë theks: “as mos fillo apo nis të bësh një veprim”. Disa shembuj: “As mos fillo të mendosh se...” (Mat. 5:17); “kurrë mos fillo të shqetësohesh...” (Mat. 6:31); “kurrë s’duhet të kesh turp...” (2 Tim. 1:8).
- C. MOHORJA E DYFISHTË me MËNYRËN LIDHORE përbën një mohim shumë të theksuar. “Kurrën e kurrës”, ose “në asnjë lloj rrethane”. Disa shembuj: “Ai nuk do të përjetojë kurrën e kurrës vdekje” (Gjoni 8:51); “Unë, kurrën e kurrës, nuk...” (1 Kor. 8:13).

IX. NYJA SHQUESE

- A. Në greqishten *koine*, NYJA SHQUESE kishte një përdorim të ngjashëm me një shquese “*the*” në anglisht. Funkzioni bazë i saj ishte të shërbente si “dëftues”, si mënyrë për të tërhequr vëmendjen ndaj një fjale, emri, ose fraze. Përdorimi i saj ndryshon nga njëri autor në tjetrin në Dhiatën e Re. NYJA SHQUESE mund të funksionojë edhe si
1. mjet ballafaques, si PËREMËR dëftor;
 2. shenjë për t’iu referuar një teme ose personi të prezantuar më herët;
 3. mënyrë për të identifikuar KRYEFJALËN në fjali me një FOLJE lidhëse. Shembuj: “Perëndia është Frymë” (Gjoni 4:24); “Perëndia është dritë” (1 Gjoni 1:5); “Perëndia është dashuri” (4:8, 16).
- B. Greqishtja *koine* nuk kishte NYJË JOSHQUESE si në anglisht, “a” ose “an”. Mungesa e NYJËS SHQUESE mund të nënkuptonte
1. Një përqendrim te karakteristikat ose cilësitë e diçkaje

2. Një fokus në kategorinë e diçkaje

C. Autorët e DhR ndryshonin së tepërmi nga njëri-tjetri për mënyrën si e përdornin NYJËN.

X. MËNYRA PËR TË TREGUAR THEKSIMIN NË DHIATËN E RE GREQISHT

A. Teknikat për të treguar theksimin ndryshojnë nga njëri autor në tjetrin në Dhiatën e Re. Shkrimtarët më të njëtrajtshëm dhe më formalë ishin Luka dhe autori i Hebrenjve.

B. Më herët, pohuam se DËFTORJA AORISTE VEPRORË ishte standarde dhe e paklasifikuar për theksim, por çdo KOHË, DIATEZË, ose MËNYRË tjetër kishte domethënie nga ana interpretuese. Me këtë nuk po themi se DËFTORJA AORISTE VEPRORË nuk përdorej shpesh në një kuptim gramatikor domethënës. (Shembull: Rom. 6:10 [dy herë]).

C. Rendi i fjalëve në greqishten *koine*

1. Greqishtja *koine* ishte një gjuhë e eptuar që, në dallim nga anglishtja, nuk varej nga rendi i fjalëve. Si rrjedhojë, autori mund ta ndryshojë rendin e pritsëm dhe normal të fjalëve për të treguar

- a. atë që autori donte t'i theksonte lexuesit
- b. atë që autori mendonte se do të ishte e papritur për lexuesin
- c. atë që autori e kishte shumë për zemër

2. Rendi normal i fjalëve në greqisht është ende një çështje e pazgjidhur. Megjithatë, rendi i supozuar normal është ky:

- a. për FOLJET lidhëse
 - (1) FOLJE
 - (2) KRYEFJALË
 - (3) PLOTËS
- b. për FOLJET KALIMTARE
 - (1) FOLJE
 - (2) KRYEFJALË
 - (3) KUNDRINOR
 - (4) KUNDRINOR I ZHDREJTË
 - (5) FRAZË PARAFJALORE
- c. për FRAZAT EMËRORE
 - (1) EMËR
 - (2) PËRCAKTOR
 - (3) FRAZË PARAFJALORE

3. Rendi i fjalëve mund të jetë një pikë jashtëzakonisht e rëndësishme ekzegjetike. Shembuj:

- a. “dorën e djathtë na dhanë mua dhe Barnabës për miqësi”. Fraza “dora e djathtë e miqësisë” ndahet dhe është vendosur në krye për të treguar domethënien e vet (Gal. 2:9).
- b. “me Krishtin” vendoset në fillim. Vdekja e tij ishte qendrore (Gal. 2:20).
- c. “ishte pjesë-pjesë dhe në shumë mënyra të ndryshme” (Heb. 1:1) vendoset në fillim. Kontrasti që po jepet është mënyra sesi Perëndia e zbuloi veten, jo fakti i zbulësës.

D. Zakonisht, njëfarë shkalle theksimi tregohet nga

1. Përsëritja e PËREMËRIT që ishte tashmë i pranishëm në formën e eptuar të FOLJES. Shembull: “unë, vetë, do të jem patjetër me ju...” (Mat. 28:20).
2. Mungesa e një LIDHËZE të pritshme, ose ndonjë tjetër mjeti lidhës mes fjalëve, frazave, fjalive, ose periudhave. Kjo gjë quhet asindet (“jo e lidhur”). Mjeti lidhës pritej, prandaj mungesa e tij tërhiqte vëmendje. Shembuj:
 - a. “Lum”-et në Mal, Mat. 5:3 e më tej (e theksoi listën)
 - b. Gjoni 14:1 (temë e re)
 - c. Romakëve 9:1 (pjesë e re)
 - d. 2 Kor. 12:20 (thekson listën)

3. Përsëritja e fjalëve ose frazave të pranishme në një kontekst të dhënë. Shembuj: “për lëvdimin e lavdisë së tij” (Efe. 1:6, 12 & 14). Kjo frazë përdoret për të treguar veprën e secilit person të Trinisë.
4. Përdorimi i një idiome ose loje fjalësh (tingujsh) mes termave
 - a. eufemizmat – zëvendësim fjalësh për disa tema tabu, si “gjumi” për vdekjen (Gjoni 11:11-14), ose “këmbët” për gjenitalet mashkullore (Ruthi 3:7-8; 1 Sam. 24:3).
 - b. perifrazimet – zëvendësim fjalësh për emrin e Perëndisë, si “Mbretëria e qiejve” (Mat. 3:21), ose “një zë nga qielli” (Mat. 3:17).
 - c. FIGURAT LETRARE
 - (1) ekzagjerime të pamundura (Mat. 3:9; 5:29-30; 19:24)
 - (2) pohime disi të tepruara (Mat. 3:5; Veprat 2:36)
 - (3) personifikime (1 Kor. 15:55)
 - (4) ironi (Gal. 5:12)
 - (5) pasazhe poetike (Fil. 2:6-11)
 - (6) lojë tingujsh mes fjalëve
 - (a) “kisha”
 - i. “kisha” (Efe. 3:21)
 - ii. “thirtja” (Efe. 4:1, 4)
 - iii. “i thirrur” (Efe. 4:1, 4)
 - (b) “i lirë”
 - i. “grua e lirë” (Gal. 4:31)
 - ii. “liri” (Gal. 5:1)
 - iii. “i lirë” (Gal. 5:1)
 - d. gjuha idiomatike – terminologji që, zakonisht, është e veçantë për kulturat dhe gjuhët e ndryshme:
 - (1) përdorimi figurativ i fjalës “ushqim” (Gjoni 4:31-34)
 - (2) përdorimi figurativ i fjalës “tempull” (Gjoni 2:19; Mat. 26:61)
 - (3) idioma hebraike për termin dhembshuri, “urrej” (Zan. 29:31; LiP. 21:15; Luka 14:36; Gjoni 12:25; Rom. 9:13)
 - (4) “Të gjithë” përkundër “shumë”-ve. Krahaso Isa. 53:6 (“të gjithë”) me 53:11 & 12 (“shumë”). Këta terma janë sinonimikë, siç e tregojnë dhe Rom. 5:18 dhe 19.
5. Përdorimi i një fraze të plotë gjuhësore, në vend të një fjale të vetme. Shembull: “Zoti Jezu Krisht”.
6. Përdorimi i veçantë i *autos*
 - a. kur ka NYJË (pozicioni atributiv), përkthehej “i njëjti”.
 - b. kur s’ka NYJË (pozicioni kallëzuesor), përkthehej si PËREMËR VETVETOR INTENSIV – “veten e tij”, “veten e saj”.

E. Studiuesi i Biblës që nuk di greqisht mund ta identifikojë theksimin në mënyra të ndryshme:

1. Përdorimi i një leksiku analitik dhe i një teksti ndërlinear greqisht/anglisht.
2. Krahasimi i përkthimeve në gjuhën angleze, sidomos ato përkthime që kanë teori të ndryshme përkthimi. Shembull: krahasimi i një përkthimi “fjalë për fjalë” (KJV, NKJV, ASV, NASB, RSV, NRSV) me një përkthim të “ekuivalencës dinamike” (Williams, NIV, NEB, REB, JB, NJB, TEV). Ndhimë e dobishme këtu do të ishte *The Bible in Twenty-Six Translations*, përkthyer nga Baker.
3. Përdorimi i *The Emphasized Bible (Bibla e theksuar)*, nga Joseph Bryant Rotherham (Kregel, 1994).
4. Përdorimi i një përkthimi shumë të fjalëpërfjalshëm
 - a. *The American Standard Version* i vitit 1901
 - b. *Young’s Literal Translation of the Bible*, nga Robert Young (Guardian Press, 1976).

Studimi i gramatikës është i mërztishëm, por i domosdoshëm për interpretimin e saktë. Këto përcaktime të shkurtra, komente dhe shembuj synojnë të inkurajojnë dhe të pajisin personat që nuk dinë greqisht që të përdorin shënimet gramatikore të dhëna në këtë vëllim. Pa dyshim, këto përcaktime janë të mbithjeshtëzuara. Ato nuk duhen përdorur në mënyrë dogmatike dhe të pandryshueshme, por si trampolina drejt të kuptuarit më të mirë të sintaksës së Dhiatës së Re. Shpresoj se këto përcaktime do t’u mundësojnë lexuesve edhe që të kuptojnë komentet e ndihmave të tjera studimore, si komentaret teknikë për Dhiatën e Re.

Duhet të jemi në gjendje që interpretimin tonë ta verifikojmë në bazë të informacionit që gjendet në tekstin e Biblës. Gramatika është një nga pjesët më të dobishme të këtij informacioni; elementet e tjera përfshijnë sfondin historik, kontekstin letrar, përdorimin bashkëkohor të fjalëve, dhe pasazhet paralele.